

RAPORT 2 I GJENDJES 0 NE MJEDIS 2 3



TIRANË 2024



Co-funded by
the European Union



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Ky material është përgatitur për botim në kuadër të projektit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e BE apo BMZ.

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS

2023

Përgatitur dhe publikuar nga:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Përmbajtja

HYRJE	7
GJETJET KRYESORE	8
KAPITULLI 1 AJRI	9
KAPITULLI 2 NDRYSHIMET KLIMATIKE	32
KAPITULLI 3 MJEDISI BREGDETAR	59
KAPITULLI 4 UJËRAT	99
KAPITULLI 5 ZHURMAT	153
KAPITULLI 6 TOKA	167
KAPITULLI 7 PYJET DHE BIODIVERSITETI	183
KAPITULLI 8 MENAXHIMI I MBETJEVE	219
KAPITULLI 9 KIMIKATET	235
KAPITULLI 10 PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE	245
KAPITULLI 11 AKTIVITETET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	253
PËRMBLEDHJE	263
ANEKS 1 RRJETET E MONITORIMIT NË PYJE	276
INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE	282

Shkurtime

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
ASHR	Autoriteti Rajonal Shëndetësor
AEM	Agjencia Europiane e Mjedisit
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
BE	Bashkimi Evropian
BTEX	Benzen Toluen, Etilbenzen, meta-para Ksilen
CORINAIR	Core Inventory of Air Emission/Inventari kryesor i emetimeve në ajër
CBRN	Chemical, Biological, Radiological, Nuclear
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
EC	European Commission
EEA	European Environment Agency
EMEP	European Monitoring Evaluation Programme
Fp	Fortësi e Përgjithshme
HEC	Hydro Energy Central (Hidrocentral)
HCB	Hekzaklorobenzen
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial
IKPK	Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
IPA	Instrumenta të Para-Aderimit
KE	Komisioni Evropian
KEMI	Agjencia Suedeze e Kimikateve
KKBNK	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
Mp	Mineralizim i Përgjithshëm
Mth	Mbetje e thatë
NMVOG	Non Metan Volatile Organic Compound/Komponime organike të avullueshme pa metan
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen

NBO5	Nevoja Biokimike për Oksigjen 5 ditore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKBZHI	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial
PNG	Potenciale të Ngrohjes Globale
PML	Përmbajtja Maksimale e Lejuar
PRTR	Pollutant Release and Transfer Register/ Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
PCB	Poliklorurbifenile
PAH	Hidrokarbure aromatike policiklike
PIPP	Proçeset Industriale dhe Përdorimi i Produkteve
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PTNPTP	Përdorimi i Tokës dhe Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjet
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
PK	Park Kombëtar
RDP	Raporti i Dytë i Përditësuar
RNM	Rezervat Natyror i Mbrojtur
SVHC	Substances of Very High Concern/ Substanca me rrezikshmëri shumë të lartë
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
TSIC	Trophic State Index, Carlson/ Indeksi i gjendjes trofike Karlson
TID	Total Indicates Dose/Doza totale e treguar
TEC-	Termo Energy Central (Termocentral energjetik)
UN	Ujëra Nëntokësore
UNEP	United Nations Environment Program/ Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WHO	World Health Organization/Organizata Botërore e Shëndetësisë

HYRJE



Shqipëria është e bekuar me një mjedis natyror të bukur, unik dhe të larmishëm. Kjo është arsyeja pse një numër i madh turistësh vizitojnë çdo vit bukuritë natyrore të vendit tonë.

Por ky mjedis nuk është gjithmonë perfekt, kjo është arsyeja pse ne duhet të punojmë shumë për ta mbrojtur atë, sepse ne duam t'ju lemë brezave teardhshëm një mjedis të pastër.

Raporti i Gjendjes së Mjedisit i cili hartohet çdo vit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, është një dokument që ofron një panoramë të situatës aktuale mjedisore dhe mbulon aspekte të ndryshme të mjedisit si klimën, ajrin, tokën, ujin, zhurmat etj.

Treguesit mjedisorë të përdorur për hartimin e raportit bazohen kryesisht nga monitorimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe nga informacionet dhe të dhënat e siguruar nga institucione të tjera publike, kërkimore dhe monitoruese në nivel kombëtar.

Ky raport mbulon disa fusha kryesore mjedisore.

- Ndikimet e ndryshimeve klimatike, cilësinë e ajrit urban dhe faktorët që kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, si dhe nivelin e zhurmave urbane në qytetet kryesore të vendit tonë.
- Degradimi i tokës bujqësore, shkaqet e degradimit dhe masat që duhet të merren për parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tyre
- Uji, cilësia e ujërave nëntokësore, lumenjve, ekosistemeve ujore, liqeneve dhe bregdetit, gjendja nga pikëpamja e ndotjes radioaktive si dhe vlerësimin e burimeve të mundshme të ndotjes. Disponueshmëria e ujit dhe përdorimi i tij.
- Biodiversiteti, Zonat e mbrojtura, Flora dhe Fauna.
- Pyjet-vlerësimi i gjendjes shëndetësore të pyjeve dhe i specieve drunore e bimore në rrezik kërcënimi apo zhdukjeje
- Menaxhimi i mbetjeve, mbetjet urbane të depozituara, sasia e mbetjeve të ricikluara dhe mbetjet e rrezikshme.
- Situata e menaxhimit të kimikateve, inventari i PCB -ve

Raporti i Gjendjes në Mjedis, 2023 jep një vështrim të përgjithshëm, për njohjen e publikut me gjendjen e komponentëve të mjedisit, treguesve të ndikimit dhe presioneve që ushtrohen nga aktivitetet njerëzore apo ato natyrore. Po ashtu ju paraqet edhe politikbërësve rekomandime për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Gjetjet kryesore

Vlerësohet se cilësia e ajrit në qytetet e monitoruara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Fier, Shkodër), nuk është e një niveli shumë të mirë.

Emetimet e gazeve me efekt serë ndikojnë në ndryshimet klimatike. Burimet kryesore të këtyre emetimeve në vendin tonë janë sektori i energjisë, bujqësisë, pyjet, mbetjet dhe proceset industriale.

Në zonat bregdetare të vendit tonë (plazhe), janë shtuar pikat e kampionimit me ngarkesë bakteriale duke i krahasuar me vitin e kaluar. Kemi përkeqësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi mezotrofike në vitin 2022 në cilësi eutrofike në vitin 2023. Problematika shfaqet me përmbajtjen e Cd dhe Pb në ujërat e Lagunave Karavasta, Nartë dhe Butrint, duke i klasifikuar ujërat e tyre me cilësi të dobët. Përsa i përket dinamikës së vijës bregore, rajoni me problematikën më të lartë është ai i Gjirit të Drinit, ku bilanci akumulim-erozion është negativ.

Lumenjtë më të ndotur janë lumi Ishëm dhe Gjanica. Kemi përmirësim të cilësisë së lumit të Vërdovës (tributar) krahasuar me 2022 duke kaluar nga cilësi e varfër në cilësi e moderuar. Ujërat nëntokësore në përgjithësi kanë veti fiziko-kimike të mira duke përjashtuar stacionin Pishë Poro që ka ujë me cilësi jo të mirë.

Niveli i zhurmave tejkalon vlerat limite për periudhën e ditës (55 dB) dhe të natës (45 dB) në të gjitha qytetet e monitoruara.

Vërehet tendencë në rritje e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme.

Nga inventari i PCB-ve në vajrat e transformatorëve që administron Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) vlerësohet se pesha totale e vajit të kontaminuar është 3,510 ton dhe sasia e përmbajtjes së PCB-ve në vajin e kontaminuar është 1196 kg.

Tirana është bashkia me gjenerimin më të lartë të mbetjeve, duke arritur 244,787 ton, shumë më tepër se bashkitë e tjera. Kjo tregon se zonat urbane më të mëdha kanë nivele më të larta të mbetjeve për shkak të dendësisë së popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike. Vlerësohet se kemi tendencë në rritje nga viti në vit të gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve për të gjitha qarqet për periudhën 2021-2023.

KAPITULLI 1

AJRI

KAPITULLI 1

AJRI

1.1 Të përgjithshme

Cilësia e ajrit është një ndër çështjet më kritike mjedisore me interes për popullatën. Deri disa vite më parë, në fakt, ndotja e ajrit mund të konsiderohej një problem i kufizuar në qendrat me të mëdha urbane, ndërsa tani, nga banorët e qyteteve të mëdha, duket të perceptohet si një problem i përhapur, për shkak të nivelit të lartë të ndotësve që ndodhin si gjatë muajve të dimrit (grimcat e imta, oksidet e azotit) dhe niveleve të larta të ozonit, veçanërisht në verë, kur reagimet atmosferike janë katalizuar në mënyrë më efikase.

Mbështetur në legjislacionin mjedisor dhe në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, miratuar nga MTM për vitin 2023, AKM ka realizuar monitorimin e cilësisë së ajrit urban me stacione automatike në qytetet kryesore të vëndit tonë si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë për treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban si: PM₁₀, PM_{2.5}, NO₂, SO₂, O₃, CO dhe BTEX.

Çështjet që trajtohen në këtë kapitull janë njohja dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit urban, duke mundësuar rritjen e bazës së të dhënave për cilësinë e ajrit në qytetet kryesore të vëndit tonë sidhe përcaktimi i faktorëve ndotës të ajrit, ndikimi i tyre në mjedis dhe marrja e masave për reduktimin e ndotjes së ajrit.

1.2 Gjendja e cilësisë së ajrit urban

1.2.1 Vlerësimi i gjendjes së ajrit



Për vitin 2023 monitorimi i ajrit urban është realizuar në 9 stacione monitorimi, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë.

Vlerësimi është kryer bazuar mbi normat e lejuara sipas VKM Nr. 352, datë 29.4.2015 që janë të unifikuara me normat e BE. (VKM e sipërmenduar është transpozuar në përputhje me direktivën 2008/50 /EC “Mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Europën”

Tabela 1. Normat e lejuara të cilësisë të ajrit

Normat e lejuara	PM ₁₀ μg/m ³	PM _{2.5} μg/m ³	SO ₂ μg/m ³	O ₃ μg/m ³	CO mg/m ³	NO ₂ μg/m ³	Benzen μg/m ³
Orare			350			200	
8 Orare				120	10		
24 Orëshe	50		125				
Vjetore	40	25				40	5

Tabela 2. Stacionet e monitorimit të ajrit urban

Nr	Stacionet	Vendndodhja	Treguesit
1	Tirana Sauk (stacioni i lëvizshëm)	Sauk, Tiranë	PM ₁₀ , NO ₂ , SO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
2	Tirana ASHR	Para godinës së Autoritetit Rajonal Shëndetësor	PM ₁₀ , NO ₂ , SO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
3	Tirana MTM	Godina e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit	PM ₁₀ , PM _{2.5}
4	Tirana AKM	Godina e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit	PM ₁₀ , PM _{2.5}
5	Durrës	Oborri i shkollës “Jusuf Puka”	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
6	Shkodër	Oborri i qendrës Shëndetësore të Rehabilitimit të handicapateve mendore	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
7	Elbasan	Përpara godinës së qarkut Elbasan	PM ₁₀ , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
8	Korcë	Oborri i shkollës “Raqi Qirinxhi”.	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
9	Fier	Oborri i shkollës “Janaq Kilica”	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX

- **Vlerësimi i situatës nga pluhurat (PM₁₀ PM_{2.5})**

- *Burimi kryesor i pluhurave*

Lënda grimcore kategorizohet në bazë të madhësisë së grimcave, PM₁₀ dhe PM_{2.5} janë grimca me diametër më të vogël se 10 dhe 2.5 μm dhe çlirohet nga burime të ndryshme. Përqendrime të PM-ve përfshijnë grimca primare të emetuara direkt në atmosferë nga burimet e djegies dhe grimca dytësore të formuara nga reaksione kimike në ajër. Burime të PM-së vijnë si nga aktivitetet njerëzore, ashtu edhe ato natyrore (si stërkalat e detit dhe pluhuri i Saharasë)

- *Ndikimi në shëndet*

Ekspozim në terma afatshkurtër dhe afatgjatë mund të përkeqësojë sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe rritjen e vdekshmërisë.

- *Ndikimi në mjedis*

Lëndët grimcore dytësore përfshijnë sulfate, nitrare dhe amonium të formuara nga: SO₂, NO_x dhe NH₃ që janë faktorët kryesorë të acidifikimit dhe eutrofikimit. Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.

➤ **Vlerësimi për PM₁₀**




Bazuar në rezultatet e monitorimit kemi tejkalim të normës vjetore të PM₁₀ (40 µg/m³), në stacionin e Tirana Higjena dhe në stacionin e Elbasanit. Në stacionin e Tirana Higjena kemi një tejkalim të normës vjetore të PM₁₀ në masën 35.4%, ndërsa në stacionin e Elbasanit kemi një tejkalim të normës vjetore në masën 19.62%.

Referuar të dhënave vjetore në stacionin e Korçës, Tirana AKM dhe Tirana MTM, vlerat e PM₁₀ i përafrohen normës vjetore, ndërsa referuar të dhënave mujore kemi tejkalim të normës vjetore të PM₁₀ në stacionin e Korçës vetëm në muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor 2023. Kjo tregon që kemi rritje të grimcave të pluhurit PM₁₀ vetëm në periudhën e ftohtë të vitit, si rezultat i përdorimit të lëndëve fosile ose drurit për ngrohjen e banesave.

Vlera mesatare e PM₁₀ për të tre muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor 2023 është 59.51 µg/m³ dhe kemi tejkalim të normës vjetore të PM₁₀ (40 µg/m³) prej 48.8% vetëm gjatë dimrit.


Grafiku 1. Vlerat vjetore të PM₁₀ për vitin 2023



Duke iu referuar të dhënave ditore të PM₁₀, krahasuar me normën ditore (50 µg/m³) kemi tejkalim të normës ditore të PM₁₀ në stacionet e Durrësit, Elbasanit, Korçës, Tirana ASHR, Tirana AKM dhe Tirana MTM në periudhën Janar –Mars, Korrik dhe Dhjetor.

Kjo ndotje shkaktohet kryesisht nga shkarkimet e automjeteve në rrugët me trafik të rënduar pasi janë stacione trafiku dhe numri i automjeteve që qarkullojnë është shumë i madh. Ndërsa nëstacionin e Korçës ngrohja e banesave është shkaktar i nivelit të lartë të PM₁₀. Një tregues i rëndësishëm i ndotjes së ajrit nga pluhurat është numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM₁₀, ku numri i ditëve të lejuara në vit është 35 ditë.

Grafiku 2. Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM₁₀



Bazuar në analizimin e këtij treguesi, vërejmë që në stacionin e Korçës kemi numrin më të lartë të ditëve që tejkalojnë numrin e lejuar. Në stacionin e Korçës kemi 60 ditë në vitin 2023 që tejkalojnë normën ditore të PM₁₀ prej 50µg/m³ dhe në stacionin Tirana ASHR ku kemi 58 ditë që tejkalojnë normën ditore të PM₁₀.


Në të gjitha stacionet e tjera kemi tejkalim të normës ditore të lejuar prej 50µg/m³ por që nuk e tejkalojnë normën 35 ditë të lejuara/vit.

➤ Vlerësimi për PM_{2.5}

Për vitin 2023, monitorimi i PM_{2.5} është realizuar në 6 stacione monitorimi, në Tiranë (MTM dhe AKM), Durrës, Shkodër, Fier dhe Korçë.

Sipa rezultateve të paraqitura në grafikun e mëposhtëm, vërejmë që nuk kemi tejkalim të normës vjetore të PM_{2.5} në asnjë nga stacionet e monitoruara. Por në stacionin e Korçës vlera e monitoruar është shumë afër normës vjetore të PM_{2.5}.

Grafiku 3. Vlerat vjetore të PM_{2.5} për vitin 2023



Referuar të dhënave mujore, kemi tejkalim të normës vjetore të PM_{2.5} në stacionin e Korçës në muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor 2023. Ashtu si në rastin e PM₁₀ kemi rritje të grimcave të PM_{2.5} vetëm në periudhën e ftohtë të vitit, kjo si rezultat i përdorimit të lëndëve fosile ose drurit për ngrohje në këtë qytet. Vlera mesatare e PM_{2.5} për të tre muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor 2023 është 44.47 µg/m³ e shprehur në % kemi tejkalim të normës vjetore të PM_{2.5} prej 77.9%.

• Vlerësimi i situatës për NO₂ (Dioksid Azoti)

- Burimi kryesor i pluhurave

Të gjitha proceset e djegies në ajër prodhojnë okside azoti (NO_x). Dyoksidi i azotit (NO₂) dhe monoksidi i azotit (NO) janë të dy okside azoti dhe të dy së bashku referohen si (NO_x). Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë.

- Ndikimi në shëndet


Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së dhe ozonit. Efektet e ekspozimit afatgjatë janë mëpak të sigurt se sa efektet e ekspozimit afatshkurtër.

- *Ndikimi në mjedis*

Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit.

Monitorimi i NO₂ për vitin 2023 është realizuar në stacionet Tirana Sauk, Tirana ASHR, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Shkodër. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore në asnjë nga stacionet e monitoruara për vitin 2023. Por në stacionin Tirana ASHR vlera e monitoruar është shumë afër normës vjetore të BE. NO₂ është një ndotës që shkarkohet në ajër si rezultat i djegjes së lëndës djegëse në proceset industriale dhe nga transporti rrugor.

Grafiku 4. Vlerat mesatare të NO₂ për vitin 2023



Referuar të dhënave mujore kemi tejkalim të normës vjetore të NO₂ në stacionin e Tirana ASHR në muajt Janar, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor. Në muajt e tjerë të vitit vlerat mesatare mujore të NO₂ janë shumë afër normës por nuk e tejkalojnë atë. Kjo rritje vjen si rezultat i qarkullimit të automjeteve shpesh herë me trafik të rënduar.

• **Vlerësimi i situatës për SO₂ (Dioksid Squfuri)**

- *Burimi kryesor i pluhurave*

Ka për origjinë djegien e karburanteve që përmbajnë sqfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë.


- *Ndikimi në shëndet*

Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së

- *Ndikimi në mjedis*

Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe çon në humbjen e biodiversitetit

Grafiku 5. Vlerat mesatare të SO₂ për vitin 2023



Monitorimi i SO₂ për vitin 2023 është realizuar në stacionet e Tirana Sauk, Tirana ASHR, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se në asnjë stacion nuk kemi tejkalim të vlerës limite ditore dhe as të vlerës limite orare për SO₂.

• **Vlerësimi i situatës për ozonin (O₃)**

- *Burimi kryesor*

Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike, që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NO_x, dhe përbërjet organike të avullueshme (volatile) VOC, të iniciuar nga rrezatimi i fortë diellor


- *Ndikimi në shëndet*

Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Gjithashtu shkakton dhe irritim të syve

- *Ndikimi në mjedis*

Mund të shkaktojë dëmtime në bimë, duke çuar në uljen e prodhimitarisë dhe ndikimit në biodiversitet. Ozoni është gjithashtu Gaz me Efekt Serë.

Grafiku 6. Vlerat vjetore të O₃ për vitin 2023



Monitorimi i O₃ është realizuar në 7 stacione, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Tirana Sauk dhe Tirana ASHR.

Referuar të dhënave të monitorimit rezulton se vlerat mesatare vjetore në të gjitha stacionet luhet nga 41.43 µg/m³ në stacionin e Tirana ASHR në 59.72 µg/m³ në stacionin e Korçës.

Bazuar në mesataret 8 orare krahasuar me normën 8 orare të O₃, vlera më e lartë në stacionin e Durrësit është regjistruar në datën 20.08.2023 dhe është 125.46 µg/m³, në stacionin e Elbasanit në datën 15.07.2023 ku vlera e monitoruar është 149.23 µg/m³ nga 120 µg/m³ që është norma e O₃. Në stacionin e Fierit vlera më e lartë është 283.77 µg/m³ dhe është regjistruar në datën 20.09.2023.

Në stacionin e Korçës vlera më e lartë është 139.95 µg/m³ dhe është regjistruar më datën 25.07.2023. Në stacionin e Shkodrës vlera më e lartë është 145.39 µg/m³ dhe është regjistruar në datën 13.07.2023.

Në stacionin e Tirana ASHR vlera më e lartë është 144.58 µg/m³ dhe është regjistruar në datën 15.07.2023, ndërsa në stacionin e Tirana Sauk vlera më e lartë është 167.26 µg/m³ dhe është regjistruar në datën 18.07.2023.

• Vlerësimi i situatës për CO (monoksidi i karbonit)

- Burimi kryesor i pluhurave

Formohet nga djegia jo e plotë e karburanteve që përmbajnë karbon. Burimi më i madh është transporti rrugor, që së bashku me djegien nga sektori shtëpiak dhe industrial, konsiderohen si kontribues kryesorë


- Ndikimi në shëndet

Shkakton dëmtime të rënda në shëndet, duke reduktuar shpërndarjen e oksigjenit në gjak, në organet e trupit (si zemra dhe truri) dhe në indet.

- Ndikimi në mjedis

CO kontribuon në formimin e smogut, ozonit të nivelit të tokës, që shkakton probleme serioze të frymëmarrjes.

Grafiku7. Vlerat mesatare të CO për vitin 2023.



Monitorimi i CO është realizuar në stacionet e Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Shkodrës, Tirana ASHR dhe Tirana Sauk. Bazuar në vlerat mesatare vjetore theksojmë se nivelet më të larta të CO janë monitoruar në stacionin e Elbasanit.

Bazuar në mesataret 8 orare të CO krahasuar me normën 8 orare të BE, kemi tejkalim të normës së lejuar 8 orare, në stacionin e Elbasanit dhe të Korçës vetëm në muajt e dimrit.

Monoksidi i karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, sektori shtëpiak dhe industria. Në stacionin e Korçës rritja e CO është si rezultat i përdorimit të lëndëve fosile dhedurrit për ngrohje gjatë periudhës së dimrit. Ndërsa në stacionin e Elbasanit si rezultat i numrit të lartë të makinave që parkojnë pranë stacionit. (Stacioni është instaluar pranë prefekturës Elbasanku është dhe një vendparkim makinash).

- **Vlerësimi i situatës nga benzeni**

- *Burimi kryesor i pluhurave*

Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përftimi nga djegiet shtëpiake, si dhe nga transporti rrugor.


- *Ndikimi në shëndet*

Ekspozimi i njerëzve ndaj benzenit është i lidhur me një sërë sëmundjesh dhe efektsh në shëndet, akute dhe afatgjata, përfshirë kancerin dhe anemone plastike. Benzeni është shumë i avullueshëm dhe ekspozimi më i madh është nëpërmjet frymëmarrjes.

- *Ndikimi në mjedis*

Benzeni avullon shumë shpejt në ajër dhe transportohet në distanca të largëta. Nëse ai shkarkohet në tokë, mund të zërthehet shpejt dhe të kontaminojë ujërat nëntokësore.

Grafiku 8. Vlerat mesatare të Benzenit për vitin 2023



Monitorimi i benzenit për vitin 2023 është realizuar në stacionet e Tirana Sauk, Tirana ASHR, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit. Vlerësohet se në asnjë stacion nuk kemi tejkalim të vlerës mesatare për vitin 2023 krahasuar me normën e lejuar vjetore të benzenit.

Referuar të dhënave të cilësisë së ajrit urban për vitin 2023, mund të vlerësohet se cilësia e ajrit në qytetet e monitoruara nuk është e një niveli shumë të mirë.

Ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë pluhurat me diametër 10 mikrometër dhe 2.5 mikrometër PM₁₀ dhe PM_{2.5} sidomos në stacionin e Korçës në periudhën e dimrit dhe në stacionin Tirana ASHR. Përsa i përket situatës për NO₂ rezultojnë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore në asnjë nga stacionet e monitoruara për vitin 2023.

Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosferë, ai formohet si rezultat i zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosphere si NO_x, CO, NMVOCs dhe CH₄ në prani dhe të rrezatimit diellor. Kjo është arsyeja që në vendin tonë gjatë periudhës së verës ku rrezatimi diellor është shumë i lartë kemi një rritje të ozonit në qytetet e monitoruara. Gjatë vitit 2023 nivelet më të larta të ozonit janë monitoruar në stacionin e Fierit. Vlera më e lartë është 283.77 µg/m³ dhe është monitoruar më datën 20.09.2023.

1.2.2 Inventari emetimeve në ajër 2022

Kombet e Bashkuara të Komisionit Ekonomik për Evropën (UNECE) miratoi Konventën Ndërkufitare të Ndotjes së Ajrit me Rreze të Largët (Longe Range Transboundary Air Pollution, CLRTAP) në 1979. Konventa LRTAP hyri në fuqi në 1983 dhe është zgjeruar me tetë protokolle specifike. Raportimi i të dhënave për shkarkimet në ajër tek Organi Ekzekutiv i Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Largët (CLRTAP) kërkohet për të përmbushur detyrimet në lidhje me strategjitë dhe politikat në përputhje me zbatimin e Protokolleve sipas Konventës. Palët duhet të përdorin procedurat e raportimit dhe u kërkohet të paraqesin emetimet vjetore kombëtare të oksideve të azotit (NO_x), komponimet organike të avullueshme jo-metan (NMVOC), dioksidi i squfurit (SO_x), amoniaku (NH₃), monoksidi i karbonit (CO), grimcat ,metale të ndryshme të rënda dhe ndotës organikë të qëndrueshëm (NOQ).

Shqipëria iu bashkua Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Afat të Gjata në 2005 me Ligjin Nr. 9425, datë 06.10.2005. Në vitin 2009, Shqipëria ratifikoi Protokollin për Kontrollin e Emetimeve të Oksideve të Azotit ose Flukset Ndërkufitare të tyre, dhe Protokollin për Reduktimit të Emetimeve të Squfurit ose Flukset e tyre Ndërkufitare me të paktën 30 % . Në vitin 2011, vendi ynë aderoi në Protokollin për Financimin Afatgjatë i Programit Bashkëpunues për Monitorim dhe Vlerësimin e Transmetimit me Rreze të Gjatë të Ndotësve të Ajrit në Evropë (EMEP).

Shqipëria ratifikoi Protokollin e Gothenburgut më 3.11.2011 (Ligji nr. 10 476/2011) por nuk është akoma palë në Protokoll, pasi nuk ishte në gjendje të propozonte ulje ambicioze të emetimeve për vitin 2011.

Ligji për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit të Ambientit përcakton përgjegjësitë e autoriteteve kompetente, përshkruan mënyrën e informimit publik mbi cilësinë e ajrit dhe siguron bazën ligjore për rregullimin e vlerësimit të cilësisë së ajrit dhe zvogëlimin e ndotjes së ajrit nga burimetë lëvizshme dhe produkte të caktuara, zhvillimin e ajrit planet e cilësisë dhe pjesëmarrjen e publikut në këto procese, raportimin mbi zbatimin e ligjit dhe shkeljet administrative.

Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", rregullon liçencimin e subjekteve të ligjshme që ushtrojnë përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre.

Sipas VKM Nr. 162/2020 "Për rregullat për përgatitjen, miratimin, rivlerësimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për zvogëlimin e emetimeve në ajër"; Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) e Shqipërisë është njësi e vetme kombëtare përgjegjëse për përgatitjen e inventarëve

vjetorë të emisioneve kombëtare të ndotësve të përmendur në Shtojcën I të këtij vendimi si dhe përgatitjen e raporteve vjetore të inventarit informues. Gjithashtu ka përgjegjësinë për të paraqitur raportin vjetor të inventarit në Konventën për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Largët (CLRTAP).

Agjencia Kombëtare e Mjedisit me ndihmën e ekspertëve të jashtëm ka arritur të llogarisë Inventarin e Shkarkimeve (emetimeve) në ajër për vitin 2022. Ky inventar është llogaritur me anë të metodologjisë EMEP/EEA 2023, TIER 1. Gjithashtu në raportin kombëtar informativ të inventarit, janë përcaktuar kategoritë kryesore që ndikojnë më së shumti në sasinë totale të ndotësve të emtuar përgjatë vitit 2022.

Identifikimi i kategorive kryesore është përgatitur në përputhje me udhëzuesin e inventarit të emetimeve të ndotësve të ajrit EMEP/EEA 2023, i cili përcakton se një kategori kryesore është ajo që ka prioritet brenda Sistemit Kombëtar.

Tabela. 1 Totali akumulativ i indikatorëve ndotës sipas industrisë më kontribuese


Indikatori	Kategoritë Kryesore (Renditur nga më e larta në më të voglën nga e majta në të djathtë)						Totali kumulativ
SO _x	1A2f (91.7%)						91.7%
NO _x	1A2f (40.9%)	1A4ciii (13.7%)	1A4ci (13.7%)	1A4bi (10.4%)	1A2e (6.3%)		85.0%
NH ₃	3B1a (46.0%)	3B2 (12.5%)	3B4gi (12.0%)	3B4d (6.1%)	3B4gii (5.4%)		82.1%
NMVOC	1A4bi (31.2%)	3B1a (25.7%)	1A2f (8.4%)	3B4gi (8.3%)	3B4d (4.7%)	3B1b (3.6%)	81.9%
CO	1A4bi (66.5%)	1A2f (26.9%)					93.5%
TSP	1A4bi (52.8%)	1A2f (14.6%)	3B4gi (12.2%)	3B1a (5.6%)			85.1%
PM10	1A4bi (63.8%)	1A2f (17.5%)					81.3%
PM2.5	1A2f (80.0%)	1A2gviii (10.3%)					90.2%
Pb	1A2f (81.3%)						81.3%
Hg	1A2f (81.4%)						81.4%
Cd	1A4bi (59.0%)	1A2f (14.1%)	1A4ci (7.7%)				80.8%

DIOX	1A4bi (65.9%)	1A2f (28.8%)					94.8%
PAH	1A4bi (87.2%)						87.2%
HCB	1A4bi (61.7%)	1A2f (13.2%)	1A4ai (7.4%)				82.3%


Sipas tabelës , ndotësi kryesor është SO_x i cili sipas kategorisë së burimit 1A2f (prodhimi i minirelave jo-metalike) vlerësohet në sasinë prej 91.7%. Më pas renditet NO_x, i cili për kategorinë 1A2f (Prodhimi mineraleve jo-metalike) vlerësohet 40.9%; 1A4ciii (Bujqësia/pyjet/peshkimi/ **peshkimi kombëtar**) vlerësohet 13.7%; 1A4ci 13.7% (Bujqësia/pyjet/peshkimi/ **peshkimi pikësor**); 1A4bi (Rezidenciale/stacionare) vlerësohet 10.4%; 1A2e (Burimet pikësore me djegie në industritë e prodhimit dhe ndërtimit: Përpunimi i ushqimit, pijeve dhe duhanit) vlerësuar me 6.3%.


Në grafikët e mëposhtëm jepet sasia totale për çdo ndotës në krahasim me industritë që kontribuojnë në % për vitin 2022.

Grafiku nr. 1 Sasia e totale e shkarkuar e oksideve të sqfurit




Oksidet e sqfurit janë shkarkuar në total 6.11 kt per vitin 2022 ku 91/7 % e tyre ka ardhur nga aktiviteti i prodhimit të mineraleve jo metalike 1A2f (Prodhimi mineraleve jo-metalike).






Oksidet e azotit të shkarkuara përgjatë vitit 2022 janë 11.52 kt, ku 40.9 % nga Prodhimi mineraleve jo-metallike 1A2f, 13.7 % nga Bujqësia/pyjet/peshkimi/ **peshkimi kombëtar** 1A4cii, 13.7 % nga Bujqësia/pyjet/peshkimi/ **peshkimi pikësor** 1A4ci, 10.4 % nga 1 A4bi dhe 6.3 % nga Burimet pikësore me djegie në industritë e prodhimit dhe ndërtimit: Përpunimi i ushqimit, pijeve dhe duhanit 1A2e




Sasia totale e amoniakut të shkarkuar përgjatë vitit 2022 është 18.58 kt, ku 46.0 % i përket menaxhimit të plehut nga mbarështimi i lopëve për prodhim qumështi 3B1a, 12.5 % është nga menaxhimi i plehut që vjen nga mbarështimi i deleve 3B2, 12.0 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështimi i pulave për prodhim vezësh 3B4gi, 6.1 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështimi i dhive 3B4d dhe 5.4 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështimi i pulave për prodhim mishi 3B4gii.




Grafiku nr. 2 Sasia totale e shkarkuar e komponimeve organike te avullueshme pa metanin.


Komponimet organike të avullueshme pa metanin të shkarkuara gjatë vitit 2022 janë 11.98 kt. Ku 31.2 % vjen nga rezidenciale/stacionare 1A4bi, 25.7 % nga menaxhimi i plehut nga lopët për prodhim qumështi 3B1a, 8.4 % nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f, 8.3 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështrimi i pulave për prodhim vezësh 3B4gi dhe 4.7 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështrimi i dhive 3B4d dhe 3.6 % nga menaxhimi i plehut nga mbarështrimi i lopëve të cilat nuk prodhojnë qumësht 3B1b.





Gjatë vitit 2022, sasia totale e monoksidit të karbonit të shkarkuar është llogaritur 11.49kt ku 66.5 % vjen nga rezidenciale/stacionare 1A4bi dhe 26.9 % nga prodhimi mineraleve jo-metalike 1A2f.




Sasia totale e grimcave të pluhurit me madhësi 10µ të shkarkuara gjatë vitit 2022, janë llogaritur 3.29 kt. Ku 63.8 % vjen nga rezidenciale/stacionare 1A4bi dhe 17.5 % nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f.



Gjatë vitit 2022 sasia totale e grimcave të pluhurit me madhësi 2.5µ të shkarkuara janë llogaritur 2.21 kt, ku 80.0 % vjen nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f dhe 10.3 % nga burimet pikësore me djegie në prodhimin e produkteve për ndërtim 1A2gviii.






Përsa i përket metaleve të rënda, specifikisht plumbi dhe mërkuri janë shkarkuar nga e njëjta industri që i përket prodhimit të mineraleve jo-metalike 1A2f. Në total kemi 1.01 ton plumb dhe 0.06 ton mërkur.



Sasia totale e kadmiumit e shkarkuar përgjatë vitit 2022 është 0.31 ton ku 59% është shkarkuar nga rezidenciale/stacionare A4bi, ku 14.1% vjen nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f dhe 7.7% nga hujësia / pyjet / peshkimi / **peshkimi pikësor** 1A4ci.

Gjatë vitit 2022, sasia totale e dioksinave dhe furaneve të shkarkuara është llogaritur 1.29 g I-TEQ nga ku 65.9% e përbëjnë burimet rezidenciale/stacionare 1A4bi dhe 28.8% nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f.





Sasia totale e hidrokarbureve aromatike policiklike (PAH) të shkarkuara gjatë vitit 2022 është llogaritur 0.33 on nga ku 87.2% ka ardhur nga Rezidenciale/stacionare 1A4bi.

Përsa i përket sasisë totale të heksaklorobenzenit (HCB) të shkarkuar rezulton të jetë 0.03 kg, ku 61.4% është nga rezidenciale/stacionare 1A4bi, 13.2% nga prodhimi i mineraleve jo-metalike 1A2f dhe 7.4% është nga burimet pikësore komerciale apo industriale 1A4ai.

1.2.3 Sektorët e ekonomisë që ndikojnë në ndotjen e ajrit

- *Transporti*

Transporti rrugor është një burim kryesor i shumë ndotësve të ajrit, në veçanti në zonat urbane. Dendësia e trafikut, mosha mesatare e parkut të automjeteve, si dhe mungesa e kontrollit të shkarkimeve të gazta nga automjetet, çojnë në rritjen e shkarkimeve duke reduktuar cilësinë e ajrit të mjedisit. Problemet janë identifikuar në shumë programe monitorimi të realizuara gjatë viteve. Përqendrime të larta të grimcave dhe të oksideve të azotit NO₂ janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura afër rrugëve me trafik të dendur në Tiranë. Deri më 2013-ën nuk ka pasur ndonjë monitorim automatik në “kanionet rrugore” në zonat e mbipopulluara dhe më shumë

trafik. Por ne vlerësojmë që ndotja e ajrit e shkaktuar nga trafiku është domethënëse në zonat me shumë trafik në Shqipëri. Bllokimet nga trafiku për shkak të menaxhimit joeficient të tij rrisin shkarkimin e këtyre ndotësve.

Menaxhimi i trafikut mund të japë një kontribut të rëndësishëm për të ndihmuar në reduktimin e shkarkimeve të ndotësve nga automjetet, si për shembull: skema që ndalojnë ose përjashtojnë makina më pak të pastra nga rrugë ose zona të veçanta, ose reduktojnë bllokimin nga trafikurrugor duke zgjidhur probleme të parkimit, pasi kapaciteti i rrugëve mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme, në qoftë se makinat e parkuara në mënyrë ilegale dhe parkimi paralel i dyfishtë do të reduktohej duke përforcuar zbatimin e legjislacionit mbi trafikun, si dhe duke rritur numrin e vendeve të disponueshme të parkimit.

- *Industria*

Shkarkimet industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Një ngaprobleme serioze të ndotjes në Elbasan janë pluhurat të shkaktuara nga industria metalurgjike, fabrika e çimentos dhe nga depozita të hapura. Në zonën e Fierit, të dhënat tregojnë probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës. Një nga ndotësit kryesor në zonën e Fierit është SO₂, i cili kryesisht shkarkohet në ajër nga nxjerrja dhe përpunimi i naftës. Shumë “pellgje vajrash” në zonën e Fierit kontribuojnë në një emetim të konsiderueshëm të hidrokarburëve. Në afërsi të industrive të mëdha mund të ekzistojnë probleme me CAM-in, por monitorimi i një burimi të vetëm nuk është një mjet eficient për strategjitë e pakësimit/zvogëlimit. Një monitorim i përshtatshëm i shkarkimeve, duhet t'i prezantohet kontrollit të shkarkimeve nga burime pikësore. Dampat dhe depozitat e krijuara nga aktivitetet të mëparshme industriale, mund të kontribuojnë gjithashtu, në shkarkimet dhe formimin e pezullive të grimcave.

- *Bujqësia*

Ndotja nga aktivitetet bujqësore ndikon negativisht në cilësinë e ajrit. Kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrialisë janë shumë të dëmshme ndaj mjedisit natyror dhe gjithashtu, mund të përbëjnë një problem edhe për njerëzit. Pesticidet e përdorura për të vrarë insektet që ushqehen me të korra, mund të shkaktojnë një dëm të madh në mjedis, nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur. Metani i çliruar nga “proceset e keqtrajtjes së ushqimit”, si pasojë e keqshqyerjes së lopëve, është gjithashtu një lloj gazi serrë, duke e shndërruar kështu pjesërisht në një përgjegjës për ngrohjen globale. Shkarkimet nga përdorimi i karburanteve nga traktorët dhe pajisje të tjera të fermave të përdorura në bujqësi, gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e ajrit.

Zjarret, të cilët nuk janë të pazakonshme në ferma, mund të jenë shumë të dëmshëm për mjedisin, nëse plehrat dhe mbetjet që vijnë nga ky sektor, digjen në mënyrë të pakontrolluar. Një draftshënim i vendit (2009), i hartuar nga Banka Botërore, tregoi se agrikultura në Shqipëri është përgjegjëse për 77% të metanit në vend dhe 91% të shkarkimeve të oksidive të azotit. Njësoj si me emetime të tjera sektoriale, kërkohet informacion më i përditësuar dhe më i saktë në lidhje me kontributet relative të gazeve me efekt serrë, substancave ozonholluese dhe ndryshimeve klimatike.

- *Zhvillimi urban*

Aktivitetet ndërtuese janë kontribuesit kryesor në përqendrimin e lartë të grimcave në ajër. Në zonat e ndërtimit, përveç aktiviteteve ndërtimore që natyrisht kanë kontributin e tyre, një kontribues i rëndësishëm mund të jetë edhe trafiku, rrugët dhe zonat e pasistemuara, si dhe më së shumti qëndrimi pezull i grimcave të ngurta. Meqë përqendrimi i këtyre grimcave është i lartë në të gjithë Shqipërinë, duhet të merret parasysh sa i madh është “kontributi natyror”.

- *Menaxhimi i mbetjeve*

Rritja e sasisë së mbetjeve urbane dhe djegia e pakontrolluar e mbetjeve shtëpiake përbën një burim të rëndësishëm të emetimit të pluhurave, dyoksinave dhe furaneve. Ky problem vazhdon të bëhet më i madh, sepse shtresa më e varfër e popullsisë beson se djegia e këtyre mbetjeve është një metodë e pranueshme e asgjësimit të mbetjeve. Ka disa landfille sanitare dhe asnjë impiant për incinerimin (djegien) e mbetjeve shtëpiake në Shqipëri. Mbetjet ruhen në vendgrumbullime të mbetjeve, dhe sasia e tyre reduktohet nëpërmjet zjarreve të pakontrolluara që shkaktojnë probleme në afërsi të depozitave.

- *Cilësia e lëndëve djegëse*

Kontrolli për respektimin e standardeve shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj realizohet nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial, në zbatim të kuadrit ligjor të mëposhtëm:

- Ligjit nr.8450, datë 24.04.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, pika 2 e nenit 23.
- VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”,
- VKM nr.429, datë 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil dhe industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhërit të Ministrit nr.6 datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”
- Udhëzimit Nr.3492, datë 30.04.2015 “Për koordinimin ndërinstytucional të procedurave standard të kontrollit cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë”,
- Udhëzimi i Përbashkët Nr.6529/2 datë 06.10.2020 “Për mbledhjen, ruajtjen, marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e benzinës, diezelit, gazit të lëngët të naftës (GLN), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta”.

Kontrolli i cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, përfshin përcaktimin e vetive fizike dhe kimike sipas kërkesave të standardeve shtetërore të miratuara, parandalimin e falsifikimit të cilësisë nga subjektet e tregtimit me shumicë dhe ato me pakicë gjatë transportimit, ruajtjes dhe tregtimit të tyre.

Nga sa më sipër ISHTI kryen marrje të mostrave për kontroll cilësor në gjitha pikat doganore të vendit tonë të produkteve të naftës të klasifikuara për tregtim sipas kategorive përkatëse, në depozitat e subjekteve të tregtimit me shumicë dhe në stacionet e tregtimit me pakicë të tyre.

Në vendin tonë me përjashtim të rafinerive të naftës që kanë laborator operacional, të gjithashoqëritë e tregtimit me shumicë që zotërojnë kapacitete depozitimi dhe stacionet e karburantevenuk kanë laboratorë dhe nuk kontrollojnë cilësinë e nënprodukteve të naftës.

Numri i mostrave dhe testimet periodike janë rregulluar me standardet dhe specifikimet teknike për llojet e produkteve të naftës, si edhe me Urdhërin nr.6/2015 të Ministrisë Përgjegjëse për hidrokarburet.

Gjatë vitit 2023 kanë ushtruar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto “Al-Global Oil” sh.a UPN në Fier dhe “RBH Beline” sh.a në Elbasan, ndërsa rafineria e Përpunimit të naftës Ballsh dhe Rafineria e naftës “AM-OIL” sha me adresë ish Uzina e Plasmasit, Lushnjë nuk kanë ushtruar aktivitet të përpunimit të naftës bruto.

Po ashtu gjatë këtij viti janë mostruar për kontroll cilësor para zhdoganimit për sasinë totale 2 249 218 ton naftë bruto dhe nënprodukte naftë, nga të cilat Gazoil 987 550 ton, Benzinë 74 495 ton, Gaz i lëngëzuar nga nafta (GLN) 335 963 ton, Lëndë djegëse (Mazut) 666 ton, vajra lubrifikantë 12 455 ton, bitum 49 240 ton, karburant për avion me turbinë JET-A-1 71 456 ton, naftë bruto 522 787 ton, nënprodukte naftë nga rafineritë e vendit tonë për eksport 30 996, gazoil + biodiesel 163 610 ton.

Janë inspektuar subjektet e tregtimit me shumicë për kontroll cilësor dhe marrje mostrash me tarifë për cdo 4-mujor, në vitin 2023 dhe janë marrë gjithsej 556 mostra me tarifë. Janë marrë gjithashtu 2586 mostra për kontroll cilësor parazhdoganimit. Janë inspektuar subjektet e tregtimit me pakicë për kontroll cilësor për vitin 2023 dhe janë marrë gjithsej 2569 mostra me tarifë, gjithashtu janë marrë 711 mostra për kontroll cilësor sondazh.

Janë inspektuar subjektet Konsumatorë të Mëdhenj nga të cilët janë marrë 10 mostra për kontroll cilësor për produktet që përdorin dhe dokumentacioni i furnizimit. Gjithsej janë analizuar 22 mostra për palë të tretë.

Zbatimi i standardeve cilësore të karburanteve S SH EN 228:2012+A1:2017 për benzinën, S SH EN 590:2022 për gazoilin dhe S SH EN 589:2018+A1:2022 për gazin e lëngët është në përputhje me teknologjinë e avancuar të motorëve, por edhe me objektivat e BE për emetimin e gazrave nga mjetet lëvizëse.

Metodat e marrjes së mostrave që zbatohen janë në përputhje me standardet S SH EN ISO 3170:2005 dhe S SH ISO 3171:2002 ndërsa kryerja e analizave është realizuar në laboratorin ekëtit institucioni i cili funksionon sipas S SH ISO/IEC 17025:2017.

BENZINA

Sasia e benzinës e cila konsumohet nga mjetet e transportit në vendin tonë furnizohet nga tregu rajonal dhe kryesisht nga rafineritë e naftës në Itali dhe Greqi, të cilat sipas analizave laboratorike rezultojnë në përputhje me kërkesat e standardit S SH EN 228:2012+A1:2017.

Janë importuar 74 495 ton dhe janë marrë gjithsej 461 mostra.

Gjatë periudhës së mostrimit benzina rezultoi në përputhje me standardet shtetërore dhe rregulloret mjedisore. Parametrat që kishin më shumë diapazon ndryshimi ishin hidrokarburet aromatike dhe presioni i avullit.

Olefinat në benzinë të cilat kanë një shkallë të lartë antiknock, vlerat mesatare të tyre u luhatën në vlerën 9-18 % duke respektuar kërkesat e standardit. Monitorimit të këtij parametri i është kushtuar rëndësi sepse oksidimi i tyre (kur benzina nuk përdoret për një kohë të gjatë), krijon depozitime në serbatorët e makinave duke bllokuar systemin e injektimit të karburantit.

Nga analizimi në laborator asnjë mostër nuk rezultoi me numër oktani të ulët dhe përmbajtje oksigjenatesh nën standardet shtetërore. Ndryshimi i vlerës së numrit të oktanit në kufijtë brenda standardit nuk influencon në ndryshimin e emetimeve.

Përmbajtja e oksigjenateve lidhet drejtëpërdrejtë me numrin e oktanit, sepse këto komponime favorizojnë djegien e plotë të benzinës. Përmbajtja e tyre gjatë kësaj periudhe luhatet nën vlerën 1-2.6% në peshë, me një vlerë mesatare 1.7 %. Ky parametër është në përputhje me rregulloret mjedisore.

Numri i oktanit lidhet me aftësinë e benzinës për t'u djegur pa goditje në motor dhe me gjenerimin e energjisë gjatë djegies të saj.

Vlerësimi i oktanit me metodën S SH EN ISO 5164 rezulton në kufijtë e lejuar. Vlera mesatare e aromatikëve gjatë kësaj periudhe rezultoi 18-33 %.

Diferenca maksimale prej 6-8% e përmbajtjes së olefinave në benzinë nuk paraqet ndonjë ndryshim të rëndësishëm në emisionet e gazrave në atmosferë.

Përmbajtja e benzenit i cili është një produkt kancerogjen, në benzinë është luhatur në kufinj të 0.4-0.7 % nga 1% që është kufiri i lejuar.

Përmbajtja e squfurit shoqërohet me formimin e oksidit të squfurit dhe formimin e shiut acid. Mesatarja e kësaj periudhe luhatet në kufijtë 5-10 ppm. Ndryshimi i vlerës të përmbajtjes së squfurit influencon në rritjen e saj në atmosferë.

Presioni i avullit karakterizon shkallën e paqëndrueshmërisë të benzinës, për të cilën kërkohet të arrihet një djegie efikase në motor është shumë i rëndësishëm për stinën e verës nuk e ka tejkaluar vlerën 60 kpa.

GAZOILI

Sasia e gazoilit që konsumohet nga mjetet e transportit në vendin tonë furnizohet nga tregu i jashtëm dhe kryesisht nga rafineritë e naftës në Itali, Greqi dhe Turqi të cilat sipas analizave laboratorike rezultojnë në përputhje me kërkesat e standardit S SH EN 589:2022.

Janë importuar gjatë këtij viti 987 550 ton dhe janë marrë gjithsej 768 mostra. Vlera mesatare e numrit të cetanit gjatë kësaj periudhe ka rezultuar 52.1 njësi.

Pika e flakërimit është një koncept i rëndësishëm për mbrojtjen nga zjarri sepse është temperatura më e ulët në të cilën egziston rreziku i zjarrit me një lëng të caktuar. Ajo tregon praninë ematerialeve të paqëndrueshme në një material të qëndrueshëm. Temperatura e flakërimit është e përcaktuar si temperaturë minimale e nevojshme për karburantin në të cilin formohet një përzierje ndezshme.

Pika e flakërimit minimalisht 55°C është në përputhje me vlerën e përcaktuar në standardet shtetërore dhe vetëm në një rast ky parametër ka rezultuar 48.5 nën vlerat e lejuara të standardit. Përmbajtja e squfurit për produktin gazoil është tregues i rëndësishëm sipas standardit SH EN 590:2022. Një rast ka rezultuar me shmangie të standardit, ku përmbajtja e squfurit ka rezultuar 15.8 mg/kg.

Motorët me naftë injektojnë lëndë djegëse të lëngët në cilindër. Në temperatura të ulëta rritet viskoziteti i gazoilit dhe mund të kufizojë rrjedhën e karburantit në cilindër. Nga analizat laboratorike pika e ngrirjes luhatet nga -18°C deri në -22°C , për të parandaluar problemet në periudhën e dimrit.

LËNDËT DJEGËSE

Në lëndët djegëse që përdoren për përdorim industrial dhe mjetet e lundrimit detar, inspektimit dhe testimit kanë patur si objektiv që lëndët djegëse të jenë në përputhje me standardin S SH UNI 6571:2011 dhe direktivën e Squfurit të BE 1999/32.

Gjatë vitit 2023 është importuar 666 ton lëndë djegëse mazut dhe janë marrë gjithsej 26 mostra lëndë djegëse për kontroll cilësor.

Të gjithë përbërësit e naftës kur digjen janë të dëmshëm për mjedisin. Papastërtitë e squfurit të naftës dhe metaleve të rënda do të shkaktojnë formimin e tymrave toksikë me përmbajtje të lartë të blozës, dhe një përmbajtje të konsiderueshme e përbërjeve që përmbajnë azot, çon në një përqëndrim relativisht të lartë të oksideve të azotit. Dëmi nga djegia e naftës së papërpunuar është e dukshme dhe jo vetëm për mjedisin, por edhe për pajisjet e përdorura.

Korrozioni i gazit të metaleve, formimi i depozitave të karbonit në furrat dhe depozitat e koksit në sprucatore, çojnë në mbyllje të shpeshta të furrave për pastrim, janë shëmbujt më të zakonshëm të përdorimit destruktiv të naftës. Prandaj, sipas legjislationit të disa vendeve për mbrojtjen e mjedisit, është e ndaluar përdorimi i naftës së papërpunuar si lëndë djegëse.

GAZI LËNGËT

Gjatë vitit 2023 janë importuar 335 963 ton GLN, ku janë marrë gjithsej 149 mostra.

Referuar VKM nr.429 datë 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil dhe industrial si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, miratimi i standardit të gazit të lëngët si rregull teknik i detyrueshëm për zbatim, disiplinon tregtimin e tij sipas kushteve klimatike të vendit tonë dhe në përputhje me standardin SSH EN 589:2018+A1:2022.

1.3 Rekomandime

Masat për reduktimin e shkarkimeve përfshijnë:

- Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i automjeteve private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxitjen e përdorimit të transportit publik për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.
- Menaxhimi dhe kontrolli i rrjedhës së trafikut në mënyrë që të shmanget bllokimi i automjeteve dhe qëndrimi i zgjatur në kryqëzimet e rrugëve dhe në zonat urbane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në këto vende.
- Rregullimi dhe kufizimi i shkarkimeve nga të gjitha mjetet motorike. Forcimi i kontrolleve të detyrueshme të shkarkimeve të gazta në të gjithë vendin, për të gjitha automjetet. Ndalimi i qarkullimit për të gjitha automjetet private dhe publike që nuk janë në gjendje të mirë, ose që tejkalojnë vlerën e përcaktuar të kufirit të shkarkimeve.
- Promovimi i përdorimit të automjeteve me ndikim të ulët në mjedis (automjeteve elektrike) dhe forcimi i rrjetit shpërndarës për karikimin elektrik jo vetëm në Tiranë por në të gjithë Shqipërinë.
- Sigurimi i karburantit me përbajtje të ulët të squfurit. Kontrolli i rregullt i testimit të shkarkimeve të automjeteve për të kufizuar dhe për të reduktuar shkarkimet e grimcave dhe ndotësve të tjerë të ajrit.
- Kufizimi dhe zvogëlimi i nivelit të parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës, në qendrat urbane, për të reduktuar volumet e trafikut dhe shkarkimet e automjeteve.
- Ndërtimi i hapësirave të gjelbëruara. Ndërtimi i zonave me gjelbërim të përjetshëm me një përthithje të lartë përgjatë rrugëve kryesore të trafikut.
- Përmirësimi i planifikimit urban dhe ndalimi i djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura.
- Larja e mjeteve të tonazhit të rëndë dhe jo vetëm, që dalin nga kantierët e ndërtimit.
- Në sektorin e bujqësisë, kufizimi i aktiviteteve të djegies së kashtës dhe drithërave në tokat bujqësore, realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë, reduktimi i emetimeve nga drutë e zjarrit.
- Promovimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme me qëllim pëmbushjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin e ujit të nxehtë.

KAPITULLI 2

NDRYSHIMET KLIMATIKE

KAPITULLI 2

NDRYSHIMET KLIMATIKE

2.1 Të përgjithshme

Shqipëria, duke qenë një vend që nuk bën pjesë në Shtojcën I të KKBNK-së, ka zhvilluar një inventar të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe përthithjeve nga përthithësit e gazeve me efekt serrë (GES) të emetuara në atmosferë ose të përthithura nga atmosfera që prej vitit 1990, në kuadër të Komunikimeve të saj Kombëtare (KK) për Ndryshimet Klimatike, dhe tashmë në kuadër të këtij raporti me titull “Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë”.

Përlllogaritjet e emetimeve dhe përthithjeve të GES-ve janë paraqitur në Raportin e Parë Dyvjeçar të Përditësuar (RDP1) për Shqipërinë, të dorëzuar në vitin 2021 dhe në tre Komunikimet Kombëtare të Shqipërisë: Komunikimi i Parë Kombëtar (KK1) i dorëzuar në vitin 2002; Komunikimi i Dytë Kombëtar (KK2) i dorëzuar në vitin 2009 dhe Komunikimi i Tretë Kombëtar (KK3) i dorëzuar në vitin 2016.

Në këtë raport përfshihet inventari kombëtar i GES-ve për vitet 2009-2019. Inventari përmban vlerësime të GES-ve nga sektori i energjisë, proceset industriale dhe përdorimi i produkteve (PIPP), bujqësia, përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (PTNPTP) dhe i mbetjeve, konkretisht për GES-et e mëposhtme: CO₂, CH₄, N₂O, hidrofluorokarbonet (HFC-të) dhe gaze të tjera për të cilat nuk disponohen PNG në Raportin e Dytë të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK) të përfshirë në Udhëzimet e PNNK-së të vitit 2006. Po ashtu jepen vlerësime të burimeve kryesore, si dhe emetimet dhe përthithjet në total, të shprehura në ekuivalentë të CO₂.

2.2 Gjendja dhe tendenca

Inventari Kombëtar i GES-ve përfshin vitet 2009-2019 dhe është në përputhje me Udhëzimet e PNNK-së të vitit 2006. Për vitet që janë mbuluar nga inventarët e mëparshëm kombëtarë të GES-ve (2009-2016) nuk u kryen rillogaritje. Gjatë këtij përditësimi të inventarit, janë mbledhur të dhëna për vitet 2017, 2018, 2019. Në të përfshihen emetimet e GES-ve dhe përlllogaritjet e përthithjeve, të ndara sipas sektorëve kryesorë të mëposhtëm, siç përcaktohet në Udhëzimet e PNNK-së të vitit 2006: Energjia, PIPP, bujqësia, PTNPTP dhe mbetjet.




Figura 1: Emetimet kombëtare të GES-ve sipas sektorit (2009-2019)

Inventari Kombëtar i GES-ve mbulon GES-et e mëposhtme: CO₂, CH₄, N₂O, PFC-të (perfluorokarbonet) dhe HFC-të. Për të lehtësuar raportimin e agreguar të vlerave të GES-ve, të shprehura si ekuivalent të dyoksidit të karbonit (CO₂ eq.), siç cilësohet në Vendimin 17/KP.8, përdoren vlerat e Potencialeve të Ngrohjes Globale (PNG) të përcaktuara në Raportin e Dytë të Vlerësimit të PNNK-së (horizonti kohor 100-vjeçar).




Figura 2 : Emetimet kombëtare të GES-ve sipas gazeve (2009-2019)

o **Sektori i energjisë**

Në figurën e mëposhtme paraqiten emetimet e GES-ve nga sektori i mbetjeve për vitet 2009-2019. Gjatë kësaj periudhe, emetimet janë rritur me 23,8%, nga 4339,02 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 5373,00 kt CO₂ eq. në vitin 2019.




Figura 3: Emetimet e GES-ve nga sektori i energjisë (2009-2019)

Në emetimet e gazeve me efekt serrë nga sektori i energjisë llogariten emetimet që rezultojnë për shkak të veprimtarive të djegies së lëndëve djegëse, si dhe emetimet aksidentale që rezultojnë nga nxjerrja e lëndëve djegëse të ngurta dhe nga transmetimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse të lëngëta dhe të gazta. Emetimet ndahen në kategoritë e mëposhtme: Industritë energjetike, industritë prodhuese dhe ndërtimi, transporti, sektorët e tjerë (sektori i tregtisë/institucional, i banesave dhe sektori i bujqësisë/pyjeve/peshkimit) dhe të paspecifikuara. Janë llogaritur gjithashtu emetimet aksidentale nga nxjerrja e linjitit dhe nga veprimtaritë e lidhura me rafinimine naftës.

Sektori i transportit është kategoria më domethënëse gjatë të gjitha viteve, i ndjekur nga sektori i industrisë prodhuese dhe ndërtimit (lidhur me konsumin e lëndëve djegëse). Furnizimi me energji primare në Shqipëri dominohet nga nënproduktet e naftës, energjia hidrike dhe energjia elektrike e importuar neto, drutë e zjarrit dhe një sasi e vogël qymyri dhe gazi natyror. Sektori i transportit përbën konsumin më të madh final të energjisë (40,22% në vitin 2019), i pasuar nga sektorifamiljar (25,02% në vitin 2019) dhe ai i industrisë (19,02% në vitin 2019). Konsumi i nënprodukteve të naftës nga sektori i transportit për vitin 2019 ka qenë pothuajse 1 milion tonë, me kosto totale për konsumatorët deri në 1,5 miliardë euro, dhe e gjitha kjo sasi është importuar duke rritur kështu deficitin tregtar të vendit.

Historikisht, energjia elektrike është prodhuar pothuajse ekskluzivisht nga hidrocentralet. Vendi ka shfrytëzuar rreth 50% të potencialit të tij të energjisë hidrike, dhe rritja e kapacitetit hidrik në të ardhmen mund të realizohet kryesisht përgjatë lumenjve të Drinit, Matit, Devollit dhe Bistricës. I vetmi termocentral në vend, përkatësisht TEC-i i Vlorës, nuk është ende funksional, dhe parashikohet transformimi i tij për t'u përdorur me gaz natyror pas ndërtimit të Gazsjellësit Trans-Adriatik (GTA). Shqipëria importon energji elektrike nga vendet fqinje, edhe pse importet janë ulur në mënyrë progresive gjatë dhjetë viteve të fundit si pasojë e rritjes së prodhimit të brendshëm të energjisë dhe reduktimit të humbjeve (teknike dhe joteknike) të energjisë elektrikenë sistemin e shpërndarjes.

○ **Sektori i proceseve industriale dhe i përdorimit të produkteve (PIPP)**

Gjatë periudhës 2009-2019, emetimet e GES-ve nga sektori i PIPP-së janë reduktuar me 1,7%, nga 1364,68 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 1341,65 kt CO₂ eq. në vitin 2019. Këto emetime shkaktohen kryesisht nga dy nënsektorë kryesorë: Industria minerare dhe industria e metaleve. Industria e metaleve ka përjetuar një rënie të madhe të emetimeve për shkak të një ndryshimi të teknologjisë në kompaninë e prodhimit të çelikut “Kurum” në Elbasan. Që nga viti 2010, ajo ka përdorur teknologjinë e furrës me hark elektrik, e cila ka një koeficient të ulët emetimi.




Figura 4: Emetimet e GES-ve nga sektori i PIPP-së (2009-2019)

Emetimet e gazeve me efekt serrë prodhohen nga një sërë veprimtarish industriale. Burimet kryesore të emetimeve vijnë nga proceset industriale që transformojnë materialet fizikisht ose kimikisht (për shembull, furnaltat në industrinë e hekurit dhe çelikut dhe në industrinë e çimentos janë shembuj të mirëfilltë të proceseve industriale që çlirojnë një sasi të konsiderueshme të CO₂)

Gjatë këtyre proceseve, mund të prodhohen gaze të ndryshme me efekt serrë, duke përfshirë CO₂, CH₄, N₂O, hidrofluorokarbonet (HFC-të) dhe perfluorokarbonet (PFC-të).

Për më tepër, gazet me efekt serrë shpeshherë përdoren në produktet e tilla si frigoriferët, shkumat ose shishet e aerosolëve. Për shembull, HFC-të përdoren si alternativa ndaj substancave ozonholluese (SOH) në përdorime të ndryshme të produktit. Kësisoj, hekzafluori i squfurit (SF₆ dhe N₂O përdoren në një sërë produktesh të përdorura në industri (p.sh. SF₆ përdoret në pajisjet elektrike, N₂O përdoret si përbërës shtytës në produktet e aerosolëve, kryesisht në industrinë ushqimore) ose nga konsumatorët fundorë (p.sh., SF₆ që përdoret tek atletet sportive, N₂O që përdoret gjatë anestezisë).

➤ **Prodhimi i çimentos**

Në prodhimin e çimentos, CO₂ gjenerohet gjatë prodhimit të klinkerit. Në pika të ndryshme të aparatit të linjës së furrës për prodhimin e klinkerit mund të gjenerohet pluhur.

Emetimet e dyoksidit të karbonit nga prodhimi i çimentos janë llogaritur duke përdorur qasjen e Nivelit 1, pasi të dhënat e vetme të disponueshme nga të gjitha shoqëritë i referohen prodhimit dhe eksportit vjetor. Qasja e Nivelit 1 bazohet në faktorët e emetimit për CO₂ të emeluar për njësi mase të lëndës së parë ose të produktit të prodhuar. Në metodën e Nivelit 1, emetimet bazohen në

përlllogaritjet e prodhimit të klinkerit që nxirren nga të dhënat e prodhimit të çimentos, duke bërë rregullimet për rastet e importeve dhe eksporteve të klinkerit.

Tabela 1: Prodhimi i çimentos në Shqipëri (2009-2019)

Përshkrimi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Antea Cement (Titan)												
Prodhimi	[ton/vit]	nuk ka	761 638	1 040 000	1 062 000	1 098 000	710 000	675 250	652 600	1 013 982	1 100 000	1 020 000
Eksporti	[ton/vit]	nuk ka	334 600	435 000	548 000	477 000	419 034	218 650	146 155	385 432	360 000	350 000
Konsumi	[ton/vit]	nuk ka	427 038	605 000	514 000	621 000	290 966	456 600	506 445	628 550	740 000	670 000
Fabrika e Çimentos Fushë-Krujë												
Prodhimi	[ton/vit]	nuk ka	900 000	910 000	1 018 000	980 000	1 087 000	955 000	850 000	790 600	750 000	1 100 000
Eksporti	[ton/vit]	nuk ka	275 000		545 000	485 000	585 000	453 878	460 800	297 700	310 000	360 000
Konsumi	[ton/vit]	nuk ka	625 000	634 065	473 000	495 000	502 000	501 122	389 200	492 900	440 000	740 000
Fabrika e Çimentos, Elbasan												
Prodhimi	[ton/vit]	nuk ka	200 000	220 000	230 000	215 000	290 000	235 000	202 000	230 000	150 000	0
Eksporti	[ton/vit]	nuk ka	145 000	154 000	125 000	130 000	100 000	161 054	86 955	95 000	80 000	0
Konsumi	[ton/vit]	nuk ka	55 000	66 000	105 000	85 000	190 000	73 946	115 045	135 000	70 000	0
Fabrika e Çimentos Colacem, Ballëdre Lezhë												
Prodhimi	[ton/vit]	0	0	0	0	215 000	235 000	255 000	252 000	253 000	250 000	110 000
Eksporti	[ton/vit]	0	0	0	0	55 000	53 000	62 000	58 000	60 000	62 000	67 000
Konsumi	[ton/vit]	0	0	0	0	160 000	182 000	193 000	194 000	193 000	188 000	43 000
Prodhimi total												
Prodhimi	[ton/vit]	1 300 000	1 861 638	2 170 000	2 310 000	2 508 000	2 322 000	2 120 250	1 956 600	2 287 582	2 250 000	2 230 000
Totali i eksporteve	[ton/vit]	nuk ka	754 600	864 935	1 218 000	1 147 000	1 157 034	895 582	751 910	838 132	812 000	777 000
Konsumi	[ton/vit]	nuk ka	1 107 038	1 305 065	1 092 000	1 361 000	1 164 966	1 224 668	1 204 690	1 449 450	1 438 000	1 453 000

Duke marrë në konsideratë larminë e produkteve të çimentos nga të gjitha fabrikat, por duke mos pasur të dhëna lidhur me sasinë e secilit produkt, përqindja e klinkerit në llogaritjet e emetimeve është marrë në vlerën 0,9.

➤ Prodhimi i gëlqeres

Oksidi i kalciumit (CaO ose gëlqerja e pashuar) formohet nga nxejja e gurit gëlqeror për të dekompozuar karbonatet. Kjo gjë kryhet zakonisht në furra rrotulluese ose vertikale nëtemperatura të larta dhe gjatë këtij procesi çlirohet CO₂. Siç është rasti për emetimet nga prodhimi i gëlqeres, ekzistojnë tre metodologji bazike për përlllogaritjen e emetimeve nga prodhimi i gëlqeres: qasja e bazuar në prodhim që përdor vlerat e paracaktuara, qasja e bazuar në prodhim që përlllogarit emetimet nga prodhimi i CaO, CaO-MgO dhe në informacionin specifik për vendin për faktorët e korrigjimit dhe qasja e bazuar në inputet e karbonateve.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e prodhimit, që janë përdorur për përlllogaritjen e emetimeve nga prodhimi i gëlqeres. Duke përdorur qasjen e Nivelit 1, faktori i emetimeve është marrë në vlerën 0,753.

Tabela 2: Prodhimi i gëlqeres në Shqipëri (2009-2019)

Përshkrimi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi i gëlqeres	[ton/vit]	114 802	46 039	46 320	23 096	23 007	26 700	26 800	18 300	22 830	27 650	24 937

➤ *Prodhimi i hekurit dhe çelikut*

Kategoria e prodhimit të hekurit dhe çelikut është një kategori kryesore për emetimet e CO₂ nëlidhje me nivelin e emetimeve. Në Shqipëri ka vetëm një fabrikë që prodhon hekur dhe çelik, pra fabrika Kurum në Elbasan, që prodhon i) Shufra metalike; ii) Shufra hekuri (Rebar); iii) Tel të laminuar të dhëmbëzuar; iv) Tel të laminuar të lëmuar; dhe v) Bobina.

Fabrika e çelikut Kurum, në Elbasan, përdor teknologjinë e furrës me hark elektrik (FHE), duke shkrirë skrapin e metalit të hekurit. Të dhënat e prodhimit të çelikut nga fabrika e çelikut Kurum, në Elbasan, jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3: Prodhimi i çelikut në fabrikën Kurum në Elbasan (2009-2019)

Përshkrimi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Lingota çeliku	[ton/vit]	nuk ka	390 850	463 620	381 692	312 789	433 735	239 300	111 072	270 224	392 000	400 584
Hekur katangë	[ton/vit]	nuk ka	235 882	295 393	248 327	249 476	272 541	234 200	121 161	260 558	366 000	379 041
Prodhimi i hekurit dhe çelikut	[ton/vit]	435 003	626 732	759 013	630 019	562 265	706 276	473 500	232 233	530 782	758 000	779 625

➤ *Prodhimi i aliazheve të hekurit*

Termi "aliazhe hekuri" përdoret për të përshkruar aliazhet e përqendruara të hekurit dhe një ose disa metale, të tilla si silici, mangani, kromi, molibdeni, vanadiumi dhe tungsteni. Në Shqipëri kryhet vetëm prodhimi i ferrokromit. Prodhimi i aliazheve të hekurit përfshin një proces reduktimi metalurgjik që gjeneron emetime të konsiderueshme të dyoksidit të karbonit. Në udhëzimet e PNNK-së parashtrihen disa qasje për llogaritjen e emetimeve të CO₂ nga prodhimi i aliazheve të hekurit. Metoda e Nivelit 1 llogarit emetimet nga faktorët e emetimeve të përgjithshme, që përdoren për prodhimin total të aliazheve të hekurit në një vend të caktuar, e cila përdoret edhe në këtë inventar. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e prodhimit, që janë përdorur për përllogaritjen e emetimeve nga prodhimi i ferrokromit.

Tabela 4: Prodhimi i ferrokromit në Shqipëri (2009-2019)

Përshkrimi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi i ferrokromit	[ton/vit]	27 267	22 518	28 502	24 018	24 700	34 897	43 669	44 551	50 199	92 851	66 402

➤ Prodhimi i aluminit

Të gjitha gazet e CO₂ dhe të PFC-ve të lidhura me proceset që çlirohen nga prodhimi i lingotave – prodhimi primar i aluminit. Prodhimi primar i aluminit (prodhimi i lingotave) nuk kryhet në Shqipëri, por ekzistojnë disa shoqëri që i përdorin lingotat për prodhimin e kornizave të ndryshme prej alumini, si edhe disa shoqëri riciklimi – prodhimi sekondar i aluminit. Pra, nuk ka emetime të lidhura me proceset, të gjeneruara nga prodhimi sekondar i aluminit. Sasia e prodhimit sekondartë aluminit paraqitet më poshtë.

Tabela 5: Prodhimi sekondar i aluminit në Shqipëri (2009-2019)

Përshkrimi	Njësia	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi i aluminit	[ton/vit]	nuk ka	20 332	20 550	19 842	21 530	16 516	17 110	21 840	27 047	25 167	23 771
Prodhimi i aluminit nga riciklimi	[ton/vit]	500	2605	3309	1940	4124	1345	9152	10 747	2910	3850	12 700
Totali i prodhimit të aluminit	[ton/vit]	500	22 937	23 859	21 782	25 654	17 861	26 262	32 587	29 957	29 017	36 471

➤ Prodhimi i plumbit

Prodhimi i plumbit konsiderohet primar kur kallëpet e plumbit të papërpunuar prodhohen nga koncentratet e plumbit, dhe sekondar kur plumbi riciklohet për ripërdorim. Në Shqipëri, kryhet prodhimi sekondar i plumbit, i cili ka një faktor të paracaktuar më të ulët të emetimeve në krahasim me prodhimin primar të plumbit. Faktori i paracaktuar i emetimeve i PNNK-së është shumëzuar me prodhimin kombëtar të plumbit nga riciklimi (siç tregohet në tabelën e mëposhtme) për të përlloragitur emetimet e CO₂ nga kategoria përkatëse e burimit.

Tabela 6: Prodhimi sekondar i plumbit në Shqipëri (2009-2019)

Përshkrimi	Njësi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi i plumbit (riciklimi)	[ton/vit]	nuk ka	3109	3351	2372	2078	2603	2091	1638	2210	1864	2478

➤ Gazet e fluorinuara (Gazet-F)

Hidrofluorokarbonet (HFC-të) dhe, në një masë tejet të kufizuar, perfluorokarbonet (PFC-të), po shërbejnë si alternativa ndaj substancave ozonholluese (SOH), të cilat po eliminohen gradualisht sipas Protokollit të Montrealit. Përdorimi i HFC-ve dhe PFC-ve në disa aplikime, konkretisht te shkuma e fortë (zakonisht shkuma me strukturë qelizore të mbyllur), ftohja dhe shuarja e zjarreve, mund të rezultojnë në zhvillimin e rezervave të materialeve rezistente.

Modelet e emetimeve nga këto përdorime mund të jenë veçanërisht të ndërlikuara dhe metodat që përdorin grupe të dhënash të disagreguara janë thelbësore për përllogaritjen e saktë të emetimeve. Aplikimet e tjera, të tilla si aerosolët dhe pastrimi me agjentë tretës mund të kenë inventarë stoku afatshkurtër, por, në kontekstin e përllogaritjes së emetimeve, mund të vijojnë të konsiderohen si burime të emetimeve direkte.

Duke qenë se CFC-të, halonet, tetrakloruri i karbonit, metilkloroformi, si dhe HCFC-të po eliminohen gradualisht, HFC-të po përdoren në mënyrë të përzgjedhur si zëvendësues të tyre. Gjithashtu, po përdoren edhe PFC-të, por në masë më të kufizuar. Edhe pse deri në 75% e aplikimeve të mëparshme të CFC-së mund të mbulohen nga teknologjitë pa fluorokarbon, përdorimi i HFC-së parashikohet që do të vazhdojë të rritet, të paktën në planin afatshkurtër.

Sipas informacionit të marrë nga projekti i OKBZHI në Shqipëri, konsumi/importi i gazeve-F në vend për periudhën 2017-2019 paraqitet si më poshtë.

Tabela 7: Importet e HFC-ve në Shqipëri (2012-2019)

IMPORTI I HFC-ve NË VEND [ton] (Materiali burimor: Raporti nga baza e të dhënave e OKBZHI)											
GAZET-F				2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
R-134a	HFC	Tetrafluoroetan	CF3CH2F	16,750	18,610	20,850	20,852	45,298	131,731	202,146	271,564
R-227ea	HFC	Heptafluoropropan	C3HF7	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	0,000	0,000	0,000
R-404A	HFC	Përzierje	R125 + R143a + R134a (%: 44/52/4)	6,400	10,460	11,730	28,819	46,238	58,081	78,282	116,829
R-407C	HFC	Përzierje	R32 + R125 + R134 (%: 23/25/52)	1,990	1,290	17,460	2,476	2,597	5,808	12,048	33,341
R-410A	HFC	Përzierje	R32 + R125 (%: 50/50)	8,860	10,200	21,360	15,980	30,256	60,350	123,897	87,423
R-507A	HFC	Përzierje	R125 + R143 (% 50/50)	0,862	2,600	0,000	0,056	0,875	1,447	8,172	17,120
R-32	HFC	Difluorometan	CH2F2				0,530	1,582	1,708	5,875	6,165
R-245fa	HFC	Pentafluoropropan	C3H3F5	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka
R-422B	HFC	Përzierje	R125 + R134a + R600	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka
HFC NË TOTAL				34,862	43,160	71,400	68,713	126,846	259,125	430,420	532,442

Duhet theksuar se periudha vijuese 2017-2019 është në përputhje me periudhën e mëparshme të përdorur në RDP. Emetimet nga të gjitha gazet e fluorinuara merren në konsideratë së bashku me sasinë totale të gazeve-F, me përjashtim të konsumit në tretës, që nuk përfshihet në inventar për shkak të mungesës së të dhënave të veprimtarisë.

o Sektori i bujqësisë

Në figurën e mëposhtme paraqiten emetimet e GES-ve nga sektori i bujqësisë për vitet 2009-2019. Gjatë kësaj periudhe, emetimet janë rritur me 4,7%, nga 2236,31 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 2341,53 kt CO₂ eq. në vitin 2019.




Figura 5: Emetimet e GES-ve nga sektori i bujqësisë (2009-2019)

Bujqësia është një nga sektorët kyç të ekonomisë shqiptare, e cila luan një rol të rëndësishëm por të ndryshueshëm dhe zë rreth 19,3% të PBB-së (2020)⁴³. Bujqësia siguron bazën e të ardhurave për pjesën më të madhe të popullsisë dhe shërben si një garanci punësimi. Sipas përlllogaritjeve, popullsia rurale përbën rreth 45% të popullsisë totale, ndërsa rreth 40% e fuqisë punëtore punon në bujqësi dhe në fusha të ngjashme. Është e dukshme që çdo ndryshim i konsiderueshëm i klimës në rang global do të ketë ndikim në bujqësinë e vendit. Megjithatë, për shkak të zhvillimit të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, kontributi i bujqësisë në PBB është ulur. Sektori i bujqësisë mbetet burimi kryesor i punësimit për më shumë se gjysmën e popullsisë.

Shqipëria është e ndarë në katër zona kryesore agroekologjike, ku pjesa më e madhe e tokës bujqësore dhe ajo më cilësore shtrihet në dy zonat e para agroekologjike:

Pjesa jugore e ultësirës bregdetare karakterizohet nga një klimë mesdhetare relativisht e thatë, me verë të nxehtë ku temperatura mesatare arrin 26°C. Klima në dimër është e butë dhe e lagësht, me temperaturë mesatare 9,8°C. Totali i reshjeve mesatare vjetore është 800- 1300 mm, por vetëm 12% e këtij totali bien në periudhën qershor-shtator. Në këtë rajon rriten shumë kultura bujqësore (drithë, kultura industriale, perime, foragjere etj.), si dhe agrumet dhe ullinjtë.

Pjesa qendrore dhe veriore e ultësirës bregdetare ka gjithashtu klimë mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë. Temperatura mesatare në verë është 23-24°C. Dimri është i lagësht dhe ka gjasa për ngrica. Sasia e reshjeve është më e lartë, veçanërisht në veri, ku arrin deri në 2000 mm. Kushtet klimatike janë të përshtatshme për kulturat bujqësore, të tilla si misri, perimet, foragjeret, hardhitë dhe pemët frutore.

Zona kodrinore shtrihet nga veriu në jug, me lartësi 600 metër mbi nivelin e detit. Luginat lumore shtrihen nga lindja në perëndim përgjatë gjithë zonës. Temperatura mesatare është 3-4°C më e

ulët se sa në zonat bregdetare, me ngrica të shpeshta. Ajo është e përshtatshme për rritjen e grurit, patates, lulediellit, duhanit, panxharsheqerit, perimeve, vreshtave dhe frutave.

Zona malore karakterizohet nga një klimë kontinentale me reshje që arrijnë deri në 600-1000 mm. Pjesa veriore e kësaj zone, në Alpet Dinarike, përjeton vlerat më të larta të reshjeve të shiut që variojnë ndërmjet 1500-2500 mm. Temperatura maksimale shënon rreth 25 °C në muajin korrik, temperaturat minimale në dimër ulen deri në -20 °C. Pjesa më e madhe e zonës mbulohet nga pyjet dhe kullotat. Janë zgjeruar fushat me grurë, foragjere, perime, patate dhe pemë frutore. Cilësia e tokës, pjerrtësia, aksesit në burime ujore, kushtet klimatike etj., ndryshojnë sipas rajonit.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ky sektor ka pasur zhvillim mesatar, duke filluar nga viti 2006. Megjithatë, zhvillimi i këtij sektori ndikohet shumë nga disa probleme strukturore. Infrastruktura relativisht e pazhvilluar në zonat rurale pengon daljen e prodhimeve bujqësore në treg. Fragmentimi i tokës bujqësore pengon organizimin efikas të prodhimit, ul rendimentin dhe rrit koston e përdorimit të mjeteve mekanike bujqësore. Ndërkohë, toka bujqësore nuk shfrytëzohet me kapacitet të plotë si pasojë e fenomenit të migracionit të jashtëm dhe të brendshëm të popullsisë. Ky fenomen së bashku me problemet e pronësisë ka kufizuar investimet e vazhdueshme në sektorin bujqësor.

Pavarësisht zgjerimit të përgjithshëm të kreditimit të ekonomisë gjatë periudhës 2000-2008, huatë për veprimtaritë bujqësore kanë mbetur në nivele të ulëta. Megjithatë, zgjerimi i këtij sektori gjatë periudhës 2005-2013 mendohet se ka kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Përveç kësaj, rritja e çmimeve bujqësore në tregjet botërore stimulon në mënyrë të përshtatshme rritjen afatgjatë të prodhimit në këtë sektor të ekonomisë shqiptare. Nga ana tjetër, reformat zhvillimore dhe strukturore (që synojnë të rrisin efikasitetin e prodhimit bujqësor, duke lehtësuar hyrjen e produkteve bujqësore lokale në tregjet vendase dhe të huaja si edhe të mbështesin financiarisht bizneset dhe fermat e këtij sektori) kanë qenë prioritet të politikave të ardhshme ekonomike.

○ **Blegtoria**

Prodhimi blegtoral konsiderohet si shtylla e bujqësisë shqiptare. Produktet blegtorale përbëjnë një burim kryesor ushqimi, duke e kthyer atë në sektorin më të rëndësishëm të bujqësisë. Megjithatë, intensiteti i prodhimit është i ulët në krahasim me standardet evropiane. Industria e bulmetit, së bashku me sistemin e grumbullimit të qumështit, janë ende në procesin e modernizimit të strukturave dhe teknologjive.

Në fund të viteve 1990, u hapën fabrikat e para private të përpunimit të qumështit në rajone të ndryshme të vendit. Shumica e njësisë të vogla të përpunimit përdorin ende teknologjitë tradicionale artizanale.

Numri i bagëtive ka mbetur pothuajse i pandryshuar që nga viti 2000. Sidoqoftë, sektori i shpendëve është i vetmi që vijon të ketë rritje të vazhdueshme vit pas viti. Numri i derrave dhe i njëhundra këve është pothuajse i njëjtë me ndryshime shumë të vogla vit pas viti. Numri i deleveka prirjen të rritet, ndërsa numri i gjedhëve po reduktohet vit pas viti.

Nga ana tjetër, pavarësisht disa ndryshimeve të vogla, numri i shpendëve është rritur nga viti në vit, deri në 2011-ën. Pas vitit 2011 është vënë re një zbritje e lehtë në numër.

Emetimet e GES-ve nga blegtoaria varen në masë të madhe nga numri, struktura dhe përbërja e llojit të kafshëve. Një tjetër faktor i rëndësishëm është menaxhimi i plehut sipas secilës kategori.

➤ *Fermentimi enterik*

Fermentimi enterik i referohet fermentimit të ushqimit të kafshëve si pjesë e proceseve tretëse normale të gjëja e gjallë. Për sa i përket bagëtive të imëta (kryesisht dhentë, delet dhe dhitë), njësisasi e konsiderueshme e fermentimit kryhet në rumen, duke rezultuar në emetime relativisht të mëdha të metanit për kalori ushqimor të konsumuara. Pseudo-bagëtitë e imëta (p.sh. kuajt) dhe kafshët monogastrike (p.sh. derrat) nuk kanë të njëjtin nivel fermentimi ushqimor, dhe rrjedhimisht emetimet nga kafshët në fjalë janë relativisht të pakta. Për këtë arsye, treguesit e emetimeve të metanit nga fermentimi enterik përqendrohen kryesisht te bagëtitë e imëta. Rreth 83% e CH₄ nxirret gjatë proceseve të fermentimit enterik.

Kafshët "monogastrike" prodhojnë sasi të pakta metani si rezultat i fermentimit rastësor që ndodh gjatë procesit të tretjes. "Kafshët barngrënëse jo-ruminante" prodhojnë metan në nivele të ndërmjetme me atë që prodhojnë kafshët monogastrike dhe bagëtitë e imëta. Edhe pse këto kafshë nuk kanë rumen, një pjesë e mirë e fermentimit kryhet në zorrën e trashë, duke bërë të mundur tretjen dhe përdorimin në masë të konsiderueshme të materialit bimor. Faktorët e emetimeve bazohen në të dhënat e karakteristikave të kafshëve dhe ushqimeve të tyre. Specifikisht, faktorët e emetimeve bazohen në kërkesat mesatare të kafshës për energji, sasinë mesatare të ushqimit të nevojshëm për të plotësuar kërkesat e tyre për energji dhe cilësinë e ushqimit të konsumuar.

Të dhënat për emetimet e GES-ve nga fermentimi enterik paraqiten në tabelën e mëposhtme; Emetimet e GES-ve nga fermentimi enterik në Gg CO₂ eq. sipas viteve.


Tabela 8: Emetimet e GES-ve nga fermentimi enterik (2009-2019)

Kategoria bagëtime	e 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjedhët	905,63	906,13	904,05	914,80	913,08	916,75	921,25	904,91	879,04	865,35	777,55
Lopët qumështore	733,89	738,05	735,97	744,28	740,12	744,28	742,20	738,05	725,57	713,10	656,96
Lloje të tjera të gjedhëve	171,74	168,08	168,08	170,52	172,96	172,47	179,05	166,87	153,47	152,25	120,58
Buajt	0,00	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14	0,14
Delet	185,64	189,63	184,59	189,95	194,88	199,08	201,39	207,06	202,23	195,72	184,59
Dhitë	81,06	81,38	79,70	85,05	91,04	94,92	97,86	98,81	97,97	96,29	90,62
Kuajt	13,23	14,36	13,23	12,85	13,23	12,10	11,72	12,10	12,10	12,10	12,10
Mushkat dhe gomarët	13,44	13,23	13,44	13,23	12,18	12,39	12,60	13,02	11,97	11,76	11,55
Derrat	3,36	3,44	3,42	3,34	3,19	3,61	3,59	3,80	3,78	3,86	3,86
TOTALI	1202,36	1208,31	1198,57	1219,36	1227,74	1238,99	1248,55	1239,84	1207,22	1185,22	1080,41

Në këtë rast, gjedhët janë emetuesit kryesorë të GES-ve, që përbëjnë rreth 74% të totalit në kategorinë e bagëtive. Kategoritë e tjera të bagëtive që kontribuojnë ndjeshëm janë delet me 15% dhe dhitë me 7,3%.

Bagëtitë riprodhohen në mbarë botën dhe përbëjnë një burim të konsiderueshëm të emetimeve të CH₄ në rang global. Sasia e metanit të emeluar nxitet kryesisht nga numri i kafshëve, lloji i aparatit tretës, si dhe lloji dhe sasia e ushqimit të konsumuar.

GHGs from enteric fermentation for the year 2019. Share of emissions within the livestock category, in %



Rreth 62,7% e emetimeve nga fermentimet enterik vijnë nga gjedhët. Për sa i përket fermentimit enterik, situata për vitin 2019 paraqitet në figurën 6.

Figura 6: Përqindja e emetimeve të GES-ve nga fermentimi enterik për vitin 2019

➤ Menaxhimi i plehut

Menaxhimi i plehut i referohet, marrjes, magazinimit, trajtimit dhe përdorimit të plehut të kafshëve në një mënyrë të qëndrueshme nga ana mjedisore. Ai mund të mbahet në mjedis të ndryshme magazinuese. Plehu i kafshëve (i njohur gjithashtu si mbetjet e kafshëve) mund të jetë në formë të lëngshme, gjysmë të lëngshme ose të ngurtë. Ai përdoret duke u shpërndarë në fusha në sasi që pasurojnë tokën pa shkaktuar ndotje të ujit ose nivele të larta të papranueshme të pasurimit me lëndë ushqyese. Menaxhimi i plehut është një përbërës i menaxhimit të lëndëve ushqyese. Emetimet nga menaxhimi i plehut përbëjnë rreth 17% të totalit të GES-ve nga bagëtitë. Plehu nga gjëja e gjallë emeton CH₄ nga fermentimi enterik, dhe CH₄ e N₂O në kushte anaerobike (pa oksigjen). Kjo ndodh për shkak se lënda organike brenda plehut nis të dekompozohet nga bakteret anaerobike; rezultatet e këtij dekompozimi përfshijnë metanin, dyoksidin e karbonit dhe lëndët organike të stabilizuara. Sasia e plehut të prodhuar dhe sasia e plehut që dekompozohet në mënyrë anaerobike janë thelbësore për përcaktimin e emetimeve të metanit. Faktorët që ndikojnë në këto dy aspekte janë lloji i sistemit të menaxhimit të plehut dhe klima. Gjedhët janë një burim i rëndësishëm i CH₄ për shkak të numrit të madh të tyre dhe shkallës së lartë të emetimeve të CH₄ në sajë të aparatit të tyre tretës ripërtypës. Emetimet e oksidit të azotit nga menaxhimi i plehut variojnë ndjeshëm ndërmjet llojeve të përdorura të sistemit të menaxhimit dhe mund të rezultojnë në emetime me efekt jo të drejtpërdrejtë për shkak të formave të tjera të humbjes së azotit nga sistemi.

Sistemet e menaxhimit të plehut mund të klasifikohen gjerësisht si në formë të lëngshme ose të thatë. Sistemet në formë të thatë përfshijnë veprimtari të tilla si shpërndarja e plehut çdo ditë, tharja e vendeve të ushqyerjes, magazinimi në gjendje të ngurtë dhe plehu i paadministruar nga gjëja e gjallë në kullota. Sistemet e lëngshme shpesh gjenden në sistemet e administrimit intensiv të gjësë së gjallë, të cilat ndodhin gjatë praktikave që përdorin depozita ose pellgje për magazinimin e plehut. Këto sisteme krijojnë kushte ideale anaerobike. Emetimet më të konsiderueshme të plehut shoqërohen me operacionet e administrimit të kafshëve në ambiente të mbyllura, ku plehu trajtohet në sisteme të lëngshme.

Prodhimi i N₂O gjatë magazinimit dhe trajtimit të mbetjeve nga kafshët mund të ndodhë nëpërmjet nitrifikimit-denitrifikimit të kombinuar të azotit që përmbajnë mbetjet. Sasia e N₂O që çlirohet, varet nga sistemi dhe kohëzgjatja e menaxhimit të mbetjeve. Duke qenë se për prodhimin e N₂O nevojitet një proces fillestar aerobik dhe më pas një proces anaerobik, supozohet që sistemet e menaxhimit aerobik në të thatë mund të ofrojnë një mjedis më të favorshëm për prodhimin e N₂O.


Tabela 9: Emetimet e GES-ve nga menaxhimi i plehut në Gg CO₂ eq. sipas viteve

Kategoria e bagëtive	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjedhët	249,44	249,82	249,23	252,16	251,51	252,60	253,47	249,55	242,97	239,11	215,89
Lopët qumështore	211,09	212,28	211,69	214,08	212,88	214,08	213,48	212,28	208,70	205,11	188,96
Lloje të tjera të gjedhëve	38,35	37,54	37,54	38,08	38,63	38,52	39,99	37,27	34,27	34,00	26,93
Buajt	0,00	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04	0,04
Delet	9,53	9,74	9,48	9,75	10,00	10,22	10,34	10,63	10,38	10,05	9,48
Dhitë	5,39	5,41	5,30	5,66	6,06	6,31	6,51	6,57	6,52	6,40	6,03
Kuajt	1,32	1,43	1,32	1,28	1,32	1,20	1,17	1,20	1,20	1,20	1,20
Mushkat dhe gomarët	1,32	1,30	1,32	1,30	1,20	1,22	1,24	1,28	1,18	1,16	1,13
Derrat	15,71	16,10	16,00	15,61	14,92	16,89	16,79	17,77	17,67	18,07	18,07
Shpendët	4,15	4,21	4,63	4,73	4,45	4,73	4,27	4,15	3,91	4,17	4,08
TOTALI	286,86	288,05	287,31	290,53	289,50	293,21	293,81	291,20	283,87	280,20	255,92

Figura 7: Emetimet e GES nga menaxhimi i plehut .

Situata lidhur me emetimet e GES-ve nga ky proces për vitin 2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Emetimet e GES-ve nga menaxhimi i plehut per vitin 2019, ne %



Në këtë rast, gjedhët kontribuojnë me 85% të emetimeve (ose 215,89 Gg CO₂ eq.)

➤ Emetimet e drejtpërdrejta të N₂O

Oksidi i azotit është një komponim i ndërmjetëm i gaztë në reaksionin zinxhir të denitrifikimit dhe një nënprodukt i nitrifikimit që rrjedh nga qelizat bakteriale në tokë me destinacion final atmosferën. Në shumicën e tokave, shtimi i sasisë së azotit (N) të disponueshëm përmirëson nivelet e nitrifikimit dhe denitrifikimit, që më pas rrisin prodhimin e N₂O. Sasia e azotit të disponueshëm mund të rritet nga veprimtaritë e shkaktuara nga njeriu ose nga ndryshimi i përdorimit të tokës dhe/ose praktikave të menaxhimit që mineralizojnë tokën me azot organik.

Burimet e mëposhtme të azotit, që janë përllogaritur në këtë inventar si emetime të drejtpërdrejta të N₂O nga tokat e administruara janë:

- Plehëruesit azotikë sintetikë
- Azoti organik i përdorur si plehërues
- Urina dhe azoti nga plehu i kafshëve, të depozituar në kullota, livadhe dhe kullota të lira nga kullotja e kafshëve

- Azoti në mbetjet e kulturave bujqësore (mbi dhe nën sipërfaqen e tokës), bimët fiksuese të azotit dhe nga foragjeret gjatë ripërtëritjes së kullotave
- Mineralizimi i azotit i lidhur me humbjen e lëndës organike të tokës, si rezultat i ndryshimit të përdorimit të tokës ose menaxhimit të dherave minerale
- Kullimi/administrimi i tokave organike.




Figura 8: GES-et nga emetimet e drejtpërdrejta të N₂O nga tokat e administruara në kt CO₂ eq.

Për sa i përket emetimeve të drejtpërdrejta të N₂O, burimet më të rëndësishme janë sekretimet e azotit nga menaxhimi i plehut, që varen nga numri dhe kategoria e bagëtive, sistemet e menaxhimit të plehut, azoti organik i përdorur në tokat e administruara, emetimet e drejtpërdrejta të N₂O nga tokat e administruara (Azoti në plehëruesit sintetikë, në plehun e kafshëve, në dherat minerale) Tendencia e emetimeve të GES-ve shënon rritje të lehtë me 11% (ose 1% në vit) nga viti 2009 në krahasim me vitin 2019.

➤ Emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O

Pavarësisht emetimeve të drejtpërdrejta të N₂O nga tokat e administruara që ndodhin përmes një trajktoreje të drejtpërdrejtë, N₂O emetohet edhe në rrugë të tërthorta:

Avullimi i azotit si NH₃ dhe okside azoti (NO_x), depozitimi i këtyre gazeve dhe produkteve të tyre NH₄ dhe NO₃ në tokë dhe në sipërfaqen e burimeve ujore.

Kullimi dhe rrjedhja e azotit nga toka nga lëndët shtesë të plehëruesve sintetikë dhe organikë, mbetjet e kulturave bujqësore, mineralizimi i azotit i lidhur me humbjen e karbonit të tokës nëdherat minerale dhe tokat organike të kulluara/administruara përmes ndryshimit të përdorimit të tokës ose praktikave të menaxhimit, si dhe depozitimi i urinës dhe plehut nga kullotja e kafshëve. Kjo mund të ndodhë në ujërat nëntokësore të tokës në të cilën është aplikuar azoti, ose në zonatku derdhen ujërat nga kullimi ose rrjedhja, ose në kanale, përrenj, lumenj dhe grykëderdhje (duke përfshirë sedimentet e tyre) ku rrjedhin përfundimisht ujërat nga kullimi..




Figura 9: GES-et nga emetimet e N₂O nga tokat e administruara

Në këtë rast, burimet e azotit nga emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O nga tokat e administruara janë:

- -Plehëruesit azotikë sintetikë të përdorur gjatë periudhës së inventarit
- -Azoti organik i përdorur si plehërues (pleh kafshësh i aplikuar, kompost, llum i ujërave tëndotura dhe lëndë të tjera organike)
- -Urina dhe azoti nga plehu i kafshëve, të depozituar në kullota, livadhe dhe kullota të lira ngakullotja e kafshëve
- -Azoti në mbetjet e kulturave bujqësore (mbi dhe nën sipërfaqen e tokës), bimët fiksuese të azotit dhe nga foragjeret/nga ripërtëritja e kullotave të kthyera në toka etj.




Figura 10: GES-et nga emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O nga menaxhimi i plehut (në Gg CO₂)

Në këtë rast, emetimet më të konsiderueshme vijnë nga azoti i plehut që avullon përmes sistemeve të menaxhimit të plehut, sasia/përqindja e azotit të plehut që humbet për shkak të kullimit/rrjedhjes dhe emetimeve me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O për shkak të kullimit dhe rrjedhjes nga menaxhimi i plehut. Në këtë kategori nuk vërehet ndonjë tendencë e dukshme lidhur me emetimet e GES-ve.


➤ Aplikimi i uresë

Duke qenë se aplikimi i uresë ndikon në emetimet e drejtpërdrejta dhe ato me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O, më poshtë gjendet një përmbledhje e kontributit të këtij plehëruesi në emetimet e GES-ve në Shqipëri gjatë periudhës së inventarit.

Sasia e aplikimit të uresë ndryshon me kalimin e viteve, por ka një tendencë në rritje për përdorimin e këtij plehëruesi në vend me 32% në harkun kohor 2009-2019. Siç është rasti edhe për aspektet e tjera bujqësore, fermerët vazhdojnë të blejnë lëndë ushqyese pa pasur informacionin/konsultimin e duhur për sa i përket kërkesave të bimëve apo analizave të tokës.

Kjo gjë vijon të mbetet një sfidë e vazhdueshme, për të cilën shërbimi i ekstensionit bujqësor dhe institucionet shkencore dhe kërkimore duhet të udhëheqin qasjen e bujqësisë së qëndrueshme në vend.


Figura 11: GES-et nga emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të N₂O nga menaxhimi i plehut



o Sektori i përdorimit të tokës, ndryshimit të përdorimit të tokës dhe i pyjeve

Gjatë periudhës 2009-2019, emetimet e GES-ve nga sektori i PTNPTP-së janë reduktuar me 10,2%, nga 1 593,69 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 1 431,89 kt CO₂ eq. në vitin 2019. Emetimet u rritën ndjeshëm në vitet 2011 dhe 2012 për shkak të zjarreve në pyje.


Figura 12: Emetimet e GES-ve nga sektori i PTNPTP-së për vitet 2009-2019



➤ **Toka pyjore**

Emetimet/përthithjet e GES-ve nga kategoria e tokave pyjore për vitet 2009-2019, paraqiten në figurën e mëposhtme. Duke marrë në konsideratë raportin ndërmjet rritjes së biomasës pyjore dhe eliminimit të saj nga shpyllëzimi dhe zjarret në pyje, në total rezulton se pyjet kanë qenë emetues të GES-ve gjatë viteve 2009-2017. Për shkak të keqadministrimit të pyjeve dhe degradimit të tyre nga prerja dhe zjarret, CO₂ mbetet gazi kryesor i emetuar nga ky sektor, ndërsa pyjet mbeten burimi kryesor i emetimeve të GES-ve. Gjatë viteve 2018-2019 pyjet u kthyen në përthithës të GES-ve në sajë të reduktimit të humbjes së biomasës pyjore gjatë këtyre dy viteve

Figura 13: Inventari i GES-ve për kategorinë e tokave pyjore për vitet 2009-2019




Pyjet janë përthithës të GES-ve për shkak të rritjes së biomasës së tyre. Gjatë periudhës së inventarit, pyjet kanë përthithur CO₂ nga atmosfera. Rritja vjetore mesatare është vetëm 1,4 m³/ha/vit. Kjo gjë rezulton edhe në kufizimin e sasisë së CO₂ që akumulohet. Nga ana tjetër, për shkak të zjarreve dhe prerjes së pyjeve, ata mund të kthehen në emetues të GES-ve.

Pyjet mbulojnë rreth 36% të sipërfaqes së tokës së Shqipërisë. Disa sipërfaqe të tjera të tokave të pyllëzuara janë përfshirë në llogaritjet e mbulesës pyjore, ku gjysma klasifikohen si korije dhe korije me standarde, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga pyje të larta. Pothuajse katër të pestat e pyjeve të mbjella janë të llojit gjethëgjërë, kryesisht të llojit gjetherënëse, dhe lis dhe ah me

gjelbërim të përhershëm. Gjatë viteve të fundit, politikat e burimeve pyjore në Shqipëri kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme. Në vitin 2016, qeveria shqiptare ngarkoi 61 NJQV me detyrën e administrimit të pyjeve (me përjashtim të zonave të mbrojtura), dhe miratoi një moratorium për prerjen e pyjeve, me qëllimin e reduktimit të vjeljes së paqëndrueshme të lëndëve drusore në vend.

Gjatë 60 viteve të fundit, pyjet shqiptare kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme dhe si rezultat sipërfaqja pyjore është reduktuar me mbi 300 000 ha, kryesisht për shkak të pastrimit për qëllime bujqësore.⁴⁴ Me përjashtim të shpyllëzimit për qëllime bujqësore, fondi pyjor është reduktuar për shkak të degradimit nga prerja, zjarret në pyje dhe mbikullotja, e cila ka ndryshuar strukturën e moshës së pyjeve, përbërjen e llojeve dhe vëllimin e stokut. Për shumë vite e dekada, shfrytëzimi i pyjeve e ka tejkaluar rritjen vjetore, gjë e cila ka rezultuar në reduktim të stokut pyjor në rritje.

Figura 14: Fondi pyjor përgjatë dekadave



➤ Toka bujqësore

Tokat bujqësore përfshijnë tokat e punueshme dhe të lërueshme, të gjitha kulturat njëvjeçare dhe shumëvjeçare dhe tokat djerrë të përkohshme. Kulturat njëvjeçare përfshijnë drithin, farat vajore, perimet, rrënjët e bimëve dhe foragjeret. Kulturat shumëvjeçare përfshijnë pemët dhe shkurret, në kombinim me kulturat barishtore (p.sh., agropylltaria), pemishtet, vreshtat dhe plantacionet me fruta arnore. Toka e punueshme (arë), që zakonisht përdoret për kultivimin e kulturave njëvjeçare, por që përdoret përkohësisht për kulturat foragjere apo për kullotje, në kuadër të rotacionit vjetor kultura-kullotje (sistemi i përzier), përfshihet në kategorinë e tokave bujqësore. Sasia e karbonit të ruajtur dhe të emetuar ose të përthithur nga tokat bujqësore të përhershme varet nga lloji i kulturës, praktikat e menaxhimit dhe variablat e tokës dhe të klimës.





Figura 15: Përthithjet e GES-ve nga tokat bujqësore për vitet 2005, 2009 dhe 2010-2016 (në kt CO₂ eq.)

o **Sektori i mbetjeve**

Në figurën e mëposhtme paraqiten emetimet e GES-ve nga sektori i mbetjeve për vitet 2009-2019. Gjatë kësaj periudhe, emetimet janë rritur me 42%, nga 620,90 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 881,56 kt CO₂ eq. në vitin 2019.

Figura 16: Emetimet e GES-ve nga sektori i mbetjeve (2009-2019)



Emetimet e GES-ve që mbulon sektori i mbetjeve përfshijnë kategoritë e mëposhtme: Asgjësimi i mbetjeve të ngurta; Trajtimi biologjik i mbetjeve të ngurta; Incinerimi dhe djegia e mbetjeve në ambiente të hapura; dhe Trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të përdorura. Në shumicën e qyteteve janë ngritur sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane. Megjithatë, riciklimi i mbetjeve është në nivele shumë të ulëta. Nuk ka sisteme grumbullimi në zonat rurale dhe nëqytetet e vogla. Shumica e mbetjeve nga këto zona asgjësohen duke u hedhur në kanale, lugina ose në anë të rrugëve, nga ku transportohen përmes ujit dhe erës në toka të tjera dhe në përfundim në rrugët ujore. Emetimet nga sektori i mbetjeve janë rritur vit pas viti. Në vitin 2019, kontributi më i madh i emetimeve ka rezultuar nga asgjësimi i mbetjeve të ngurta, i ndjekur nga trajtimi i ujërave të përdorura.

Gjatë viteve të fundit, menaxhimi i mbetjeve urbane në Shqipëri është rinovuar plotësisht, pas përdorimit të teknologjisë së incinerimit.

Nuk ekziston një sistem për menaxhimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme (shtëpiake ose tregtare), dhe riciklimi i mbetjeve mbetet në nivele të ulëta. Metoda e zakonshme e trajtimit të mbetjeve në qytete është përmes hedhjes së tyre në vendgrumbullime të papërshtatshme nga pikëpamja ndërtimore (pra, nuk janë landfillë), duke rezultuar kështu në ndotje të përhershme të mjedisit.

Problemet e gjenerimit dhe menaxhimit të mbetjeve janë të shumta dhe të ndryshme. Sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara (sipas peshës) prirjen të jenë materialet inerte, konkretisht ato të ndërtimit, por rreziqet më të mëdha lidhen me vëllimet më të vogla të mbetjeve të rrezikshme (kryesisht industriale). Për mbetjet urbane nevojiten masa të zgjeruara dhe të kushtueshme për grumbullimin, transportin dhe asgjësimin. Për disa kategori të veçanta, si p.sh. mbetjet klinike, duhet të zbatohen masa të veçanta.

Ky sektor paraqet disa nga vështirësitë më të mëdha për Shqipërinë, ku raporti "Për gjendjen e mjedisit" për këtë periudhë përmbledh çështjet e mëposhtme:

- ✚ Sistemet për grumbullimin dhe eliminimin e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe joefikase
- ✚ Nuk mund të merren vendime të informuara për opsionet e grumbullimit dhe asgjësimit nëmungesë të informacioneve të besueshme
- ✚ Nuk ka një traditë të trajtimit dhe asgjësimit të duhur të mbetjeve
- ✚ Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme
- ✚ Qytetarët nuk janë të ndërgjegjësuar për dëmin e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i ujërave të përdorura aktualisht konsiston në transportimin e ujërave të përdorura në kanale dhe më pas në lumenj. Aktualisht, në vend nuk ka asnjë impiant trajtimi të ndërtuar përfundimisht. Megjithatë, ekzistojnë disa projekte për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura, ndërkohë që impianti i trajtimit të ujërave të përdorura në Kavajë është në ndërtim e sipër. Në kapacitetin e tij maksimal, do t'i shërbejë 100 000 njerëzve.

➤ *Prekursorët dhe emetimet e gazeve me efekt jo të drejtpërdrejtë*

Edhe pse nuk përfshihen në totalin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në potencialin e llogaritur të ngrohjes globale, emetimet e monoksidit të karbonit (CO), të oksideve të azotit (NO_x), të përbërësve organikë të avullueshëm pa metan (NMVOC), dhe të dyoksidit të squfurit (SO₂) raportohen në inventarët e gazeve me efekt serrë. CO, NO_x dhe NMVOC-të të cilët në praninë e dritës së diellit kontribuojnë në formimin e gazit me efekt serrë, pra të Ozonit (O₃) në troposferë, dhe shpeshherë quhen "prekursorë të ozonit". Për më tepër, emetimi i NO_x luan një roltë rëndësishëm në ciklin e azotit të tokës. Emetimet e SO₂ rezultojnë në formimin e grimcave të sulfatit, të cilat ndikojnë në ndryshimet klimatike. Amoniaku (NH₃) është prekursor i aerosolit por luan një rol më pak të rëndësishëm në formimin e aerosolit, në krahasim me SO₂.

Tabela 10: Përmbledhje e emetimeve të prekursorëve nga të gjithë sektorët (Gg)

NO _x , Categories	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
1-Energy	23.828	25.656	26.183	26.526	27.401	32.834	33.063	39.200	39.220	39.244	39.255
2-IPPU	0.259	0.055	0.063	0.049	0.011	0.06	0.000	0.010	0.000	0.000	0.000
3- LULUCF	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
4-Waste	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
Total	24.087	25.711	26.246	26.575	27.412	32.894	33.063	39.210	39.220	39.244	39.255

Udhëzimet më të fundit të PNNK-së të vitit 2006 për Inventarët Kombëtarë të Gazeve me Efekt Serrë, në kapitullin 7, "Prekursorët dhe emetimet e gazeve me efekt jo të drejtpërdrejtë" paraqesin mënyra për miratimin e metodologjive lidhur me llogaritjen e emetimeve të ndryshme nga GES, duke referuar kapitujt përkatës të metodologjisë në udhëzuesin e inventarit të emetimeve EMEP/CORINAIR.

Emetimet e NO_x, CO, NMVOC-ve dhe SO₂ janë shtuar në mënyrë konsistente, të plotë dhe të krahasueshme për të gjithë periudhën e inventarit 2009-2019. Fatkeqësisht, softueri i PNNK-së për inventarët nuk përmban një modul që mbështet llogaritjen e prekursorëve, prandaj llogaritja e emetimeve të këtyre gazeve është bërë në skedarë të veçantë Excel-i, në bazë të raporteve të Shqipërisë, sipas Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët (NNADL)" të KEKBE-së. Oksidi i azotit prodhohet në tokë përmes procesit biologjik të nitrifikimit dhe denitrifikimit. Emetimet e N₂O do të shtohen edhe nga azoti i depozituar në oqeanë e liqene. Për këtë arsye, Udhëzimet e vitit 2006 përfshijnë shpjegime për përlllogaritjen e emetimeve të N₂O që vijnë nga depozitimi i azotit në të gjitha burimet antropogjene të NO_x dhe NH₃.

Vlerat e emetimeve të gazeve prekursorë, të vëna në dispozicion nga Konventa e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët (NNADL)" e KEKBE-së, janë integruar në programin e llogaritjes së GES-ve të PNNK-së, dhe janë shumëzuar me faktorin përkatës të emetimeve. Analiza tregon se sektori i transportit kontribuon në pothuajse 65-75% të totalit të gazeve prekursorë çdo vit. Emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të NO₂ nga sektori i PIPP-së vijnë nga nënkategoritë e prodhimit të çimentos dhe të prodhimit të hekurit dhe çelikut. Prekursorët dhe gazet e tjera (CO, NO_x, NMVOC-të dhe SO₂) vijnë kryesisht nga nënkategoritë e prodhimit të çimentos dhe të prodhimit të hekurit dhe çelikut, si dhe nga përdorimi i aluminit, industria e celulozës dhe e letrës dhe nga industria e ushqimit dhe pijeve. Këto të dhëna janë marrë edhe nga NNADL-ja dhe janë hedhur në skedarin përfundimtar Excel të sektorit të PIPP-së.

Burimet jo të drejtpërdrejta të emetimeve të N₂O nga sektori i PTNPTP-së lidhen me avullimin e azotit si NH₃ dhe të oksideve të azotit (NO_x), dhe me depozitimin e këtyre gazeve dhe produkteve të tyre NH₄⁺ dhe NO₃ në tokë dhe në ujëra. Burimet e azotit në formën e NH₃ dhe NO_x vijnë kryesisht nga plehëruesit bujqësorë sintetikë dhe organik, kullimi dhe rrjedhja e azotit nga toka përmes plehëruesve, mbetjet e kulturave bujqësore, mineralizimi i azotit, depozitimi i urinës dhe plehut nga kullotja e kafshëve, si edhe nga djegia e biomasës. Emetimet me efekt jo të drejtpërdrejtë të NO₂ nga sektori i mbetjeve gjenerohen gjatë asgjësimit në sipërfaqe të mbetjeve

të ngurta si rezultat i depozitimeve të NH₃. Këto depozitime raportohen në përputhje me Konventën e vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët" të KEKBE-së. Emetimet e derivuara me efekt jo të drejtpërdrejtë të NO₂ janë të papërfillshme. Këto emetime janë NMVOC-të për kategoritë e asgjësimit të mbetjeve të ngurta dhe trajtimit biologjik të mbetjeve të ngurta.

2.2.1 Gjetjet kryesore

- ✓ Sektori i transportit përbën konsumin më të madh final të energjisë (40,22% në vitin 2019), i pasuar nga sektori familjar (25,02% në vitin 2019) dhe ai i industrisë (19,02% në vitin 2019). Burimet kryesore të emetimeve të GHG vijnë nga proceset industriale që transformojnë materialet fizikisht ose kimikisht (për shembull, furnalatat në industrinë e hekurit dhe çelikut dhe në industrinë e çimentos).
- ✓ Emetimet e GHG në sektorin e bujqësisë janë rritur me 4,7%, nga 2236,31 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 2341,53 kt CO₂ eq. në vitin 2019
- ✓ Në sektorin e blegtorisë, gjedhët janë emetuesit kryesorë të GES-ve, që përbëjnë rreth 74% të totalit në kategorinë e bagëtive. Kategoritë e tjera të bagëtive që kontribuojnë ndjeshëm janë delet me 15% dhe dhitë me 7,3%. Emetimet e GES-ve nga blegtoaria varen në masë të madhe nga numri, struktura dhe përbërja e llojit të kafshëve. Një tjetër faktor i rëndësishëm është menaxhimi i plehut.
- ✓ Pyjet janë përthithës të GES-ve për shkak të rritjes së biomasës së tyre. Gjatë periudhës së inventarit, pyjet kanë përthithur CO₂ nga atmosfera. Rritja vjetore mesatare është vetëm 1,4 m³ /ha/vit. Kjo gjë rezultoi në kufizimin e sasisë së CO₂ që akumulohet. Nga ana tjetër, për shkak të zjarreve dhe prerjes së pyjeve, ata mund të kthehen në emetues të GES-ve. Pyjet më cilësore në Shqipëri janë pyjet e larta, të cilat mbulojnë rreth 36% të sipërfaqes së fondit pyjor dhe 83% të vëllimit të stokut.
- ✓ Emetimet nga sektori i mbetjeve janë rritur me 42%, nga 620,90 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 881,56 kt CO₂ eq. në vitin 2019. Emetimet e GES-ve nga sektori i mbetjeve përfshijnë asgjësimin i mbetjeve të ngurta, trajtimin biologjik i mbetjeve të ngurta, incinerimin dhe djegia e mbetjeve në ambiente të hapura dhe trajtimin dhe shkarkimin i ujërave të përdorura

2.3 Masat zbutëse

1- Sektori i prodhimit të energjisë

- Eliminimi i pengesave dhe stimulimi i investimeve në energjinë e rinovueshme në shkallë të vogël. Kjo masë synon mundësimin e një procesi tranzicioni drejt diversifikimit, largimit nga energjia hidrike dhe promovimit të burimeve alternative të energjisë së rinovueshme. Konsumi final bruto i energjisë synohet të arrijë në 42% deri në vitin 2030.

Djegia e lëndëve djegëse në sektorin industrial

Eliminimi i pengesave dhe stimulimi i depërtimit të efikasitetit të energjisë për stoqet e elektromotorëve, kaldajat industriale dhe teknologjitë e tjera të konsumit të energjisë.

Konsumi i energjisë në sektorin e shërbimeve

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë (EE) të ndërtesave të shërbimeve qendrore dhe bashkiake, si dhe të ndërtesave të shërbimeve private të cilat janë pjesë e sektorit të shërbimeve. Kjo do të arrihet përmes prezantimit të një grupi masash të EE-së për përmbushjen e kërkesave minimale, masash për zero emetime neto dhe masash të EE-së lidhur me kaldajat me biomasë dhe sistemet e paneleve diellore për ujë të ngrohtë. Për përmirësimin e performancës së energjisë do të merren në konsideratë kushtet lokale dhe klimatike, komforti i brendshëm i ndërtesave dhe masat me kosto efektive. Synimi është rinovimi, çdo vit, i një 2%-shi të mëtejshëm të stokut të ndërtesave publike (që janë nën administrim publik, që përdoren nga një autoritet publik ose që përdoren për ofrimin e shërbimeve publike) për të përmbushur kërkesat minimale të performancës së energjisë.

Konsumi i energjisë në sektorin e banesave

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë të ndërtesave me një dhe disa njësi banimi në sektorin e banesave. Kjo do të arrihet përmes prezantimit të një grupi masash të EE-së për përmbushjen e kërkesave minimale, për zero emetime neto dhe për kaldajat me biomasë. Për përmirësimin e performancës së energjisë do të merren në konsideratë kushtet lokale dhe klimatike, komforti i brendshëm i ndërtesave dhe masat me kosto efektive.

Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë në sektorin e bujqësisë, veçanërisht në fushat e mëposhtme, konsumi i energjisë së përdorur nga traktorët, konsumi i energjisë së përdorur për ujitje, biomasa bujqësore.

2-Sektori i Transportit

Reduktimi i emetimeve nga transporti rrugor përbën një zhvendosje modale drejt mënyrave aktive të udhëtimit, si pedalimi dhe ecja, si dhe inkurajon përdorimin e transportit publik. Kjo masë përfshin gjithashtu zhvillimin e një sistemi efikas transporti, siç dokumentohet në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, 2018-2030. Strategjia Kombëtare e Energjisë detajon objektivin e reduktimit të përdorimit të mjeteve private, rritjes së lëvizshmërisë përmes mjeteve elektrike (përmes energjisë elektrike të furnizuar nga impiantet e energjisë së rinovueshme/prodhuesit e energjisë së rinovueshme për konsum vetjak), si për transportin e pasagjerëve ashtu dhe për atë të mallrave. Për shembull, brenda vitit 2030, 30% e udhëtimeve të transportit rrugor në distanca prej më shumë se 300 km do të kalojnë drejt modalitetëve të tjera të transportit, shifër kjo që do të rritet deri në 50% brenda vitit 2050.

3-Sektori i Bujqësisë

Optimizimi i ushqimit të kafshëve

Reduktimit të emetimeve të GES-ve nga blegtoaria, me anë të përmirësimit të ushqimit të kafshëve. Kjo mund të realizohet përmes masave të tilla si, ushqyerja e bagëtive dhe kafshëve të tjera në bazë të nevojave për lëndë ushqyese, nxitja e efikasitetit të prodhimit blegtoral dhe përdorimit të burimeve, përpjekja për dieta të shëndetshme e të qëndrueshme, si dhe marrja në konsideratë e alternativave proteinike, përdorimi i aditivëve të ushqimit të bagëtive dhe zgjedhja e ushqimeve cilësore të cilat do të reduktojnë metanin e çliaruar nga fermentimi enterik.

Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të plehut

Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të plehut, me anë të përmirësimit të praktikave të grumbullimit, trajtimit, depozitimit dhe aplikimit të plehut në toka. Një gjë e tillë jo vetëm përmirëson rendimentin, por mund të sjellë gjithashtu edhe përfitime të tjera shtesë të tilla si reduktimi i rrjedhjes së azotit (NO₃) dhe fosforit (P), si dhe reduktimi i avullimit të amoniakut (NH₃) dhe emetimeve të oksidit të azotit (N₂O) dhe metanit (CH₄). Masat e tjera mund të përfshijnë: Mbulimin e objekteve të depozitimit të plehut, optimizimin e përdorimit të plehut me anë të planit të menaxhimit të lëndëve ushqyese dhe kapjen dhe djegjen e metanit të çliruar nga plehu i depozituar.

4- Sektori PTNPTP

Zbatimi i praktikave agropjore në tokat bujqësore

Reduktimin e emetimeve me anë të zbatimit të praktikave agropjore në tokat bujqësore. Kjo do të arrihet përmes (1) sekuestrimit të karbonit në biomasën tokësore dhe në toka, (2) reduktimit të emetimeve të GES-ve dhe (3) parandalimit të emetimeve nëpërmjet reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile dhe energjisë fosile.

Realizimi i pyllëzimeve të reja

Pyllëzimi i tokave të degraduara pyjore me anë të mbjelljes së llojeve me rritje të shpejtë, çka mund të rezultojë në: (1) sekuestrimin e karbonit në biomasën tokësore dhe në toka, (2) reduktimin e emetimeve të GES-ve dhe (3) parandalimin e emetimeve nëpërmjet reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile dhe energjisë fosile. Në bazë të rrethanave kombëtare dhe duke marrë në konsideratë tendencat aktuale, potenciali për pyllëzime të reja vlerësohet në 300 hanë vit.

Përmirësimi i menaxhimit dhe i monitorimit me qëllim parandalimin e zjarreve

Rritja e përthithjes së karbonit në ekosistemet pyjore në Shqipëri, me anë të përfundimit të mbrojtjes së pyjeve nga zjarret. Ndonëse nuk është e mundur të parashikohen rastet e ardhshme të zjarreve, përmirësimi i monitorimit dhe i menaxhimit të zjarreve në pyje do të ndihmojë në reduktimin e këtij rreziku. Kjo do të arrihet përmes një programi gjithëpërfshirës masash për të investuar në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, çka mund të rezultojë në: (1) sekuestrimin e karbonit në biomasën tokësore dhe në toka, (2) reduktimin e emetimeve të GES-ve dhe (3) parandalimin e emetimeve nëpërmjet reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile dhe energjisë fosile.

Përmirësimi i rendimentit të djegies së druve të zjarrit nëpërmjet rritjes së efikasitetit të sobave me dru

Përmirësimi i efikasitetit të djegies së druve të zjarrit me anë të futjes në përdorim të sobave me dru tejet efikase. Kjo do të arrihet përmes një programi gjithëpërfshirës masash për të investuar në futjen në përdorim të sobave të reja me dru tejet efikase (deri në 95%), çka mund të rezultojë në: (1) sekuestrimin e karbonit në biomasën tokësore dhe në toka, (2) reduktimin e emetimeve të GES-ve dhe (3) parandalimin e emetimeve nëpërmjet reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse fosile dhe energjisë fosile. Kjo do të rezultojë gjithashtu në reduktimin e mbetjeve të drurëve të zjarrit.

Përmirësimi i shfrytëzimit të pyjeve

Për shkak të nivelit të ulët të mekanizimit në fushën e pylltarisë, një pjesë e konsiderueshme e biomasës pyjore nga prerja e druve mbetet në pyje. Kjo biomasë e pashfrytëzuar arrin deri në 25% të biomasës totale nga prerja e druve në pyje. Përmirësimi i shfrytëzimit të pyjeve nënkupton reduktimin e sasisë së biomasës së vjelë të mbetur në pyje, me qëllim reduktimin e saj nga 25% deri në 15% në vitin 2030.

Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve

Rritja e biomasës pyjore nëpërmjet ndërhyrjeve silvikulturore, duke rezultuar kështu në intensifikimin e rritjes vjetore të biomasës.

Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve me anë të mbajtjes nën kontroll të insekteve të dëmshme dhe sëmundjeve

Përmirësimi i mbajtjes nën kontroll të insekteve të dëmshme dhe sëmundjeve në pyje, i cili do të rezultojë në intensifikimin e rritjes totale të biomasës.

5-Menaxhimi i mbetjeve

Përmirësimi i menaxhimit dhe i monitorimit të grumbullimit në landfille

Reduktimi i sasisë së mbetjeve që dërgohen në landfille: reduktim prej 35% në sasinë (në bazë të peshës) e mbetjeve bashkiake të biodegradueshme që janë gjeneruar dhe që dërgohen në landfille, krahasuar me vitin 2010. Sa më sipër është në përputhje me kuadrin rregullator kombëtar në fuqi (dekreti qeveritar nr. 418, datë 27.5.2020)

Instalimi i impianteve të kapjes së metanit: nisja e praktikës së kapjes së CH₄ në vitin 2025 dhe një zhvillim linear me një kapje të metanit deri në masën 10% nga 1,34 milionë m³ CH₄ deri në vitin 2030. Rritja e sasisë së mbetjeve të kompostuara: rritje prej 85% në periudhën 2009-2020, si dhe një rritje prej 3% çdo vit deri në vitin 2030.

Zhvillimi i teknologjisë së incinerimit të mbetjeve me rikuperim të energjisë

Rritja e incinerimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (MNU), intensifikimin e kalimit nga dërgimi i mbetjeve në landfille dhe vendgrumbullim, në incinerimin e tyre, uljen e sasisë së mbetjeve të djegura në ambiente të hapura, me anë të përmirësimit të normave të grumbullimit të MNU-ve.

KAPITULLI 3

MJEDISI BREGDETAR

KAPITULLI 3

MJEDISI BREGDETAR

3.1 Të përgjithshme

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer monitorimin e cilësisë së ujërave bregdetare në 20stacione të zonës bregdetare në qytetet Durrës, Vlorë , Sarandë, Shëngjin, Velipojë, Dhërmi, Himarë, Borsh, Lukovë, Ksamil dhe Zvërnec. Gjithashtu ky institucion ka kryer dhe vlerësimin e ndikimit të shkarkimeve urbane të lëngëta në mjediset ujore pritëse.


Vlerësimi për përmbajtjen e parametrave mikrobiologjik Intestinal Enterococce (IE) dhe Escherichia Coli (EC) është kryer nga Instituti i Shëndetit Publik në 123 stacione monitorimi në plazhet kryesore të bregdetit tonë.

Monitorimi i dinamikës bregore të bregdetit Shqiptar është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me një periudhë kohore 4 vjeçare për secilin segment monitorimi që shtrihet në bregdetine deteve Jon dhe Adriatik. Zonat me problematikë më të madhe mbahen në monitorim të vazhdueshëm nëpërmjet sondazheve të përvitshëm.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është institucioni përgjegjës për kontrollin e zonës bregdetare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Gjithashtu monitoron sipërfaqet bregdetare të shfrytëzuara për sezonin turistik.

3.2 Gjendja dhe tendenca

3.2.1 Cilësia e ujërave bregdetare larëse



Bregdeti i Shqipërisë përfshin pjesë të Detit Adriatik dhe Detit Jon. Bregu i Detit Jon është i njohur për bukurinë e tij me malësi shkëmbore dhenjë biosferë të mrekullueshme detare, ndërsa bregu i Detit Adriatik përbëhet nga plazhe me rërë dhe ujëra të cekëta bregdetare.

Plazhi i Pogradecit është një plazh i cili ndodhet pranë qytetit të Pogradecit, në brigjet e Liqenit të Ohrit dhe si i tillë është plazhi më i madh liqenor në Shqipëri.

Pjesa më e madhe e ndotësve mikrobiologjik e kimik të ujërave larëse e kanë origjinën nga aktivitetet njerëzore dhe shkarkimi i ujërave urbane të pa

Monitorimi mikrobiologjik është kryer në tre sezone, në muajin Maj para sezonit të larjes, gjatë sezonit të larjes Qershor-Shtator dhe pas sezonit të larjes. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes për parametrat mikrobiologjik Escherichia Coli (EC) dhe Intestinal Enterococce (IE), kryhet bazuar mbi standarte të WHO/UNEP, BE për kategorizimin sipas vlerave 90- 95%-tile

Tabela 1: Kategorizimi për cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes


Kategoria	A	B	C	D
Vlera Limit e	< 100 *	101-200 *	185**	> 185 **
Cilësia e ujit	Cilësi e shkëlqyer	Cilësi e mirë	Cilësi e mjaftueshme	Cilësi e keq/Masa të menjëhershme
* - 95 -th percentile Intestinal Enterococci/100 ml				
** - 90 - th percentile Intestinal Enterococci /100 ml				

➤ Plazhet Velipojë, Shëngjin dhe Tale

Plazhi i Velipojës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	B-R Belavista	49	51	A	14.3% , A-cilësi e shkëlqyer
2	Hotel Adriatik	52	106	B	
3	B-R Fantazia	71	151		
4	Hyrja Plazh	84	135	B	71% , B- cilësi e mirë
5	Pallatet e Reja	131	117	B	
6	Dolce Vita	185	200	B	14.3% , C- cilësi e mjaftueshme
7	Pranë Lagunës Vilunit	126	216	B	

Referuar rezultateve mikrobiologjike në plazhet e Velipojës për vitin 2023 vlerësohet se: 1 stacion i përket kategorinë C- Cilësisë së mjaftueshme, pika 1 vlerësohet në kategorinë A- të Cilësisë shumë të mirë dhe pikat e tjera vlerësohen të kategorisë B- Cilësisë së mirë.



Në plazhin e Velipojës për vitin 2023, numri i stacioneve që i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave është më i ulët se vitet e mëparshme. Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësi e mirë të ujërave dhe i kategorisë C- Cilësi e mjaftueshme për vitin 2023 është më i lartë se vitet e kaluara. Pra kemi një tendencë në ulje të cilësisë të ujërave duke kaluar nga cilësi e shkëlqyer në cilësi të mirë.

Vihet re që nuk kemi stacione të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, për periudhën 2016-2023.


Plazhi i Shëngjinit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Ish kabinat	255	191	B	20% , B-cilësi e mirë
2	Hotel "Doro"	221	251	D	
3	Hotel "Kristian"	317	418	D	20% , C-cilësi e mjaftueshme
4	B-R Gjahtari	476	570	D	
5	Kune	231	268	C	60% , D-cilësi e keqe

Sipas rezultateve mikrobiologjike, rezulton se pika 5, vlerësohet në kategorinë C- Cilësisë së mjaftueshme, pikat 2, 3, 4 vlerësohen të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujrave, pika 1 vlerësohet në kategorinë B- Cilësisë së mirë.

Për vitin 2023, rezulton se nuk kemi stacione që i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, krahasuar me vitet e mëparshme. Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujrave, për vitin 2023 është i lartë

Nga grafiku i mëposhtëm shihet tendencë në ulje e cilësisë së ujërave duke kaluar nga cilësi e shkëlqyer (2022) në cilësi e keqe (2023).




Plazhi Tale

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja qendrore, djathtas, tek Palmat	144	218	C	33.3%, B-Cilësi e mirë 66.6, C- cilësi e mjaftueshme
2	Në qendër të hyrjes, tek Antena	107	137	B	
3	Majtas hyrjes qendrore, Bar-Restorant USA	152	267	C	

Sipas rezultateve bakteriologjike, këto plazhe vlerësohen në kategorinë: B- Cilësisë së mirë dhe kategorisë C-Cilësisë së mjaftueshme.

Tendenca e cilësisë së ujërave sipas kategorive në %, plazhi Tale



Për Plazhin Tale në vitin 2023, është rritur numri i stacioneve të Kategorisë B- cilësi e mirë dhe C- cilësi e mjaftueshme. Nuk kemi stacione të kategorisë A- cilësi e shkëlqyer.

Vlerësohet tendencë në ulje e cilësisë të ujërave krahasuar me vitet e mëparshme, duke kaluar nga cilësi e shkëlqyer në cilësi të mjaftueshme.

➤ **Plazhet e Durrësit dhe Gjirit të Lalzit**

Plazhi i Durrësit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Currila 1	391	205	C	33.4%, B- Cilësi e mirë
2	Plazhi Currila 2	209	153	B	
3	Plazhi Zhiron	950	763	D	
4	Ura e Dajlanit	581	447	D	
5	Plazhi Filadelfia	295	280	D	
6	Plazhi Teuta	264	234	C	
7	Plazhi Gostivar	313	188	B	
8	Apollonia	302	205	C	
9	Hekurudha (Policia)	267	180	B	14.6, C- Cilësi e mjaftueshme
10	Hotel Adriatik	169	121	B	
11	Plazhi Iliria (pista)	182	105	B	
12	Iliria pranë Bllokut	174	152	B	
13	Ministria e Rendit	117	155	B	52%, D- Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme
14	Kompleksi Tropikal	253	200	D	
15	Pas kanalit (Plepa)	2887	2682	D	
16	Shkëmbi i Kavajës	928	880	D	
17	Bar Hotel Hoti	374	387	D	
18	Plazhi Benilva	304	361	D	
19	Plazhi, Hotel Andi	358	269	D	
20	Hotel Xixa	501	329	D	
21	Kompleksi Xhardino	514	576	D	

Plazhet e Durrësit për vitin 2023, sipas rezultateve bakteriologjike vlerësohen: të kategorisë B- Cilësisë së mirë për 7 pika monitorimi, të Kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme për 3 pika monitorimi, dhe të kategorisë D- Cilësisë së keqe për 11 pika monitorimi.

Tabela 2. Plazhi i Durrësit. Vlerësimi i cilësisë së ujrave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016- 2023 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
A-Cilësi e shkëlqyer	5%	33%	66.7%	71.5%	90.5%	38%	28.5%	0%
B - Cilësi e mirë	33%	33%	23.8%	0%	0%	47.7%	48%	33.4%
C - Cilësi e mjaftueshme	19%	24%	0%	19%	0%	4.8%	9.5%	14.3%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	43%	10%	9.5%	9.5%	9.5%	9.5%	14%	52%

Numri stacioneve të kategorisë B – Cilësia e mirë e ujërave për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe më i ulët se vitet 2021, 2022.


Numri stacioneve të kategorisë C – Cilësia e mjaftueshme e ujërave, për vitin 2023 është më i ulët se në vitet 2016, 2017, 2019, dhe është më i lartë në krahasim me 2018, 2020, 2021, 2022.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshme, për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me vitet e kaluara.

✓ Plazhet e Gjirit të Lalzit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Kepi i Rodonit	77	42	A	40%, A- Cilësi e shkëlqyer
2	Fshati Turistik Lura	79	55	A	
3	Plazhi Publik pas Lurës	77	120	B	
4	Gjiri Lalzit (Kompleksi Alioma)	138	118	B	60%, B-Cilësi e mirë
5	Gjiri Lalzit (Fshati Turistik Lura 3)	205	172	B	

Për gjirin e Lalzit gjatë 2023 vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave 2 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësisë së mirë , 3 pika monitorimi.




Për plazhin e Lalzit në periudhën 2020-2022, të gjitha stacionet i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pa ngarkesa mikrobike. Kurse për vitin 2023 kemi uljen e numrit të stacioneve të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer dhe rritjen e stacioneve të kategorisë B- Cilësi e mirë

✓ **Plazhi i Kavajës(Golem)**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Majami	1384	1718	D	44.5%, B-Cilësi e mirë
2	Vjena	1214	1416	D	
3	Golem-Kosmira	1107	1294	D	
4	Vapori mbytur	2877	4750	D	
5	Kompleksi FAFA (ish Piceri Jurgen)	189	117	B	55,5%, D -Cilësi e keqe/ Masa të menjëherëshme
6	Piceri Argjëndi	167	102	B	
7	Mak Albania	462	347	D	
8	Lokali Reshatit	462	138	B	
9	Bunkeri i Bardhë	138	110	B	

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Kavajës gjatë monitorimit vlerësohen: të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshm pikat 1,2,3,4,7 dhe të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujrave për 3 pikat e monitorimit 5, 6, 8, 9.




Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshme, për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me vitet e mëparshme. Vihet re tendencë në ulje e cilësisë të ujërave duke kaluar nga cilësi e shkëlqyer dhe e mirë (2022) në cilësi të mirëdhe të keqe (2023).

✓ **Plazhi i Qerretit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Qerret, Ish Fusha Sportit	2328	804	D	100%, D- Cilësi e keqe/ Masa të menjëherëshme
2	Kompleksi Belavista	3198	1159	D	
3	Qerret, Bar-Kafe Holliday	4412	1758	D	

Për vitin 2023, sipas rezultateve mikrobiologjike vlerësohen të kategorisë D- Cilësia e keqe/ Masa të menjëherëshme në të gjitha pikat e kampionimit




Referuar grafikut shihetnjë përkeqësim i cilësisë të ujërave krahasuar me vitet e mëparshme, dukekaluar nga cilësi e shkëlqyer në cilësi të keqe.

✓ **Plazhi i Spillesë**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Spille Djathtas, Bar-Restorant Martini	293	327	D	100% , D-Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme
2	Spille Qendër, Hotel Basana	286	326	D	
3	Greth i Mesëm, Palmat e fundit	345	344	D	

Sipas rezultateve mikrobiologjike vlerësohen të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshme në të gjitha pikat e kampionimit.



Gjatë vitit 2023 vihet re një ulje e cilësisë. Ujërat janë të kategorisë D- Cilësi e keqe/ Masa të menjëherëshme në krahasim me vitin 2022, ku plazhet ishin të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.


➤ **Plazhet e Semanit dhe i Divjakës:**

✓ **Plazhi i Semanit dhe Darëzës:**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja në plazh, tek Policia, Bunkerit	245	130	B	43%, A-cilësi e shkëlqyer
2	Kulla e Ujit	215	89	A	
3	Plazhi Darzëzë	138	140	B	43%, B- cilësi e mirë
4	Lokali Gjermanit Seman	125	260	C	
5	Bar restorant 4 Flamuj Seman	73	87	A	

6	Lokali Ilir Lani Darzez	63	72	A	14%, C- Cilësi e mjaftueshme
7	Ish reparti ushtarak Pish Poro	120	148	B	

Sipas rezultateve bakteriologjike, këto plazhe vlerësohen: të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujrave për 3 stacione , të kategorisë C – Cilësia e mjaftueshme e ujërave 1 stacion, dhe kategorisëA- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, 3 stacione.




Për vitin 2023 ka një ulje të kategorisë A-cilësi e shkëlqyer të ujërave, në krahasim me tre vitet 2020, 2021, 2022 ku të gjitha pikat e monitorimit të analizuar, vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

✓ **Plazhi i Divjakës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja në plazh, tek Policia	196	195	B	33.3% A- Cilësi e shkëlqyer
2	Hyrja kryesore në plazh	220	205	C	
3	1000 m larg dhe majtas pikës 2	154	171	A	33.3% B- Cilësi e mirë 33.3% C- Cilësi e mjaftueshme

Sipas rezultateve bakteriologjike plazhet e Divjakës për vitin 2013, vlerësohen: A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave pika 3 e kampionimit, e kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave pika 1 e kampionimit dhe e kategorisë C – Cilësia e mjaftueshme e ujërave pika 2 e kampionimit.




Plazhet e Divjakës gjatë vitit 2023 rezultojnë të kenë ulje e cilësisë së ujërave në krahasim me vitet e mëparshme, të cilat i përkasin kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer në të gjitha stacionet e monitorimit.

➤ **Plazhet e Zvërnecit ,Vlorës dhe Orikumit**

✓ **Plazhi i Zvërnecit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Para Xhemalit (djathtas)	67	97	A	100% A-Cilësie shkëlqyer
2	Bar-Restorant Olsi (në mes)	101	99	A	
3	Bar-Restorant Kapiteni (majtas)	141	83	A	

Plazhet e Zvërnecit, gjatë 2023, pas përpunimit të rezultateve për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.




Kemi një përmirësim të dukshëm të cilësisë gjatë viteve 2022-2023, ku të gjitha stacionet janë të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave krahasuar me vitin 2021.

✓ **Plazhi i Vlorës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi i Vjetër, Kampi i Pionierëve	295	447	D	30 % A- Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi i Vjetër, Kabinat	304	500	D	
3	Shkolla e Marinës	965	1191	D	10% B-Cilësi emirë
4	Plazhi i Ri	499	814	D	
5	Ish Vilat, Blloku	66	100	A	
6	Jonufer	120	255	C	20 % C- Cilësi e mjaftueshme
7	Plazhi Paradisë	59	83	A	
8	Plazhi Lame Borshi	55	80	A	40% D-Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme
9	Radhimë, Hotel Grand	117	183	B	
10	Lokali Boja 1	212	295	C	

Për plazhin e Vlorës gjatë 2023 kanë rezultuar 30% plazhe të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer të ujërave, 10% plazhe të kategorisë B- Cilësi e mirë të ujërave, 20% plazhe të kategorisë C- Cilësi e mjaftueshme të ujërave dhe 40% plazhe të kategorisë D- Cilësi e keqe të ujërave.



Për vitin 2023, kemi tendencë në ulje të stacioneve që i përkasin kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer.


Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme të ujërave dhe i kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, ka tendencë në rritje krahasuar me vitin 2022.

Kjo tregon përkeqësim të cilësisë të ujërave.

✓ **Plazhi i Orikumit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Kompleksi Orikum	110	193	B	67% B-Cilësi e mirë
2	Bar- Restorant Aleksandër	133	307	C	
3	Para Repartit Pashaliman	87	178	B	33% C-Cilësi e mjaftueshme

Sipas rezultateve analitike, këto plazhe vlerësohen të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme të ujërave I pikë monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësi e mirë, 2 pika monitorimi.




Për vitin 2023 nuk kemi stacione të kategorisë A-Cilësi shkëlqyer të ujërave, duke paraqitur kështu, një tendencë në ulje krahasuar me vitet e kaluara. Shihet një ulje e cilësisë të ujërave në plazhin Orikum nga cilësi e shkëlqyer dhe e mirë (2021-2022) në cilësi të mirë dhe të mjaftueshme (2023).

➤ **Plazhet e Palasës, Drimadhes, Dhërmiut, Jalës, Livadhes,**

✓ **Plazhi i Palasës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi i Palasës 1	30	30	A	100% A- Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi i Palasës 2	30	28	A	

Për plazhin e Palasës të dy pikat e monitorimit nuk kanë ngarkesa mikrobiale, janë të kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer të ujërave.




Plazhi i Palasës për periudhën 2020-2023 ka cilësi të shkëlqyer të ujërave.

Të gjitha stacionet i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

✓ **Plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi te Lisi	89	44	A	66.7 % A- Cilësie shkëlqyer
2	Hotel Anastasia	270	165	B	
3	Kampi i Punëtorëve	66	28	A	
4	Plazhi Drimadhes 1	187	80	A	33.3% B- Cilësi e mirë
5	Plazhi Drimadhes 2	154	81	A	

Sipas rezultateve bakteriologjike, këto plazhe vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për pika 1, 3 ,4,5 dhe të kategorisë B- Cilësi e mirë pika 2 e kampionimit.




Për plazhin e Dhërmiut për vitin 2023, numri i stacioneve që i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave është më të ulët se në vitet e kaluara. Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësi e mirë, (33.3 %) është më të lartë se vitet e kaluara.

✓ **Plazhi i Jalës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Jalë Djathtas	73	81	A	100% A- Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Jalë Majtas	92	86	A	

Plazhet e Jalës gjatë 2023, vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, nuk kanë ngarkesa mikrobiale.




Plazhet e Jalës përgjatë periudhës 2020- 2023, i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave

✓ **Plazhi i Livadhes**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Livadhe 1	52	74	A	100% A- Cilësi e shkëlqyer
2	Livadhe 2	64	55	A	
3	Livadhe 3	67	51	A	

Plazhet e Livadhes gjatë 2023 nuk rezultojnë me prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) dhe vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.




Plazhet e Livadhes përgjatë periudhës së monitorimit 2021-2023, i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer. Ujërat janë pa ngarkesa mikrobiale.

✓ **Plazhi i Himarës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Himarë qendër	181	161	B	50% A-Cilësie Shkëlqyer
2	Pas Shkëmbit	115	106	B	
3	Potam Alqi	80	51	A	50% B-Cilësie mirë
4	Hotel Likoka	118	89	A	

Sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 2 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësi e mirë, 2 pika monitorimi.




Për plazhin e Himarës vihet re një tendencë në ulje për tre vitet e fundit 2021-2023 krahasuar me periudhën 2016-2020 ku të gjitha stacionet e këtyre plazheve i përkisnin cilësisë së shkëlqyer.

✓ **Plazhi i Qeparoit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Qeparo majtas	132	168	B	100% B- Cilësi e mirë
2	Qeparo djathtas	122	167	B	

Sipas rezultateve bakteriologjike, për vitin 2023 këto plazhe vlerësohen në kategorinë B – Cilësia e mirë e ujërave.




Për vitin 2023 nuk kemistacione që i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

Kjo tregon një tendencë në ulje të cilësisë të ujërave duke kaluar nga cilësi e shkëlqyer (2020-2022) në cilësi të mirë(2023).

✓ **Plazhi i Borshit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Borshi Djathtas	72	91	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Borshi në mes	55	78	A	
3	Borshi Majtas	49	59	A	

Plazhet e Borshit gjatë 2023 vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Nuk ka prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal.



Për plazhin e Borshit për vitin 2022 dhe 2023, cilësia e ujërave i përket kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer 100%, pa ngarkesa mikrobiale në krahasim me vitin 2021, ku 33% e stacioneve i përkisnin cilësisë të mirë.

✓ **Plazhi i Lukovës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Lukova Djathtas	72	91	A	100% A- Cilësi e shkëlqyer
2	Lukova në mes	55	78	A	
3	Lukova Majtas	49	59	A	


Gjatë vitit 2023, pas vlerësimit për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal, rezulton se Plazhet e Lukovës i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer.

Referuar paraqitjes grafike të mëposhtme për periudhën 2020-2023, vlerësohet se Plazhi i Lukovës i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

✓ **Plazhi i Sarandës**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Limion	153	112	B	16.6% A-Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Pllaka	106	92	A	33.4% B- Cilësi e mirë
3	Plazhi i Ri	458	219	C	16.6% C-Cilësi e mjaftueshme
4	Plazhi i Fëmijëve	533	267	D	33.4% D-Cilësi e keqe
5	Hotel Grand	180	137	B	/Masa të menjëherëshme
6	Kanali i Çukës	1106	574	D	

Plazhet e Sarandës për vitin 2023 vlerësohen: , të kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer, të kategorisë B- Cilësisë së mirë, të kategorisë C-Cilësi e mjaftueshme, dhe të Kategorisë D- Cilësisë së keqe.



Për vitin 2023 kemi rritje të stacioneve që i përkasin kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer krahasuar me 2022.


Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2023 janë më të ulëta krahasuar me vitin 2022.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujrave janë më të larta krahasuar me periudhën 2016-2020 dhe më të ulëta krahasuar me vitet 2021 dhe 2022. Kemi një tendencë në ulje të cilësisë së ujërave për tre vitet e fundit (2021-2023) krahasuar me vitet e mëparshme.

✓ **Plazhi i Ksamilit**

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Rilindja	157	176	B	33.3% A-Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Bora-Bora	109	111	B	shkëlqyer
3	Plazhi Kështjella	88	78	A	66.7% B- Cilësi e mirë

Sipas rezultateve bakteriologjike, këto plazhe vlerësohen të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer, 1 pikë monitorimi dhe të Kategorisë D- Cilësisë së mirë, 2 pika monitorimi.




Për vitin 2023, ujërat e kategorisë A - Cilësi e shkëlqyer janë në ulje krahasuar me periudhën 2020 - 2022. Nuk kemi stacione të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2023. Kjo tregon një përmirësim të situatës krahasuar me 2022 ku 33% e stacioneve i përkisnin kësaj kategorie.

Plazhet Lin-Pogradec

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 500	IE 95% - Norma 200	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Lin Hotel-Resort Relaks	81	85	A	12.5% , A- Cilësie shkëlqyer
2	Resort Komplex Lyhnida	395	526	C	
3	Dogana – pika e Molit	213	291	B	
4	Hotel Enkelana (Ish Turizmi i vjetër)	2420	4168	D	25%, B- Cilësi e mirë
5	Hotel 1 Maj	4267	4634	D	
6	Tushemisht Hotel Millenium	246	316	B	12.5%, C- Cilësi mjaftueshme
7	Hotel Depo (Kompleksi Ermano)	4159	5303	D	
8	Voloreka	922	955	D	50%, D-Cilësi e keqe

Sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer pika 1, të kategorisë B- Cilësi e mirë pikat 3 dhe 6, të Kategorisë C- Cilësi e mjaftueshme pika 2, të kategorisë D- Cilësi e keqe pikat 4, 5, 7 dhe 8.



Numri i stacioneve të kategorisë A- Cilësisë së shkëlqyer të ujërave, për vitin 2023 është ulur në krahasim me vitin 2022.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2023 është e rritur lehtësisht në krahasim me vitin 2022, 2021, por është ulur në krahasim me 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë C - Cilësi e mjaftueshme, për vitin 2023 është ulur në krahasim me vitin 2022.

Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2023 është rritur në krahasim me vitin 2022.

Tabela 3: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes, për vitin 2023 numri i stacioneve për secilën kategori.

KATEGORIA	A-Cilësi e shkëlqyer	B-Cilësi e mirë	C-Cilësi e mjaftueshme	D-Cilësi e keqe Masa të menjëherëshme
STACIONE	34	40	15	34
%	27.8%	32.5%	12.1%	27.6%

Sipas rezultateve mikrobiologjike vlerësohen të cilësisë shumë të mirë plazhet e Zvërnecit, Palasës, Drimadhes, Jalës, Livadhes dhe Lukovës. Gjatë sezonit veror të vitit 2023 u konstatua prani e lartë e pushuesve gjatë gjithë sezonit në të gjithë bregdetin e Shqipërisë. Sezoni është zgjatur në kohë si rezultat i temperaturave të larta.

Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të këtyre ujërave.

Tabela 4. Tendenca e cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016-2023 (e shprehur sipas numrit të stacioneve dhe e shprehur në %)

Cilësia	2016		2017		2018		2019		2020		2021		2022		2023	
	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione
A-Cilësi e shkëlqyer	53%	52	68%	53	82.4%	89	89%	106	89.9%	107	51%	60	67.5%	83	27.8%	34
B-Cilësi e mirë	23%	23	15%	12	13%	14	2.5%	3	5.0%	6	32%	38	19.5%	24	32.5%	40
C-Cilësi e mjaftueshme	9%	9	6%	5	0.9%	1	6%	7	0.9%	1	8%	10	4.1%	5	12.1%	15
D-Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	15%	15	10%	8	3.7%	4	2.5%	3	4.2%	5	9%	11	8.9%	11	27.6%	34

Numri i stacioneve të kategorisë A- Cilësisë shumë të mirë, për plazhet e monitoruara për vitin 2023 është më i ulur në krahasim me vitet 2016, 2017, 2018, 201, 2020,2021 dhe 2022.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me vitet 2016, 2017, 2018, 201, 2020, 2021 dhe 2022.

Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë e keqe për vitin 2023 është më i lartë në krahasim me vitet 2016,2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

✚ Cilësia e ujrave bregdetare në Dhërmi, Himarë, Borsh, Lukovë, Ksamil, Zvërnec, Shëngjin, Velipojë.



Bazuar në Programin e Monitorimit për vitin 2023 është realizuar vlerësimi i parametrave fiziko –kimikë në zonat bregdetare siç janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 5. Stacionet e monitorimit të zonave bregdetare

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i stacionit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dhe	Zonë bregdetare Dhërmi	Në mes të plazhit kryesor	N 40.083187 E 19.380408
2.	Hi	Zonë bregdetare Himarë	Plazhi në mes të qytetit të Himarës	N 40.060153 E 19.443742
3.	Bo	Zonë bregdetare Borsh	Në det 100 m larg bregut	N 40.023901 E 19.503488
4.	Lu	Zonë bregdetare Lukove	Në det 100 m larg bregut	N 39.582651 E 19.543780
5.	Ks	Zonë bregdetare Ksamil	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N 39.462753 E 20.000157
6.	Zv	Zonë bregdetare Zvërnec	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N 40.294703 E 19.251227
7.	Shgj1	Zonë bregdetare Shëngjin	Tek porti jashtë argjinaturës	N 41.4841 E 19.3533
8.	Shgj2	Zonë bregdetare Shëngjin	Në fund të plazhit, afër Kunes	N 41.4741 E 19.3680
9.	Ve1	Zonë bregdetare Velipojë	Kompleksi “La Maroja”	N 41.5653 E 19.3615
10.	Ve2	Zonë bregdetare Velipojë	100 m larg ujë këmbimit det - lagunë	N 41.5435 E 19.2625


✓ Oksigjeni i tretur

Ky parametër është matur in – situ dhe nga vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara, ujërat janë të ngopura me oksigjen të cilat variojnë nga 10 – 12 mg/l.




✓ Nevoja kimike për oksigjen

Referuar grafikut të mëposhtëm vlerat mesatare të matura nuk janë vlerësuar në vlera të larta.



✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Ky parametër është shumë i rëndësishëm për të vlerësuar ndotjen organike e cila ka si burim shkarkimet urbane të patrajtura, duke vlerësuar grafikun e mëposhtëm vlerat mesatare janë të ulëta të cilat variojnë nga 2 – 5 mgO/l.




✓ Përmbajtja e amonjakut

Sic vihet re edhe nga grafiku, ku janë paraqitur vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara vihet re përmbajtje në vlera shumë të ulëta që variojnë nga 0.06 – 0.39 mg/l (< 1 mg/l).

✓ Përmbajtja e nitriteve


Prania e nitriteve në ujërat bregdetare të monitoruara në keto stacione është vlerësuar në vlerashumë të ulëta.



Është vlerësuar përmbajtja e ulët e fosforit në vlera deri 0.012 mg/l.

Në stacionet e monitoruara vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithëparametrat fiziko - kimikë.

3.2.2 Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare



Vlerësimi i ndikimit të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare është kryer në qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë.

Në qytetin e Durrësit, ujërat urbane shkarkohen në det, në zonën e Porto Romanos (Spitalle), në qytetin e Vlorës shkarkohen në det në zonën e Pyllit të Sodës, kurse në qytetin e Sarandës shkarkohen në kanalën e Çukës e më pas në det.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave urbane është kryer sipas normave të shkarkimeve të lëngëta urbane nga impiantet e trajtimit, të përcaktuara në VKM Nr.177 datë 31.03.2005, që janë të njëjta me ato të Direktivës së Komunitetit

Tabela. 6 Normat e shkarkimeve të lëngëta urbane

Nr	Parametrat	Perqendrimi
1	Nevoja biokimike per oksigjen (NBO5)	25 mg/l O2
2	Nevoja kimike per oksigjen (NKO)	125 mg/l O2
3	Lenda totale ne suspension	35 mg/l
4	Fosfori total	1 mg P/l


Stacionet e monitorimit janë paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

Nr.	Kodi kampionit	Zona bregdetare	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dr1	Durrës	Porto Romano	N 41.375550 E 19.421549
2.	Dr2	Durrës	10 m në det	N 41.374478 E 19.421225
3.	Dr3	Durrës	Currilat	N 41.319580 E 19.430960
4.	Dr4	Durrës	Kanali Plepa – Shkëmbi i Kavajës	N 41.28543 E 19.50894
5.	V1	Vlorë	Hidrovari Vlorë – Pylli i Sodës	N 40.470928 E 19.458578
6.	V2	Vlorë	Në det 20 m pas stacionit të pompimit – Pylli i Sodës	N 40.469208 E 19.454117
7.	V3	Vlorë	Plazhi i Ri - Vlorë	N40.453422 E 19.478732

8.	V4	Vlorë	Shkolla e Marinës	N 40.442729 E 19.494879
9.	S1	Sarandë	Plazhi i qytetit – Tek porti	N 39.873377 E 20.008538
10.	S2	Sarandë	Bar Riviera në qendër të qytetit	N 39.868564 E 19.998654

Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare

Stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave bregdetare për statusin kimik janë shtrirë në qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë.



Nevoja Biokimike për Oksigjen

Ky tregues është nga më të rëndësishmit në vlerësimin e ndotjes organike të ujërave sipërfaqësore si pasojë e shkarkimeve urbane të patrajtuara.



Përmbajtja e Nevojës Biokimike për Oksigjen tejkalon normën e lejuar sipas VKM 177 datë 31.03.2005 në stacionet V1 – Në det pas hidrovarit tek Pylli i Sodës dhe V3 – Plazhi Kabinat.

Nevoja Kimike për oksigjen

Siç vihet re edhe nga grafiku përmbajtja e NKO është nën vlerën e lejuar, për të gjitha stacionet e monitorimit, ku vlera më e lartë është matur në stacionin V1 – Në det pas hidrovarit tek Pylli i Sodës në vlerën 85 mg/l por nën normën e lejuar (< 125mg/l).

Lënda pezull

Përmbajtja e lëndës pezull rezulton mbi normën e lejuar pothuajse në të gjitha stacionet e monitoruara në Durrës, Vlorë dhe Sarandë, ku vlera më e lartë është marrë në stacionin Dr3 – Currilat, në det.



▪ Përmbajtja e fosforit total

Përmbajtja e fosforit total është vlerësuar mbi normën e lejuar vetëm në stacionin Dr1 – Hidrovari Porto Romano.





Referuar rezultateve të ndikimit të shkarkimeve të lëngëta urbane në zonat bregdetare vlerësohet se ndikimi më i lartë paraqitet në stacionin Hidrovari Vlorë – Pylli i Sodës duke vijuar me stacionin në Porto Romano dhe Currilat.

- **Tendenca ndër vite**

Përsa i përket tendencës së përmbajtjes së NBO5 vërehet se në stacionet Dr3, V1, V3,S1 dhe S2 kemi rritje të NBO5 krahasuar me vitin 2022, ndërsa në stacionet Dr1, Dr4 dhe V2 shihet përmirësim i cilësisë krahasuar me vitin e mëparshëm.

Referuar përmbajtjes së NKO, gjatë vitit 2023 kemi tendencë në rritje krahasuar me 2022, pothuajse në të gjitha stacionet duke përjashtuar Dr1 dhe Dr4. Për periudhën 2021-2023, përmbajtja e NKO është brenda normës në të gjitha stacionet.

Gjatë vitit 2023, vlerësohet se kemi rritje të përmbajtjes së lëndës pezull në stacionet Dr1, Dr3, Dr4 dhe V4 dhe ulje të vlerave në stacionet V1, V2, V3, S1 dhe S2 krahasuar me vitin e mëparshëm.



Referuar përbajtjes së P-total vërehet se nuk kemi ndryshime të theksuara të vlerave për periudhën 2021-2023 në stacionet Dr3, V3, V4, S1 dhe S2. Kemi përmirësim të cilësisë në stacionet Dr4, V1 dhe V2 ku paraqiten vlera më të ulëta krahasuar me vitin e mëparshëm, duke përjashtuar stacionin Dr1 ku kemi vlera më të larta se 2022.

3.2.3 Lagunat bregdetare

Lagunat të cilat kanë komunikim me detin janë habitate me kripshtëmi të lartë dhe si të tilla shfaqin luhajtje të vlerave të pH në kohë dhe hapësirë.

Këto habitate ujore ku prania e lëndës organike mund të jetë krahasimisht e lartë dhe shpejtësia e lëvizjes së ujit është e ulët, trupi ujqor është i prirur për shtresëzim dhe tendencë për kërkesë të lartë të respirimit të cilat çojnë në reduktim të sasisë së oksigjenit duke ecur drejt shtratit të lagunës.

Karakteristikat e lagunave bregdetare si habitate ujore me kripshtëmi si vijon:

- Lagunat e kripara bregdetare janë trupa ujore me hidrodinamikë të ulët
- Habitati kryesor i lagunave bregdetare është sub – litoral
- Kushtet e mjedisit janë ekstremisht të ndryshueshme, në kohë dhe hapësirë, ku ndryshime të tilla janë unike për lagunat

Direktiva Kuadër e Ujit thekson kërkesën për monitorim dhe vlerësim të vazhduar të këtyre habitateve. Lagunat nuk janë lumenj, por në vlerësimin sipas kësaj direktive i referohen normat limite të liqeneve.

Metalet e rënda hyjnë në laguna përmes disa rrugëve, kryesisht për shkak të proceseve pedo-geologjike si dhe aktivitetit njerëzor. Vlerësimi i gjendjes së synon të përcaktojë sasinë e origjinës, shpërndarjes hapësinore dhe nivelin e ndotjes së shkaktuar nga metalet e rënda në tokë, sedimente, ujë dhe midhje të lagunës së Butrintit. Vlerësimi i cilësisë për metalet e rënda është kryer bazuar në

standardet e Direktivës Kuadër të Ujit (75/440/EEC) të Bashkimit Europian (BE) dhe VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”.

Tabela 7. Normat e përcaktuara nga VKM dhe standardi i BE


Nr.	Parametrat	Standardi Shqiptar në µg/l						Standardi BE në µg/l				
		VKM Nr. 379, datë 25.5.2016						Direktiva Kuadër e Ujit (75/440/EEC)				
		A1		A2		A3		KLASA				
G	I	G	I	G	I	I	II	III	IV	V		
1	Merkur total (Hg _T)	0.5	1	0.5	1	0.5	1	<1	1	1	1	>1
2	Plumb total (Pb _T)	-	50	-	50	-	50	<2.5	2.5	2.5	2.5	>2.5
3	Kadmium total (Cd _T)	1	5	1	5	1	5	<0.2	0.2	1	1	>1
4	Arsenik total (As _T)	10	50	-	50	50	100	<0.2	50	50	50	>100
5	Bakër total (Cu _T)	20	50	50	-	1000	-	<50	50	100	1000	>1000

I = i detyrueshëm


G= udhëzues ose i rekomanduar

• Laguna e Butrintit

Monitorimi është realizuar në një stacion kampionimi me dy thellësi dhe përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi ku temperatura e ujit varion nga 21.9 – 24.3°C dhe oksigjeni i tretur i matur in – situ rezulton 5.6 – 7 mg O/l ku dëshmon që ujërat nuk janë të pasura me oksigjen. Kjo lagunë është zonë e cila përdoret për kultivimin e midhjeve.



Vlera mesatare e transparencës së matur është 1.6 m dhe referuar këtij treguesi vlerësojmë se cilësia është mezotrofike. Nevoja kimike për oksigjen është vlerësuar në vlerë mesatare 24 mg O/l dhe siç vihet re nga grafiku vlera mesatare vjetore e klasifikon lagunën me cilësi eutrofike. Gjithashtu edhe vlerat e nevojës biokimike për oksigjen e klasifikojnë Lagunën e Butrintit me cilësi eutrofike



Përmbajtja e nitrative rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike pasi vlera mesatare e dy stacioneve të monitorimit është 0.377 mg/l (<1 mg/l).

Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet e kampionimit me thellësi të ndryshme përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi është 0.012 mg/l ku i klasifikojnë këto ujëra me cilësi mezotrofike.

Tabela 8. Vlerat mesatare të përmbajtjes së metaleve, 2023

		Përmbajtja e metaleve µg/l				
		As	Cd	Cu	Pb	Hg
Laguna e Butrintit	Sipërfaqe	0	21	41	618	0
	5m thellësi	0	16	61	825	0

Referuar të dhënave, vlerësojmë se ujërat e lagunës së Butrintit vlerësohen me cilësi eutrofike, e vlerësuar kjo për përmbajtjen e lartë organike. Bazuar mbi përmbajtjen e Cd dhe Pb, ujërat e lagunës klasifikohen me cilësi të dobët.

- **Tendenca në vite**

Për vitin 2023 vlerësohet se kemi përkeqësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi mezotrofike në vitin 2022 në cilësi eutrofike.

	2020	2021	2022	2023
Laguna e Butrintit	Cilësi mezotrofike me tendencë eutrofie	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofike	Cilësi eutrofike

• **Laguna e Karavastasë dhe Nartës**

Laguna e Karavastasë është nën presionin e depozitimeve të Lumenjve Shkumbin dhe Seman dhe aktivitetit bujqësor në zonën rreth saj. Laguna e Nartës është nën ndikimin e depozitimeve të Lumit Vjosa dhe aktivitetit bujqësor.

Origjina e metaleve (Cd, Pb dhe në disa raste Cu) për lagunën e Karavastasë mund të jetë e lidhur me ndikimin historik të ujërave të ndotura të Lumit Shkumbin. Shkarkimet industriale në zonën e Elbasanit para viteve 1990 dhe me pas depozitimi i mbetjeve dhe derdhja e ujërave të ndotura urbane në Lumin Shkumbin.

Cd dhe Pb janë dy elementë që bashkëshoqërojnë industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës. Shkarkimet historike të Semanit në Detin Adriatik dhe depërtimi i tyre në ujin e Lagunës së Karavastasë mund të jetë shkak për kontaminimin e ujërave.

Tabela 9. Përmbajtja e metaleve në ujin e lagunave për vitin 2023

Monitorimi i cilësisë së lagunave		Përmbajtja e metaleve µg/l				
		As	Cd	Cu	Pb	Hg
Laguna e Karavastasë	Lagunë	0	104	57.	948	0
	Ujëkëmbim det – lagunë	0	92	79	928	0
Laguna e Nartës	Ura e Manastirit	0	25	98	1779	0
	Ujëkëmbim det – lagunë	0	53	99	1777	0

Origjina e Cd dhe Cu mund të jenë agrokimiketat, plehrat kimik ose preparatet për mbrojtjen e bimëve (PMB), pesticide ose herbicide. Plehrat fosforike sidomos ato me cilësi të ulët janë të njohura për përmbajtjen e Cd i cili akumulohet në napën freatike dhe më pas depozitohet në ujin e lagunave.

Prania e Cu mund të jetë e lidhur me përdorimin e kimikateve në zonën bujqësore me përmbajtje bakri si mikroelement për mbajtjen e bimëve në bujqësi. Vërehet se përmbajtja e Pb ngelet më e lartë se nivelet e rekomanduara nga DKU.

Rezultatet tregojnë se **As dhe Hg nuk janë të pranishëm në ujin e lagunave**. Referuar standardeve të DKU, uji i lagunave është me cilësi të lartë ose është i pastër nga dy elementë metalik me toksicitet shumë të lartë/të konsideruar si kancerogjenë.

Problematika shfaqet me përmbajtjen e **Cd dhe Pb** në ujërat e Lagunave Karavasta, Nartë dhe Butrint, duke i klasifikuar ujërat e tyre me **cilësi të dobët**. Tendenca e përqëndrimit të lartë të metaleve Cd dhe Pb është e njëjtë për tre sezonet Pranverë, Verë dhe Vjeshtë.

Ekspozimi i njerëzve ndaj riskut mjedisor (përmbajtja e lartë e Cd dhe Pb) mund të ndodhë vetëm nëpërmjet konsumimit të produktit të këtyre lagunave.

3.2.4 Dinamika bregore për bregdetin shqiptar

Të dhënat për gjendjen aktuale të sipërfaqeve të eroduara dhe të akumuluar në bregdetet edeteve Jon dhe Adriatik përfshijnë periudhat 2017 - 2022 dhe monitorime të vitit 2023 për zonat me problematikë më të lartë. Rajonet me të dhënat përkatëse për segmentet përbërëse jepen në tabelat në vazhdim:

Tabela 10. Gjendja e dinamikës bregore të bregdetit Adriatik, 2017-2023

Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut)			
Rajoni Gjiri i Drinit			
Segmentet	Akumulim	Erozion	Bilanci
	<i>Hektarë (ha)</i>		
Grykëderdhja e Bunës – Gryka e Vilunit (Rrjoll)	13.15	14.92	-1.77
Gryka e Vilunit (Rrjoll) – Shëngjin	1.4	10.5	-9.1
Shuma	14.55	25.42	-10.87
Shëngjin – Grykëderdhja e Drinit	1.87	7.93	-6.06
Grykëderdhja e Drinit – Grykëderdhja e	0.35	14.8	-14.45
Grykëderdhja e Matit – Grykëderdhja e	7.1	2.7	+4.4
Shuma	9.32	25.43	-16.11

Rajoni Gjiri i Lalzit			
Shën Pjetër – Hamallaj	4.6	7.3	-2.7
Rrushkull – Fshati Rinia	3.16	5.2	-2.04
Shuma	7.76	12.5	-4.74
Rajoni Gjiri i Durrësit			
Durrës – Shkëmbi i Kavajes	1.87	0.97	+0.9
Shkëmbi i Kavajës – Qerret	7.4	4.9	+2.5
Qerret – Karpen	3.2	3.05	+0.15
Shuma	12.47	8.92	+3.55
Rajoni Spille – Karavasta			
Plazhi i Spillesë	2.61	0.69	+1.92
Grykëderdhja e Shkumbinit (krahu verior)	3.3	1.79	+1.51
Grykëderdhja e Shkumbinit (krahu jugor)	0.48	31.87	-31.39
Delta e Shkumbinit (Kanal Bashtove-Grykëderdhja e vjetër e Shkumbinit)	1.28	2.7	-1.42
Veriu i Plazhit Divjakës	19.6	13.5	+6.1
Plazhi i Divjakes	25.9	0	+25.9
Shuma	53,17	50,55	2,62
Rajoni Grykëderdhja e Semanit – Kepi i Dajlanit			
Kanali i Myzeqesë – Grykëderdhja Semanit	32.6	2.9	+29.7
Grykëderdhja Semanit – Plazhi Seman	5.35	7	-1.65
Kanali i Hoxharës – Darzezë	1.6	1.27	+0.33
Darzezë – Grykëderdhja e Vjosës	11.4	20.2	-8.8
Grykëderdhja Vjosës – Kepi i Dajlanit	63.3	18.1	45.2
Shuma	114,25	49,47	64,78
Rajoni plazhi Zvërnec – Plazhi i vjetër (Vlorë)			
Plazhi Zvërnec (Treport-Porti i riparimit të anijeve)	24.4	7.6	+16.8
Plazhi Pylli i Sodes- Plazhi i Vjetër (Vlorë)	24.5	3.8	+20.7
Shuma	48,9	11,4	37,5

Tabela 11. Gjendja e dinamikës bregore të bregdetit Jon, 2017-2023

Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Jonit)			
Rajoni Palasë – Kakome			
Segmentet	Akumulim	Erozion	Bilanci
	<i>Hektarë (ha)</i>		
Plazhi Palasë	0	0	0
Plazhi Drimadhë	0.2	0.3	-0.1
Plazhi Dhërmi	0.07	0.54	-0.47
Plazhi Livadh	0.03	0.51	-0.48
Plazhi Himarë	0	0.15	-0.15
Plazhi Potam	0	0.22	-0.22
Plazhi Qeparo	0	0.3	-0.3
Plazhi Borsh	0.24	1.92	-1.68
Plazhi Piqeras	0	0	0
Plazhi Lukovë	0.11	0.21	-0.10
Shuma	0,65	4,15	-3,5
Rajoni Kakome – Ksamil			
Plazhi Krorezë	2.5	0.1	+2.4
Plazhi Kakome	0.2	0.3	-0.1
Plazhi Sarandë	0.28	0.015	+0.265
Plazhi Ksamil	0.6	0.17	+0.43
Shuma	3,58	0,585	2,995

Aktualisht rajoni me problematikën më të lartë është ai i Gjirit të Drinit, ku bilanci është negativ.

I vetmi segment i rajonit në gjendje akumulimi është segmenti Grykëderdhja e Drinit – Grykëderdhja e Matit. Zona e akumuluar është sa 21 % të sipërfaqes së përgjithëshme të akumulim erozionit.

Sondazhi i kryer gjatë vitit 2023, nga Sektori i Dinamikës Detare, rikonfirmoi këtë gjendje. Dy monitorime të kryera në Gusht dhe në Dhjetor tregojnë se në dy pjesë të veçanta përparimi i detit drejt tokës është i dukshëm dhe me pasoja në drejtim të shkatërrimit të infrastrukturës të shërbimeve turistike, kanalizimeve dhe komunikacionit.

Në hapësirën në veri dhe jug të impiantit të pastrimit të ujërave të zeza në Kune, Shëngjin, deti ka disa vjet që ka shfaqur shenja përparimi por këtë vit, sidomos gjatë stuhive veprimtaria e tij kaqenë më agresive. Niveli i detit në këtë zonë arriti, gjatë korrikut të vitit 2023, në vijën e dytë të shezlloneve (afërsisht 5 metra përparim) të vendosur në breg nga operatorë turistikë. Vërshimi i tijkave në rrezik një subjekt tregtar të gjendur në afërsi të plazhit, dhe po i afrohet një segmenti të rrugës automobilistike Shëngjin – Kune.

Kjo hapësirë përbën pjesën më të rëndësishme erozive të segmentit Shëngjin – Grykëderdhja e Drinit, ku erozioni i përgjithshëm është 7.93 ha në katër vjeçarin e fundit me një trend prejafërsisht 2 hektarësh të humbura në vit.

Një zonë tjetër në rajonin e Gjirit të Drinit, që mund të sjellë pasoja të dëmshme në infrastrukturën turistike dhe atë rrugore ndodhet në segmentin Rrjoll – Shëngjin, në afërsi të Shëngjinit. Në vendin e njohur si “Camping Riviera” vërehet një përparim i detit drejt plazhit. Ky përparim përveçse nëpërmjet përmytjes një pjesë të plazhit të dikurshëm këtu, shprehet edhe me veprimtari dëmtuese, e dallueshme nëpërmjet subsidencës (çedimit) të një pjese të murit mbrojtës që subjekti ka ndërtuar. Gjykojmë se përparimi i mëtejshëm mund të çojë deri në shembje të objektit inxhinierik, por dhe më tej në shembje të rrugës. Struktura gjeologjike, shfaqet me njëzonë tektonike në faqen e malit e cila mund të favorizojë sidsidencën dhe depërtimin e ujit nëpërmjet blloqeve shkëmbore e për rrjedhojë të sjellë pasoja të rënda ekonomike por dhe njerëzore nëse nuk fillon një studim për zbutjen deri në eliminimin e efekteve negative të shfaqura.

Gjithashtu me bilanc negativ për bregdetin e Adriatikut rezulton rajoni i gjirit të Lalzit. Rajonet e tjera paraqiten me bilanc pozitiv.

Në këto rajone një bilanc negativ vërehet prej – 8.8 Ha vërehet në segmentin Darzezë - Grykëderdhja e Vjosës, i cili në fakt kompesohet me bilancin pozitiv prej 45.2 Ha në jug të grykëderdhjes së Vjosës.

Plazhet e detit Jon kanë shfaqur një bilanc negativ në rajonin verior nga Palasa deri në Kakome, ndërsa për pjesën në jug të Kakomesë i vetmi segment me bilanc negativ është ai i Plazhit të Kakomesë.

Pjesa tjetër e plazheve të bregdetit të Jonit janë në gjendje akumuluese ose në stabilitet (plazhi i Palasës).

3.2.5 Sipërfaqet e shfrytëzuara të plazheve

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, bazuar në VKM nr 171, date 27.03.2019” Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar, ka kryer monitorime të sipërfaqeve të plazheve të shfrytëzuara gjatë sezonit turistik 2023. Sipërfaqet kategorizohen në hapësira private, të cilat menaxhohen nga subjekte private dhe hapësira publike që shfrytëzohen nga publiku.

Tabela 12. Sipërfaqe e plazheve sipas bashkive 2023

Bashkia	Tipologjia	Sipërfaqe sipas tipologjisë (m ²)	Totali i sipërfaqes (m ²)
Divjakë	Hapësirë Private	107,857	171,437
	Hapësirë Publike	63,580	

Durrës	Hapësirë Private	691,180	1,183,517
	Hapësirë Publike	492,337	
Fier	Hapësirë Private	359,031	520,227
	Hapësirë Publike	161,196	
Himarë	Hapësirë Private	428,126	566,605
	Hapësirë Publike	138,479	
Kavajë	Hapësirë Private	198,572	286,917
	Hapësirë Publike	88,345	
Lezhë	Hapësirë Private	371,777	567,925
	Hapësirë Publike	196,148	
Pogradec	Hapësirë Private	96,503	144,609
	Hapësirë Publike	48,106	
Rrogozhinë	Hapësirë Private	320,168	457,589
	Hapësirë Publike	137,421	
Sarandë	Hapësirë Private	106,126	155,822
	Hapësirë Publike	49,696	
Shkodër	Hapësirë Private	151,524	215,092
	Hapësirë Publike	63,568	
Vlorë	Hapësirë Private	471,383	701,606
	Hapësirë Publike	230,223	
Totali			4,971,346



Sipërfaqja totale e hapësirave publike është 1,669,099 m² ndërsa sipërfaqe totale e hapësirave të menaxhuara (private) është 3,302,247 m². Vihet re, se referuar sipërfaqes totale të hapësirave të përdorura rezulton se , 33.6 % jane sipërfaqe publike dhe 66.4 % janë sipërfaqe private. Bashkia Durrës ka sipërfaqen më të madhe të shfrytëzuar (Private dhe Publike) me 1,183,517 m² duke vijuar me Vlorën 701,606 m².

Gjatë sezonit turistik 2023 sipërfaqja totale e shfrytëzuar është **4,971,346 m²**, duke treguar një rritje të sipërfaqeve të plazheve të shfrytëzuara krahasuar me vitin 2022 ku sipërfaqja totale rezulton **4,531,889 m²** dhe në vitin 2021 me një sipërfaqe totale **4,579,706 m²**.

- Tendenca ndër vite


Në paraqitjet grafike të mëposhtme jepet tendenca në vite e sipërfaqeve totale të shfrytëzuara si dhe të sipërfaqeve të menaxhuara dhe publike.

Kemi një tendencë nërritje të hapësirave (private dhe publike) gjatë sezonit turistik 2023 krahasuar me vitet e mëparshme për të gjitha bashkitë duke përjashtuar Vlorën e cila ka tendencë në ulje të hapësirave të shfrytëzuara



Përsa i përket hapësirave të menaxhuara vihet re tendencë në rritje për bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Pogradec, Himarë dhe Sarandë.

Ndërsa për bashkitë Lezhë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier dhe Vlorë shihet tendencë në ulje gjatë vitit 2023



Në përgjithësi vërehet tendencë në rritje e shfrytëzimit të hapësirave publike në plazhe krahasuar me vitin 2022.

3.3 Rekomandime

- Rekomandohet marrja e masave nga Pushteti Lokal për përmirësimin e sistemimit të ujërave të zeza në zonat e plazheve për trajtimin e ujërave urbane, përpara shkarkimit të tyre në ujërat pritëse.
- Me shumë rëndësi është vënia në funksionim me efikasitet të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të Impiantëve të Trajtimit të Ujërave Urbane ekzistuese si dhe ngritja e Impiantëve të rinj.
- Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave bregdetare kërkon realizimin e investimeve në trajtimin të shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në zonat bregdetare ku paraqitet ndotje më e lartë.
- Menaxhimi i plazheve dhe marrja e masave nga Pushteti Vendor për plotësimin e kushteve higjieno sanitare të pushuesve.
- Të përmirësohen kushtet higjieno-sanitare si në plazhet publike dhe në plazhet që administrohen nga privatët.
- Marrja e masave nga Pushteti Lokal për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave inerte si dhe mbeturinave urbane në plazhe.
- Zhvillimi i metodave parandaluese të cilat do të përfshijnë, kontrollin dhe/ose aplikimin e trajtimit të shkarkimeve të derdhura në lagunë.
- Kryerja e studimeve për zbutjen deri në eliminimin e efekteve negative të shfaqura përgjatë vijës bregore të bregdetit Adriatik dhe Jon.

KAPITULLI 4

UJËRAT

KAPITULLI 4

UJËRAT

4.1 Të përgjithshme

Uji është një pasuri natyrore me vlera të mëdha kombëtare dhe më gjerë. Përdorimet e tij janë të gjithanëshme në bujqësi, industri, turizëm, energji dhe në furnizimin e qendrave të banuara për nevoja të popullatës. Njohja dhe menaxhimi me efikasitet i burimeve ujore përbën një nga sfidat më të mpërhta të kohës, nisur kjo nga kërkesat e mëdha për ujë në të gjitha fushat e përmënduramë sipër.

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë për parametrat fiziko- kimik , biologjik dhe trofik është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me një frekuencë 4 herë/vit në 38 stacione në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë., 3 stacione për tributarët e liqenit të Ohrit, 10 stacione në liqenet natyrore, Ohër, Shkodër, Prespë, Prespë e Vogël.

Ndotja radioaktive alfa-beta total e ujrave sipërfaqësore dhe precipitimeve atmosferike (Fallout) është monitoruar nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar në lumenj dhe liqene

Monitorimi i prurjeve në lumenjtë Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe siguron një informacion mbi intensitetin e prurjeve në kohë të ndryshme të vitit bazuar në matje të sakta me metodat klasike ekzistuese dhenë varësi të ndryshimeve të motit.

Gjithashtu, Instituti i Gjeoshkencës ka kryer monitorimin e prurjeve në ujëra sipërfaqësore përgjatë gjithë vitit 2023, në lumenjtë Buna, Drin, Mat, Ishëm Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, Bistricë.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për basenet Drin, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë, Zona jonike me frekuencë dy herë në vit .

4.2 Gjendja dhe tendenca

Shqipëria, falë pozicionit të saj të mrekullueshëm dhe të favorshëm gjeografik e klimatik, zotëron një potencial të admirueshëm të rezervave ujore, qofshin këto sipërfaqësore apo nëntokësore.


4.2.1 Ujërat sipërfaqësore

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene dhe vlerësimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuaratë përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE si dhe VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 për

miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm” për sa i përket përmbajtjes së metaleve të rënda. Monitorimi i cilësisë të ujërave sipërfaqësore për **praninë e metaleve të rënda** është kryer në tre sezone; pranverë, verë dhe vjeshtë. Prania e metaleve të rënda në sipërfaqen e ujit mund të jetë për shkak të aktiviteteve natyrore ose antropogjene. Në aktivitetet natyrore, mund të përfshihen gërryerja e shkëmbinjve që përmbajnë metale, zjarret në pyll dhe proceset natyrore të motit.

Disa nga presionet kryesore në hapësirën e një baseni janë: mbetjet e ngurta dhe ujërat e ndotura, nxjerrja e mineraleve/minierat, bujqësia intensive dhe zhvillimi urban, turizmi i paqëndrueshëm, etj. Këto presione çojnë në shkallë të gjerë ndikimesh si: shpyllëzim, ndotje të ujërave, erozion i përsheptuar, humbja e ekosistemeve të vlefshme dhe biodiversitetit, përmbytje të ashpra dhe më të shpeshta, etj

4.2.1.1 Cilësia e ujërave të lumenjve



Monitorimi është kryer në 38 stacione në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë. Vlerësimi i cilësisë është kryer referuar vlerave limite për parametrat kimikë të paraqitura në tabelën e mëposhtme si dhe normave të metaleve të rënda sipas tabelës 7, kapitulli 3.

Temperaturat e ujërave variojnë në varësi të stinës dhe pozicionimin e stacioneve të kampionimit, ku në rrjedhat e sipërme ujërat e lumenjve karakterizohen nga temperatura më të ulëta, pasi janë ujëra që burojnë nga zonat malore. Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline .

Tabela 1. Vlerat limite të parametrave kimike në lumenj sipas DKU

	Njesia	Vlerat limite te parametrave kimike				
		Gjendje e Lartë Kl.I	Gjendje e Mirë Kl.II	Gjendje e Moderuar Kl.III	Gjendje e Varfër K.IV	Gjendje e Keqe Kl.V
Oksigjen i tretur	mgO/l	>7	>6	>5	>4	<3
NBO ₅	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)			>6.5	>6		
pH (alkalin)			<8.5	<9		

NH ₄	mgN/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO ₂	mgN/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO ₃	mgN/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO ₄	mgP/l	<0.05	<0.10	<0.2	0.5	>0.5
P-total	mgP/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

➤ Baseni Drin

Është monitoruar në 7 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij deri para derdhjes në det.

Tabela 2. Vlerat mesatare vjetore për basenin Drin, 2023

Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO ₅ mg/l	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PO ₄ mg/l	P-total mg/l
D1	Drini i Zi	TopoJan – Ura Burrel Peshkopi	13.0	7.6	1.0	0.03	0.0006	0.17	0.0075	0.009
D2	Drini	Bahçallek– Ura Bahçallek	8.6	7.3	4.0	0.013	0.0047	0.35	0.0075	0.010
D3	Drini i Bardhë	Luma - Kukës	12.6	7.5	1.0	0.029	0.0005	0.093	0.0064	0.0072
Bu1	Buna	Muriqan – afër fshatit, në kufi	8.5	7.5	5.5	0.018	0.0046	0.33	0.0076	0.011
Ki	Drin	Ura e mesit	9.7	7.7	3.0	0.022	0.0062	0.12	0.0058	0.0081
Bu2	Buna	Ura e vjetër Shkodër - Shirokë	7.5	7.3	2.0	0.019	0.0058	0.083	0.005	0.008
DLe	Drini Lezhë	Kune – Vain para derdhjes në det	8.2	7.6	11.0	0.49	0.04	0.61	0.038	0.045

Vlerësojmë se të gjitha stacionet janë të ngopura me oksigjen me vlera > 7 (Klasa I – Gjendje e lartë). Referuar NBO₅, ujërat paraqesin cilësi të mirë në lidhje me këtë parametër në rrjedhën e sipërme duke u klasifikuar në Klasën II dhe në Klasën III, ndërsa në stacionet pranë zonave të banuara dhe përkatësisht stacioni DLe – Drini Lezhë klasifikohet në Klasën IV – Gjendje e varfër. Amonjaku është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU.

Drini Lezhë ka një përmbajtje më të lartë të amonjakut në vlerën 0.49 mg/l duke u klasifikuar në Klasën III- Gjendje e moderuar. Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar që varion në vlerat < 0.001 – 0.04 mg/l duke i klasifikuar të gjitha stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë. Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, në vlerat 0.083 – 0.61 mg/l duke i klasifikuar të gjitha stacionet në Klasën I – Gjendje elartë.


Referuar vlerave mesatare të fosforit, nuk kemi tejkallim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve por në stacionin DLe ka një përmbajtje mesatare vjetore në vlerën 0.038 mg/l, brenda normës.

Duke vlerësuar të gjithë parametrat e DKU të paraqitura edhe më sipër, vlerësojmë cilësinë e ujërave të Basenit të Drinit në Klasën IV – Gjendje e varfër duke nënvizuar se ndotja është

vlerësuar në stacionin DLe – Drini Lezhë, pasi të gjithë stacionet e tjera janë me parametra brenda normës.

Cilësia e ujërave në trupën ujore të Drinit klasifikohet e mirë dhe shumë e mirë në përputhje me standardet e VKM dhe BE duke ju referuar përmbajtjes së As, Hg dhe Cu. Gjurmë të Cd dhe Pb shfaqen në ujërat e Drinit të Zi pranë fashtit Maqellarë dhe Shupenzë, në ujërat e Kirit dhe Bunës. Këto ujëra janë të kategorisë së parë referuar standardeve Shqiptare por me cilësi më të dobët referuar DKU të BE.

Grafiku 1. Vlerat mesatare të përqendrimit të metaleve në basenin Drin, 2023



➤ **Baseni Mat**

Ky basen është monitoruar në 4 stacione kampionimi në gjithë gjatësinë e vet.

Tabela 3. Vlerat mesatare vjetore për basenin Mat, 2023


Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO ₅ mg/l	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PO ₄ mg/l	P-total mg/l
Ma1	Fani i Madh	Ndërfushë, ndërmjet urave Milot – Kukës dhe Milot - Rrëshen	11	7.47	1	0.005	0.0001	0.08	0.006	0.007
Ma2	Fani i Vogël	Bukemire – Ura e Vjetër Milot – Kukës që të lidh me Rrugën e Kombit	13	7.62	1	0.025	0.0005	0.13	0.004	0.008
Ma3	Lumi Mat	Klos - Darsë	10	7.58	3	0.026	0.004	0.36	0.005	0.006
Ma4	Lumi Mat	Ura e Re Tiranë - Shkodër	11.8	7.75	3	0.026	0.0023	0.33	0.005	0.009

Stacionet janë të ngopura me oksigjen dhe klasifikohen në KL I- Gjendje e lartë. Për përmbajtjen e e NBOs, vlerësojmë se stacionet klasifikohen në Klasën II – Cilësi e mirë. Përmbajtja e amonjakut i klasifikon stacionet në cilësi shumë të mirë, Klasa I- Gjendje e lartë. Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar, duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë. Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë. Nuk ka tejkalim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve duke i klasifikuar stacionet në Klasën I – Gjendje elartë.

Referuar pranisë se fosforit total këto stacione klasifikohen në Klasën I – Gjendje e lartë.

Duke vlerësuar të gjithë parametrat bazë të Direktivës Kuadër të Ujit, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Matit klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë.

Grafiku 2. Vlerat mesatare të përmbajtjes të As, Cd, Cu dhe Pb në basenin Mat



Ujërat e Lumit Mat dhe degëve të tij, janë të pastra referuar As, Cu dhe Hg por përmbajtja e Cd dhe Pb në disa pika monitorimi (Shënkoll, Lumi i Matit dhe Drini i Lezhës në afërsi të Kune Vain), tejkalon vlerat e rekomanduara.

➤ **Baseni Ishëm – Erzen**

Monitorimi i këtij baseni realizohet në 10 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij.

Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO ₅ mg/l	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PO ₄ mg/l	P-total mg/l
T1	Lumi i Tiranës	Ura e Brarit	9.4	7.8	3	0.03	0.0008	0.26	0.03	0.04
T2	Lumi i Tiranës	Kamëz – poshtë urës	7.9	7.73	9	3.9	0.013	0.43	0.22	0.26

L1	Lumi i Lanës	Lanabregas- 200 – 300 m sipër gurores Dajti	7.5	7.41	22	4.1	0.0043	0.33	0.3	0.36
L2	Lumi i Lanës	Ish dogana Kashar në autostradë 200m poshtë urës, 700 – 800m nga kryqëzimi i Coca - Colës	5	6.88	73	19.8	0.01	0.6	1.4	1.58
Ish1	Ishëm	Ura Rinas	6.4	7.10	45	12.65	0.039	0.46	1.37	1.43
Ish2	Ishëm	Ura e Gjolës	4.9	7.25	40	7.3	0.043	0.47	1.16	1.21
Ish3	Ishëm	Ura Salmer	5.3	7.25	40	10.6	0.061	0.57	1.11	1.16
Er1	Erzen	Pëllumbas	11.5	7.6	4	0.17	0.0041	0.22	0.03	0.022
Er2	Erzen	Ura e Beshirit	11	7.63	10	2.7	0.02	0.36	0.05	0.039
Er3	Erzen	Sallmone – Fshati Rinia	9	7.51	15.5	3.44	0.038	1.09	0.06	0.015

Në stacionet e Lumit Ishëm përmbajtja e oksigjenit të tretur është nën vlerën e lejuar duke e klasifikuar këtë lumë në Klasën IV – Gjendje e Varfër. Gjithashtu, edhe stacioni L2 – Yrshek (Ish dogana) është vlerësuar me një oksigjen të tretur në vlerën 5 mg/l duke e klasifikuar edhe këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër. Lumi Erzen paraqitet të jetë me ujëra të pasur me oksigjen duke u klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë në të tre stacionet.

Tejkalim të vlerës limite për parametrin nevoja biokimike për oksigjen kemi në stacionet T2 – Kamëz poshtë urës, Li – Lanabregas, L2 – Ish Dogana Kashar ku vlera mesatare e ekspeditave të realizuara është 73 mgO/l një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje shumë të lartë duke e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe ku duhet të merren masa të menjëhershme (> 18 mg/l).

Tejkalim të normës kemi edhe në tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe. Lumi Erzen paraqitet të jetë mbi normën e lejuar në stacionin Er2 – Ura e Beshirit dhe Er3 – Ura Sallmone.

Në stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës limite për përmbajtjen e amonjakut në stacionin T2 – Ura Kamëz, L1 – Lanabregas me vlerën mesatare më të lartë 4.11 mg/l dhe L2 – Yrshek (Ish Dogana) në vlerën 19.8 mg/l duke i klasifikuar këto stacione në Klasën V – Gjendje e keqe, si dhe në të tre stacionet e Ishmit të cilat klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe.

Stacionet e Lumit Erzen Er2 dhe Er3 klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe. Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në të gjitha stacionet e këtij baseni. Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezultojnë në vlera më të ulëta se norma e lejuar.


Vlerësojmë se kemi tejkalim të vlerës limite të përbajtjes së orto – fosfateve në stacionin T2 – Ura e Kamzës, L2 – Lanabregas në vlerën 1.4 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe. Tejkallim të vlerës limite kemi edhe në të tre stacionet e Ishmit duke e klasifikuar këtë lumë në Klasën e V – Gjendje e keqe. Stacionet e Lumit Erzen nuk kanë përbajtje të fosforit

Referuar vlerave mesatare të fosforit total, vlerësojmë se stacioni L2 –Lanabregas tejkalon vlerën limite të Klasës së III duke klasifikuar Lanabregasin në Klasën V – Gjendje e keqe. Gjithashtu, është vlerësuar se ka prani të fosforit total në të tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm në vlera të larta. Lumi i Erzenit nuk ka përbajtje të fosforit total.

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vlerësojmë se Baseni Ishëm – Erzen klasifikohet në Klasën V – Gjendje e keqe.


Bazuar në rezultatet e përbajtjes së metaleve të rënda, ujërat e Lanës dhe të Lumit Ishëm janë të kontaminuara referuar përbajtjes së As. Vlerat mesatare janë më të larta se nivelet e rekomanduara nga VKM dhe DKU (>10 µg/l), duke i konsideruar të Klasës A2- Cilësi e mirë.

Grafiku 2. Vlerat mesatare të përqëndrimit të metaleve në trupën ujore të Lumit Ishëm



Gjithashtu Cd është më i lartë se vlera e parashikuar nga VKM (5 µg/l), por edhe shumë më e lartë se limiti (1 µg/l). Përbajtja e Cd dhe Pb tejkalon vlerat e përcaktuara nga DKU për trupën ujore të Ishmit (Lumi i Lanës, Lumi i Tiranës dhe Lumi i Ishmit) për shkak të ndotjes urbane që shkarkohet nëpërmjet ujërave të përdorura në aglomeratin e Tiranës.

Grafiku 3. Vlerat mesatare të përqëndrimit të metaleve në trupën ujore të Lumit Erzen





Ujërat e Lumi Erzen janë më të pastra në rrjedhën e sipërme (Pëllumbas). Në vazhdim të rrjedhës ato ndikohen nga shkarkimet urbane (mbetje dhe ujërat e zeza) duke u pasuruar me Cd dhe Pb. Megjithatë përbajtja e metaleve është nën limitet e përcaktuara nga VKM.

➤ **Baseni Shkumbin**



Monitorimi i këtij baseni realizohet në 4 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij, të cilat janë paraqitur në formë tabelare si vijon.

Tabela 5. Stacionet e monitorimit, baseni Shkumbin



Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	Sh1	Lumi i Shkumbinit	Qukës – 500 mbi fshatin Qukës
2.	Sh2	Lumi i Shkumbinit	Ura Toplias
3.	Sh3	Lumi i Shkumbinit	Ura e Paprit
4.	Sh4	Lumi i Shkumbinit	Ura Rrogozhinë




Stacionet dëshmojnë për ujëra të ngopura me oksigjen, duke i klasifikuar ujërat e Basenit të Shkumbinit në Klasën I – Gjendje e lartë. Nuk kemi tejkalim të vlerës limite për NBO₅ në asnjë nga stacionet e monitoruara.



Përmbajtja e amonjakut i klasifikon të gjitha stacionet në Klasën II – Gjendje e mirë. Referuar vlerave të nitriteve, stacionet vlerësohen në Klasën I – Gjendje e lartë.



Përmbajtja e nitrateve, ortofosfateve dhe fosforit total në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera të ulëta duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.



Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Shkumbinit klasifikohen në Klasën e III – Gjendje e moderuar.

Ujërat e Shkumbinit janë të pastra nga As, Hg, Cd dhe Cu, përmbajtja e tyre është nën nivelin e përcaktuar nga VKM dhe DKU duke i klasifikuar këto ujëra të Klasës A1. Përmbajtja e Pb, për

katër stacionet e monitorimit është më e ulët se standardi i parashikuar nga VKM ose <50 µg/l por më i lartë se 2.5 µg/l ose vlera e përcaktuar nga DKU.

Tabela 6. Përqëndrimi i As, Cd, Cu dhe Pb në trupën ujore të Basenit Shkumbin, 2023

Emërtimi i lumit	Stacioni	Përbajtja e metaleve µg/L: Mesatare viti 2023				
		As	Cd	Cu	Pb	Hg
Lumi Shkumbin	Qukës	0.00	0.75	3.5	4.84	0
	Qafë – Plloç	0.00	0.196	3.06	6.44	0
	Toplias	0.00	0.07	0.87	6.20	0
	Paper	0.00	0.156	2.43	8.36	0
	Rrogozhinë	0.00	0.256	2.93	5.36	0

➤ **Baseni Vjosë**

Baseni i Vjosës është monitoruar në 5 pika monitorimi. Vlerësimi sipas stacioneve jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7. Vlerat mesatare për basenin Vjosë, 2023


Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO ₅ mg/l	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PO ₄ mg/l	P-total mg/l
Vj1	Vjosa	Çarshovë – pas fshatit Petran	10.71	7.7	2	0.01	0.0004	0.20	0.010	0.012
Vj2	Vjoses	Ura e qytetit	10.75	7.6	2	0.005	0.00059	0.14	0.005	0.007
Vj3	Lumi Drino	Ura e Leklit - Tepelenë	10.7	7.5	3.5	0.004	0.00059	0.15	0.005	0.005
Vj4	Lumi i Vjoses	Ura Memaliaj	10.55	7.44	2.5	0.003	0.00046	0.21	0.003	0.003
Vj5	Lumi i Vjoses	Ura e Mifolit - Vlorë	10.45	7.49	2.5	0.004	0.0008	0.15	0.004	0.005

Ujërat këtij baseni janë të pasura me oksigjen duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë. Përbajtja e NBO₅ i klasifikon stacionet në Klasën II – Gjendje e mirë. Ujërat e këtyre stacioneve për përbajtjen e amonjakut janë të një cilësie shumë të mirë. Përbajtja e nitriteve dhe nitrateve në stacionet e monitorimit të Basenit të Vjosës është në vlera shumë të ulëta, duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë. Referuar përbajtjes së orto – fosfateve dhe fosforit total vlerësojmë se këto stacione klasifikohen në Klasën I – Gjendje e lartë.

Referuar përbajtjes së parametrave të mësipërm, vlerësojmë se stacionet e Basenit të Vjosës klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë.

Në ujërat e Vjosës, përmbajtja e Cd është gjetur e lartë krahasuar me vlerat e përcaktuara nga standardi udhëzues i VKM dhe DKU ose >1 µg/l në mostrat e marra pranë Lumit Drino dhe Vjosë. Ndërsa, përmbajtja e Pb, është më e ulët se standardi i parashikuar nga VKM ose <50 µg/l por më i lartë se 2.5 µg/l ose vlera e përcaktuar nga DKU për të gjithë stacionet e monitoruara.

Grafiku 5. Vlerat mesatare të përqendrimit të metaleve në trupën ujore të Lumit Vjosë.



➤ **Baseni i Semanit**

Baseni i Semanit është monitoruar në 8 pika monitorimi në të gjithë gjatësinë e tij.


Tabela 8. Vlerat mesatare për basenin Seman, 2023

Kodi	Lumi	Vendndodhja	Oksigjeni i tretur, mg/l	pH	NBO ₅ mg/l	NH ₄ mg/l	NO ₂ mg/l	NO ₃ mg/l	PO ₄ mg/l	P-total mg/l
Dv0	Seman	Bilisht – Ura e Treshit	11	7.56	5	0.031	0.003	0.3	0.04	0.025
Dv1	Devoll	Kuçovë – Ura Kuçovë Kozarë	9.8	7.71	6	0.077	0.001	0.28	0.008	0.01
Os1	Osum	Ura Lapan	9	7.69	2.5	0.08	0.002	0.23	0.01	0.012
Os2	Osumit	Fshati Uznovë	9.1	7.43	5.5	0.062	0.006	0.23	0.008	0.011
Os3	Osumit	Ura Vajgurore	9.7	7.64	2.5	0.044	0.001	0.2	0.02	0.004
Gj4	Gjanice	Ura e Qytetit Fier	9.8	7.62	12	0.46	0.005	0.67	0.018	0.021
Se5	Seman	Ura e Mbrostarit	8.5	7.57	4.5	0.23	0.0006	0.38	0.013	0.017
Se6	Seman	Mujalli, Libofsh	7.2	7.6	6	0.077	0.0028	0.26	0.016	0.021

Ujërat janë të ngopura me oksigjen. Nevoja biokimike për oksigjen (NBO₅) është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, ku stacioni Gj4 – Ura e qytetit ka një përmbajtje të lartë të NBO₅ duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër. Referuar vlerave mesatare të amonjakut, vlerësojmë ndotje ne stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier duke u klasifikuar në Klasën III – Gjendje e moderuar. Përmbajtja e nitriteve,

nitrateve dhe fosforit total i klasifikon stacionet në Klasa I – Gjendje e Lartë. Bazuar mbi përmbajtjen e orto – fosfateve, këto stacione klasifikohen në Klasa II- Gjendje e mirë.

Vlerësojmë se Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën IV- Gjendje e varfër me nje ndotje te konstatuar në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është i lartë.



Grafiku 6. Vlerat mesatare të përqendrimit të metaleve në trupën ujore të Lumit Seman

Cilësia e ujit të Lumit Seman është e mirë referuar vlerave limite të VKM, por shfaq problem lidhur me përmbajtjen e Cd dhe Pb në rrjedhën e Osumit dhe Gjanicës. Vlerat e metaleve janë mbi limitet e rekomanduara nga DKU.

➤ **Ndotja radioaktive dhe precipitimet atmosferike**

Monitorimi mbi nivelin e ndotjeve radioaktive të ujërave sipërfaqësore kryesore të vendit dhe precipitimeve atmosferike, në disa pika të caktuara të vendit tonë është kryer në dy sezone (Qershor, Nëntor). Ky monitorim shërben për vëzhgimin dhe evidentimin e gjendjes nga pikëpamja e ndotjes radioaktive si dhe vlerësimin e burimeve të mundshme të ndotjes. Treguesit e pranisë së ndotjes radioaktive në ujë janë përqëndrimi i aktiviteit alfa/beta total, radionuklidet natyrore: Uranium – 238, Uranium – 234, Radium – 226, Radium – 228, radionuklidet artificiale: Karbon -14, Stroncium – 90, Plutonium 239/240, Americium – 241, Kobalt – 60, Cezium -134, Cezium – 137, Jod – 131.

Tabela 9. Rezultatet përmblledhëse mesatare për çdo stacion

Vlerat mesatare 2023	Aktiviteti alfa total mesatar mBq/L	Vlera e rekomanduar e aktivitetit alfa total (KE) mBq/L	Aktiviteti beta total mesatar mBq/L	Vlera e rekomanduar e aktivitetit beta total (KE) mBq/L
Lumi Drin (Baçallëk, Shkodër)	129.3	500	721.695	1000
Lumi Mat (Ura e Re në Milot)	56.31	500	488.34	1000
Lumi Erzen (Ura e Beshirit)	64.48	500	525.925	1000
Lumi Erzen (Ura e Peshkatarit)	94.41	500	684.315	1000
Lumi Shkumbin Mirake (Qukës)	83.82	500	487.505	1000
Lumi Shkumbin (Ura Rrogozhinë)	76.47	500	277.855	1000
Lumi Vjosë (Ura e Mifolit)	69.23	500	616.42	1000
Precipitime (Fallout)	Bq/m ² ne muaj		Bq/m ² ne muaj	
Tirane	0.74		6.76	

- *Aktiviteti alfa-total i ujrave të lumenjve*



Vlera më e lartë e aktivitetit alfa total mesatar vjetor vrojtohet në lumin Drin (Baçallëk, Shkodër), (129.3 ± 12.23) mBq/L. Ndërsa vlera më e ulët e aktivitetit alfa total mesatar për vitin 2023 vrojtohet në lumin Mat (Ura e Re në Milot) 56.31 ± 5.45 mBq/L. Duke i'u referuar të dhënave të viteve të kaluara që ka IFBZ (vitet 2000-2005, 2007-2009, 2015), ka luhatje të vlerave që mund të konsiderohen si variacion sezonal normal, me prirje për rritje të vlerave në sezonin e vjeshtës, për shkak të prurjeve të shtuara nga shirat e stinës.

- *Aktiviteti beta-total i ujërave të lumenjve*

Vlera më e lartë e aktivitetit beta total mesatar vjetor vrojtohet në lumin Drin (Baçallëk, Shkodër) 721.695 ± 71.34 mBq/L ndërsa vlera më e ulët vrojtohet në lumin Shkumbin (Ura e Rrogozhinës) 277.85 ± 26.32 mBq/l. Këto jane variacione të pranueshme, nisur nga statistikat edhe të rajonit.

- *Aktiviteti alfa-beta total i precipitimeve atmosferike (Fallout)*

Përsa i përket vlerave të aktivitetit alfa-beta total të precipitimeve atmosferike (Fallout), nga matjet e kryera para vitit 2005, gjatë 2015 - 2021 mund të thuhet se aktiviteti alfa beta total është në intervalin e vlerave që janë konstatuar në vendin tonë gjatë dekadës së kaluar. Vlerat e maturapër aktivitetin alfa total variojnë nga 0.3 Bq/m² /muaj deri në 1.2 Bq/m² /muaj. Po kështu për aktivitetin beta total rendi i vlerave nga matjet e kaluara është 2.1 – 12.9 Bq/ m² /muaj



Nga rezultatet e monitorimit shihet se vlerat e radioaktivitetit alfa dhe beta total janë nën vlerat e përcaktuara në standartet ndërkombëtare (KE) dhe kombëtare për ujin e pijshëm.

Sipas legjislacionit Shqiptar dhe rekomandimeve të KE, normat e lejuara për ujin e pijshëm janë: 0.5 Bq/l për radioaktivitetin alfa total dhe 1 Bq/l për radioaktivitetin beta total.


Duke patur parasysh që disa nga burimet e ujit për konsum të popullsisë dhe sidomos për nevoja të përdorimit të gjerë në bujqësi furnizohen nga lumenjtë është shumë e rëndësishme që treguesit e radioaktivitetit të jenë në monitorim të vazhdueshëm periodik.

Sipas Rekomandimeve të Këshillit të Europës të vitit 1980 për parametrat e ujit (radioaktiviteti në ujin për konsum njerëzor), të rishikuara në vitin 1998 (Direktiva e Këshillit të Europës 98/83) u vendos një set i ri parametrash për nivelet e përqëndrimit të radioaktivitetit në ujë. Parametrat e ujit përfshijnë edhe TID (Total Indicated Dose). Direktivat e reja përcaktojnë që TID nuk duhet të kalojë vlerën 0.1 mSv/vit. TID është doza totale e rrezatimit të gjithë radionuklideve prezente në ujë, pa marrë në konsideratë Tritiumin, Kaliumin-40, radonin dhe bijat e tij.

Shqipëria synon të bëhet së shpejti një vend kandidat për në BE. Në këtë situatë, ne duhet të jemi të përgatitur për të përmbushur kërkesat e nenit 35 dhe 36 të Traktatit të Euratomit në lidhje me monitorimin e niveleve të radioaktivitetit në mjedis (në ujërat sipërfaqësore dhe të pijshme) për qëllimin e vlerësimit të ekspozimit të popullsisë ndaj rrezatimeve radioaktive në tërësi.

Prania e ujërave që përmbajnë vlera të larta të radioaktivitetit alfa dhe beta total ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale që shërbejnë për konsum të popullatës. Ky fakt sjell si pasojë rritjen e dozës së rrezatimit dhe rritjen e propabilitetit për sëmundje kancerogjene.

4.2.1.2 Cilësia e ujërave të liqeneve



Liqeni i Ohrit ushqehet kryesisht nga ujërat nëntokësorë (rreth 50%) dhe burime të ndryshme karstike (Shën Naumi kontribuon në afërsisht 75% të prurjes së përgjithshme nëntokësore, Tushemishti në 25% të saj).

Liqeni i Prespës është një ndër liqenet me ujëra të freskëta në Europë që u takon tre shteteve; Maqedonisë Veriut, Shqipërisë dhe Greqisë, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 318.9 km² nga të cilat 38.8 km² i takojnë Shqipërisë. Prespa ndahet në dy liqene: Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël.

Liqeni i Shkodrës ka një sipërfaqe prej 368 km², nga të cilat 149 km² me një gjatësi brigjesh prej 57 km i përkasin Republikës së Shqipërisë ndërsa 2/3 Malit të

Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të liqeneve bazohemi në vlerat limite të parametrave kimikë të Direktivës Kuadër të Ujit të BE, për përcaktimin e gjendjes së liqenit.

Vlerat limite të cilësisë së ujërave të liqeneve sipas DKU

Parametrat	Njësia matëse	Vlerat limite për përcaktimin e gjendjes		
		Oligotrofik	Mezotrofik	Eutrofik
Transparenca	m	5-10 (max 15-20)	1-2 (max.5-10)	<1 (max 2-3)
Nevoja Kimike për Oksigjen (NKO)	mg O ₂ /l	1-2	8-9	20-65
Nevoja Biokimike për Oksigjen(NBO ₅)	mg O ₂ /l	<3	3-5,5	5,5-14
Nitrate (NO ₃ -N)	mg N/l	<1	<1	>2
Fosfor total (P- total)	µg P/l	4-10	10-35	35-100



Indeksi i gjendjes trofike Karlson (TSI)

Indeksi TSI	Përshkrimi
TSI <30	Oligotrofi klasike; ujëra të qarta, oksigjen gjatë gjithë vitit në shtresën lipolimnion, peshq në thellësi.
TSI 30-40	Liqenet e thellë paraqiten oligotrofe klasike, por ujërat e cekta bëhen anoksike gjatë verës.
TS 40-50	Ujëra akoma të qarta, por rritet probabiliteti i anoksisë në shtresën hipolimnion gjatë verës.
TS 50-60	Nivel i ulët i eutrofisë klasike: reduktim i transparencës, anoksi në hipolimnion gjatë verës, makrofite të pranishme, peshq të ujërave të ngrohta.
TSI 60-70	Predomonojnë algat blu-të gjelbërta, shkuma e algave e mundshme, prani e vlerësueshme e makrofiteve.

TSI 70-80	“Bloom” i algave gjatë verës, shtresë e dendur makrofite, po me shtrirje të kufizuar për shkak të depërtimit të dritës. Shpesh gjendja mund të klasifikohet si hipereutrofike.
TSI > 80	Shkumë algash, peshq të ngordhur gjatë verës, makrofitet, dominojnë peshq rezistentë.



Liqeni i Shkodrës


Monitorimi i Liqenit të Shkodrës realizohet në tre stacione në Koplík (Stërbec), Shirokë dhe Zogaj, ku në çdo pikë monitorimi janë kampionuar mostra në 2 thellësi të ndryshme: 0 m dhe 10m. Liqeni i Shkodrës është një liqen me thellësi relativisht të vogël, ku mungon fenomeni i shtresëzimit, përzierjes së ujit.



Vlerat mesatare të transparencës së ujit variojnë nga 2 m – 2.3 m duke i klasifikuar ujërat me cilësi mezotrofike. Referuar vlerave mesatare të përmbajtjes kimike për oksigjen në të tre stacionet e Liqenit të Shkodrës vlerësojmë se ujërat e liqenit janë të cilësisë mezotrofike.

Nevoja biokimike për oksigjen paraqitet me vlera të cilat i klasifikojnë ujërat e liqenit në cilësi mezotrofike në të tre stacionet e monitoruar. Përmbajtja e nitrateve i plotëson kushtet për cilësi oligotrofike, pasi vlerat mesatare të monitorimit janë < 1 mgN/l.





Përmbajtja mesatare e fosforit total në stacionin e Koplíkut rezulton më e lartë duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.

Liçeni i Shkodrës nuk paraqet ndotje biologjike referuar indeksit Karlson, ujërat kanë nivel mesatar të ushqyesve pasi klasifikohen në cilësi mezotrofike, shkallë e cila rrit probabilitetin e problemeve në cilësinë e ujërave të liçenit.

Klorofila -a (mg/m³)



Shirokë - 2.83

Zogaj - 2.81

Koplík - 3.6

Indeksi Karlson (TSCI)



Shirokë - 38.32



Zogaj - 34.7

Koplík - 41.99



Liçeni i Ohrit dhe tributarët e tij

Monitorimi i Liçenit të Ohrit është realizuar në dy pika, ku stacioni i parë është stacion reference në thellësi 150 metra, dhe mostrat merren në 8 thellësi nga sipërfaqja deri në fund të liçenit e përkatësisht 0, 20, 40, 60, 80, 100, 120, 150 m, kurse stacioni nr.2 është 200 m nga bregu,përballë qytetit, në thellësi mbi 5 metra. Cilësia e tributarëve (Lumi i Pogradecit, Vërdovës dhe Tushemishtit) të cilët derdhen në liçenin e Ohrit, ndikon në cilësinë e këtij liçeni. Prandaj janë kryer monitorime të cilësisë të tyre për disa parametra.


Vlerësimi për tributarët është kryer referuar normave të DKU për lumenjtë (tabela 1, kapitulli “Ujërat”).



Ujërat e liqenit janë të ngopura me oksigjen me vlera që variojnë 5.3 – 9.1 mgO/l. Liqeni i Ohrit për parametrin e transparencës paraqet gjendje oligotrofike në stacionin e referencës, ndërsa në stacionin litoral transparenca është me tendencë në cilësi mezotrofike. Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen në stacionin e referencës paraqet vlerën 4 mg/l, ndërsa në stacionin litoral në vlerën 5.6 mg/l duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.



Referuar përmbajtjes së nevojës biokimike për oksigjen, stacionet e referencës dhe litoral, vlerësohen me cilësi oligotrofike. Përmbajtja e nitrateve plotëson kushtet për cilësi oligotrofike për stacionin e referencës, pasi në stacionin litoral është vlerësuar përmbajtje e nitrateve në vlerën 1.4 mgN/l duke u klasifikuar në cilësi mezotrofike.



Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet është e ulët duke i klasifikuar stacionet në cilësi oligotrofike.

Nga të dhënat e monitorimit të klorofilës - a dhe indeksit trofik, ujërat e këtij liqeni vlerësohen me cilësi oligotrofike në stacionin e referencës dhe mezotrofike në stacionin litoral.

Klorofila -a (mg/m³)

Indeksi Karlson (TSCI)



□ Stacion reference- 1.38

□ Stacion reference - 33.6

□ Stacion litoral- 1.75


□ Stacion litoral- 30.6

Përsa i përket përmbajtjes së metaleve të rënda në liqenin e Ohrit, rezulton se, referuar standardeve të përcaktuara nga VKM dhe DKU përmbajtja e As, Cd, Cu dhe Hg është e ulët duke i klasifikuar ato në Klasën A1, ose me *cilësi të mirë*. Referuar përmbajtjes së Pb, vlera është më e ulët se standardi Shqiptar por më e lartë së 2.5 µg/l përcaktuar nga DKU.

Tabela. 10 Përqëndrimi i metaleve në ujin e liqenit të Ohrit



	Distanca nga bregu (në m)	Përmbajtja e metaleve µg/L: : Mesatare për 2023				
		As	Cd	Cu	Pb	Hg
Liqeni i Ohrit	0	3.00	1.51	1.64	5.39	0
	10	0.00	0.34	2.02	2.75	0
	20	0.00	0.38	2.50	3.02	0
	40	0.00	0.52	7.24	2.99	0
	60	0.00	0.49	2.04	3.22	0
	80	0.00	0.22	2.06	3.35	0
	100	0.00	0.24	2.41	1.92	0
	150	0.00	0.34	2.24	3.81	0
	Liqeni i Ohrit-Pogradec (200m nga bregu, litoral zone.0m)	0.00	0.27	1.87	3.59	0

Tributarët e liqenit të Ohrit (Lumi i Pogradecit, Lumi Vërdovë, Lumi Tushemisht)





Ujërat e këtyre tre lumenjve vlerësohen alkaline me pH <8.5, me vlera që variojnë nga 7.07 – 7.67.

Temperaturat mesatare të ujërave variojnë në përputhje me ndryshimet sezonale. Të gjitha stacionet janë të ngopura me oksigjen me vlera > 6 (Klasa II – Gjendje e mirë).





Përmbajtja më e lartë e Nevojës Biokimike për Oksigjen është vlerësuar në Lumin e Verdovës duke u klasifikuar në Klasën III – Gjendje e moderuar. Referuar vlerave mesatare të amonjakut, Lumi i Pogradecit paraqitet në gjendje të mirë me një vlerë mesatare 0.019 mg/l, në Lumin e Vërdovës përmbajtja mesatare është 0.35mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën III –Gjendje e moderuar dhe Lumi i Tushemishtit plotëson kushtet për ujëra me cilësi të lartë.

Përmbajtja e nitrateve për të tre stacionet e kampionimit rezulton të jetë brenda normës së lejuar. Prania e nitrateve në ujërat e lumenjve vjen kryesisht nga përdorimi i plehrave kimike në bujqësi në tokat rreth zonës së kampionimit. Në të tre stacionet e monitoruara ka përmbajtje të ulët të nitriteve.



Referuar rezultateve mesatare të monitorimit për përmbajtjen e ortofosforit, Lumi i Pogradecit dhe Tushemishtit klasifikohen në Klasën I – Gjendje e lartë, ndërsa Lumi i Vërdovës klasifikohet në Klasën III – Gjendje e moderuar.



Përmbajtja e fosforit total në stacionet Lumi i Pogradecit dhe Tushemishtit vlerësohen brenda normës së lejuar, ndërsa në stacionin e Vërdovës është në vlerën 0.12 mg/l duke u klasifikuar në Klasën II - Gjendje e mirë.

Lumi i Pogradecit vlerësohet në Klasën II- Gjendje e mire. Lumi i Vërdovës klasifikohet në Klasën III- Gjendje e moderuar, ku vlerësohet përmbajtje e amonjakut dhe fosforit, të cilat dëshmojnë për shkarkime urbane të cilat derdhen direkt pa asnjë trajtim paraprak. Por duhet theksuar se kemi përmirësim krahasuar me 2022, ku ky lumë ishte i një cilësie të varfër. Lumi i Tushemishtit vlerësohet në Klasën I- Gjendje e lartë.


Tabela. 11 .Përqëndrimi i metaleve në tributarët e liqenit të Ohrit

	Përmbajtja e metaleve µg/L: : Mesatare për 2023				
	As	Cd	Cu	Pb	Hg
Lumi Pogradecit	0.00	0.40	1.62	7.79	0
Lumi Verdoves	0.00	0.65	0.87	5.47	0
Lumi Tushemishtit	0.00	0.39	3.35	2.62	0



Referuar normave të DKU, përmbajtja e Pb është më e lartë në ujin e Lumit Pogradecit dhe Vërdovës. Megjithatë përmbajtja e Pb është më e ulët se vlera e rekomanduar e VKM.

Liqeni i Prespës


Monitorimi i Liqenit të Prespës së Madhe realizohet në tre pika kampionimi përkatësisht në Goricë, Liqenas dhe Gollomboç dhe monitorimi i Prespës së Vogël realizohet në një pikë kampionimi.



Vlera mesatare e transparencës për ujërat e liqenit të Prespës së Madhe janë 3.02 m duke eklasifikuar Prespën e Madhe me cilësi mezotrofike dhe në Prespën e Vogël vlera e transparencës është 2 m. Bazuar mbi përmbajtjen e nevoja kimike për oksigjen, në të tre stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave të Liqenit të Prespës së Madhe kemi një klasifikim në cilësi mezotrofike të ujërave, ndërsa Prespa e Vogël klasifikohet në cilësi eutrofike.




Përsa i përket nevojës biokimike për oksigjen në të tre stacionet e monitorimit të Prespës së Madhe vlerat mesatare variojnë 3.8 - 5 mg/l, në Prespën e Vogël vlera e matur është 8 mg/l. Përmbajtja e nitrateve është brenda normës së lejuar < 1mg/l për të gjitha stacionet.




Referuar përmbajtjes mesatare të fosforit total është vlerësuar përmbajtje e fosforit total në Prespën e Vogël duke eklasifikuar në cilësi eutrofike.

Klorofila -a (mg/m³)



Indeksi Karlson (TSCI)




Duke u nisur nga vlerësimi i të gjithë parametrave bazë të mësipërm, vlerësojmë se ujërat e Liqenit të Shkodrës, Ohrit dhe Prespës së Madhe janë të cilësisë mezotrofike, ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike.

Referuar përmbajtjes së metaleve As, Hg, cilësia e ujit të liqeneve Pogradec, Prespë dhe Shkodër Cu, konsiderohet e mirë (A1). Megjithatë, janë gjetur gjurmë të Cd dhe Pb në disa pika monitorimi mbi vlerat e rekomanduara nga DKU. Gjurmë të tilla janë gjetur në përroin e Vërdovës i cili derdhet në Liqenin e Pogradecit, në Prespë dhe Liqenin e Shkodrës.

4.2.2 Prurjet e ujërave në lumenj

Monitorimi i vazhdueshëm i prurjeve siguron të dhëna sa më reale mbi prurjet ujore dhe shpërndarjen e tyre në kohë gjatë gjithë stinëve të vitit. Gjithashtu jep mundësinë për të kontrolluar karakteristikat e rrjedhës, rrezikon që ajo mbart dhe për të orientuar optimalisht, si mirëmenaxhimin e saj ashtu edhe masat parandaluese nga dëmet e pritshme. Një koordinim dhenjë përputhje e mirë e këtyre të dhënave me kërkesat për ujë, siguron një planifikim dhe menaxhim të drejtë të të gjitha aktiviteteve që kanë domosdoshmëri përdorimin e rezervave ujore.



Në faktorët natyrorë që ndikojnë në sasinë e prurjeve ujore, rëndësi parësore kanë:

- faktorët hidrometeorologjikë (rreshjet dhe intensiteti i tyre),
- ndërtimi gjeologjik i rajonit (shkalla e përshkueshmërisë së formacioneve),
- pjerrësitë e reliefit në brigjet e shtretërve, shkalla e pyllëzimit (koeficienti i rrjedhës),
- pjerrësitë e vetë shtratit (gradienti i shtratit dhe i rrjedhës),
- sedimentimi apo erozioni i aluvioneve në shtratin e lumit (ulje-ngritjet e bazamentit),
- shkalla e zhveshmërisë së pellgut ujëmbledhës (mbulesa bimore), etj.

Monitorimi i prurjeve është kryer në lumenjtë Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë. Kohëzgjatja e këtij procesi është brenda vitit kalendarik, dhe është ndarë në dy cikle matjesh në kohë të ndryshme prurjesh në 24 stacione në rrjetin lumor të Shqipërisë. Matjet përfazën e parë të punimeve janë kryer në muajt Korrik - fillim Gushti, pra në stinë e verës, stinë ecila karakterizohet nga një minimum i prurjeve ujore në shtretërit e lumenjve të Shqipërisë. Matjet e fazës së dytë janë kryer gjatë periudhës së muajit Tetor 2023.

Lumi Drin

Ura e Topojanit

Nuk ekziston rreziku i përmbytjes në këtë segment pasi sasia e ujit që kalon është e kontrolluar dhe sipërfaqja e seksionit tërthor të kanalit deri në nivelin e urës përballonsasitë maksimale të prurjeve.

Ura e Lumës

Prania e HEC-it devijon sasi të konsiderueshme uji dhe shmang rrezikon e përmbytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë.

Bahçallëk

Ka sasi të më të mëdha të prurjeve. Rreziku i përmbytjes në këtë zonë është evident dhe ka ndodhur shpesh gjatë dekadave të fundit.

Ura e Mesit

Për të dy fazat nuk u kryen matje për shkak të mungesës së ujit në shtrat. Lumi i Kirit ka karakter të theksuar stinor dhe rrjedhje me shpejtësi. Mungesa e reshjeve pasqyrohet në praninë e një shtrati të thatë.

Lumi Buna**Ura e Bunës**

Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të mëdha nga kaskada e Vaut të Dejës mbi lumin e Drinit.

Murriqan

Vlera e Rrezes $R_H = 2.09$, tregon aftësi të mira përcjellëse të kanalit, por në raste prurjesh të mëdha, për shkak të disniveleve të vogla me bankot e lumit, rrjedha kalon edhe në stadin e përmbytjes.

Lumi Mat**Darsi**

Sasitë e vogla të prurjeve janë rezultat i thatësisë së zgjatur. Pakësimi i prurjeve në fazën e dytë është ndikim direkt i mungesës së reshjeve. Në këtë segment nuk ka ekzistuar më parë rreziku i përmbytjeve, por vitin e fundit niveli i ujit kaloi atë të urës duke përmbytur pjesërisht nivelin e terracës së parë, kjo e konfirmuar nga banorët e zonës.

Ura e Fanit

Sasia e ulët e ujit në shtrat lidhet kryesisht me thatësinë e zgjatur, por edhe me regjimin e HEC-eve të ngritura mbi lumin e Fanit. Pjesa më e madhe e rrjedhës gjatë matjeve në të dyja fazat janë ujëra të zeza të qytetit të Rrëshenit dhe fshatrave në afërsi. Nuk ka rrezik për

Ura e Zogut

Sasitë e ujit në këtë stacion janë funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të HEC-eve mbi lumenjtë e Fanit dhe Matit. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm në pjesët poshtë Urës së autostradës deri në det, sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në periudhë të shkurtër kohore.

Lumi Ishëm**Ura e Brarit**

Forma e shtratit e ngushtë dhe e thellë lejon kalimin e sasive të mëdha të ujit për në seksionet e mëposhtëm. Nuk ka rrezik përmbytjeje.

Salme-Shetaj

Sasia më e madhe e ujit kalon në krahun e djathtë të shtratit. Rreziku për përmbytje është i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëherëshme në kohë të shkurtër

Lumi Erzen

Pëllumbas

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të rezervuarit të Skoranës në hyrje të kanionit. Në këtë sektor të lumit, po ndërtohen vepra tërthore për uljen e shpejtësisë së rrjedhës dhe minimizimin e erozionit prapësor. Nuk ka rrezik për përmbytje.

Sallmone

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Rreziku i përmbytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident, pasi shtrati i ngushtë në kohë plotash ekstreme, rrezikon të mos përballojë sasisë të ujit.

Lumi Shkumbin

Proptisht

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Rreziku i përmbytjes së zonës është evident, pasi shtrati në kohë plotash ekstreme, rrezikon të mos përballojë sasisë të ujit. Por nuk rrezikohen objektet dhe shtëpitë e banimit pasi ato ndodhen jashtë kësaj zone.

Labinot + Përroi i Gurës

Punimet e kryera në pjesët e mësipërme në shtratin e lumit për zgjerimin e rrugës nacionale kanë ndikuar ndjeshëm në prishjen e regjimit të rrjedhës. Rreziku i përmbytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident.

Ura e Rrogzhinës

Prurja është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin ujëmbledhës në Çengelaj. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër.

Lumi Seman

Bilishtit

Ky stacion ndodhet në pjesën e sipërme të rrjedhës së lumit Devoll. Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore.

Ura e Lapanjit

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Forma e thellë e kanionit lejon kalimin e sasive të mëdha të ujit për në seksionet e mëposhtëm. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

Fier (lumi i Gjanicës)

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Një pjesë e madhe e prurjeve të matura janë ujëra të zeza të cilat shkarkohen fare pranë Urës në krahun e

Ura e Mbrostari

Prurja është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin e Thanës. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër

Lumi Vjosa

Tri Urat

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Nuk ka rrezik për

Ura e Leklit

Vërehet ndryshueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera, kjo për shkak të mungesës së reshjeve Nuk ka rrezik për përmbytje.

Memaliaj

Paraqet aftësi përcjellëse të mira të kanalit të rrjedhës. Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore Nuk ka rrezik për përmbytje në këtë sektor.


Ura Mifolit

Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të mëdha në periudhë të shkurtër kohore. Të rrezikuara janë të gjitha objektet inxhinieriketë ndërtuara dhe ato të banimit që gjenden në të dy anët e lumit

Tabela 12. Rezultatet e matjeve të prurjeve për vitin 2023

Lumi	Stacionet e monitorimit	Koordinatat		Prurjet (m ³ /sek)	
		N	E	Faza e I	Faza e II
Drin	Ura e Topojanit	41° 34' 50,00"	20° 26' 2,49"	59.8	13.9
	Ura e Lumës	42° 4' 3,66"	20° 27' 50,74"	1.01	2.85
	Bahçallëk	42° 2' 31,79"	19° 29' 32,48"	242.2	167.3
	Ura e Mesit	42° 06' 50"	19° 34' 29"	0	0
Buna	Ura e Vjetër e Bunës	42° 3' 3,17"	19° 29' 28,16"	119.5	90.63
	Murriqan	42° 0' 30,20"	19° 24' 14,78"	321.48	310.03
Mati	Ura e Darsit	41° 30' 23,91"	20° 04' 58,52"	4.19	3.11
	Ura e Fanit (Fani i Vogël),	41° 46' 32,40"	19° 51' 34,10"	0.83	0.697
	Ura e Zogut	41° 41' 57,50"	19° 43' 33,62"	9.84	15.33
Erzeni	Pëllumbas	41° 14' 43,24"	19° 56' 9,32"	0.81	1.3
	Sallmone	41° 21' 39,55"	19° 32' 56,85"	2.32	2.57
Ishmi	Ura e Brarit (lumi i Tiranës),	41° 22' 47,72"	19° 51' 34,27"	0.55	0.31
	Salme-Shete (lumi Ishëm)	41° 32' 29,39"	19° 36' 37,98"	3.83	4.89
Shkumbini	Proptisht (Qukës-Prrenjas)	40° 58' 57,86"	20° 30' 38,39"	1.36	2.26
	Labinot,	41° 08' 53,77"	20° 9' 58,47"	26.02	7.914
	Ura vjetër (Rrogozhinë)	41° 03' 52,14"	19° 39' 13,13"	25.52	10.61
Semani	Bilisht (lumi Devoll)	40° 39' 17,53"	20° 57' 17,82"	1.103	0.712

	Ura e Lapanit-Çorovodë (lumi Osum),	40 ⁰ 25' 42,55"	20 ⁰ 17' 13,47"	2.34	2.11
	Ura Gjanicës-Fier (lumi i Gjanicës),	40 ⁰ 44' 2,83"	19 ⁰ 34' 19,86"	0.656	0.248
	Ura e Mbrostarit (Seman)	40 ⁰ 49' 44,72"	19 ⁰ 54' 38,85"	10.12	23.42
Vjosa	Tri Urat	40 ⁰ 06' 44,08"	20 ⁰ 32' 23,96"	13.51	9.82
	Ura e Leklit (lumi Drinos),	40 ⁰ 15' 33,19"	20 ⁰ 03' 19,86"	5.63	3.22
	Memaliaj	40 ⁰ 21' 05,61"	19 ⁰ 58' 22,19"	32.8	20.64
	Ura Mifoliti	40 ⁰ 38 ' 4,26"	19 ⁰ 27' 39,08"	31.9	48.75
Gjithsej	24 stacione				



Nga rezultati i matjeve të kryera, rezulton se në përgjithësi kemi patur sasira të vogla të prurjeve ujore në të gjitha stacionet ku janë kryer këto matje, referuar edhe stinëve përkatëse dhe sasishtëpër të kufizuar të reshjeve në vendin tonë. Jemi në periudhë thatësire ndaj dhe këto rezultatekanë qenë të pritshme. Shtojmë këtu edhe reshjet e pakta që kanë rënë sidomos në periudhënnatyrare të tyre, në atë të vjeshtës.

Rreziku i përmbytjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në seksione të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Nga shkaqet kryesore të këtij fenomenij janë ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë.

- **Tendenca e prurjeve ujore**

Tabela 13 . Rezultatet e prurjeve për vitet 2016 - 2023, fazat e para.

Nr	Stacionet	Kodi	Lumi	2016	2018	2019	2022	2023
1	Ura Topojanit	D1	Drin	20.9	156.9	20.7	10.786	59.8
2	Ura e Lumës	D3	Drin	14,3	39.0	7.6	0.6	1.01
3	Bahçallëk	D2	Drin	656,4	466.0	196.4	280.94	242.2
4	Ura e Mesit	K1	Kir	-	-	11.4	0	0
5	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	76,5	457.8	236.0	77.89	119.5
6	Murriqan	Bu1	Bunë	777.0	1049.3	441.3	368.97	321.48
7	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit	35.5	45.1	8.6	2.766	4.19
8	Ura e Fanit	Ma1	Fani Vogël	6.7	2.4	10.0	0.399	0.83
9	Ura e Zogut	Ma5	Mat	126.4	180.5	143.3	10.744	9.84
10	Ura e Brarit	T1	Ishëm	5.4	1.9	3.4	0.736	0.55
11	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	29.9	6.1	10.6	3.2	3.83
12	Pëllumbas	Er1	Erzen	8.3	6.5	2.8	0.543	0.81
13	Sallmone	Er3	Erzen	14.3	16.8	7.66	0.906	2.32
14	Proptisht	Sh6	Shkumbin	27.3	18.8	16.2	0.797	1.36
15	Labinot	Sh5	Shkumbin	144.9	125.0	101.1	6.15	26.03
16	Rrogozhinë	Sh4	Shkumbin	98.2	105.4	133.1	3.24	25.52
17	Bilisht	Dv2	Devoll	-	5.0	2.6	0.473	1.103
18	Ura Lapanjtit	Os4	Osum	-	23.7	10.7	2.347	2.34
19	Fier	Gj4	Gjanicë	2.1	3.7	3.2	1.154	0.656
20	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	60.2	231.4	151.5	13.41	10.12
21	Tri Urat	Vj1	Vjosë	74.2	85.4	58.4	16.01	13.51
22	Ura e Leklit	Vj3	Drinos	105.5	47.3	18.8	5.38	5.63
23	Memaliaj	Vj4	Vjosë	-	135.5	78.0	40.0	32.8
24	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	247.6	234.7	125.4	49.93	31.9

Tabela 14 . Rezultatet e prurjeve për vitet 2016 - 2023 fazat e dyta

Nr	Stacionet	Kodi	Lumi	2016	2018	2019	2022	2023
1	Ura Topojanit	D1	Drin	15.4	50.9	8.93	18.805	13.9
2	Ura e Lumës	D3	Drin	0.7	6.2	0.62	0.327	2.85
3	Bahçallëk	D2	Drin	231.9	278.2	70.27	334.8	167.3
4	Ura e Mesit	K1	Kir	-	-	-	1.482	0
5	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	64.4	66.2	93.27	92.454	90.63
6	Murriqan	Bu1	Bunë	341.2	360.0	202.22	384.78	310.03
7	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit	7.7	2.2	1.8	9.55	3.11
8	Ura e Fanit	Ma1	Fani Vogël	0.5	2.3	0.25	3.07	0.697
9	Ura e Zogut	Ma5	Mat	26.9	16.1	14.24	20.827	15.33
10	Ura e Brarit	T1	Ishëm	1.5	0.4	0.46	1.419	0.31
11	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	7.1	5.1	4.44	4.328	4.89
12	Pëllumbas	Er1	Erzen	1.3	1.2	1.21	2.106	1.3
13	Sallmone	Er3	Erzen	5.0	3.8	4.08	4.31	2.57
14	Proptisht	Sh6	Shkumbin	4.9	1.4	0.94	0.896	2.26

15	Labinot	Sh5	Shkumbin	26.0	12.4	4.08	19.543	7.914
16	Rrogzhinë	Sh4	Shkumbin	41.8	20.9	4.45	14.578	10.61
17	Kuçovë	Dv1	Devoll	44.1	-	-	-	0.712
18	Bilisht	Dv2	Devoll	-	0.5	0.27	0.481	2.11
19	Ura Lapanjit	Os4	Osum	-	0.9	3.03	2.53	0.248
20	Fier	Gj4	Gjanicë	0.3	1.5	0.74	0.109	23.42
21	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	40.2	29.9	14.26	22.3	9.82
22	Tri Urat	Vj1	Vjosë	29.8	14.9	20.86	15.77	3.22
23	Ura e Leklit	Vj3	Drinos	0.6	6.9	7.05	3.198	20.64
24	Memaliaj	Vj4	Vjosë	-	37.4	44.81	38.16	48.75
25	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	59.6	41.6	115.69	84.756	13.9

Instituti i Gjeoshkencës ka kryer monitorimin e prurjeve në ujëra sipërfaqësore përgjatë gjithë vitit 2023, në lumenjtë Buna, Drin, Mat, Ishëm Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë, Bistricë.

Tabela 15. Stacionet e monitorimit të prurjeve nga Instituti i Gjeoshkencës

Emri i stacionit	Vendodhja (koordinata)			Sipërfaqja (km ²)
	X	Y	Z	
Buna - Dajç	19.4141667	41.98625	2	19375
Drini - Ura Bahcallek	19.4919167	42.0425	6	14173
Mati - Milot	19.726	41.6992222	15	2430
Ishëm - Sukth Vendas	19.6183889	41.5256944	7	651
Erzeni - Ndroq	19.6604722	41.2648056	34.26	663
Shkumbini - Paper	19.9565556	41.0498333	60	1958
Semani - Ura e Mbrostarit	19.5775556	40.7505278	8	5238
Vjosa - Mifol	19.4608056	40.6344444	4	6680
Bistrica - Çukë	20.0191498	39.7435658	3	447

Matja e niveleve është kryer me Hidrometer. Kthimi në prurje është kryer me anë të kurbës së prurjeve disa vjeçare. Rezultatet paraqiten në tabelën e mëposhtme.


Tabela 16. Prurjet e ujërave sipërfaqësore 2023 (Instituti i Gjeoshkencës)

Muajt	Prurjet e ujërave, m3/s								
	Buna	Drin	Mat	Ishëm	Erzen	Shkumbin	Seman	Vjosa	Bistricë
Janar	1305	524	126	97	25	70	170	622	58
Shkurt	854	337	83	43	20	46	148	138	51
Mars	623	260	123	42	28	68	147	204	51

Prill	423	222	121	68	49	67	130	176	45
Maj	274	231	104	36	16	58	114	144	41
Qershor	167	192	76	18	11	42	145	631	20
Korrik	141	180	36	11	5	20	90	129	10
Gusht	163	198	34	10	5	19	68	142	11
Shtator	253	184	32	12	5	18	68	145	12
Tetor	327	233	59	10	12	33	95	161	16
Nentor	497	274	147	55	34	82	172	349	64
Dhjetor	1122	388	120	47	38	67	181	229	52
Vlera mesatare vjetore	512	269	88	38	21	49	127	256	36

Bazuar mbi vlerat mesatare vjetore rezultojn se lumi Buna ka sasinë më të madhe të prurjeve, duke vijuar me lumin Drin dhe Vjosa.

4.2.3 Ujërat nëntokësore



Ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë janë në parim burime natyrore të rinovueshme. Furnizimi i popullsisë me ujë të pijshëm në Shqipërinë bëhet kryesisht nga ujërat nëntokësore.

Akuiferët porozë si: Shkodër-Nënszkodër, Lezhë-Tiranë, Rogozhinë-Çermë, Elbasan, Korçë, Berat, Vjosë-Shushicë, Drinos, Vrion-Mursi dhe vetë terracat lumore të lumenjëve të Shqipërisë janë burimi kryesor i furnizimit me ujë të pijshëm e teknologjik të qyteteve dhe fshatrave të Shqipërisë. Rreth 90 % e popullsisë furnizohen me ujë të pijshëm nga këto akuifer porozë.

Akuiferi karbonatik është akuiferi me resurse të mëdha ujërash nëntokësore me ujëra me cilësi shumë të mirë, ku vetëm 2-3% e tyre shfrytëzohen për ujë të pijshëm.

Shfrytëzimi intensiv e në rritje i ujërave nëntokësore shpesh krijon disekuilibre hidrodinamike e hidrokimike si dhe stimulon ndotjen e ujit nga faktorë sipërfaqësore të veprimitarisë njerëzore.

Pikërisht për këto arsye, kjo pasuri natyrore kombëtare në çdo vend monitorohet me prioritet dhe monitorimi ka karakter të përhershëm.

Monitorimi për vitin 2023, u krye në ujërat nëntokësore të akuferëve porozë dhe karbonatikë, si akuiferët më potencialë nga pikëpamja e ujëmbajtjes dhe vulnerabilitetit të tyre. Ky monitorim është kryer me frekuencë 2 herë në vit, në 7 basenet ujëmbajtëse për akuiferet porozë të kuaternarit : Shkodër, Lezhë, Fushë - Kuqe, Tiranë, Fushë - Krujë, Elbasan, Lushnjë, Berat, Korçë, Gjirokastrë, Kafaraj, Novoselë, Vurg - Mursi e Orikum.

Tabela 17 . Rrjeti i monitorimit hidrokimik për çdo basen

Baseni Drinit	8 stacione	4 shpime - në Shkodër dhe 4 burime
Baseni Matit	10 stacione	9 shpime-4 në Lezhë, 5në Fushë-Kuqe, 1Rrëshen
Baseni Ishëm-Erzenit	9 stacione	9 shpime - 4 në Fushë - Krujë e 5 shpime në Tiranë
Baseni Shkumbinit	6 stacione	6 shpime - 3 në Elbasan e 3 në Lushnjë
Baseni Semanit	13 stacione	4 shpime në Korçë e 1 burim; 6 shpime në Berat e 2 burime
Baseni Vjosës	9 stacione	5 shpime - 4 në Gjirokastrë e 1 burim dhe 3 në Fier
Baseni Zonës Jonike	4 stacione	4 shpime 3 në Sarandë e 1 në Vlorë dhe 2 burime

Tabela 18 . Rrjeti i monitorimit hidrodinamik për çdo basen

Baseni Drinit	4 shpime - në Shkodër
Baseni Matit	2 shpime - 1 në Lezhë, 1 në Fushë-Kuqe
Baseni Ishëm-Erzenit	3 shpime - 2 në Fushë - Krujë e 1 shpim në Tiranë
Baseni Shkumbinit	4 shpime - 1 në Elbasan e 3 në Lushnjë
Baseni Semanit	1 shpim në Korçë, 2 shpime në Berat
Baseni Vjosës	5 shpime - 1 në Gjirokastrë e 4 në Fier e Vlorë
Baseni Zonës Jonike	2 shpime - 2 në Sarandë

Vlerësimi cilësor i ujërave nëntokësore është kryer duke u bazuar mbi normat e lejuara sipas VKM 379 (25.05.2016) si dhe E.C. 80/778 .

Tabela 19. Normat për analizat kimike

	pH	K	Na	Ca	Mg	Fe ²⁺³	NH4	Cl	SO4	NO3	NO2	MP	M.Th	FP °gj	T °C	O ₂ i tretur	Konduktivitet
VKM 379	6.5-8.5	12,0	200	200	50	0.2-0.3	0.1 (0.5)	250	250	50	0.5	1200	500 (1000)	0-20 (25)	8-15;20	>8	2500.0
E.C 80/778	6.5-8.5	10-12	20-150	100	30-50	0.05-0.2	0.05-0.5	25	25-250	25-50	nl-0,1		1500	>60	12-25,0	>75%	400(2500)

Tabela 20. Normat për metalet e rënda (mikroelementë) në mg/l

	Ni	Mn	Zn	Pb	Cu	Co	Cr	Cd
VKM 379 (25.05.2016)	0,02	0.05	3	0.01-0.025	2		0,05	0,005
E.C. 80/778 (P.M.L.)	0.02	0.05	0,1-5	0,05	2		0,025	0,01

- **Baseni i Drinit**

Në këtë basen u krye monitorimi hidrokimik në 4 shpime të akuiferit të Kuaternarit dhe në 4 burime natyrore të akuiferit karbonatik (Syri i Sheganit, Gurra e Kolesjanit, Tushemisht dhe Lin).

- **Akuiferi i Kuaternar**

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet në akuiferin e Shkodrës është 1200 - 1300 l/sek që përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Shkodrës dhe fshatrave.

Koeficienti i shfrytëzimit varion : $K = 0.33 - 0.5$

-Risku i ndotjes është i lartë :

- Për shkak të mbulesës së vogël mbrojtëse sidomos në akuiferin e Dobraçit.
- Nga plehërimi i tokës bujqësore.
- Shfrytëzimi intensiv mund të çojë në prishjen e ekuilibrave hidrodinamikë të akuiferit.

- **Akuiferi Karbonatik**

Në këtë akuifer përfshihen

Akuiferi karbonatik i Alpeve Shqipëtare

Akuiferi karbonatik Koritnik-Gjallicë.

Akuiferi karbonatik Mali i Thatë-Rakickë

Akuiferi karbonatik Lin-Jabllanicë-Klenjë

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga burimet është 1200-1300 l/sek që përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Kukësit, Pogradecit dhe fshatrave.

Koeficienti i shfrytëzimit varion : $K = 0.2 - 0.25$

- Risku i ndotjes është i lartë :

- Mesatarisht i lartë për shkak të mungesës së mbulesës, lartësisë dhe përhapjes së madhe të akuiferit si dhe shpejtësisë së përhapjes së ndotjes.
- Nga veprimtari kryesisht blegtorale ose plehërimi i tokave bujqësore
- Shfrytëzimi kryhet vetëm nëpërmjet burimeve natyrore.

Ujërat nëntokësore të këtyre akuiferëve kanë veti fiziko – kimike të mira e shumë të mira. Ato janë ujëra pa shije, pa ngjyrë, pa erë e transparentë. Ujërat janë të freskët, me temperatura të ulëta dhe fortësi të ulët. Temperatura e tyre është e ndryshme dhe kjo varet direkt nga zona e ushqimit, kushtet dhe zona e drenimit të këtyre ujrave. Ujërat nëntokësore janë të tipit hidrokarbonat- kalciumit e më rallë hidrokarbonat-magneziumi.

Tabela 21 . Vlerësimi hidrodinamik Baseni Drin

Periudha	Grudë Fushë	Dobraç	Shtoj i vjetër	Aliaj
2023 - Korrik	-15.96 m	- 1.95 m	-15.21 m	-32 m
2023 - Tetor	-19.2 m	-2.95 m (nivel dinamik)	-16.99 m	-32.6 m
Amplituda m	3.24 m		1.78 m	0.6 m

Nivelet më të thella u takuan në shpimin Aliaj, që i përket dhe pjesës më veriore të akuiferit të monitoruar.

○ Vlerësimi i metaleve të rënda për baseni Drin

Analizat për mikroelementë janë marrë në shpimin nr.1 Dobraq për Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd. Nga vlerësimi i analizave në të dy fazat përmbajtja e mikroelementëve varion: Ni = 0.001 – 0.0003 mg/l, Mn = 0.0023 - 0.0167 mg/l, Zn = 0.0069 - 0.0104 mg/l, Pb = 0.0003 - 0.001 mg/l, Cu = 0 mg/l, Co = 0.0001 mg/l, Cr = 0.0005 – 0.0033 mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve është nën përmbajtjen e rekomanduar VKM 379 (25.05.2016) si dhe E.C. 80/778 (Tab. Nr. 20).

● Baseni Mat

Në basenin e Matit janë monitoruar akuiferi poroz i Lezhës dhe Fushë-Kuqes.

➤ Akuiferi kuaternar i Lezhës

Monitorohet me 4 shpime: shpimi nr. 50 Barbullojë, në shpimin 29 e nr.46 në Ishull - Lezhë, nr.2s Rrilë. Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është 850 - 900 l/sek për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit Lezhë, Shëngjin dhe fshatrave përreth. Koeficienti i shfrytëzimit është: K = 0.4 - 0.45

Risku i ndotjes

- Nga sipërfaqja është i ulët falë mbulesës së trashë ekranizuese, largësisë së zonës së ushqimit dhe karakterit artesian të shtresave ujëmbajtëse.
- Mund të vijë nga plehërimi i tokës bujqësore.
- Vetëm intensifikimi i madh i shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujërave me mineralizim të lartë nga krahu verior e perëndimor i akuiferit ujëmbajtës.
- Një rrezik potencial për ndotjen e akuiferit janë shpimet e kryera nga individë që shpesh herë nuk janë kryer sipas rregullave teknike.

➤ Akuiferi Kuaternar Fushë - Kuqe

Është monitoruar në 6 shpime që përfshijnë të gjithë akuiferin : Milot, Gurrëz, Fushë - Kuqe, Patok, Laç dhe st. Rrëshen. Përkatësisht nr.176 Milot, nr.26 Fushë - Kuqe, nr.197 Gurrëz, nr.177 Patok, nr.509 Laç.

Sasia e ujit që shfrytëzohet është 1250 - 1300 l/sek për furnizimin e qyteteve të Durrësit, Laçit, Milotit, Mamurrasit dhe fshatrave të zonës deri në Durrës. Është akuiferi ujëmbajtës me shfrytëzim më intensiv dhe më perspektivë për rritje rezervash të UN.

Koeficienti i shfrytëzimit është: K = 0.35 - 0.5

Risku i ndotjes:

- Nga sipërfaqja është mesatar.
- Ai mund të vijë nga zona e ushqimit në veri të akuiferit - shtrati i lumit Mat nga i cili mund të priten depërtime të metaleve të rënda me prejardhje minerare.

- Risku më i madh për shkak të shfrytëzimit intensiv mbetet ai i rritjes së mineralizimit të përgjithshëm (kryesisht për rritje të Na e Cl) që vjen nga zhvillimi i hinkës së depresionit në drejtimin jug perëndimor ku predominon tipi i ujit me mineralizim të lartë.

Ujërat nëntokësore të akuiferëve në përgjithësi kanë veti të mira fiziko-kimike. Janë të freskët e nën temperaturën maksimale të lejuar prej 20°C. Paraqesin veti alkaline të dobët, janë ujëra të ëmbla dhe me fortësi të butë.

Tabela 22 . Vlerësimi hidrodinamik Baseni Mat

Periudha	Shënkoll	Gorre
2023 - Korrik	- 5.06m	- 1.96 m
2023 - Tetor	- 5.32m	-2.19 m
Amplituda m	0.26 m	0.23

o Vlerësimi i metaleve të rënda për basenin Mat

Analiza për mikroelementë janë marrë në shpimin nr.50 Barbullojë për akuiferin e Lezhës dhe në shpimin nr. 26 Fushë – Kuqe për akuiferin e Fushë Kuqes. Analizat për mikroelementë janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd.

Shpimin nr.50 Barbullojë ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0004 – 0.0009 mg/l, Mn = 0.01 mg/l, Zn = 0.0 - 0.0114 mg/l, Pb = 0.0002 - 0.001mg/l, Cu = 0 - 0.0008 mg/l, Co = 0 – 0.0001 mg/l, Cr = 0 - 0.0026mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin H. Gjuetisë është nën përmbajtjen e rekomanduar.

Shpimin nr.26 Fushë - Kuqe ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0006 - 0.0008 mg/l, Mn = 0.0056 – 0.0095 mg/l, Zn = 0.0036 - 0.0047 mg/l, Pb = 0.0004- 0.0008 mg/l, Cu = 0 mg/l, Co = 0.0001 mg/l, Cr = 0.0012 - 0.0039 mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve në stacionin **nr.26 Fushë - Kuqe** është nën përmbajtjen e rekomanduar, krahasuar me normat e standartitshqiptar dhe të BE.

• Baseni Erzen-Ishëm

Në basenin e Erzen - Ishmit është monitoruar akuiferi ujëmbajtës i zhavorreve të kuaternarit të Tiranës me një rrjet monitorimi me 5 shpime dhe akuiferi ujëmbajtës i zhavorreve të Fushë -Krujës me 4 shpime.

➤ Akuiferi kuaternar i Tiranës :

Monitorohet me 5 shpime në qytetin e Tiranës, nr. 1P Tiranë, nr.16/97 Rruga e Kavajës, st. Buka, nr.6 Laknas, nr.47 Bërxull. Sasia e ujit që shfrytëzohet është rreth 1200 - 1300 l/sek, përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës, Vorës, Kamzës dhe qendrat e banuara si dhe ujë teknologjik. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit në Tiranë varion $K = 0,85 - 0,95$

Risku i ndotjes është i lartë:

- për shkak të mbulesës së vogël mbrojtëse të shtresës ujëmbajtëse në Kamëz, Laknas etj.
- infiltrimet e ujit të ndotur të lumit të Tiranës dhe Lanës në shtresat ujëmbajtëse.

- shfrytëzimi e përpunimi i tokave bujqësore me plehërime të ndryshme.
- shfrytëzimi i shtresave zhavorrore për materiale inerte në taracat lumore ku janë dhe vendburime uji për fshatra të ndryshme.

➤ **Akuiferi kuaternar Fushë - Krujë :**

Është monitoruar në 4 shpime në Rinas, Fushë - Krujë, Gramëz, Thumanë.

Sasia e ujit që shfrytëzohet është rreth 600 - 700 L/sek, për qytetin e Shijakut, Fushë - Krujë, Prezës, Mazhës, Bubqit, Thumanës, Gramëz, Derven e fshatra të tjerë.

Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K = 0,85 - 0,95$

Risku i ndotjes nga sipërfaqja është i vogël në sajë të mbulesës së madhe mbrojtëse të shtresës ujëmbajtëse.

Ujërat janë të freskët e nën temperaturën maksimale të lejuar, të tipit alkalinë të dobët në Fushë-Krujë dhe neutral në Tiranë. Referuar vlerave klasifikohen si ujëra të forta dhe të ëmbla.

Ujërat paraqesin veti fiziko- kimike të mira.

Tabela 23 . Vlerësimi hidrodinamik Baseni Erzen- Ishëm

Periudha	Laknas	Bilaj
2023 - Korrik	- 10.5m	- 11.72 m
2023 - Shtator	- 12.5m	- 13.2 m
Amplituda m	2.0 m	0.48

Luhatja e nivelit të ujërave nëntokësore lidhet me ndryshimet stinore dhe me ndryshimet për efekt shfrytëzimi.

○ **Vlerësimi i metaleve të rënda për basenin Ishëm-Erzen**

Analiza për mikroelementë janë marrë në shpimin nr.6 Laknas për akuiferin e Tiranës dhe në shpimin nr. 327 Fushë – Krujë për akuiferin e Fushë Krujë. Analizat për mikroelementë janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd.

Shpimin nr.6 Laknas ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.002 - 0.034 mg/l, Mn = 0.0016 - 0.0175 mg/l, Zn = 0.0015 - 0.0049 mg/l, Pb = 0.0006 - 0.0019mg/l, Cu = 0 - 0.0009 mg/l, Co = 0 - 0.0004 mg/l, Cr = 0 - 0.023 mg/l, Cd = 0 mg/l.

Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin nr.6 Laknas është nën përmbajtjen e rekomanduar. (Tab. Nr.4).

Shpimin nr. 327 Fushë – Krujë ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0076 – 0.0081 mg/l, Mn = 0.0029 - 0.0092 mg/l, Zn = 0.0051 – 0.0064 mg/l, Pb = 0.0011 – 0.0014 mg/l, Cu = 0 - 0.0056 mg/l, Co = 0 mg/l, Cr = 0.0011 – 0.004 mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve në stacionin **nr.327 Fushë - Krujë** është nën përmbajtjen e rekomanduar, krahasuar me normat e standartit shqiptar dhe të BE.

- **Baseni Shkumbin**

Është monitoruar në akuifein e Elbasanit dhe akuiferin e Lushnjes me frekuencë 2 herë në vit në Korrik e Tetor.

- **Akuiferi kuaternar Elbasan**

Monitorohet me 3 shpime: - shpimi nr.3/90 në Krastën e Madhe, shpimi nr.2/90 në Krastën e Vogël dhe shpimi nr.10 në Vidhas. Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 1250 L/sek, për furnizimin e qytetit të Elbasanit me ujë të pijshëm kryesisht nga Krasta e Madhe dhe Krasta e Vogël dhe për industrinë metalurgjike nga zona e Vidhasit etj.

Koeficienti i shfrytëzimit është $K = 0.25 - 0.3$

Risku i ndotjes

- Është i lartë për shkak të mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse, sidomos në Krastën e Madhe dhe të Vogël, popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare në të dy Krastat dhe shkarkimeve industriale në zonën e Vidhasit.
- Në zonën Krastë e Madhe e Krastë e Vogël trashësia e mbulesës së mbrojtëse të shtresës ujëmbajtëse është e vogël ose mungon fare.
- Gjithë zona është populluar pa respektuar zonat e mbrojtjes sanitare.
- Në zonën Vidhas, me rivënien në punë të industrisë metalurgjike, rrezikohet prishja e cilësisë së UN nga shkarkimet industriale.
- Mundësi ndotje paraqet dhe plehërimi intensiv i tokave bujqësore.

- **Akuiferi kuaternar Lushnjë**

Është monitoruar në 3 shpime: shpimi nr. 1D Çermë (stacioni Divjakës), st. Konjat, 286 Çermë Sasia e ujit që shfrytëzohet nga ky akuifer është 650 - 700 l/sek për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Lushnjës dhe fshatrave.

Risku i ndotjes sipërfaqësore është i vogël, falë mbulesës së madhe argjilore. Vetëm intensifikimi i madh i shfrytëzimit mund të nxisë depërtimin e ujërave me mineralizim të lartë të sektorit jugor të akuiferit.

Klasifikohen si ujëra të freskët, të ëmbël dhe të tipit alkaline të dobët. Referuar vlerave të fortësisë të përgjithshme janë mesatarisht të forta deri të forta. Në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira.

Tabela 24. Vlerësimi hidrodinamik Baseni Shkumbin

Periudha	Vidhas	286 Çermë	281 Çermë	Konjat
2023 - Korrik	-6.67 m	-12.94 m	- 11.44 m	-11.3 m
2023 - Tetor	-7.48 m	-12.41 m	-13.4m	-12 m
Amplituda m		0.53 m	1.96 m	0.7 m

Shënim: Nuk është llogaritur amplituda në Vidhas pasi niveli i matur ishte dinamik. Kjo për arsye se pusi ishte në shfrytëzim.

❖ Vlerësimi i metaleve të rënda në basenin Shkumbin

Kampionet për mikroelementë janë marrë në shpimin nr. Nr. 17A Vidhas për akuiferin Elbasan dhe në shpimin nr. 1D Divjakë për akuiferin Lushnjë. Analizat janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd.

Shpimin nr. Nr. 17A Vidhas ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0069 - 0.0074 mg/l, Mn = 0.0001- 0.0046 mg/l, Zn = 0.0006 – 0.0051 mg/l, Pb = 0 - 0.0018 mg/l, Cu = 0 – 0.0011 mg/l, Co = 0 mg/l, Cr = 0.001- 0.0036 mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin Nr. 17A Vidhas është nën përmbajtjen e rekomanduar, krahasuar me normat e standartit shqiptar dhe të BE.

Shpimin nr. 1D Divjakë ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0001 - 0.0054 mg/l, Mn = 0.0345 – 0.0174 mg/l, Zn = 0.0046 – 0.0083mg/l, Pb = 0.0007- 0.0014 mg/l, Cu = 0.0005 – 0.003 mg/l, Co = 0.0006 - 0mg/l, Cr = 0.0013 - 0.2548 mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin 1D Divjakë është nën përmbajtjen e rekomanduar.

• Baseni Seman

Monitorohet në zonën e Korçës me 4 shpime në akuiferin zhavorror të Kuaternarit dhe një burim në akuiferin karbonatik.

➤ Akuiferi kuaternar Korçë

Monitorohet me 4 shpime në akuiferin zhavorror të Kuaternarit dhe një burim në akuiferin karbonatik : në shpimin nr.3 Turan, nr.1v I.Terova, nr.108 Bulgarec, nr.173/1 Sheqeras. Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 500 – 550 l/sek. Rezervat më të mëdha shfrytëzohen në Turan. Koeficienti i shfrytëzimit varion K = 0.3 - 0.5

Risku i ndotjes është mesatar, favorizuese janë kushtet natyrore të shtrirjes së disa horizonteve ujëmbajtëse në thellësi të ekranizuar ndërmjet tyre me shtresa argjilore. I vetmi burim sipërfaqësor ndotjeje mund të jetë lumi i Dunavecit nga krahu juglindor i akuiferit, kryesisht për horizontin e parë ujëmbajtës i cili si rregull nuk shfrytëzohet.

➤ Akuiferi kuaternar Berat

Janë kryer monitorime në 6 shpime në akuiferin zhavorror të kuaternarit dhe dy burime në akuiferin karbonatik : në shpimin nr. 83 Banaj, nr. 6k Arrëz, St. Çiflig, nr.3 Kozare, nr. 19 Otlak, nr. 1 Lapardha dhe burimet Bogovë dhe burimi Ura Vajgurore.

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet është rreth 500 - 590 l/sek. Rezervat më të mëdha shfrytëzohen në Çiflig, Banaj. Koeficienti i shfrytëzimit varion K = 0.3 - 0.4

Risku i ndotjes është i lartë, si pasojë e ndotjes së tokës nga hidrokarburet sidomos në zonën Çiflig. Gjithashtu plehërimi i tokave me plehra inorganikë për vite me rradhë megjithëse kushtet natyrore të shtrirjes së disa horizonteve ujëmbajtëse në thellësi të ekranizuar ndërmjet tyre me shtresa argjilore janë favorizuese, vërehet rritje e treguesve të ndotjes.

➤ **Akuiferi karbonatik**

Janë monitoruar akuiferët karbonatikë e mëposhtëm

Akuiferi karbonatik Mali i Thatë-Rakickë

Akuiferi karbonatik i Tomorrit.

Akuiferi karbonatik i Shpiragut

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga burimet është 1200 - 1300 l/sek që përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Beratit, Urës Vajguore dhe fshatrave.

Koeficienti i shfrytëzimit varion : $K = 0.2 - 0.3$

Risku i ndotjes është :

- Mesatarisht i lartë për shkak të mungesës së mbulesës, lartësisë dhe përhapjes së madhe të akuiferit si dhe shpejtësisë së përhapjes së ndotjes.
- Nga veprimtari kryesisht blegtorale ose plehërimi i tokave bujqësore
- Shfrytëzimi kryhet vetëm nëpërmjet burimeve natyrore.

Ujërat nëntokësore në këto zona kanë veti fiziko - kimike e kushteve higjieno - sanitare të mira. Janë ujëra të ëmbla, pa erë, pa ngjyrë, pa shije, të freskët e nën temperaturën maksimale të lejuar. Paraqesin veti të tipit alkalinë të dobët dhe fortësi mesatare. Në akuiferët karbonatik, ujërat janë të tipit hidrokarbonat – kalçium dhe me rrallë hidrokarbonat – kalçium – magneziumi.

Tabela 26. Vlerësimi hidrodinamik Baseni Seman

Periudha	Bulgarec	Banaj	Çiflig
2023 - Korrik	+0.62m	-9.7m	-5.2
2023 - Tetor	+0.54m	-7.8m	-4.63
Amplituda m	0.08m	1.9 m	0.57

Luhatja e nivelit të ujërave nëntokësore lidhet me ndryshimet stinore dhe me ndryshimet për efekt shfrytëzimi.

○ **Vlerësimi i metaleve të rënda në basenin Seman**

Monitorimet janë kryer në shpimin nr. nr.3 Turan për akuiferin e Korçës dhe në shpimin nr.83 Banaj për akuiferin e Beratit. Analizat për mikroelementë janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn,Pb, Cu, Co, Cr, Cd.

Shpimi nr. 3 Turan ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0012 – 0.0014mg/l, Mn = 0.0001 - 0 mg/l, Zn = 0.0031- 0.0005 mg/l, Pb = 0 – 0.003 mg/l, Cu = 0 mg/l, Co = 0 mg/l, Cr = 0.0141- 0.0332mg/l, Cd = 0 mg/l Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin nr.3 Turan është nën përmbajtjen e rekomanduar deri në PML, me përjashtim të përmbajtjes së kromit në fazën e dytë është mbi E.C. 80/778 (P.M.L.) (0.025 mg/l, krahasuar me normat e standartit shqiptar dhe të BE

Shpimi nr.23 Banaj ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0053 – 0.0044mg/l, Mn = 0.1886 - 0.1663 mg/l, Zn = 0.0117 – 0.0038mg/l, Pb = 0.0008 - 0.0011mg/l, Cu = 0.0014 -0 mg/l, Co = 0.0003 – 0 mg/l, Cr = 0.0003 - 0.0029mg/l, Cd = 0 mg/l. Përmbajtja e mikroelementeve në stacionin **nr.23 Banaj** është nën përmbajtjen e rekomanduar, me përjashtim të përmbajtjes së manganit që është mbi normë në të dy fazat, krahasuar me normat e standartit shqiptar VKM 379(25.05.2016) (P.M.L.) (0.05 mg/l)dhe E.C. 80/778 (P.M.L.) (0.05 mg/l).

➤ **Baseni Vjosë**

○ **Akuiferi poroz Vjosë**

Monitorohet me 5 shpime: në Buduk, Budrishtë, Kafaraj, Novoselë dhe Pish - Poro me analiza kimike dhe mikroelementë.

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet aktualisht është rreth 140 l/sek në akuiferin Drinos, kryesisht zonën Buduk – Lazarat, Gjirokastrë.

Në Kafaraj shfrytëzohet sasia 720 - 900 l/sek. Në Novoselë shfrytëzohet Q = 300 l/sek.

- Koeficienti i shfrytëzimit varion K = 0.65 - 0.7.

Risku i ndotjes është mesatar, favorizuese janë kushtet natyrore të shtrirjes së horizonteve ujëmbajtëse në thellësi të ekranizuar ndërmjet tyre me shtresa argjilore. I vetmi burim sipërfaqësor ndotjeje mund të jetë lumi i Vjosës.

○ **Akuiferi karbonatik i Kurveleshit**

Risku i ndotjes është::

a) Mesatarisht i lartë për shkak të mungesës së mbulesës, lartësisë dhe përhapjes së madhe të akuiferit si dhe shpejtësisë së përhapjes së ndotjes.

b) Nga veprimtari kryesisht blegtorale ose plehërimi i tokave bujqësore

c) Shfrytëzimi kryhet vetëm nëpërmjet burimeve natyrore.

Gjatë vitit 2023 rezulton se UN në zonat e akuiferit poroz kanë veti fiziko - kimike e kushte higjieno - sanitare të mira. Ujërat janë pa erë, pa ngjyrë, pa shije, të freskët e nën temperaturën maksimale të lejuar prej 20°C. Janë të tipit alkalinë të dobët, referuar fortësisë të përgjithshme klasifikohen si ujëra të forta e mesatarisht të forta.

Ujërat nëntokësorë të akuiferëve karbonatikë kanë veti të mira fiziko - kimike. Ujërat janë të tipit alkalinë të dobët, të freskët, të ëmbla, me temperatura të ulëta dhe fortësi të ulët.

Tabela 27. Vlerësimi hidrodinamik Baseni Vjosë

Periudha	Budrishtë	Novoselë Nr 2	Novoselë nr 3	Kafaraj 3/96
2023 - Korrik	3	-3.6	-1.74	-6.17
2023 - Tetor	5.44	- 3.6	-1.72	-6.42
Amplituda m	2.44m	0 m	0.02m	0.25m

Ndryshimet stinore kanë të bëjnë me kushtet klimatike gjatë vitit shprehen me ngritjen e nivelit të UN në muajin Nëntor me rënien e reshjeve të para. Luhatja e nivelit të ujërave nëntokësore lidhet me ndryshimet stinore dhe me ndryshimet për efekt shfrytëzimi.

○ Vlerësimi i metaleve të rënda në basenin Vjose

Analiza për mikroelementë janë marrë në shpimin Novoselë për akuiferin e Vjosës. Analizat për mikroelementë janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Cr, Cd.

Shpimi Novoselë ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0035 – 0.0034mg/l, Mn = 0.004 - 0.0012mg/l, Zn = 0.015 – 0.0011mg/l, Pb = 0.0003 – 0.0046 mg/l, Cu = 0 – 0.0001mg/l, Co = 0.0001-0mg/l, Cr = 0.0004 - 0.003mg/l, Cd = 0mg/l. Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin Novoselë është nën përmbajtjen e rekomanduar, krahasuar me normat e standartit shqiptar dhe tëBE.

➤ Baseni Zonës Jonike

Monitorimi i cilësisë së UN në basenin e Zonës Jonike u krye me 6 stacione: shpime Orikum, Karahaxh, Vrion, Mursi dhe 2burime: burimi Syri i Kaltër, burimi Uji i Ftohtë - Vlorë.

○ Akuiferi poroz Vrion - Orikum

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet në këto akuifere është rreth 200 – 285 l/sek në akuiferin e Vurgut, dhe 20 l/sek në akuiferin poroz Dukat.

- Koeficienti i shfrytëzimit varion $K = 0.5 - 0.7$

- *Risku i ndotjes* është mesatar, favorizuese janë kushtet natyrore të shtrirjes së horizonteve ujëmbajtëse.

Ujërat nëntokësore në këto zona kanë veti fiziko - kimike dhe kushte higjieno - sanitare të mira. Ujërat janë të tipit alkaline të dobët, pa erë, pa ngjyrë, pa shije, të freskët, të ëmbla e nën temperaturën maksimale të lejuar prej 20°C. Uji është brënda normës së ujit të pijshëm referuar fortësisë së përgjithshme.

Akuiferët karbonatik janë monitoruar në:

- **Akuiferi karbonatik i Malit të Gjerë**
- **Akuiferi karbonatik i Tragjasit**

-Risku i ndotjes është i lartë :

a) Mesatarisht i lartë për shkak të mungesës së mbulesës, lartësisë dhe përhapjes së madhe të akuiferit si dhe shpejtësisë së përhapjes së ndotjes.

b) Nga veprimtari kryesisht blegtorale ose plehërimi i tokave bujqësore

c) Shfrytëzimi kryhet nëpërmjet burimeve natyrore ose me galeri.

- *Sasia e përgjithshme e ujit* që shfrytëzohet nga burimet është 1200 - 1300 l/sek që përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Vlorës dhe fshatrave.

Koeficienti i shfrytëzimit varion: $K = 0.2 - 0.3$

Ujërat e akuifereve janë tipit alkalinë të dobët, të freskët, me temperatura të ulëta, fortësi të ulët. Përbërja cilësore e ujërave nëntokësore të akuiferit karstik të Malit të Gjerë është shumë e mirë.

Tabela 28. Vlerësimi hidrodinamik Baseni i Zonës Jonike

Periudha	Nr.2 Vrion	Karahaxh
2023 - Korrik	-3.7	-3.59
2023 - Tetor	-3.94	-3.82
Amplituda m	0.24m	0.23m

o **Vlerësimi i metaleve të rënda në basenin e Zonës Jonike**

Analiza për mikroelementë janë marrë në shpimin Vrion - Sarandë për akuiferin poroz të Zonës Jonikë. Analizat për mikroelementë janë kryer për elementët Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr, Cd.

Shpimi Vrion ka përmbajtje të mikroelementeve: Ni = 0.0013 - 0 mg/l, Mn = 0.0022 - 0.0001mg/l, Zn = 0.0091- 0.0101mg/l, Pb = 0.0008- 0.0018 mg/l, Cu = 0 mg/l, Co = 0.0001 -0 mg/l, Cr = 0.0018 - 0.0037 mg/l, Cd = 0mg/l. Përmbajtja e mikroelementëve në stacionin Vrion është nën përmbajtjen e rekomanduar, krahasuar me normat e standartit shqiptar dhe të BE.

Vlerësim i përgjithshëm

Në basenet e monitoruara në akuiferët porozë e karbonatikë shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të UN për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve dhe zonave të banuara, për industrinë e shpesh edhe për vaditje.

Nga monitorimi i përbërjes kimike të UN të akuiferëve porozë e karbonatikë me frekuencë 2 herë në vit në muajt Korrik dhe Shtator – Tetor, ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Nga monitorimi hidrodinamik i kryer në akuiferë ka rezultuar se amplituda e këtij viti nuk ka qenë më e lartë se e viteve të mëparshme. Nivelet hidrodinamike të fazës së dytë të monitorimit të vitit 2023, në përgjithësi janë më të ulëta se të fazës së parë.

Ka përmbytje të lartë mbi përmbytjen e rekomanduar të disa treguesve të Cl, Mg, Na, SO₄ në shpimet nr.46 H.Gjuetisë, nr.177 Patok, st. Vidhas, nr. 286 Çermë, Konjat, st. Divjakë, st. Gramëz, 327 F. Krujë, nr.1v I.Terova - Korçë, Banaj, Kozare, Otlak, Lapardha 2, Kafaraj, Pish - Poro. Mund të klasifikohen si zona me kripshmëri të lartë zonat që mbulohen në monitorim nga shpimet nr.177 Patok, Pish Poro të cilët kanë mineralizim të lartë dhe përmbytje të Na, Cl, SO₄ mbinormë.

Ndotje masive nuk ka. Në disa shpime në faza të ndryshme të monitorimit shfaqet prezenca e NO₂, NH₄, të cilat nuk përsëriten dhe lidhen kryesisht nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare. Më problematike janë shpimet: st. nr.50 Barbullonjë, st. Shëngjinit, nr. 46 H.Gjuetisë - Lezhë, Laknas, nr.3 Konjat, st. Vidhas, nr.1D Divjakë, Pish - Poro, Banaj, St. Çiflig, st. Kozare.

Ujërat nëntokësore të akuiferëve ujëmbajtëse të Kuaternarit janë shumë të butë e të butë në shpimet Hot i Ri, nr.29 I.Lezhë, nr.50 Barbullojë, nr.46 I.Lezhë. Janë me fortësi mesatare nëshpimet nr.1 Dobrac, Velipojë, nr.3 Kisha Shkodër, nr.176 Milot, nr.197 Gurrëz, nr.177 Patok, nr.26 F. Kuqe, nr.2/90 Krastë e Vogël, nr.3 Krastë e Madhe, nr.1D Divjaka, nr.3 Turan, nr.108 Bulgarec, nr.173/1 Sheqeras, Buduk, Orikum, Karahaxh, Vrion e Mursi. Janë ujëra të fortë në shpimet nr.2s Rrilë, nr.1P Selitë, nr.16/97 Rr.Kavajës, nr.6 Laknas, nr.47 Bërxull, nr.2/97 Rinas, nr.327 F.Krujë, nr.160 Thumanë, nr.17 Vidhas, nr.3 Konjat, nr.286 Çermë, nr.1v I.Terova, Novoselë, Pish - Poro. Ujërat nëntokësore në akuiferin e Lezhës të shtresave të sipërme janë shumë të butë e të butë.

Në sektorë e shpime të veçantë në Kafaraj, Pish - Poro ujërat janë shumë të fortë. Mineralizimi i përgjithshëm është nën 1gr/l, janë ujëra të ëmbla. Në Lezhë, Fushë - Kuqe në sektorët perëndimorë Rrile - Patok që shfrytëzojnë shtresat e poshtme janë me Mp = 1- 2.5 gr/l, janë ujëra me kripëzim të dobët e me përmbytje të lartë të Cl dhe Na.

Analizat e kryera për mikroelemente në akuiferët ujëmbajtës rezultojnë me përmbytje të disa metaleve të rënda Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr të cilët kanë vlera të ulëta, nën sasinë e rekomanduar dhe nën përmbytjen maksimale të lejuar.

Tendenca për treguesit e ndotjes së ujërave nëntokësore me amonjak, nitrite, nitrate nuk është në rritje. Takohen çfaqje të herëpashershme të treguesve të ndotjes në faza monitorimi të veçanta. Prezenca e ndotjeve lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare, nga shfrytëzimi pakriter i akuiferëve dhe shpimet individuale të kryera shpesh herë jashtë kushteve teknike.

Zona me kripshmëri të lartë është zona Rrilë – Lezhë, Hoteli i Gjuetisë dhe Patok – Laç e basenit Mat, shtresa e poshtme ujëmbajtëse e monitoruar me shpimin nr.177 Patok, ka përmbajtje të lartë Na, Cl, SO₄ dhe mineralizim të lartë.

Zona me përmbajtje të lartë të Natriumit, Klorit dhe me tendence rritje janë Kafaraj, Pish – Poro, dhe Konjat. Kjo rritje e kripshmërisë vjen nga shfrytëzimi intensiv.

Zonat të ndjeshme ndaj ndotjes janë zonat pa mbulesë mbrojtëse ose me mbulesë të vogël të papërshkueshme argjilore me trashësi 0 - 5 m. Zona më të ndjeshme janë zona Dobraq, Thumanë, Laknas, Barbullojë, Krastë e Madhe, Krastë e Vogël, Vidhas, Konjat, Berat, Kafaraj, Novoselë, Pishë - Poro, Buduk, Orikum.

Stacioni Pishë Poro ka ujë më cilësi jo të mirë. Përmbajtja e NO₂, NO₃, NH₄, Cl, Na dhe Mg, mbetje e thatë e mineralizim i përgjithshëm janë mbi normat e ujit të pijshëm sipas standartit shqiptar në fuqi dhe BE.

Tabela. 29 Vlerat mesatare të parametrave fiziko- kimike

Vend-ndodhja	REZULTATET E ANALIZAVE, mg/l																		
	pH	Parametrat kimike																	
		K mg/l	Na mg/l	Ca mg/l	Mg mg/l	Fe ²⁺³ mg/l	NH ₄ mg/l	HCO ₃ mg/l	CO ₃ mg/l	Cl mg/l	SO ₄ mg/l	NO ₃ mg/l	NO ₂ mg/l	M.P. mg/l	M.Th mg/l	Fp. ° gj	T ° C	O ₂	Kond µs/cm
St. Velipojë	7.9	1.745	9.175	21.04	32.225	0.018	0.13	209.23	3	9.765	15.64	0.33	0.0055	302.29	187.68	10.36	15.9	5.67	376.5
Kisha e Mëdhe	7.445	0.15	3.735	53.61	10.945	0.005	0.01	199.775	0	5.68	11.72	1.62	0.003	287.25	177.365	10.01	17.2	8.05	351.5
Hot I Ri	7.515	0.27	4.275	44.09	7.6	0.008	0.008	158.6	0	4.44	12.55	0.555	0.0015	232.39	143.095	7.91	15.85	9.635	273.5
Dobraç	7.37	0.43	5.19	62.125	12.46	0.0105	0.005	227.22	0	8.165	14.2	3.245	0.001	333.05	209.445	11.55	17.55	101.6	404.5
I. Lezhë, st. Shëngjinit	8.36	4.945	124.415	4.01	2.92	0.023	0.125	163.17	9.75	78.1	33.54	0.24	0.046	421.28	329.685	1.23	16.95	6.835	562
H.Gjuetisë	8.34	10.325	225.285	6.21	5.35	0	0.165	183	10.8	245.8	24.69	0.025	0.0045	710.19	608.695	2.1	16.4	4.295	1149
Barbullojë -St. Lezhë	8.59	8.075	149.365	5.21	5.23	0.01	0.08	175.375	9	127.8	25.72	0.225	0.025	506.11	408.425	1.93	16	3.572	771.5
Rrilë, Lezhë	8.1	7.665	80.11	13.03	12.77	0.0155	0.973	169.275	5.25	55.03	43.21	0.0025	0.02	387.34	292.705	4.76	15.1	2.255	483.5
St. Rrëshen	7.52	0.775	5.69	51.7	10.64	0	0.005	163.175	0.75	7.81	35.39	0.22	0	276.16	184.57	9.67	19.95	3.735	359.5
Patok	8.255	6.475	283.51	10.02	11.215	0.05	0.008	183	4.95	323.9	66.87	0.293	0.004	890.36	788.865	3.99	18.8	2.285	1436
F.Kuçe	7.995	6.01	24.35	21.44	35.445	0.0155	0.008	169.885	3	65.32	20.99	0.315	0.002	346.78	251.84	11.155	15.75	2.32	518
Lac	7.815	1.635	13.01	39.78	29.065	0.005	0.013	236.68	2.85	11.37	28.81	0.98	0.001	364.18	235.84	12.25	17.6	7.1	445
Milot	7.565	0.79	7.855	56.615	31.92	0.0025	0	295.85	0	14.2	21.2	2.135	0.0015	430.56	272.635	15.26	17.15	6.075	528
Gurrëz	8.09	1.58	7.32	20.04	21.89	0.0105	0	152.5	3.75	6.745	14.82	0.49	0.0005	229.13	142.885	7.84	16.7	6.93	286
Tiranë, Selltë	7.005	4.13	22.395	99.195	16.72	0.0025	0.01	353.19	0	24.32	35.2	4.47	0	559.63	373.035	17.71	17.13	5.71	709
Buka	6.945	2.665	21.985	109.22	9.835	0.0075	0	369.05	0	25.74	35.68	5.575	0.03	584.77	390.245	18.675	17.65	6.555	747.5
Rr.Kavajës	7.175	3.725	21.725	99.7	19.395	0.005	0.0025	355.325	0	26.63	38.64	7.985	0.0005	573.12	385.46	18.395	22	7.83	727.5
Laknas	6.95	2.34	42.54	130.76	35.11	0.005	0.0275	484.95	0	61.78	68.49	4.81	0	830.80	575.33	26.355	17.8	8.465	1039
Bërshull	6.875	2.055	33.085	139.28	44.08	0.02	0.005	557.54	0.75	40.3	73.04	4.71	0.005	894.86	606.09	29.605	17.75	6.525	1115
Rinas	7.04	2.055	11.675	96.695	34.045	0.03	0.0075	373.93	0	15.8	71.6	0.51	0.01	606.35	409.395	21.35	17.45	4.465	750.5
F.Krujë	7.235	1.385	16.315	97.695	69.01	0.01	0.0025	566.995	0	17.22	63.43	4.635	0.008	836.69	543.2	29.53	16.7	10.605	967.5

Gramëz	7.3	1.96	18.42	74.15	77.035	0.03	0	557.235	0	26.79	34.68	6.135	0.0745	796.495	507.88	28.09	16.75	1.74	926.5
Thumanë	7.175	0.99	9.475	78.66	42.56	0.02	0.01	420.9	0	11.36	19.57	6.15	0.0125	589.7	369.255	20.785	17.05	5.005	704
Mengel K.Madhe	7.67	0.53	4.825	35.18	27.05	0.0075	0	222.04	1.5	7.455	11.73	1	0	311.31	190.29	11.145	15.65	7.975	371.5
Vidhas	7.34	2.42	23.15	75.655	74.66	0.0125	0.03	437.675	0	32.49	128.4	3.655	0	778.125	549.29	27.75	16.9	2.87	977.5
K.Vogel	7.495	0.875	5.72	37.575	34.835	0.0075	0.0025	267.485	0	9.41	11.32	2.85	0	369.945	226.205	13.27	16.55	7.16	448.5
Divjake	8.25	1.33	25.3	5.11	58.855	0.005	0.11	245.525	8.1	61.95	7.815	1.86	0.0065	414.295	281.535	14.26	17.05	2	583.5
Konjat	8.14	2.735	59.245	9.52	93.935	0.013	0.62	293.715	10.2	157.8	56.38	0.29	0.0645	684.515	527.655	22.95	18.55	4.775	1053
Çerme	7.995	1.985	20.89	12.02	109.44	0.0125	0.065	443.165	12.5	37.28	80.04	0.525	0.008	717.87	486.285	26.87	16.65	4.095	886.5
Turan	7.635	1.935	16.335	36.17	39.155	0.0025	0.01	269.315	0.75	35.86	12.14	1.21	0	412.875	268.215	14.07	13.83	3.87	544
Bulgarec	7.645	0.775	8.955	36.075	41.65	0.0275	0	285.175	0.75	19.71	16.05	1.53	0.001	410.675	258.085	14.63	13.5	4.95	532.5
Sheqeras	7.135	1.185	13.775	73.145	28.76	0.018	0.005	366	0	9.41	16.26	0.92	0.002	509.465	316.465	16.84	13.4	4.03	581.5
Irakli Terova	7.695	23.835	11.73	47.595	54.72	0.0075	0.035	303.78	0	19.89	80.45	7.47	0	527.31	365.42	19.24	11.95	6.275	681.5
Banaj	7.415	3.285	135.665	57.615	72.05	0.275	1.015	517.89	1.5	183.7	49.18	0.175	0.077	1022.43	753.485	24.63	17.65	5.74	1391
Arrez	7.495	5.035	55.975	58.52	34.78	0.015	0.05	394.975	0.75	51.12	17.49	0.2915	0.0335	619.025	411.535	16.18	17.1	8.355	771.5
Çiflig	7.46	6.005	60.175	87.175	52.895	0.18	0.595	496.235	0.75	97.63	20.97	0.188	0.03	822.815	564.7	24.35	17.5	8.17	1042.5
Kozare	7.81	4.545	31.11	27.35	132.725	0.035	0.11	526.125	2.25	43.67	180.7	0.205	0.1735	948.94	675.88	34.37	17.45	3.14	1146
Otlak	8.305	2.47	21.35	109.72	64.935	0.015	0.015	603.29	0	24.5	47.73	8.195	0.0005	882.215	570.57	30.275	17.15	1.618	1025.5
Lapardha 2	6.92	8.075	27.74	110.02	74.42	0.01	0.005	612.135	0	41.72	63.14	16.63	0.0015	953.885	637.815	32.5	15.96	7.215	1150.5
Buduk	7.215	0.75	5.78	76.155	15.99	0.008	0.035	300.425	0	6.925	7.61	0.765	0.004	414.445	254.23	14.32	15.55	10.01	489.5
Budrishtë	7.28	4.59	59.26	64.125	11.55	0.01	0.04	276.94	0	70.83	9.26	2.03	0.0045	498.635	350.165	11.62	18.95	7.865	664.5
Novoselë	7.625	3.47	48.38	54.31	41.83	0.005	0.02	291.275	0.75	84.14	50.83	0.59	0.0125	575.6	419.96	17.22	16.6	3.9	836
Kafaraj	7.23	2.79	45.37	89.39	58.55	0.01	0.025	434.625	0	99.05	57.82	1.645	0.0075	789.06	698.25	25.935	16.85	1.53	1098.5
Pish-Poro	7.8	18.4	252.95	37.575	89.375	0.0435	0.29	272.975	8.25	518.7	49.59	0.64	0.0085	1978.6	1832.12	38.485	17.9	6.455	167.71
Orikum Vlore	7.26	1.165	5.985	67.635	23.715	0.01	0.0025	281.82	0	6.72	28.4	0.79	0	421.23	270.315	14.91	15	8.165	521
Karahaxh	7.025	2.155	10.62	119.24	17.695	0.0625	0.01	419.985	0	12.96	26.13	0.88	0.0015	609.725	389.73	20.735	21.2	6.195	723.5
Xare Mursi	6.99	4.765	75.91	89.93	12.92	0.005	0.01	253.15	0	146.4	25.72	2.61	0.0035	611.46	474.885	15.54	17.9	6.905	896.5
Vrion Sarande	7.425	0.36	4.28	84.37	9.18	0.01	0.0075	251.93	0	7.635	35.19	1.38	0.0035	324.975	258.375	13.9	18.3	14.31	483
Burimi Syri i Sheganit- M.Madhe	7.305	0.135	3.58	52.105	4.56	0.0075	0.015	173.85	0.08	2.665	6.995	0.625	0.0025	244.61	147.69	8.33	11.6	10.895	285

Burimi Gurrae Kolesjanit	7.745	0.995	4.37	35.67	5.53	0.005	0.01	126.88	1.65	3.745	8.49	0.805	0	188.155	114.71	6.26	9.55	13.335	208.5
Burimi Tushemishtit	7.245	0.425	3.875	53.105	8.45	0	0.015	197.945	0	5.95	4.32	0.47	0.002	274.56	165.585	9.365	11.38	5.87	329.5
Burimi i Linit-Pogradec	7.285	0.475	3.09	49.6	7.415	0	0.0175	185.44	0	4.46	1.445	0.345	0.0025	252.285	149.565	8.64	9.75	10.925	291
Burimi i Mancurishtit	6.99	0.68	2.09	72.34	32.1	0.0025	0.01	362.185	0	4.795	4.73	0.59	0.0005	488.025	292.43	17.495	11.15	9.665	563.5
Burimi i Bogovës	7.465	0.255	1.9	41.58	7.905	0.005	0.005	154.025	0	4.615	4.735	0.89	0.005	215.915	128.905	7.63	11.65	11	270.5
Burimi Ura Vajguore	7.34	0.625	6.815	75.955	4.925	0.0425	0.005	240.34	0	9.765	11.4	1.125	0	350.985	220.82	11.745	18.65	9.57	423
Burimi Syri i Kaltër	7.24	1.47	12.02	100.5	16.84	0.0125	0.0025	207.705	0	18.64	139.7	3.645	0.0025	500.54	386.685	17.92	12.8	8.725	645.5
Burimi i Uji i Ftohtë -Vlorë	7.325	0.805	11.17	47.595	15.02	0.0125	0.01	190.625	0	19.53	16.55	0.42	0	303.08	197.765	10.105	12.85	8.61	467
Burimi i Uji i Ftohtë - Tepelenë	7.51	0.23	2.2215	47.595	4.26	0	0.033	157.075	0	5.415	3.5	0.285	0.002	220.845	132.305	7.63	12.15	11.46	261.5
Shpim - Vanistër	7.3	0.935	5	75.15	4.865	0	0.02	218.075	0	8.875	22.48	4.125	0	339.525	220.49	11.62	19.1	7.92	418.5
VKM 379, 25.05.2016	6,5-8,5	12,0	200	200	50	0,2-0,3	0,1 (0,5)			250	250	50	0,5	1200	500 (1000)	0-20 (25)	8-15;20	>8	2500,0
E.C. 80/778 (P.M.L.)	6,5-8,5	10-12	20-150	100	30-50	0,05-0,2	0,05-0,5			25	25-250	25-50	nl-0,1		1500,0	>60	12-25,0	>75%	400(2500)

Tabela 30. Vlerësimi i cilësisë të stacioneve të monitoruara.

Basenet	Nr. Pusit	Vendndodhja	pH	Na	Ca	Mg	Fe	NH ₄	Cl	SO ₄	NO ₃	NO ₂	Mp	Mth	Fp	Vlerësimi i ujit
Baseni i	1	St.Shkodrës-Dobraç														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	H	St.Hot i Ri														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	36	St.Velipojë-U.Gjollit														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	3	Kisha e madhe-Shkoder														Veti shumë të mira fiziko - kimike

Drint	Burim	Burimi Syri Sheganit														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi Linit														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi Tushemisht														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Gurra e Kolesjanit														Veti shumë të mira fiziko - kimike
i	50	St Lezhë - Barbullonjë														Tregues jo te mirë kimike - Përbajtje deri mbi normë të pH, mbi normën BE të Na, Përbajtje deri mbi normë të NH ₄ , Përbajtje nën normë të Ca e Mg e Fp.
	29	St.Shëngjinit - I. Lezhë														
	2s	Rrilë														Tregues të mirë kimike - Përbajtje mbi normë të NH ₄ dhe nën normë të Fp
Baseni	46	Hoteli i Gjuetisë														Tregues jo te mire kimike- Përbajtje mbi norme te pH, Na, Cl, NH ₄ , Përbajtje nën normë të Ca e Mg e Fp.
Matit	197	St.Gurrëz- Laç														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	176	Milot- Laç														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	177	Patok- Laç														Tregues jo te mire kimike- Përbajtje te larte te Na, Cl - shtrusat e poshtme ujembajtese
	509	St.Laçit														Veti shumë të mira fiziko - kimike
	26	St.Durrësit - Fushë-Kuqe														Veti shumë të mira fiziko - kimike
		St. Rrëshen													Veti shumë të mira fiziko - kimike	

Basenet	Nr. Pusit	Vendndodhja	pH	Na	Ca	Mg	Fe	NH ₄	Cl	SO ₄	NO ₃	NO ₂	Mp	Mth	Fp	Vlerësimi i ujit	
Shkumbinit	2/90.	St.Elbasan-Krastë e Madhe	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	3/70.	St.Elbasan-Krastë e Vogël	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	17/A	St.Metalurgjiku-Vidhas	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😬	Veti jo te mira fiziko - kimike, ka permbajtje mbi norme Mg,Fp, NH4 me tendence rritje per SO ₄ , Ca.	
	3	St. Konjat-Lushnjë	😊	😊	😬	😡	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Veti jo te mira fiziko - kimike, ka permbajtje mbi norme Mg, ndotje NH ₄ me tendence rritje Fp.Përmbajtje nën normë të Ca.	
	286	St.Çermë - Lushnjë	😊	😊	😬	😡	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Veti jo te mira fiziko-kimike, ka permbajtje mbi norme Mg,Fp.Përmbajtje nën normë të Ca.
	1D	St.Divjakë-Çermë	😬	😊	😬	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti te mira fiziko-kimike, ka permbajtje mbi norme Mg, NH ₄ , ka tendencë rritje të pH.Përmbajtje nën normë të Ca.
Erzen-ishmit		St.Buka - Tiranë	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti të mira fiziko - kimike.	
	1P	St. Selitë-Tiranë	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti të mira fiziko - kimike.	
	16/97	Rr.Kavajës-Tiranë	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	Veti të mira fiziko - kimike, tendence rritje e NO ₂ .	
	6	St.Laknas- Tiranë	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Veti te mira fiziko-kimike- Tencencë rritje të Mg, Fp të lartë mbi normë.
	47	St.Bërxtull-Tiranë	😊	😊	😬	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	😊	😬	Veti jo te mira fiziko-kimike- ka Fp te larte mbi norme, tendence rritje te Ca, Mg, Mp.
	2/97.	Rinas-Fushë-Krujë	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Veti shume te mira fiziko-kimike. Tendence rritje te Ca, Fp.
	160	St.Thumanë-Fushë-Krujë	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Veti shume te mira fiziko-kimike. Tendence rritje te Mg, Fp.
	1 N	St.Gramëz- Gramëz	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Tregues jo te mire kimike- ka fortesi te larte, permbajtje mbi norme te Mg.
327	St.F.Krujë-F.Krujë	😊	😊	😬	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😬	Tregues jo te mire kimike - ka fortesi te larte, permbajtje mbi norme të Mg dhe tendencë rritje të Ca.	
Baseni	3	St. Korçë -Turan	😊	😊	😊	😬	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	😊	Veti shume te mira fiziko-kimike, me tendence rritje Mg.	

i Semanit	108	St.Bulgarec														Veti shumë të mira fiziko-kimike, me tendence rritje Mg.
	173/1	St.Sheqeras														Veti shume të mira fiziko-kimike,
	Iv.	I.Terova														Veti te mira fiziko-kimike- ka permbajtte mbi norme te Mg.

	Burim	Burimi Maqurishit														Veti shume te mira fiziko-kimike.
	83	Banaj														Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, Mg, NH4, me tendence rritje të Na, Mp dhe Fp.
	St.	Arrez														Tregues të mirë kimikë.
	St.	Çiflig														Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, NH4, me tendence rritje të Mg.
	St.	Kozare														Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg,NH4, Fp me tendencë rritje SO ₂ e NO ₂ .
		Otlak														Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje Mp
		Lapardha 2														Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp. Me tendencë rritje NO3 e Mp.
	Burim	Bogovë														Veti shumë të mira fiziko - kimike
Burim	Ura Vajgurore														Veti shumë të mira fiziko - kimike	
Baseni I Vjosës	P.V	St.Gjirokastër Buduk													Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	St.B	Budrishtë-Gjirokastër													Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Shp.	Vanistër													Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Burim	Uji i Ftohtë -Tepelenë													Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	St.N	St.Novoselë													Veti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë rritje Mg.	

	St.K	St.Kafaraj																	Tregues jo te mire kimike - Përmbajtja e Mg, mbi normë, me tendencë rritje Fp.
	St.	Pish-Poro																	Tregues jo te mire kimike- Na, Mg, Cl, NH4 mbi normë, te larte, Mth, Mp , Fp, ujë i papijshëm.
Baseni i Zonës-Jonike	Vrion	St.Vrion-Sarandë																Veti shumë të mira fiziko - kimike	
	Karahaxh	St.Karahaxh-Sarandë																	Veti shumë të mira fiziko - kimike, me tendence te rritjes se Fp.
	Mursi	St.Mursi-Sarandë																	Veti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë rritje Cl.
	Orikum	St.Orikum-Vlorë																	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Syri i Kaltër																	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Uji i Ftohtë -Vlorë																	Veti shumë të mira fiziko - kimike

STASH 3904-88(P.M.L)	6,5-9,5	20-100	75-200	20-50	0.2 - 0.3	nl-0,05	25-200	25-250	25-50	nl-0,05	1200	500-100	10-25(30)
E.C. 80/778 (P.M.L.)	6,5-8,5	20-150	100	30-50	0.05-0.2	0,05-0.5	25	25-250	25-50	nl-0,1		1500,0	>60

	Vlera brenda normave
	Vlera brenda normave me tendence rritje
	Vlera te larta mbi norma
	Vlera shumë te larta mbi norma
	Vlera nën norma

Tabela 31. Vlerat mesatare për metalet e rënda (mikroelementët)

Vendndodhja	Mikroelementët , mg/l							
	Ni	Mn	Zn	Pb	Cu	Co	Cr	Cd
Hoteli Gjuetisë, 46	0.00065	0.0095	0.0085	0.00065	0	0.0001	0.0019	0
Fushë Kuqe, 26	0.0007	0.01	0.0045	0.0006	0	0.0001	0.0025	0
Laknas, 6	0.018	0.0095	0.0035	0.0013	0.0009	0.0004	0.02	0
Fushë Krujë, 327	0.01	0.006	0.0057	0.001	0.006	0	0.00255	0
Vidhas, 17/A	0.007	0.015	0.005	0.002	0.001	0	0.0023	0
Divjakë, 1D	0.005	0.026	0.0065	0.001	0.0017	0.0006	0.128	0
Turan, 3A	0.001	0.0001	0.00175	0.003	0	0	0.0236	0
Banaj, 83	0.0045	0.1774	0.01	0.001	0.001	0	0.003	0
Novoselë	0.0035	0.0026	0.008	0.0024	0.0001	0.0001	0.0017	0
Vrion, Sarandë	0.001	0.002	0.0096	0.0013	0	0.0001	0.00275	0
VKM 379(25.05.2016) (P.M.L.)	0,02	0.05	3	0.01- 0.025	2		0,05	0,005
E.C. 80/778 (P.M.L.)	0.02	0.05	0,1-5	0,05	2		0,025	0,01

4.3 Rekomandime

Ujërat sipërfaqësore

- Rekomandojmë marrjen e masave nga organet e Pushtetit Vendor apo edhe në nivel Kombëtar për të minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe nëzona bregdetare.
- Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave sipërfaqësore kërkon realizimin e investimeve në trajtimin të shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në Tiranë, Fier e në qytetet e mëdha të zonës bregdetare pasi gjëndja dhe cilësia e tyre vazhdon të jetë në të njëjtën situatë.
- Të respektohen standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësorë. Nga ana tjetër kontrolli i vazhdueshëm në zbatimin e ligjit do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Ndotja radioaktive dhe precipitimet

- Monitorim i vazhdueshëm i ujërave të lumenjve në të gjitha pikat e përcaktuara dhe caktimi i pikave të tjera për të monitoruar më mirë të gjithë vendin tonë.
- Kontrolli i vazhdueshëm i gjëndjes mjedisore të ndotjes radioaktive të ujërave sipërfaqësore në përputhje me VKM Nr. 379, datë 25.5.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, shtojca 1, pjesa D, Radioaktiviteti.
- Rekomandojmë monitorimin e vazhdueshëm të precipitimeve atmosferike pasi ata janë një nga treguesit e rëndësishëm të ndotjes radioaktive që vjen nga ajri.

Prurjet ujore

- Të vazhdojë procesi i monitorimit në të ardhmen. Kjo do t'i shërbejë nxjerrjes së të dhënave krahasuese dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse të lidhura me to.
- Të kryhen matjet edhe në stacionet e tjera ekzistente (janë rreth 40 gjithsej në të gjithë rrethin lumor) pasi kjo do t'i shërbente rritjes së shkallës së informacionit për të gjithë lumenjtë.
- Të kryhen matjet edhe në lumenj të tjerë në të ardhmen për të rritur shkallën e informacionin në të gjithë hapësirën e rrejtit ujqor të vendit tonë.

Ujërat nëntokësore

- Rekomandojmë vazhdimin e monitorimit të ujërave nëntokësore (UN) në basenet e akuiferët e monitoruara, për të gjithë elementët e monitorimit. Monitorimi për vitin 2024 në vazhdim rekomandohet të kryhet në 7 basenet me frekuencë 2 herë në vit.
- Rekomandojmë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim të mbështesin financiarisht kryerjen e shpimeve për plotësimin dhe dendësimin e rrejtit të monitorimit hidrodinamik. Kryerja e shpimeve të reja dhe vendosja e aparaturave monitoruese vetëregjistruese shumë parametrike do të japë të dhëna mbi të cilat mund të llogaritet gjendja e rezervave të UN, sipas akuiferëve.
- Rekomandojmë që Ndërmarrjet e Ujësjellsave të zbatojnë zonat e rreptësisë sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit, të marrin masa për pastimet e kanaleve kulluese që shpesh herë mbushen me mbeturina që infiltrojnë dhe ndotin akuiferët.
- Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm të stacioneve Pishë – Poro, Konjat, Banaj, Çiflig – fshat, ose zgjidhjen e furnizimit të tyre merrugë të tjera pasi ujqrat e këtyre stacioneve janë të papijshëm.
- Stacioni Pishë - Poro të mos përdoret për furnizim me ujë të pijshëm të popullsisë, pasi uji i tij nuk plotëson standardin për ujë të pijshëm. Furnizimi me ujë të pijshëm i fshatrave Poro, Pishë - Poro, Darëzezë, Qarri etj, të furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi i Kafarajt.
- Rekomandojmë që AMBU, AKM dhe SHGJSH në bashkëpunim, të shpallin zonat e ushqimit të akuiferëve si zona me status të veçantë dhe të mbrohen nga çdo ndërhyrje. Ruajtja e këtyre zonave sot është një garanci për të siguruar ujra me sasi e cilësi të mirë.
- Rekomandojmë që agjencitë ligjzbatuese të kontrollojnë, monitorojnë e ndalojnë depozitimin, hedhjen e mbeturinave urbane në shtretërit e lumenjeve për ruajtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore, pasi këto janë dhe zonat e ushqimit të akuiferëve ujëmbajtës.
- Rekomandojmë të ndalohet shfrytëzimi i zhavorreve në shtretërit e lumenjeve për mbrojtjen e shpimeve të shfrytëzimit në tarcat lumore dhe ruajtjen e ekuilibreve hidrodinamike e hidrokimike të ushqimit të akuiferëve ujëmbajtëse.

KAPITULLI 5

ZHURMAT

KAPITULLI 5

ZHURMAT


5.1 Të përgjithshme

Vlerësimi i zhurmave urbane është kryer bazuar mbi rezultatet e monitorimit për periudhën Janar–Dhjetor 2023. Monitorimi është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për një kohë matje 24 orëshe dhe niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën u llogarit nga ora 06⁰⁰ - 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰ - 06⁰⁰.

Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegullës dhe borës, shpejtësia e erës nuk duhet të jetë më e lartë se 5 m/s, mikrofoni i mbrojtur me kufje anti-erë. Zinxhiri i matjeve duhet të jetë në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.

Në vendin tonë shkaktari kryesor i emëtimit të zhurmave është trafiku rrugor. Kjo sepse në vendin tonë sistemi hekurudhor pothuajse nuk ekziston, ndërsa përsa i përket sistemit ajror ne kemi dy aeroporte ndërkombëtar. Gjithashtu dhe lokalet gjenerojnë zhurma si ditën ashtu dhe natën.

5.2 Gjendja dhe tendenca




Monitorimi i zhurmave urbane kryhet në përputhje të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit mbështetur në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit, në legjislacionin Shqipëtar dhe Direktivat e BE dhe Ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Tabela si vijon paraqet të dhënat mesatare të monitorimit vjetor 2023 në qytetet e monitoruara.

Tabela 1 - Vlerat mesatare te nivelit të zhurmave LAeq ditën dhe natën.


Viti 2023	LAeq/Ditën dB(A)	LAeq/Natën dB(A)
Vlorë	62.8	54.79
Tiranë	64.88	54.52
Shkodër	63.26	53.36
Sarandë	60.54	51.5
Pogradec	56.95	46.66
Lezhë	62.28	51.49
Kukës	56.65	45.31
Korcë	61.68	49.76
Gjirokastrë	60.74	50.35
Fier	62.2	51.27
Berat	59.31	50.23



Monitorimi i zhurmave ditën kryhet nga ora 06:00 deri në orën 23:00 ku me të dhënat e monitoruara në këtë periudhë llogariten LAeq ditën për çdo stacion dhe LAeq ditën për qytetet e monitoruara. Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave ditën, siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në qytetin Tiranës ku kemi tejkalim të normës në masën 17.9 %, Shkodër 15.01%, Vlorës 14.18%.

Nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Trafiku rrugor është një fenomen i karakterit të rastësishëm, për këtë arsye themi që ndikimi i trafikut ose i çdo faktori tjetër të jashtëm që shkakton zhurmë në momentin e monitorimit mund të jetë shkaktori i uljes apo rritjes së nivelit të zhurmave urbane në qytetet e monitoruara.



Monitorimi i zhurmave natën kryhet nga ora 23:00 deri në orën 06:00 ku me të dhënat e monitoruara në këtë periudhë llogariten LAeq ditën dhe LAeq natën për qytetet e monitoruara.



Bazuar në të dhënat e monitoruara natën siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se tejkalimin më të lartë të normës natën (që është 45 dB) kemi në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Vlorës ku kemi tejkalim të normës me 21.75 %, Tiranës me 21.15 % dhe Shkodrës me 18.57 % dhe nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Korçës.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Vlorës**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Vlorë për vitin 2023 është realizuar në 4 stacione si më poshtë:

Tabela 2 - Stacionet e monitoruara ne qytetin e Vlorës

Nr.	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq/Ditën	LAeq/Natën
1	Hotel Bolonja	40°27'12.71"N	19°29'12.90"E	64.16	58.17
2	Hyrja e Qytetit	40°28'41.35"N	19°29'18.99"E	65.37	59.17
3	Xhamia	40°28'5.03"N	19°29'29.70"E	60.21	50.66
4	Uji i Ftohtë	40°25'42.12"N	19°29'33.04"E	61.48	51.19



Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Vlorës vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën.

Nivelet më të larta ditën, janë monitoruar në stacionin “Hyrja e Qytetit” në vlerën 65.37 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Xhamia” 60.21 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 45.26 % tek stacioni “Hyrja e Qytetit” dhe në masën 33.8% tek stacioni “Xhamia” me nivelin më të ulët të monitoruar.



Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Hyrja e Qytetit” në vlerën 59.17 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Xhamia” në vlerën 50.66 dB(A) . E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 31.48% tek stacioni “Hyrja e Qytetit” dhe në masën 12.57% tek stacioni “Xhamia” me nivelin më të ulët të monitoruar.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Beratit**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Beratit është realizuar në dy stacione, Bashkia dhe Kryqëzimi i Spitalit për të dy treguesit LAeq ditën dhe LAeq natën, ku rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën.

Tabela 3- Stacionet e monitoruara në qytetin e Beratit

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Bashkia	40° 42'11.50" N	19°57'23"E	60.49	51.11
2	Kryqëzimi i Spitalit	40° 42'03.12"N	19°58'07.64"E	58.14	49.36



Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Beratit vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën.

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Bashkia” në vlerën 60.49 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Kryqëzimi i Spitalit” 58.14 dB(A) . E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 9.98% tek stacioni “Bashkia” dhe në masën 5.70% tek stacioni “Kryqëzimi i Spitalit” me nivelin më të ulët të monitoruar.

Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Bashkia” në vlerën 51.11 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Kryqëzimi i Spitalit” 49.36 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të



normës me 13.57% tek stacioni “Bashkia” dhe në masën 9.68% tek stacioni “Kryqëzimi i Spitalit” me nivelin më të ulët të monitoruar.

❖ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Shkodrës

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Shkodrës është realizuar në dy stacione, në “Kryqëzimin e Hyrjes” dhe “Universiteti (Hotel Rozafa)”. Monitorimi është realizuar për dy tregues LAeq/Ditën dhe LAeq/Natën.

Tabela 4 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Shkodrës

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësi a gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Kryqëzimi i hyrjes	40° 42'11.50" N	19°57'23"E	64.4	54.3
2	Universiteti (Hotel Rozafa)	40° 42'03.12"N	19°58'07.64"E	65.37	55.14





Referuar të dhënave të monitoruara vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Në stacionin “Universiteti (Hotel Rozafa)” niveli i zhurmave e tejkalon normën ditën 18.85% dhe natën me 22.53%, ndërsa në stacionin “Hyrja e Qytetit” niveli i zhurmave ditën e tejkalon normën me 17.09% ndërsa niveli i zhurmave natën e tejkalon normën me 20.66%.

❖ Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lezhës

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lezhës është realizuar në dy stacione, në Kryqëzimin Lagja Gurra dhe 11 Janari. Monitorimi është realizuar për dy tregues LAeq/Ditën dhe LAeq/Natën.

Tabela 5 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Lezhës

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	11 Janari	41° 46'49.64"N	19°38'36.63"E	61.63	50.59
2	Kryqëzimi L. Gurra	41° 46'31.90"N	19°38'09.30"E	62.94	52.39





Niveli i zhurmave ditën dhe natën në të dy stacionet e Lezhës rezultojnë të lartë krahasuar me normat. Në stacionin e “11 Janarit” niveli i zhurmave ditën është 12.05 % më e lartë se norma ndërsa natën 12.42 % më e lartë se norma. Ndërsa në stacionin e “Kryqezimi te Lagjia Gurra” niveli i zhurmave ditën është 14.43 % më i lartë se norma, ndërsa natën është në masën 16.42 % më i lartë se norma.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Fierit**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Fierit realizohet në 4 stacione si janë paraqitur në tabelën më poshtë. Monitorimi i zhurmave është realizuar për LAeq ditën dhe LAeq natën, të dhënat e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën .

Tabela 6- Stacionet e monitoruara ne qytetin Fierit

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Kryqezimi për në Vlorë	40°43'52.43"N	19°34'3.99"E	63.09	54.38
2	Prefektura	40°43'40.70"N	19°33'36.69"E	63.02	51.65
3	Kryqezimi i Hyrjes në Qytet	40°43'31.65"N	19°33'22.82"E	61.19	49.96
4	Tregu (Banka)	40°43'9.73"N	19°33'15.51"E	61.5	49.11



Referuar të dhënave të monitoruara, siç duket dhe nga grafiku, niveli i zhurmave ditën dhe natën është më i lartë se norma ditën në të katër stacionet e monitoruara. Niveli më i lartë ditën është matur në stacionin “Kryqëzimi për në Vlorë” në vlerën 63.09 dB(A) me një tejkalim në vlerën 14.70%.



Niveli i zhurmave natën është më i lartë se norma në të katër stacionet e monitoruara. Niveli më i lartë natën është matur në stacionin “Kryqëzimi për në Vlorë” ku kemi tejkalim të normës në masën 20.84%.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Korçës**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Korçës është realizuar në 4 stacione ditën dhe natën si në tabelën 7.

Tabela 7 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Korçës

Nr.	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Kryqëzimi i Hyrjes	40°37'26.74"N	20°46'55.94"E	62.19	51.42
2	Tregu i Shumicës	40°37'3.88"N	20°46'33.88"E	61.51	45.47
3	Kryqëzimi i Spitalit	40°36'45.73"N	20°47'1.51"E	62.02	51.45
4	Telekomi	40°37'4.32"N	20°46'55.68"E	61.01	50.73



Referuar të dhënave të monitoruara vërejmë se niveli më i lartë i zhurmave në qytetin e Korçës është monitoruar në stacionin “Kryqëzimi i Hyrjes” në nivelin 13.07 % mbi normën e lejuar krahasuar kjo me normën ditore dhe në stacionin “Kryqëzimi i Spitalit” në masën 14.33% për nivelin e zhurmave natën.


Në stacionin “Tregu i Shumicës” kemi tejkalimin më të ulët të nivelit të zhurmave natën, vlera e monitoruar është 45.47dB(A).


❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Tiranës**

Monitorimi i zhurmave në Tiranë për vitin 2023 është realizuar në 15 stacione si më poshtë

Tabela 8- Stacionet e monitoruara ne qytetin e Tiranë

Tiranë	LAeq/Ditën dB(A)	LAeq/Natën dB(A)
Rruga Elbasanit	63.86	59
Kryqëzimi "Vasil Shanto"	65.12	59.35
Kryqëzimi "21 Dhjetori"	68.87	58.08
Drejtoria e Policisë	64.34	51.63
Shkolla e Bashkuar	61.96	51.19
Stadiumi Dinamo	60.57	50.8
Laparak	66.28	53.16
Stacioni i Trenit	65.16	54.1
Sheshi Skënderbej	68.74	57.63
Partizani i Panjohur	69.14	58.37
Kryqëzimi te Selvia	63.74	51.26
Pallati i Kongreseve	65.8	51.95
Farmacia Nr.10	64.09	53.05
Shkolla Edit Durham	62.45	54.15
Ish Banka Amerikane	63.19	54.14





Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Tiranës vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën në të gjitha stacionet e monitoruara.

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Partizani i Panjohur” në vlerën 69.14 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Shkolla e Bashkuar” në vlerën 51.96 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 25.7% tek stacioni “Partizani i Panjohur” dhe në masën 12.65% tek stacionin “Shkolla e Bashkuar” me nivelin më të ulët.



Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Kryqëzimi Vasil Shanto” në vlerën 59.35 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Stadiumi Dinamo” në vlerën 50.8 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 31.88 % tek stacioni “Kryqëzimi Vasil Shanto” dhe në masën 12.88% tek stacioni “Stadiumi Dinamo”.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Sarandës**

Monitorimi i zhurmave urbane për vitin 2023 në Sarandë është realizuar në 4 stacione monitorimi paraqitur si në tabelën më poshtë.

Tabela 9- Stacionet e monitoruara në qytetin e Sarandës

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Kryqëzimi Lagja Kodër	39°52'23.57"N	20° 0'1.12"E	61.92	50.71
2	Bashkia	39°52'30.50"N	20° 0'24.95"E	62.4	50.05
3	Tregu Valutës	39°52'32.08"N	20° 0'15.84"E	57.91	50.14
4	Hotel Butrinti	39°52'9.88"N	20° 0'52.57"E	59.93	55.13



Niveli i zhurmave në qytetin e Sarandës, krahasuar me normën si ditën ashtu dhe natën rezultojnë lartë në të gjitha stacionet.

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Bashkia” ku vlera e monitoruar është 62.4 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 13.45% më e lartë se norma.



Ndërsa natën nivelet më të larta janë monitoruar në stacionin “Hotel Butrinti” ku vlera e monitoruar është 55.13 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 22.51% më e lartë se norma.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Kukësit**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Kukësit është realizuar në dy stacione, stacioni i “Bashkia” dhe “Stacioni i Autobusave”. Monitorimi është realizuar për dy tregues LAeq ditën dhe LAeq natën. Rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën.

Tabela 10 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Kukësit

Nr	Stacionet monitorimit	Gjatesi gjeografike	Gjeresi gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Bashkia	42° 04'38.26"N	20°24'58.02"E	57.41	44.73
2	Stacioni i autobusave	42° 04'32.10"N	20°25'33.37"E	55.89	45.89



Monitorimi i zhurmave në qytetin e Kukësit është kryer në dy stacione , “Bashkia” dhe “Stacioni i Autobusave”, ditën dhe natën . Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Bashkia” ku vlera e monitoruar është 57.41 dB dhe e shprehur në përqindje 4.38 % më e lartë se norma.



Ndërsa natën nivelet më të larta janë monitoruar në stacionin “Stacioni i Autobusave” ku vlera e monitoruar është 45.89 dB dhe e shprehur në përqindje 1.97 % më e lartë se norma.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Gjirokastrës**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Gjirokastrës është realizuar në dy stacione, “Kryqëzimi në hyrje” dhe “Rrethrotullimi tek Stadiumi”. Monitorimi është realizuar për dy tregues LAeq ditën dhe LAeq natën, ku rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën.

Tabela 11- Stacionet e monitoruara ne qytetin e Gjirokastrës

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatësia gjeografike	Gjerësia gjeografike	LAeq Ditën	LAeq Natën
1	Kryqezimi hyries në qytet	40° 05'03.44"N	20°08'40.60"E	61.56	50.05
2	Rrethrotullimi te Stadiumi	40° 04'48.78"N	20°08'17.56"E	59.92	50.65



Referuar të dhënave siç duket dhe nga grafikët kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Kryqëzimit në Hyrje” ku vlera e monitoruar është 61.56 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 11.92% më e lartë se norma.



Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Rrethrotullimi te Stadiumi” ku vlera e monitoruar është 50.65 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 12.55 % më e lartë se norma.

❖ **Monitorimi i zhurmave në qytetin e Pogradecit**

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Pogradecit është realizuar në dy stacione “Hyrja e Qytetit” dhe “Kryqëzimi tek Terminali” me koordinata sipas tabelës së mëposhtme. Monitorimi është realizuar për LAeq ditën dhe LAeq natën dhe rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën e zhurmave ditën dhe natën.

Tabela 12 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Pogradecit

Nr	Stacionet e monitorimit	Gjatesi gjeografike	Gjeresi gjeografike	LAeq/Ditën	LAeq/Natën
1	Kryqezimi tek Terminali	40° 54'25.77"N	20°39'02.03"E	57.47	46.57
2	Hyrja e qytetit	40° 54'00.56"N	20°39'23.79"E	56.44	46.76



Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Pogradecit vërejmë që kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Kryqezimit tek Terminali” ku vlera e monitoruar është 57.47 dB dhe e shprehur në përqindje 4.49 % më e lartë se norma.

Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Hyrja e Qytetit” ku vlera e monitoruar është 46.76 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 3.91 % më e lartë se norma.

❖ Monitorimi i Zhurmave 2018-2023


Tabela 13. Tendanca e zhurmave mjedisore 2018-2023 për periudhën e ditës (dB)

LAeq/Ditën dB(A)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Tirane	66.1	67.15	62.47	63.36	62.91	64.88
Fier	60.17	58.16	60.47	62.07	60.62	62.2
Vlore	63.34	64.6	60.47	61.82	62.82	62.8
Sarande	61.66	65.16	60.1	62.36	61.28	60.54
Korce	61	60.96	58.05	59.99	60.05	61.68
Berat	60.95	62.25	57.1	58.26	59.4	59.31
Gjirokastrer	59.57	61	58.34	59.83	59.71	60.74
Pogradec	57.44	56.78	56.33	58.07	56.28	56.95
Shkoder	63.47	59.36	63.15	62.01	65.23	63.26
Kukes	55.99	56.42	54.76	53.88	54.56	56.65
Lezhe	61.23	60.69	62.12	62.64	61.89	62.28


Tabela 14. Tendenca e zhurmave mjedisore 2018-2023 për periudhën e natës (dB)

L _{Aeq} /Naten dB(A)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Tirane	57.94	57.49	56	53.05	50.8	54.52
Fier	47.99	49.36	52.89	51.62	50.5	51.27
Vlore	53.41	53.44	51.1	49.05	47.56	54.79
Sarande	50.12	50.6	48.7	50.39	48.45	51.5
Korce	51.13	51.02	52.89	47.72	48.13	49.76
Berat	50.25	52.17	48.6	47.07	43.5	50.23
Gjirokastrer	50.09	53	49.89	50.8	49.98	50.35
Pogradec	45	46.08	45.52	46.6	46.02	46.66
Shkoder	51.1	52.14	53.83	50.84	51.05	53.36
Kukes	45.46	45.24	43.35	42.41	44.03	45.31
Lezhe	49.38	48.44	48.5	49.83	49.05	51.49

Grafiku 1 - Niveli i zhurmave ditën për periudhën 2018-2023



Grafiku 2 - Niveli i zhurmave natën për periudhën 2018-2023



Nga grafikët e mësipërm vërejmë që niveli i zhurmave si ditën ashtu edhe natën janë mbi normë.

Në të gjitha qytetet e monitoruara nga viti 2018-2023 kemi tejkallim të standartit për LAeq ditën. Tejkallimin më të lartë ndër vite kemi në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Ndërsa tejkallimet më të ulta i kemi në qytetin e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Përsai i përket monitorimit gjatë natës vërehet se në qytetet e Beratit dhe Kukësit nuk kemi tejkallim të standartit LAeq/Natën për vitin 2023.

Për vitin 2023 tejkallim më të ulët të normës LAeq/Natën kemi në qytetet e Kukësit dhe Pogradecit.

Ndikimi kryesor në rritjen e nivelit të zhurmave në qytetet e monitoruara është vlerësuar fluksi i madh i automjeteve. Gjendja motorike e automjeteve në qarkullim dhe mosha e vjetër e tyre, sjellin uljen e parametrave optimale të çertifikatës teknike të automjetit, lidhur me emetimin e zhurmës, boritë e automjeteve ku drejtuesit e të cilëve u bien pa kriter. Gjatë natës, zhurma mjedisore duke filluar në nivelet LAeq në 45 dB mund të shkaktojë efekte negative në gjumë të tilla si lëvizjet e trupit, zgjimet, shqetësimet, si dhe efektet në sistemin kardiovaskular që bëhen të dukshme mbi 55 dB.

Zhurmat po bëhen një shqetësim gjithmonë e më serioz për shëndetin mendor dhe fizik të popullsisë.

5.3 Rekomandime

Për zvogëlimin e impaktit të zhurmës në komunitetin urban rekomandohet:

1. Sigurimi i brezit mbrojtës të gjelbër dhe hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara dhe rrugës kryesore, si një nga masat më eko - miqësore për të reduktuar nivelin e ndotjes.
2. Të përcaktohen me rregullore distancat midis rrugëve dhe banesave.
3. Të bëhen projekte për zvogëlimin e zhurmës, që në projektimin e ndërtimeve të reja (institucione, shkolla, spitale, rrugë etj.)
4. Të sigurohet kontrolli periodik i mjeteve të transportit që gjenerojnë zhurmë.
5. Të parashikohen ndërhyrjet në sinjalistikën rrugore, ku të përfshihen në të sinjalet që lidhen me zhurmat si dhe vendosjen e tyre në pika të caktuara.
6. Vendim – marrja për efektet negative që shkakton zhurma në shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë.
7. Edukimi i publikut është kërkesa më e rëndësishme. Programet e ndërhyrjes për zvogëlimin e zhurmës mund të mos kenë sukses pa pjesëmarrjen e publikut.

KAPITULLI 6

TOKAT

KAPITULLI 6

TOKAT

6.1 Të përgjithshme

Degradimi i tokës bujqësore është një problem serioz, i cili shoqërohet me zvogëlimin ose humbjen totale të produktivitetit fizik, kimik, biologjik dhe ekonomik të saj. Një nga problemet e këtij procesi, është shpejtësia jashtëzakonisht e madhe me të cilën degradon toka dhe ritmet jashtëzakonisht të ngadalta të rigjenerimit të saj.

Çështjet që trajtohen në këtë raport janë evidentimi i sipërfaqes dhe shkalla e degradimit të tokës bujqësore, për tokat me kripëzim të lartë në Dërmenas dhe Libofshë qarku Fier dhe tokat e moçalizuara në Orikum Vlorë dhe Sheqeras, Qarku Korçë. Gjithashtu janë vlerësuar shkaqet e degradimit dhe masat që duhet të merren për parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tyre. Studimi është realizuar për parametrat fiziko –kimik të tokës dhe parametrat kimik të ujit në zonat që është realizuar studimi.

6.2 Gjëndja dhe tendenca

Degradimi i tokës, është proces i gjërë dhe shtrihet në afate kohore të ndryshme. Ai mund të ndodhë në një moment të vetëm, nga fuqi madhore ose mund të ndodhë në mënyrë graduale, përnjë kohë të gjatë, që përfshin vite dhe dekada të tëra. Faktorët që nxisin degradimin e tokës bujqësore janë jashtëzakonisht të larmishëm dhe shumë prej tyre janë të lidhur me njëri-tjetrin, duke e bërë të vështirë studimin dhe specifikimin e tij.

Ekzistojnë klasifikime të ndryshme të degradimit të tokës. Për disa ky fenomen mund të grupohet në : degradim për shkak të uljes së pjellorisë dhe degradim nga ndotja fizike ose kiminë e tokës. Në rastin e degradimit për shkak të humbjes së pjellorisë, ka një rënie të ndjeshme të kapacitetit prodhues të tokës në fjalë, e cila vjen si rezultat mungesës së kushteve për rritjen dhe zhvillimin normal të mikro dhe makroorganizmave, faktor të domosdoshëm, për krijimin e kushteve optimal për rritjen e bimëve. Shkalla e ndotjes përcaktohet nga sasia e substancave të dëmshme toksike në përbërjen e tokës duke vështirësuar ose duke e bërë të pa mundur zhvillimin e jetës në të.

Tokat e degraduara nga moçalizimi

Tokat e moçalizuara karakterizohen nga: prania shumë e lartë e ujit deri në përmytje, aciditeti i lartë dhe prania e materialeve të shumta toksike, të cilat ndikojnë rëndë në kompromentimin e prodhimit. Tokat e kënetëzuara (moçalike) dallohen lehtësisht nga përmytje e lartë e lëndës organike të padekompozuar, gazra të dëmshëm dhe njolla minerale. Tokat e moçalizuara, janë një gjendje, në të cilën një zonë e saj është e mbingopur me ujë, shpesh për shkak të dukurive natyrore. Këto toka kthehen në ligatina ose kënetat me prezencë të gjatë të ujit në formën e përmytjes. Përmytja e këtyre tokave ndodh si rezultat i pamundësisë së largimit të shpejtë të sasisë së madhe të ujit, të ardhur nga përmytjet ose nga sasia e lartë e rreshjeve me intensitet të lartë, për shkak të konfigurimit të terrenit ose kapacitetit të kufizuar të hidrovoreve. Por mund të vijnë edhe nga mosfunksionimi normal i skemave kulluese. Një nga efektet më të rëndësishme negative përveç emetimit të Metanit (CH₄), të tokave të moçalizuara, është se prania e oksigjenit është i kufizuar dhe se oksigjeni i mbetur konsumohet shumë shpejt përmes frymëmarrjes aerobe. Në tokat e përmytura, të moçalizuara ndodhin ndryshime të mëdha fizike, biologjike dhe kimike.

➤ **Maliq (Sheqeras)**

Bashkia Maliq ka një sipërfaqe toke bujqësore prej rreth 13150 ha , ku 6000 ha janë pjesë torfike, nga të cilat 4660 ha janë përfitur nga tharja e kënetës. Gjatë tharjes së kënetës u ndërtuan kolektore, kanale të dytë, kanale të tretë, kanale të ujrave të larta, dhe u bë ndërhyrja në shtratine lumit Devoll, për kullimin e fushës kur ka reshje të larta shiu.

Në disa vite sipërfaqja e mbjelle e tokës bujqësore ishte më pak e punushme për arsye të përbyctjes së saj dhe kryesisht asaj torfike sepse nuk funksiononin kolektorët dhe kanalet për largimin e ujit. Vitet e fundit rifilloi puna për hapjen e kanaleve të dytë dhe të tretë në fushë, në bashkëpunim dhe me bordin e kullimit Korçë. U ndërtuan portat e kolektorit të Sovjanit të cilat nuk lejonin me ujrën e Lumit Devoll të futeshin në kolektor dhe të përmyctnin një pjesë të konsiderushme të fushës, për këtë arsye sipërfaqja e mbjelle u rrit dhe punohet në të gjithë sipërfaqen torfike përveçse në disa pjesë ku është djegur torfa dhe niveli I saj ka rënë shumë nën nivelin e mëparshëm. Kulturat kryesore që mbillen në këtë sipërfaqe janë: Misri, Gruri, Panxhari etj.

Kanali kryesor i cili zë të gjithë sipërfaqen e torfës është C2 ose kolektori i Sovjanit me gjatësi 15200 m, ai shërben për kullimin e tokave torfike kur ka intesitet të lartë të reshjeve të shiut, dhe ku ujrën e lumit Devoll hyjnë në kolektor dhe mbytin pjesët me të ulta të sipërfaqes së torfës e cila është 809 – 811 m mbi nivelin e detit.

Kanali i parë i quajtur O1 lidhet me kolektorin e Sovjanit dhe vazhdon në juglindje të pjesës torfike, gjatësia e tij varjon rreth 5 km, shërben kryesisht për kullimin e fushës dhe për vaditjen e saj nëpërmjet infiltrimit. Kanalet e dyta, në pjesën e Vreshtasit deri në Sheqeras që mbulon tokat torfike janë 22 kanale të dytë kullues, gjatësitë e këtyre kanaleve varjojnë nga 2.5 km deri në 3km, largësia kanali nga kanali varjon nga 250 m deri në 600 m. Kanali i tretë kullues, pothuajse nuk ekziston, ato janë punuar dhe janë mbyllur nga vetë fermeret ose si rezultat i mos pastrimit.

➤ **Orikum, Vlorë**

E kundër paraqitet gjëndja në Orikum. Sipërfaqet e tokave në të majtë (Jug dhe Jug- perendim) të Orikumit, janë pothuajse të rimoçalizuara. Nga rreth 400 ha tokë bujqësore, shumë produktive me rendimente konkurruese, në vitet 1980 -1990, sot më pak se gjysma e sipërfaqes së përfitur në fillim nga bonifikimet e kahershme, janë pa prezencë të ujit dhe kultivohen. Rreth 260 ha tokë janë pothuajse totalisht nën pushtetin e ujit, duke u kthyer në një moçal të vërtetë, të mbuluar pothuajse totalisht nga kallamishtet. Rrjeti i kullimit është pothuajse jo funksional, i pa pastruar dhe i mbuluar me kallamishte. Hidrovori ishte në gjëndje punë por kapaciteti i tij i vogël dhe funksionimi pa një grafik të mirfilltë bën të pamundur largimin e plotë të ujrave dhe për pasojë mos kultivimin e këtyre tokave.

Diagrama e lëvizjes së tokës së mocalizuar në Orikum paraqitet më poshtë.



▪ Tokat e degraduara nga kripëzimi i lartë

Kripëzimi i tokës bujqësore është një fenomen shumë shqetësues, si në rang global ashtu edhe rajonal. Në shkallë botërore këto 20 vitet e fundit, degradohen nga kripëzimi, afërsisht 2000 ha tokë bujqësore në vit. Aktualisht në shkallë botërore kemi afërsisht 62 miljon ha tokë bujqësore të kripëzuara, para vitit 1990 kjo sipërfaqe ka qenë më e vogël afërsisht 45 miljon.

Në vëndin tonë tokat e kripura janë afërsisht 40 000 ha, që shtrihen në të gjithë gjatësinë e tokave bujqësore, përgjatë bregdetit, nga Vrina dhe Xara në Sarandë, vazhdon përgjatë vijës bregdetare, në drejtim të Vlorës, Fierit, Durësit, Lezhës deri në Velipojë, Shkodër. Para viteve 1990 si rezultati bonifikimit dhe masave të tjera përmirësuese të marra, shumë toka të përmytura dhe të kripëzuara u vunë nën kulturë dhe u shfrytëzuan për një kohë relativisht të gjatë.

Tokat të cilat në tretësirën ujore përmbajnë mjaftueshëm kripëra të tretshme të afta për të penguar aftësinë thithëse të ujit nga bimët quhen toka të kripura. Kripëzimi i tokës shprehet nëpërmjet kontaktivitetit elektrik dhe matet me aparat, të quajtur matës deciSiemens ; tokat konsiderohen të kripura nëse përçueshmëria e tretësirës së ekstraktit të ngopjes së tyre kalon 4 deciSiemens/ meter-1. Kjo njësi matëse shpreh përqendrimin e kripës jonike dhe është relativisht e lehtë për t'u vlerësuar. Kripërat më të zakonshme në tretësirën tokësore, vijnë nga përzierjet e natriumit, kalciumit dhe magnezit me klorure, sulfate dhe bikarbonate. Shtresat e sipërme, të një toke të kripur, zakonisht kanë një strukturë të mirë dhe kjo është e rëndësishme për të kuptuar se këto toka duhet të përmirsohen nëpërmjet kullimit dhe aplikimit të metodave të ndryshme të çkripëzimit. Kjo lloj strukture ka pore relativisht të mëdha, uji mund të rrjedhë shpejt nëpër to, gjë që ndihmon në largimin e ujit të kripur, duke e bërë më të lehtë çkripëzimin e tokës, nëpërmjet shpëlarjes.

- *Dermenas dhe Libofshë*

Studimi është realizuar në njësitë administrative: Dërmenas dhe Libofshë, në të gjithë sipërfaqet e tyre, që shtrihen nga bregdeti deri në thellësi të këtyre njërive.

Tokat e këtyre njërive, paraqitet me një relief mjaft të sheshtë, me pjerrësi tepër të vogël drejt detit Adriatik. Pjesa më e madhe e fushës ka një lartësi jo më të madhe se 5 m mbi nivelin e detit.

Por një sipërfaqe e konsiderueshme është nën nivelin e detit me lartësi -1, -2 deri në -3 metra disnivel. Nga pikëpamja gjemorfologjike kjo fushë përbëhet nga depozitime shumë të hershme dhe nga ato të sotme të përfaqësuar nga argjilat dhe torfa në thellësi të profilit tokësor.

Në përbërje të këtyre tokave takohen edhe grimca rëre dhe zhavori me origjin aluviale si dhe depozitime aluvionale në të dy krahët e rrjedhjeve të poshtme të lumenjve që përshkojnë këto zona. Janë toka me kapacitet të lartë, që nuk lëshojnë lehtë ujin, janë të pasura me minerale të dyta dhe për pasojë, këto toka të jenë shumë të ngjeshura, të pa përshkushme dhe me një regjim ajror shumë të reduktuar. Në këto kushte aktiviteti biologjik i tokave të kësaj zone ekologjike presupozohet shumë i reduktuar në numër dhe diversitet si dhe në llojet përfaqësuese të grupeve të dobishme të mikroorganizmave banor të tokës. Në këtë rast intensiteti i mineralizimit të

materialeve organike bëhet me temperatura shumë të ngadalta duke ndikuar kështu në qarkullim të ngadaltë të elementëve ushqyes, në tretësirën tokësore të domosdoshëm për rritjen dhe zhvillimin e bimëve.







Nisur nga kjo dukuri mund të mendohet se këto toka kanë nivel të lartë të lëndës organike, por në fakt është e kundërta, pasi rritja e bimëve në këto toka është shumë e kufizuar dhe materiali bimor i akumuluar në tokë është i pa përfillshëm. Tokat e kësaj zone ekologjike janë kthyer në kullota natyrale dimërore dhe verore për bagëtit e imta të cilat jo vetëm i zhveshin këto toka nga bimësia spontane por dhe e ngjeshin atë. Në këto kushte jo vetëm që nuk kemi një bilanc pozitiv të lëndës organike në tokë, por kemi një përkeqësim të mëtejshëm të vetive fizike, kimik dhe biologjike të këtyre tokave duke shpejtuar kështu procesin e shkretëtirimit të tyre.







➤ **Vlerësimi i tokës bazuar mbi treguesit fiziko -kimik.**


Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e matjeve të treguesve fiziko-kimik të tokës në rastin e tokave të moçalizuara dhe kripëzuara .

				Toka të moçalizuara		Toka të kripëzuara		
Nr.	Treguesit fiziko-kimik te tokes	Njësia matëse	Limitet	Mesataret Sheqeras	Mesataret Orikum	Mesataret Dermenas 1	Mesataret Dermenas 2	Mesataret Libofshë
1	pH- ujor	-log[H+]	7	7.59	8.29	8.26	9.04	8.2
2	Konduktiviteti Elektrik (KE)	ds/m	0.2-0.4	1.73	0.15	3.30	3.54	0.258
3	Humusi	%	1.5-3	6.24	2.19	1.90	2.55	2.77
4	Azoti (N)	%	0.1-0.25	0.42	0.17	0.15	0.20	0.231
5	Fosfori (P2O5)	ppm	5-30	89.77	28.71	10.64	7.79	27.32
6	Kaliumi (K2O)	mg/100g	22-180	36.96	11.05	34.44	31.43	26.93
7	Kloruret (Cl)	mg/100g	0-3	11.37	4.88	385.82	485.89	14.2
8	Sulfatet (SO4)	mg/100g	0-2	249.24	135.00	208.70	202.08	120
9	Natriumi (Na)	mek/100g	0-4	0.23	0.08	15.90	30.78	0.27
10	Masa Organike	%		6.97	2.95	2.03	2.80	5.86
11	Kalciumi (Ca)	mg/100g	1-80	7.63	0.43	11.20	0.80	1.2
12	Mangani (Mn)	mg/ kg	10-100	36.00	36.38	39.50	39.20	33.1
13	Zinku (Zn)	mg/kg	3-5	3.56	4.09	4.17	4.51	4.18
14	Përbërja mekanike (granulometria)							
14/1	Rërë	%		30.34	29.50	29.75	6.64	4
14/2	Lym	%		37.07	34.73	30.75	36.40	55.6
14/3	Argjile	%		32.59	35.75	39.72	56.96	40.4

Grafikët e mëposhtëm paraqesin mesataret e matjeve për treguesit fiziko -kimik të tokës







➤ **Njësia Administrative Sheqeras.**

Fusha e Maliqit me sipërfaqe rreth 9500 ha shtrihet afer qytetit të Korçës rreth 10 km larg tij dhe kufizohet në lindje nga Mali i Thatë në veri nga kodrat e Pretushës dhe Çausllisë, në perëndim nga vargu i kodrave të Leminitot dhe Zboqit dhe në Jug nga fshatrat Bulgarec, Terovë, Pendavinj. Tokat e kësaj fushe janë argjilore dhe 5000 ha janë torfike me trashësi nga 1.5 ÷11.0 m, kryesisht në zonën qëndrore të saj.

Kjo fushë para vitit 1948 ka qënë kënetë. Në këtë kënetë derdreshin ujrat e lumenjëve të Devollit dhe të Dunavecit si dhe të gjithë përrenjtë që vinin nga Mali i Thatë e nga kodrat për rreth si ai i Priftit, i Novoselës etj. Lumi i Devollit i cili buron në malet e Gramozit dhe ai i Dunavecit i cili buron në kodrat e Qarrit si dhe të gjithë përrenjtë deri në kontakt me fushën kishin shtrat të formuar. Ndërsa kur hynin në fushë derdhja e tyre bëhej në mënyrë natyrore, pa shtrat të përcaktuar duke e ngritur nivelin e ujit në kënetë në periudhën e rreshjeve maksimale deri në kuotën absolute 820 mbi nivelin e detit, ndërsa në periudhën e thatësirës niveli i ujit ulej deri në kuotën 816.4 duke krijuar një zonë prej 2000 ha të përherëshme me ujë, e cila quhej liqeni i Maliqit.

Punimet e bonifikimit të kësaj kohë konsistonin kryesisht në thellimin për krijimin e shtratit të lumit të Devollit dhe Dunavecit brënda fushës së Maliqit, si dhe thellimin e lumit të Devollit poshtë urës së Maliqit. Tek ura e Maliqit u ndërtua një rregullator me 8 hapësira (2.5 x 6.5 m) me porta kuota e tabanit të rregullatorit 812.4 m Liqeni i Maliqit u la me sipërfaqe 1000 ha. U ndërtuan argjinatura në lumin e Devollit dhe të Dunavecit dhe u hap një rrjet kanalesh kullues nëtë gjithë sipërfaqen.

Sheqerasi shtrihet në këtë zonë cila përbën edhe një tokë kryesisht moçalore, duke ju referuar tabelës së mësipërme vërejmë se tokat në këtë njësi paraqiten me një strukturë shumë të mirë, me nje aftësi të lartë prodhuese me kapacitet të mirë ujëmbajtës. Elementët bazë prodhues janë në raporte të kënaqëshme. Pehashi uJOR është në normalitet të plotë duke mos krijuar asnjë problematikë stresuese për rritjen dhe zhvillimin e bimëve.

Gjatë marjes së mostrave të tokës dhe rigonicionit u vërejt një fenomen shumë shqetësues dhe negativ që ka të bëjë më djegijen e kashtës dhe mbeturinave të tokës, por që shoqërohet edhe me djegijen e torfes në thellësi, duke sjellur një degradim të parikuperueshëm për një kohë të gjatë.

Tek parcelat që kemi prezent fenomenin e djegies po të shikojmë me kujdes kemi dhe një konduktivitet të lartë, si rezultat i akumulimit dhe lidhjes së gazrave gjatë procesit të djegies.

Prania e torfës dhe lëndës organike e cila paraqitet në tregues shumë të mirë, shoqëruar edhe me përbërjen mekanike të lehtë, krijon kushte specifike për rritjen dhe zhvillimin e kulturave zhardhokore, panxhar, patate dhe qepë.

➤ Njësia Administrative Orikum

Duke parë me kujdes treguesit e paraqitur në tabelën dhe grafiket mësipërm shikohet që përgjithësisht tokat paraqiten me tregues stabil dhe me ambient të mirë për rritjen dhe zhvillimin normal të bimëve të arave dhe kulturave drufrutorë. I vetmi problem, por jo në raport të rënduar dhe frenues për zhvillim normal paraqitet pH me vlera 8.1 deri 8.4.

Treguesit granulometrik paraqiten në raporte shumë normale, duke krijuar një mjedis shumë normal, me aftësi të mira dhe shumë të mira për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore.

Prania e torfës dhe lëndës organike e cila paraqitet në tregues shumë të mirë, shoqëruar edhe me përbërjen mekanike të lehtë, krijon kushte specifike për rritjen dhe zhvillimin e kulturave zhardhokor. Faktori pengues për kultivimin e tyre është prania e madhe e ujit, duke u kthyer në një moçal, duke penguar në këtë mënyrë plugimin dhe zhvillimin normal të bimëve.

➤ Njësitë administrative Dermenas dhe Libofsh

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën dhe grafiket e mësipërm vihet re se vlerat e pH rezultojnë të larta gati në të gjitha rastet. Duke iu referuar të dhënave analitike, rezulton se tokat e kësaj zone ekologjike, përsa i përket pH, klasifikohen në masën 45.5% mesatarisht alkaline, 38.7% fuqimisht alkaline, 6.0% pak alkaline dhe 3.6% shumë fuqimisht alkaline.

Një tregues shumë i rëndësishëm për vlersimin e tokave është reaksioni i tij, ai përcakton shkallën e normalitetit të shfrytëzimit të lëndëve ushqyese nga bimët dhe rritjes së tyre. Të gjitha gjallesat rriten, zhvillohen dhe kryen aktivitetin e tyre jetësor në një ambient me reaksion të caktuar. Shumica e bimëve dhe mikroorganizmave banorë të tokës e zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor në reaksion neutral. Ndryshimi i vlerave të këtij treguesi, bëhet frenues për rritjen normale të bimëve dhe mikroorganizmave të tokës dhe në kufi ekstreme shkaktojnë edhe zhdukjen e tyre. Në rastet kur pH i solucionit tokësor rritet mbi 7 formohen produkte në formën e sulfideve (HS^- dhe H_2S), të cilët për shumicën e mikroorganizmave janë lëndë me toksicitet të lartë. Këto forma të sulfidit vepronë fuqishëm edhe mbi florën dhe faunën në ambientin e dhënë.

Reaksioni i tokës varet nga përqëndrimi i joneve hidrogjen në solucionin tokësor, natyra e kompleksit koloidal, shkalla e ngopjes së këtij të fundit me baza dhe nga natyra e bazave të këmbyeshme që ndodhen në kompleksin thithës të tokës.

Të dhënat tregojnë se vlerat me të larta të pH janë regjistruar në tokat e Libofshës, ku 52% e mostrave të analizuar rezultojnë fuqimisht alkaline dhe 48% mesatarisht alkaline. Ndërsa në Dermenas 30.1% janë fuqimisht alkaline dhe 60.3% mesatarisht alkaline. Në tokat ku niveli i pH është mbi 9.0, mund të themi se një pjesë e mirë e tyre janë të soduara ose janë në proces sodimi.

Nivelet më të larta të konduktivitetit elektrik janë regjistruar në tokat e Dermenasit të rrethit të Fierit, ku vlerat luhaten në kufij 0.164-15.7 dS/m në periudhën e thatë të vitit. Ndërsa vlerat më të ulta të konduktivitetit elektrik janë regjistruar në tokat e Libofshës.

Rezultatet e matjeve tregojnë se *topografia* ndikon shumë në proceset e kripëzimit të tokave. Nga të dhënat e analizave kimike rezulton se pjesët më të ulta më depresione të fushës paraqiten me kripëzim më të lartë se ato me sipërfaqe të sheshtë. Kjo dukuri duket së është rezultat i akumulimit dhe avullimit të mëvonshëm të ujit të kripur gjatë sezonit të nxehtë dhe të thatë të vitit, por edhe nga ujrat e ardhura nga pjesët e sipërme të fushës. Gjithashtu të dhënat e konduktivitetit elektrik treguan së në rritjen e kripëzimit ndikon shumë *tipi i tokës*. Kështu në tokat

të cilat karakterizohen me shtresa rëre afër horizontit të punushëm të tokës rezultojnë me vlera më të ulta të konduktivitetit elektrik se sa tokat ku dominon argjili dhe lymi.

Po ashtu mund të themi se sistemi i mbjelljeve dhe punimit kanë ndikim të dukshëm pozitivë, në uljen e kripëzimit dhe sodimit. Kështu mostrat e tokës përfaqësuese të ngastrave të mbjellë me kultura bujqësore, vlerat e konduktivitetit elektrik rezultuan më të ulta se ato të lëna jashtë sistemit të mbjelljeve apo ato të lëna djerr dhe abandonuara.

Nisur nga të dhënat e mësipërme mund të themi se, degradimi dhe shkretëzimi i këtyre tokave mund të parandalohet duke aplikuar një sistem mbjelljesh me bimë tolerante dhe përmirësues kimik dhe biologjik.

Duke ju referuar mbetjes së thatë tokat e studiuar klasifikohen: jo të kripura 4.8%, dobësisht të kripura 41.5%, mesatarisht të kripura 11.6% dhe shumë të kripura 42.75%. Nga të dhënat e analizave rezulton se ka diferenca të theksuar ndërmjet komunave përsa i përket nivelit të kripëzimit. Më poshtë po japim klasifikimin e tokave sipas komunave:

Komunat	Klasifikimi i tokave sipas nivelit të kripëzimit	Në %
Dërmenas	Jo të kripura	12.6
	Dobësisht të kripura	9.5
	Mesatarisht të kripura	7.9
	Shumë të kripura	66.6
Libofsh	Dobësisht të kripura	64.0
	Mesatarisht të kripura	16.0
	Shumë të kripura	20.0





Siç shihet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, tokat me të kripura rezultojnë tokat e komunës Ndërmenas me 66.6% dhe më pak të kripura ato të Libofshës me 20%. Nisur nga niveli i lartë i kripave dhe pH shumë i lartë (mbi 9) mund të themi se tokat e kësaj zone ekologjike kanë probleme kripëzimi dhe sodimi. Duke ju referuar të dhënave të analizave kimike mund të themi setokat me probleme kripëzimi kanë tendence që të zgjerohen në thellësi të tokave që më parë ishin me tregues normal të pjellorisë, duke rritur kështu sipërfaqen e tokave me probleme kripëzimi krahasuar me periudhën para viteve 1990.






Të dhënat e analizave të mostave përfaqësuese të tokave të zonës bregdetare të komunës Libofsh rezultojnë pa probleme sodimi, ndërsa vlerat e Na rezultojnë në nivele nga mesatare deri në të larta. Duke analizuar të dhënat e tabelave të mësipërme përkatëse vëmë re se, në të gjithë rastet tokat e monitoruara paraqiten me probleme kripëzimi dhe sodimi. Shkalla e kripëzimit në tokat e monitoruara, sipas klasifikimit të cituar mësipërm, është në nivele të ndryshme, nga toka të pa kripura deri në shumë të kripura dhe sodike.

Me nivel me të lartë të kripëzimit dhe sodimit paraqiten tokat e Dërmenasit, ndërsa ato të Libofshës më pak të kripura. Natriumi i këmblyshëm luhet në kufijë 0.41-43.80 mek/100g në tokat e Dërmenasit dhe 0.53-1.62 në tokat e Libofshës.

➤ Vlerësimi për treguesit kimik të ujit

Permbaj.e kriprave	Njesia	Limitet	Mesataret Sheqeras	Mesataret Oriqum	Mesataret Darzeze	Mesataret Libofsh	Mesataret Povelce
Konduk. Elektrik	ds/m	0-3	0.589	0,832	9,513	11,060	11,125
Kalcium	m.e / l	0-20	0.213	0,387	0,253	0,133	0,240
Magnez	m.e / l	0-5	0.267	0,303	0,250	0,225	0,295
Natrium	m.e / l	0-40	1,730	1.463	4,910	1,413	2,990
Bikarbonatet	m.e / l	0-10	9.743	11.000	6,167	7,157	10,735
Kloruret	m.e / l	0-30	1.333	1.400	4,203	1,537	1,700
Sulfatet	m.e / l	0-20	15.137	14.447	5,700	9,787	12,220
Aciditeti	- log [H+]	6.0-8.5	7,533	7.233	7,933	7,867	7,750
Mbetje e thatë	gr/l		0.377	0.530	6,150	11,520	7,200





Përmbajtja e kripërave në ujrata e moçalizuara të njësisë administrative Sheqeras dhe Orikum

Problemi kryesor që lidhet me cilësinë e ujit të përdorur për ujtje është përmbajtja e kripërave. Përmbajtja e kripërave në ujë i referohet sasisë totale të kripërave të tretura në ujë por papërcaktuar se çfarë lloj kripërash ka në të. Niveli i lartë i kripërave në ujin e përdorur për ujtje ul sasinë e ujit të disponueshëm për bimët (për shkak të rritjes së presionit osmotik) dhe shkakton

zvogëlim të prodhimit. Mbi një nivel të caktuar të përqendrimit të kripërave në ujë, zvogëlimi i prodhimit është proporcional me rritjen e nivelit të kripëzimit. Bimët ndryshojnë midis tyre për sa i përket tolerancës ndaj kripëzimit dhe për këtë ato kanë nivele të ndryshme të pragut kritik të kripëzimit, si edhe ritme të ndryshme të zvogëlimit të prodhimit për shkak të kapërcimit të këtij pragu.

ECW (konduktiviteti elektrik i tokës së saturuar) është proporcional me konduktivitetin elektrik të ujit të përdorur për ujitje, në varësi të përqindjes së ujit që kullon poshtë zonës ku shtrihet sistemi rrënjor i bimëve.

Treguesi që shfrytëzohet për të përcaktuar përmbajtjen e natriumit në ujin për ujitje dhe rreziqet që mund të burojnë për shkak të prezencës së tij është 'raporti i absorbimit të natrimit' – SAR. Ky tregues përcakton sasinë e natriumit në ujin për ujitje, në raport me kalciumin dhe magnezin. Si kalciumi dhe magnezi tentojnë të neutralizojnë efektet negative të natriumit.

Toksiciteti i joneve specifike në ujin për ujitje, influencohet në një masë të madhe nga përmbajtja e disa joneve specifike, që mund të mbartin veti toksike (helmuese për bimët). Ndryshimi midis kripëzimit dhe toksicitetit qëndron në atë që toksiciteti ndodh brenda në bimë, si rezultat i grumbullimit gradual në gjethe apo organet e tjera të saj të joneve të vecantë. Jonet më të zakonshëm që mund të shkaktojnë toksicitet në bimë janë klori, natriumi dhe bori. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar borit sepse toksiciteti për shkak të tij ndodh në përqendrime shumë të ulëta, ndonëse ai është një element ushqyes i domosdoshëm për bimët. Ashtu si edhe në rastin e kripëzimit bimët ndryshojnë për sa i përket ndjeshmërisë ndaj këtyre joneve. Edhe në qoftë se një jon i vetëm është në nivele toksike në ujin për ujitje, ai mund ta bëjë atë të papërshtatshme për t'u përdorur. Gjithsesi, ekzistojnë disa praktika që mund të ndihmojnë në pakësimin e dëmit. Këto përfshijnë marrjen e masave për kullimin e përshtatshëm të tokës, rritjen e frekuencës së ujitjeve, shmangien e ujitjeve në formë shiu, shmangien e përdorimit të plehrave që përmbajnë klorure apo bor, përzgjedhjen e bimëve të përshtatshme, etj.

Alkaliniteti dhe pH. Alkaliniteti e stabilizon ujin nga ndryshimet e papritura të pH-it. Në qoftë se alkaliniteti është shumë i ulët, çdo plehë acid i shtuar në ujin për ujitje do të ndikojë në uljen e menjëhershme të pH. Bimët e rritura në vazo dhe në kultura ujore (hidropozi), nëpërmjet joneve të çliruara nga rrënjët e tyre mundën gjithashtu të ndryshojnë pH në mënyrë të menjëhershme, në qoftë se alkaliniteti i substratit ose i tretësirës ushqyese është i ulët.

Në Sheqeras, Korçë është monitoruar në kanalet kryesore kulluese të fushës si dhe në sekondare dhe terziare. Nga analizat e kryera konduktiviteti elektrik rezulton 11.25 ds/m duke tejkaluar normën, pra janë ujëra të kripura në nivele të larta nga pikëpamja e sasisë së kripërave të tretura. Gjithsesi nuk ka vend për toksicitet. Një nga treguesit kryesor për gërryeshmerinë e lumit është edhe mbetja e thatë e cila transportohet me masën ujore dhe përbën shkallën erozive të tokës së gërryer e cila luhet 7 deri 8 gram/litër.

Përmbajtja e kripërave në ujrart e mocalizuara të njesisë administrative Dermenas dhe Libofshë

Po të vëmë re nga treguesit të cilët kanë të bëjnë me gërryeshmërinë e tokës pra me sasinë transportuese aluvionale të tokës bashkë me ujin e kolektorit të hidrovorit Darëzezë dhe sekondarët e KK-kulluese që shkarkojnë në hidrovor vihet re prania e sasisë së madhe të kripërave të tretura në ujë pra konduktiviteti është në nivele të larta mbi normat e lejuara, ndotja e madhe e këtyre kanaleve e cila vihet re nga nivelet e larta të klorureve, sulfatëve dhe si dhe prania e lëndëve pezull.

Ujrat e kullimit për këta kolektorë vlerësohen me probleme të mëdha deri mbi mesatare të kripëzimit dhe infiltrimit në tokë (duke ulur shpejtësinë e tij).

Lëndët Pezull aluvionale - përsa i përket lëndës pezull në të gjitha stacionet, këtë vit kanë luhajat mesatare si dhe vlera të ulëta për mbetjen e ngurtë në gram /liter për stacionet e monitoruara mbasi ky vit ka rezultuar relativisht i thatë dhe me rreshje të pakta krahasuar me mesataren shumë vjecare. Luhajat sezonale janë relativisht të ulta. Vihet re një ulje e vlerave në fazën e dytë të marrjes së mostrave që përkon edhe me minimumin e reshjeve. Në rrjedhën e sipërme ujrat janë më të pastra, parametrat janë brënda niveleve shumë mirë dhe mirë. Në rrjedhën e mesme dhe të poshtme pas shkarkimeve urbane, industriale e bujqësore në lumenj cilësia e ujrave priset duke paraqitur ndotje pothuaj në të gjithë elementet e duke u klasifikuar e moderuar deri e keqe. Shfrytëzimi i materialeve inerte në zona të caktuara shpesh herë pa projekte dhe në mënyrë individuale pa projekte jep ndikime të rëndësishme në gjëryeshmërinë e brigjevesi dhe në cilësinë e ujrave të kanaleve kulluese dhe kolektoreve të hidrovoreve.

Prurjet e ujit në këta kolektore i binden ligjësisë së shtimit të prurjeve nga rrjedhja e sipërme në atë të poshtme e rrjedhjes. Duhet theksuar se këta tregues ndikojnë direkt negativisht në degradimin e tokës bujqësore mbasi uji deperton në sipërfaqe disa hektare të tokës bujqësore.

Vlerësimi për tokat :

Burimet kryesore për ndotjen e tokave përfshijnë, aktivitetin njerëzor, bujqësinë, klima dhe topografia. Ndërsa shkaqet kryesore që ndikojnë në gjëndjen e tokave janë: mbyllja e kanaleve të kullimit ose mospastrimi i tyre, djegja e kashtës dhe mbeturinave të tokës, përdorimi i tokave për kullota. Aktiviteti njerëzor ndaj tokave ndikon në prishjen e ekosistencës së tokës, kënetëzim, moçalizim dhe për parandalimin e këtyre ndikimeve duhet kryer kullimi i përshtatshëm i tokës, rritja e frekuencës së ujitjeve, shmangia e ujitjeve në formë shiu si dhe plehërimi i gjelbër.

Tokat e marra në studim sipas klasifikimit rezultojnë me shkallë të ndryshme kripëzimi, duke filluar nga niveli i tokave dobësisht të kripura në shumë të kripura.

Nga vlerësimi duket se ka një rritje të tokave të kripura dhe shumë të kripura, zona e tokave me probleme kripëzimi shtrihet edhe në thellësi të tokave normale. Përbajtja e kripërave të përgjithshme shkon nga 0.610% në 8.600 %.

Ka një rritje alarmuese të tokave të kripura, shumë të kripura dhe sodike, në rreth 1.5 herë krahasuar me vitin 1984. Sodimi i tokave është një problem alarmues jo vetëm si element toksik, por impakti i saj manifestohet në ndryshimin e cilësive të tokës, uljen e shkallës së përdorimit dhe degradimin kimik, fizik dhe biologjik të saj.

Ka ndryshime të theksuara në përbajtjen e kripërave në tokat e studiuara ndërmjet zonave dhe brënda tyre, si rezultat i mos ndërhyrjes me masa parandaluese ose lënia jashtë vëmëndjes dhe abandonimi i tyre.

Nga vlerësimi i treguesve të analizuar për natyrën e kripëzimit, ka rezultuar se ai i përket tipit të kripëzimit tërësisht klorur, pasi vlerat e raportit Cl/SO₄ janë mbi 2.

Reaksioni i tokës në zonën e studiuar rezulton në vlera shumë të larta që shkon nga 7.9 në 9.8. Sipas klasifikimit karakterizohen shumë alkaline deri në shumë fuqimisht alkaline, duke favorizuar kështu procesin e sodimit.

Tokat e studiuara janë me përbërje grimcometrike të rënda, ku fraksionet e lymit dhe argjilës përbëjnë mbi 60% . Lidhur me vlerat e larta të lymit dhe argjilës, këto toka në përgjithësi paraqiten tipike argjilore dhe të pa përshkueshme, gjë që tregon për vështirësi kullimi dhe trajtim të tyre.

Vlera e konduktivitetit elektrik të ujit (EC) në rrjetin kullues në nivele 5.3 – 21.4 ds/m dhe 6.6 – 15.2 ds/m në ujin nëntokësorë, është tregues për fenomenin e kripëzimit, si rezultat i mungesës së kullimit dhe gradës së lartë të avullimit.

Fusha e Libofshës dhe e Semanit në skemat kryesore të saj ujitëse kulluese ka nevojë përrehabilitim si në pastrim të kanaleve kulluese dhe riksionimin e tyre.

6.3 Rekomandime

- Rregullimin e regjimit hidrik dhe ajror të tokës në të gjithë zonën e studiuar. Për këtë mendojmë se duhet të ndërhyhet në infrastrukturën e kullimit për të sjell në parametra normal rrjetin kullues.
- Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit të tretë kullues dhe atij ujitës, të mbështetet suvensionimi ose kreditimi i fermerëve pronarë të tokave.
- Në kushtet e përmbytjeve periodike të tejzgjatura dhe efektet e saj në kushtet e redoksit të tokës, do të rekomandonim ndjekjen në dinamik të përmbytjes së kriprave dhe masat për përmirsimin e tyre.
- Për tokat që rezultojnë me përmbytje të lartë kripë do të rekomandonim mbjelljen e bimëve tolerante ndaj kripëzimit si tërfili, elbi, festuka, sorgumi, sebanja etj.
- Për të parandaluar rritjen e shkallës së kripëzimit dhe sodimit të këtyre tokave, do të rekomandonim aplikimin e plehrit të gjelbër në sistemin e mbjelljes së bimëve që kanë si qëllim rritjen e lëndës organike dhe përmirsimin e raportit uji/ajër. Për këtë do të rekomandonim përdorimin e kulturave me raport C/N shumë të gjerë 15- 20 sic janë sebanja dhe sorgumi të përshtatura mjaft mirë ndaj kripëzimit.
- Ndërtimi i serave dhe kultivimi i perimeve, hardhisë, agrumeve dhe luleve, do të rriste shkallën e përdorimit dhe efektivitetin ekonomik të këtyre tokave, duke ndikuar kështu edhe në uljen e nivelit të kripëzimit dhe sodimit të tyre.

- Për të parandaluar avancimin e mëtejshëm të proceseve të kripëzimit dhe rritjen e mundësisë së përdorimit të këtyre tokave, nga më fushorët e vendit, do të sugjeronim ndërmarjen e një studimi me kompleks në zonat me probleme kripëzimi.
- Përgatitja e një teknologjie për të sjell në parametra të pranueshëm faktorët kufizues për rritjen e shkallës së përdorimit të këtyre tokëve nga me fushorët e vendit tonë.
- Rekomandohet që ky model të përdoret për qëllime projektimi dhe menaxhimi në skemat ujitëse, ti sugjerohet fermave të reja të integruara private, për të pasur një ujitje sa më efiçiente. Rikujtojmë që ujitja është një element tepër i rëndësishëm për bimën dhe mos përcaktimi i saktë i sasisë së ujit që i nevojitet bimës shpesh herë sjell në ulje të prodhimit bujqësorë deri në vlerën ekstreme .

KAPITULLI 7

PYJET DHE BIODIVERSITETI

KAPITULLI 7

BIODIVERSITETI DHE PYJET

7.1 Të përgjithshme

Shqipëria, në gjithë territorin e saj të vogël 28748 km², është një vend me florë të pasur. Kjo pasuri e saj në shumëllojshmëri biologjike është pasqyrim i diversitetit të klimës, topografisë, gjeologjisë, gjeomorfologjisë, të cilët formojnë kushte për një larmi habitatesh, flore. Fal dhe pozicionit të saj gjeografik në Mesdhe, Shqipëria dallohet si një vend me një biodiversitet të pasurdetar e bregdetar. Një mori habitatesh vendosen brenda territorit të saj si: pyje (pyje gjethegjërë, halorë dhe të përzier, pyje gjysëm natyrorë, pyjet e mbjellë); shkure dhe shkureta (gjettherënesedhe gjithnjë të gjelbërta, ose makia); sipërfaqe me bimësi barishtore (kullota) livadhe subalpine e alpine (natyrore, gjysëm natyrore dhe të përmirësuara) dhe kënetore përrenj dhe lumenj, liqene e rezevuare, laguna bregdetare, kënetë të kripura, duna ranore dhe vegetacion të tjera.

Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura monitorohen nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Këtu përfshihen speciet e kërcënuara e të mbrojtura të florës dhe faunës si dhe sistemii zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshinë aktualisht rreth 21.4% të territorit të vendit. Një aktivitet i rëndësishëm në vëzhgimin e biodiversitetit në Shqipëri është zhvillimi i Numërimit Ndërkombëtar i Shpendëve Dimëruar në Shqipëri i cili u organizua në Janar 2023, me përfshirje Administrative të Zonave të Mbrojtura.

Inventari i pyjeve dhe kullotave për vitin 2023, vlerësimi i gjëndjes shëndetësore të pyjeve dhe i specieve drunore e bimore në rrezik kërcënim apo zhdukjeje është kryer nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

7.2 Gjëndja dhe tendenca

7.2.1 Biodiversiteti

- **Flora dhe fauna**

Lista e kuqe e florës dhe faunës së egër shqiptare është miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit Nr.1280, datë 20.11.2013 “Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër” dhe përmban 402 lloje florë dhe 575 lloje faunë. Gjithashtu është në fuqi edhe VKM Nr. 760, datë 9.12. 2021 “Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës të vendit”.

Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimëruar në Shqipëri u organizua në Janar 2023 dhe mbuloj 34 ligatina (lumenj, liqene, rezerve, ekosisteme bregdetare etj) në të gjithë Shqipërinë. Për vitin 2023 në total u regjistruan 66 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 114293. Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*).

Në RNM “Liqeni Shkodrës” është evidentuar numri më i madh i shpendëve me 32089 individë, më pas vjen PK “Divjakë – Karavasta”, me 25757 individë.

Tabela 1. Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimërues, 2023

Vendnumërimet	Individë	Specie
Divjakë - Karavasta	25757	52
Kune-Vain	11534	32
Liçeni_Shkodrës	32089	23
Prespa e Madhe	6884	21
Ohër	7137	22
Narta	14742	42
Thana	1722	22
Butrinti	2430	30
Lalzi	3498	18
Orikum	969	21
Buna-Velipojë	807	15
Patok	1020	19
Fierza	1399	10
Liçeni i Tiranës	600	5
Vau i Dejës	187	11
Prespa e Vogël	307	9
Shëna-Vlash	186	15
Karpen	91	9
Seman	94	9
Banja	198	2
Belshi	375	9
Liçeni i Farkës	59	2
Rezervari i Bulos	453	11
Syri i Kaltër	73	4
Liçeni i Ulzës	44	4
Rezervuari i Kasharit	9	2
Rezervuari i Paskuqanit	747	5
Liçeni i Tapizës	146	8
Liçeni i Bovillës	-	-
Rezervuari i Kujanit	207	9
Kënetë e Roskovecit	2	2
Rezervuari i Kusit	15	1
Rezervuari i Gjançit	77	7
Rezervuari Shtyllës	9	1
Rezervuari Thumanës	426	6
Totali	114293	66

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), që nga 6-mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim është përfshirë në kryerjen e punës, për ndjekjen permanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim. Në Vëzhgim - Monitorim, janë gjithsej 40 specie, si më poshtë vijon:

<ol style="list-style-type: none"> 1. Ariu i Murmë (<i>Ursus arctos</i>), 2. Mace e Egër (<i>Felis silvestris</i>), 3. Rrëqebulli (<i>Lynx lynx balcanicus</i>), 4. Lundërza (<i>Lutra lutra</i>), 5. Dhia e Egër (<i>Rupicapra rupicapra</i>), 6. Kaprolli (<i>Capreolus capreolus</i>), 7. Baldosa (<i>Meles meles</i>), 8. Ujku (<i>Canis lupus</i>), 9. Çakalli (<i>Canis aureus</i>), 10. Derri i Egër (<i>Sus scrofa</i>), 11. Lepuri i Egër (<i>Lepus europaeus</i>), 12. Dhelpra (<i>Vulpes vulpes</i>), 13. Zardafi/Kunadhja Gushëverdhtë (<i>Martes martes</i>), 14. Shqarthy/Kunadhja Gushëbardhë (<i>Martes foina</i>), 15. Kryekuqe e Madhe (<i>Anas penelope</i>), 16. Kryekuqe Qafëgjelbër (<i>Anas platyrhynchos</i>), 17. Grilla (<i>Anas crecca</i>), 18. Rosa Bishtëgjelë (<i>Anas acuta</i>), 19. Rosa e Përhime (<i>Anas strepera</i>), 20. Sqepluga (<i>Anas clypeata</i>), 	<ol style="list-style-type: none"> 21. Marsatorja (<i>Anas querquedula</i>), 22. Shapka e Ujit (<i>Gallinago gallinago</i>), 23. Bajza (<i>Fulica atra</i>), 24. Thëllënxa e Malit (<i>Alectoris graeca</i>), 25. Pëllumb i Egër (<i>Columba livia</i>), 26. Shapka (<i>Scolopax rusticola</i>), 27. Turtulli (<i>Streptopelia turtur</i>), 28. Shkurta (<i>Coturnix coturnix</i>), 29. Lauresha (<i>Alauda arvensis</i>), 30. Pelikani Kaçurrel (<i>Pelecanus crispus</i>), 31. Kryekuqja e Mjeme (<i>Aythya ferina</i>), 32. Kryekuqja e Vogël (<i>Aythya nyroca</i>), 33. Zhytraku i Madh (<i>Mergus merganser</i>), 34. Karabullaku Madh (<i>Phalacrocorax corba</i>), 35. Karabullaku me Çafkë (<i>Phalacrocorax aristotelis</i>), 36. Pelikani Rozë (<i>Pelecanus onocrotalus</i>), 37. Çafka e Përhime (<i>Ardea cinerea</i>), 38. Karabullaku i Vogël (<i>Phalacrocorax pygmeus</i>), 39. Murrçaku (<i>Netta rufina</i>), 40. Dallandyshja Faqebardhë e Detit (<i>Chlidonias hybrida</i>).
---	--

Nga këto specie, 13 janë gjitarë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e gjitarëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujorë e jo ujorë.

Nga këto 40 specie, 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat, konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim.

Procesi realizohet nëpërmjet punës së përditëshme të Rangers-ave (Rojeve Mjedisore), sipas AdZM-ve në të 12-të qarqet e vendit.

Bazuar në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 92/43/EEC e datës 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës e florës së egër (Direktiva e Habitave) dhe gjithashtu në Direktivën e Këshillit të Europë nr. 79/409/EEC e datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (Direktiva e Shpendëve), AKZM ka krijuar një Sistem të Monitorimit të Faunës së Egër “AKZM-SiMF”, si sistem kombëtar i monitorimit, i njëzuar me sistemin e BIONNA-s, si sistem ndërkombëtar i monitorimit. Vazhdon të praktikohet hedhja online e të dhënave nëpërmjet aplikimit të këtij sistemi të ri, në mënyrë të përditësuar.

Evidentimi i specieve dhe identifikimi i tyre realizohet sipas këtyre mënyrave: Kamera Kurth, Vrojtim direkt, Jashtëqitje, Gjurmë, Tjetër (Pupla, Qime etj). Përveç këtyre, në tërësinë e të dhënave të Rangers-ave, në bashkëpunim me specialistët e AdZM-së përkatëse, janë plotësuar edhe informacioni për datën, orën, koordinatat në gradë Decimal, pra jo në UTM dhe vendin e identifikimit (zonë e mbrojtur apo jo dhe emri popullor), konfliktet e ndodhura, lloji i dëmit të shkaktuar dhe koha e kryerjes së tij, ngordhjet e konstatuara në F. Egër (koha, shkaku, mënyra e ngordhjes dhe gjinia e moshës për specien e ngordhur), pa përfshyrtur këtu shënime apo sqarime të tjera specifike për çdo rast, sipas zonave të mbrojtura ku është kryer Vëzhgim-Monitorimi.

▪ **Zona e mbrojtura mjedisore**

Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura mjedisore janë shpallur, me VKM-të përkatëse, bazuar në aktet ligjore dhe në ligjet nr. 8906 “Për zonat e mbrojtura”, datë 06.06.2002, (të ndryshuar) me ligjin nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, (në fuqi). Në vitin 2022 u bënë ndryshimet përkatëse vetëm për dy kategori Park Kombëtar dhe Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror, sipas VKM nr. 59, datë 26.01.2022 “Për Miratimin e Ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore “Park Kombëtar” (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore” dhe VKM nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të Sipërfaqeve ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”. Në vitin 2022 është shpallur me VKM nr. 557, datë 29.07.2022 zona e mbrojtur Park Natyror “Gjiri i Porto –Palermës” me sipërfaqe prej 1694.98 ha dhe është shpallur me VKM nr. 694, datë 26.10.2022 PM “Pishë Poro – Nartë” me sipërfaqe prej 16124.61 ha. Gjatë vitit 2023 është shpallur Park Kombëtar “Lumi Vjosa” me VKM nr. 155, datë 13.03.2023 me sipërfaqe prej 12727.0 ha si dhe është shpallur monumenti natyror (MN) “Habitati i Tulipanit Shqiptar” me VKM nr. 154, datë 13.03.2023 me sipërfaqe 35.5 ha.

I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshinë aktualisht rreth 21.4% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së, në gjashtë kategori:

Tabela. 2 Kategoritë e Zonave të Mbrojtura

Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur mjedisore	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Park Kombëtar	12	II	313923,77
2	Monumente Natyre	724	III	1550,00
3	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	23	IV	216024,68
4	Peizazh i Mbrojtur	10	V	81922,68
	Totali	767		613456.63

Tabela 3. Monumentet e natyrës sipas VKM Nr. 187, datë 25.03. 2021

Nr.	Qarku	Bashkia	Numri i MN
I	Berat	Berat	8
		Skrapar	27
		Poliçan	2
	Totali		37
II	Dibër	Dibër	42
		Bulqizë	18
		Mat	23
	Totali		83
III	Durrës	Durrës	5
		Krujë	11
		Shijak	2

	Totali		18
IV	Elbasan	Elbasan	15
		Librazhd	22
		Gramsh	19
		Prrenjas	11
		Belsh	4
		Peqin	5
	Totali		76
V	Fier	Fier	4
		Lushnjë	5
		Divjakë	9
		Patos	3
		Mallakastër	13
	Totali		34
VI	Gjirokastër	Gjirokastër	12
		Përmet	21
		Libohovë	17
		Dropull	13
		Tepelenë	14
		Memaliaj	4
		Këlcyrë	4
	Totali		85
VII	Korçë	Korçë	11
		Pogradec	17
		Devoll	9
		Maliq	10
		Pustec	7
		Kolonjë	23
	Totali		77
VIII	Kukës	Kukës	16
		Has	7
		Tropojë	25
	Totali		48
IX	Lezhë	Lezhë	10
		Mirditë	18
		Kurbin	12
	Totali		40
X	Shkodër	Shkodër	57
		Vau Dejës	3
		Fushë Arrëz	9
		Pukë	12
		Malësi e Madhe	34
	Totali		115
XI	Tiranë	Tiranë	14
		Rrogozhinë	2
		Kavajë	7

	Totali		23
XII	Vlorë	Vlorë	20
		Sarandë	3
		Selenicë	10
		Himarë	28
		Delvinë	12
		Finiq	8
		Konispol	5
	Totali		86
	Shuma Total (MN)		722

Me VKM-në nr. 187, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, janë shpallur gjithsej 721 monumente natyre me koordinata (MN) dhe me VKM Nr. 154, datë 13.03.2023, është shpallur MN “Tulipani Shqiptar” me vendndodhje, Surroj Kukës, pra shkon gjithsej numuri i MN në 722.


Gjithashtu sqarojmë se, në total numrit të monumenteve natyror (MN), duhet ti shtohen edhe 2 (dy) monumente natyror (MN), të cilët janë shpallur me VKM nr. 102, datë 15.01.1996 me sipërfaqe dhe konkretisht janë:

- 1- Zheji (qarku Gjirokastrë): 1500.0 ha
- 2- Vlashaj (qarku Dibër): 50.0 ha.

Në total janë gjithsej **724** monumente natyrorë në vendin tonë.


▪ **Tendenca**

Zonat e mbrojtura kanë një rëndësi të veçantë për vlerat natyrore dhe biodiversitetin që përfaqësojnë. Kuadri ligjor në lidhje me zonat e mbrojtura së bashku me politikat ndërkombëtare, konventat dhe portokollet përkatëse ku Republika e Shqipërisë është pale. Direktivat e Bashkimit Evropian si ajo e habitateve dhe shpendëve, përbëjnë në tërësinë e tyre rregullat ligjore mbi të cilat bazohet menaxhimi i territoreve të zonave të mbrojtura në vendin tonë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet tendenca e sipërfaqes totale të zonave të mbrojtura në vendin tonë.



Vërehet tendencë në rritje e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme.

Tendenca e numërimit të shpendëve dimërues 2020-2023



Referuar të dhënave shihet se kemi tendencë në ulje të numrit total të individëve krahasuar me vitet e mëparshme.

7.2.2 Pyjet

• Shtrirja e fondit pyjor kombëtar

Bazuar në të dhënat kadastrale të vitit 2023 pyjet në Shqipëri shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 ha që përfaqëson 67 % të fondit pyjor dhe kulllosor. Kulllotat dhe livadhet zenë një sipërfaqe 449.175 ha ose 26 % të fondit pyjor dhe kulllosor. Sipërfaqet më bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zenë një sipërfaqe 121.351 ha ose 7,0 % të këtij fondi.

Tabela 4. Shpërndarja sipas mbulesës së tokës

Viti	Pyje		Kulllota		Sipërfaqe me bimësi pyjore		Djerr + Sip. inproduktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2023	1,146,725	66.2	449,175	25.9	74,158	4.3	61,844	3.6	1,731,901	100

Tabela 5. Shpërndarja e pyjeve sipas pronësisë

Pronesia	Sipërfaqja	% ndaj totalit	Volumi	% ndaj totalit
Pyje publike	1,117,945	97	50,816	94
Pyje private	28,780	3	3,247	6
Total	1,146,725	100	54,063	100

- **Fondi pyjor sipas formës së qeverisjes**

Pyjet e vendit mbulojnë një sipërfaqe prej 1,146,725 ha dhe llogaritet të ketë një volum në këmbë prej 54 Milion m³. Vlerësimi i materialit drusor të klasifikuar sipas formave të menaxhimit të pyjeve është gur themeli për zbatimin dhe vlerësimin e teknikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Shpërndarja e volumeve për format e qeverisjes së pyjeve është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumit në bazë të formës së qeverisjes

Forma e qeverisjes	Sipërfaqia		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m ³)	Përqindja
Trungishte	402	35	45	83
Cungishte	471	41	5	9
Shkurre	273	24	4	7
Totali	1,147	100	54	100


Kjo shpërndarje e fondit pyjor në raport me sipërfaqen dhe volumin në këmbë duhet të merret në konsideratë nga politik-bërësit gjatë përgatitjes së dokumentit të strategjisë së zhvillimit të sektorit pyjor apo edhe të programit për zhvillimin e këtij sektorit për të rritur sipërfaqen me trungishte si forma e qeverisjes me potencial më të lartë të prodhimit.

Vlerësimi i shtrirjes dhe volumit që mbartin pyjet sipas përbërjes llojore na lejon të llogarisim disponibilitetin e tyre për furnizimin me produkte pyjore duke ruajtur ekuilibrat natyrore të shtimit të tyre.

Tabela 7. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve bazuar në përbërjen llojore

Përbërja llojore	Sipërfaqia		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m ³)	Përqindja
Halorë	135	11	12	21
Shoqërimet pyjore të dominuara nga halorët	39	4	4	7
Shoqërime pyjore të dominuara nga fletorët	57	5	4	7
Fletorë/gjethgjerë	916	80	34	64
Totali	1147	100	54	100

Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë dhe kjo është e lidhur ngushtësisht me pozicionin gjeografik dhe ekologjik të vendit. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor.



- **Fondi pyjor sipas tipeve te pyllit**

Klasifikimi i pyjeve sipas tipeve është shumë i rëndësishëm për raportimin dhe monitorimin lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve”.

Tabela 8. Shpërndarja e sipërfaqeve/zonave pyjore sipas tipit të pyllit

Tipi i pyllit		Sipërfaqia	
		(1000 ha)	Përqindja
Pyje qarri, pyje shparthi, pyje bunge	THO	231	22
Pyje bunge, pyje shkoze	SOH	128	13
Pyje malorë ilirikë ahu	IMB	125	10
Pyje të tjerë termofilë gjetherënës	OTD	118	10
Pyje të tjerë sklerofitë, karakterizuar nga një vegetacion me mbizotërim dafine(<i>lauriphyllus</i>)	MSO	95	8
Pyje me pishë të zeze mesdhetarë dhe të Anadollit	MAP	87	7
Pyje të tjera mezofitë gjetherënës	OMD	73	6
Pyje Moezianë malorë ahu	MMB	64	5
Pyje me dushqe mesdhetarë përherë të blertë	MEO	58	5
Pyje dëllinjash mesdhetare	MJU	29	2
Pyje me pishë mesdhetare	MPF	28	2
Tipe të tjera pyjesh (ASP, BE, TD, MAF, PNS, RIF, FLF, SAM, PNN, CM, FP, AC)		103	10
Totali i përgjithëm		1147	100


Analizimi i klasave të moshës ndarë sipas formës së qeverisjes është shumë e rëndësishme për tu analizuar mbasi ky tregues ka të bëjë me shpërndarjen diametrike të drurëve në pyje sipas formës menaxhuese, dy elemnte që shërbejnë për përcaktimin e disponueshmerisë së pyllit për lëndë druri aq me tepër si rregullatore për normalizimin e ciklit të prodhimit të grumbujve pyjorë.

- **Shpërndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit për klasat e moshës**

- *Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për pyjet trungishte*

Nga sipërfaqia totale rreth 402 mijë ha janë trungishte, 67% e trungishteve janë pyje të rinj (më pak se 81 vjeçarë) dhe vetëm 34% janë pyje të pjekur/të arrirë (më të vjetër se të 80 vjeçarë). Nga pyjet e pjekur vetëm 17% janë mbi 100 vjeçarë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë druriësthtë vetëm në 34% të pyjeve me regjim trungishteje.

Nga paraqitja grafike vihet re përqëndrimi i volumit në moshat e reja apo klasat e ulëta të moshës, si dhe një shpërndarje jouniforme e volumit të lëndës drusore në kategoritë e klasave të moshës.



- *Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për pyjet cungishte*

Nga sipërfaqia totale e rreth 471,000 ha pyje cungishte, 96% janë më të reja se 40 vjeç dhe vetëm 4% e tyre janë pyje cungishte të pjekur/të arrirë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë është vetëm në 4% të pyjeve me regjim cungishteje, shifër kjo tejet e ulët.

Paraqitja grafike jep një konfigurim të qartë të shpërndarjes së klasave të moshës në cungishte ku vihet re përqëndrimi i volumit në moshat e reja apo klasat e ulëta të moshës.



➤ *Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për shkurret*

Nga sipërfaqia totale e rreth 273.300 ha shkurre, 88% janë më të reja se 20 vjeç dhe vetëm 12% janë më të pjekura/të arrira.




Tabela 9. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve për klasat e moshës për shkurret

Sistemi i qeverisjes	Klasat e moshës	Sipërfaqia		Volume	
		(1000 ha)	Përqindje	(milion m³)	Përqindje
Shkurre	0 - 5 vite	5	2	0	1
	6 - 10 vite	44	14	0.4	4
	11 - 15 vite	98	37	1.9	13
	16 - 20 vite	93	35	2.1	60
	21 - 25 vite	25	9	0.8	15
	26 - 30 vite	2	1	0	1
	>30 vite	6	2	0.1	6
	Grand Total	273	100	5.3	100

Pyjet e Shqipërisë kanë një strukturë të çrregullt lidhur me klasat e moshës, dhe kjo përbën një sfidë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Edhe pse Shqipëria është një vend i pasur me pyje, nuk disponon shumë zona për shfrytëzim. E fundit por jo më pak e rëndësishme, pyjet e Shqipërisë nuk janë në një fazë intensive rritjeje.

• **Rritja në volum dhe mundësia vjetore e shfrytëzimit**

Të dhënat e strukturës së moshës në raport me volumin në këmbë treguan se në të tre format e menaxhimit kemi një dominim të grumbujve të rinj. Për rrjedhojë pritet që rritja e këtyre grumbujve të jetë e lartë për shkak se shumica e grumbujve pyjore bëjnë pjesë në fazën e rinisë dhe të maturimit. Llogaritja e rritjes sipas formave të menaxhimit shërben për të llogaritur edhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit ose prerjen e lejuar vjetore të pyjeve në Shqipëri.




Rritja vjetore totale e pyjeve në shkallë kombëtare nga llogaritjet rezultoi 1,36 milion metër kub në vit. Nëse bëjmë një bilanc midis rritjes vjetore të pyjeve (1,36 milion m³) dhe sasisë vjetore prej 2.48 milion m³ /vit të materialit drusor që nevojitet për dru zjarri (FAO,2017), rezulton se nevojat për dru zjarri në shkallë kombëtare janë 1.82 herë më të mëdha sesa rritja vjetore e pyjeve e llogaritur nga IKPK 2021. Në mënyrë që të kemi një akumulim të volumit në këmbë të materialit drusor duhet që çdo vit të vilet një sasi materiali drusor e cila të jetë më e vogël se rritja vjetore në volum psh: 80-85% e kësaj rritje.


- **Pyjet si sekuestrues të karbonit**

Pyjet janë ekosistem i madh i kapjes së karbonit. Sasia e karbonit (C) stokohet jo vetëm në pyll, tokë, por edhe në produktet drusore. Nga llogaritjet rezultoi se sasia e C e stokuar në pyjet në

Shqipëri është 100.9 milion ton C dhe 80% e kësaj sasive ekuivalente me 81 milion ton C stokohet në tokat pyjore dhe 20% (19.9 milion ton C) stokohet në biomasën pyjore.



Nga grafiku shikojmë se pyjet trugishte japin kontributin kryesor në stokimin e C me 78% e ndjekur nga cungishtet që stokojnë rreth 14% të sasisë së C dhe vetëm 8% e C stokohet nga shkurret. Pyjet trugishte fletorë kontribuojnë me 51% (10 milion ton) në stokimin e karbonit, kurse pyjet trugishte halorë stokojnë 27% të C (5.4 milion ton).



- **Sipërfaqet pyjore e kullimore të djegur nga zjarret**

Nga të dhënat e raportuara nga 61 bashkitë rezulton se numuri i rasteve të zjarreve ne pyje e kullota gjatë vitit 2023 është 150 me nje sipërfaqe të përshkuar 1563 ha dhe sipërfaqe të djegur plotësisht 307 ha.

Nr. i zjarreve në pyje dhe kullota	Sip. e përshkuar në pyje / ha	Sip. e përshkuar në kullota / ha	Sip. e djegur në pyje / ha	Sip. e djegur në kullota / ha	Material i djegur plotësisht m3	Dru i djegur por perdorshem m3	Fondet e harxhuara ne lek
150	1563	438	307	521	2722	5938	125000

Materiali drusor i djegur plotësisht raportohet në volum prej 2722 m³, ndërsa materiali drusor i djegur por i përdorshëm raportohet nga bashkitë në volumin prej 5938 m³.

- **Fondi kullor sipas pronësisë**

Rreth 90% e sipërfaqes kullorë është në pronësi publike dhe vetëm 10% është në pronësi private

Pronesia	Sipërfaqja 1000 ha	% ndaj totalit
Kullota publike	404	90
Kullota private	46	10
Total	449	100

Kullotat, zënë një sipërfaqe totale që është rreth 449,175 ha, e shpërndarë në format e përdorimit siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Shpërndarja e tokave kullorë sipas kullotave verore dhe dimërore

Sistemi i qeverisjes	Sipërfaqja 1000 ha	Përqindja
Kullotat verore	314	70
Kullotat dimërore	135	30
Totali	449	100

Kullotat verore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash nëse ato përdoren në një mënyrë të qëndrueshme kur bëhet shtegëtimi i bagëtive në këto kullota gjatë verës, siç është bërë tadicionalisht vite më parë.

- **Bimët mjekësore dhe aromatike**

Mbështetur në dokumentacionin e inventareve të bimëve aromatike dhe mjeksore të realizuara në vitet e mëparshme dhe të përditësuara rezulton:

Në shkallë vëndi rriten 252 lloje bimësh mjeksore dhe aromatike ku vetëm drunore janë 66 lloje.

Sipërfaqja ku shtrihen këto bimë është 591908 ha dhe drunoret zënë 342049.2 ha, në total **933957 ha**.

Tabela 9. Prodhimi i përgjithshëm bruto

Lule	Gjethë	Herba	Fruta	fara	Levore	Rrenj+ Tub	Bis+ sytha	Myshk	Totali (ton)	
1879.0	10494.3	5190.2	7216.9	106.1	2938.61	75297.8	36202	853.2	140178.0	Prodhim
1879.0	10494.3	5190.2	3935.4	106.1	1993.7	2668.1	97.8	853.2	27217.9	Eksport

Tabela 10. Llojet e bimeve mjekësore më kryesoret që grumbullohen.

Nr	Emri latinisht	Emri shqip	Sipërfaqe, ha	Sasia që grumbullohet (ton)
1	Arbutus unedo	Mareja	55497	32446.0
2	Asparagus officinalis	Ferremane	10829	206.3
3	Bellis perennis	Luleshqera	3141	152.7
4	Castanea sativa	Gështenja	10517	6940.0
5	Cichorium intybus	Çikore	46795	269.2
6	Colchicum autumnale	Xhirokulli	1324	11.2

7	Cornus mass	Thanë	21494	481.0
8	Corylus colurna	Lajthia	12834	171.3
9	Cotinus Coggygria	Cermedelli	18304	77.1
10	Crataegus monogyna	Murrizi njobërthamësh	29270,3	473.7
11	Cynedon dactylon	Grami	34025	993.3
12	Fragaria vesca	Luleshtrydhja	5349	408.7
13	Hypericum perforatum	Lulja e balsamit	1233	179.3
14	Juniperus communis	Dëllenja e zezë	12662	330.0
15	Juniperus oxycedrus	Dëllinjë e kuqe	58022	395.5
16	Laurus nobilis	Dafina	788	254.4
17	Malus sylvestris	Molla e eger	5695,9	253.1
18	Malva sylvestris	Mëllagë e egër	46415	52.6
19	Matricaria chamomilla	Kamomili	332	0.0
20	Melilotus officinalis	Jonxha e egër	494	96.5
21	Melissa officinalis	Bar blete	575	301.5
22	Mentha longifolia	Mendra gjethegjate	29208	102.0
23	Mentha pulegium	Mendra pulege	49400	195.5
24	Myrtus communis	Mersina	2593	156.5
25	Ononis spinosa	Gjuhë nuse	1985	329.9
26	Origanum Vulgare	Rigoni I kuq	23.564	200.3
27	Origanum vulgare vavirride	Rigoni i bardhe	20190	286.0
28	Paliuris Spinachristi	Driza	5267	842.0
29	Papaver rhoeas	Lulëkuqja	11935	56.7
30	Pistacia lentiscus	Xina	1500	0.0
31	Plantago major	Gjethedelli i madh	22051	47.0
32	Plantago media	Gjethedelli i ndërmjetëm	19096	53.5
33	Primula officinalis	Agulice	1940	70.8
34	Prunus spinosa	Kulumbria	4765	133.3
35	Punica granatum	Shega e egër	1180	144.8
36	Quercus aegilops	Valanidhi	5767	600.0
37	Robinia Pseudoacacia	Akacia	4562	381.0
38	Rosa canina	Trëndafil i egër	6216	920.5
39	Rubus ideaus	Mjedra	2689	469.9
40	Salix alba	Shelgu i bardhë	307	1917.5
41	Salvia officinalis	Sherebela	26207	2389.5
42	Salvia sclarea	Shengjini	433	35.4
43	Sambucus ebulus	Shtog	351	51.1
44	Sambucus nigra	Shtog i zi	468,05	108.1
45	Sambucus obulus	Qingel	634	147.2
46	Satureia montana	Trumza	23324	887.8
47	Scilla martima	Qepë deti	2867	84.8
48	Sideritis roesseri	Çaji I malit	13765	91.7
49	Silybium marienum	Gjemb gomari	21436	61.7
50	Tercium polium	Bar majaselli	14492	275.8
51	Teucrium chamaedrys	Arrësi dushkvoqël	11950	261.0
52	Thymus vulgaris	Timusi	5513	242.0
53	Tilia Argentea	Bliri i Argjendtë	666	42.0
54	Tilia platyphyllos	Bliri gjethevogël	386	80.9
55	Trifolium arvense	Terfil i bardhe	1329	84.5
56	Trifolium pratense	Terfil i kuq	1656	114.6
57	Tussilago farfara	Thundërmushka	23217	286.0
58	Vaccinium myrtillus	Boronica	14352	392.4
	Totali		693882.564	57037.2

Tabela 11. Eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike për vitin 2023.

Nr.	Lloji	Pesha në ton	Pesha në kg
1	Bime Medicinale te ndryshme	4305.60044	4305600.44
2	Sherebele	2106.088	2106088
3	Gjethe Ferre	305.367	305367
4	Luleshurdha	250.68	250680
5	Trumez	210.665	210665
6	Urthi	191.58	191580
7	Molle E Eger	158.075	158075
8	Lavandula	130.522	130522
9	Rrushkull	123.4283	123428.3
10	Murrizi	101.93	101930
11	Dellinje E Zeze	81.4	81400
12	Hithri	55.605	55605
13	Gjethe Mjedre	54.199	54199
14	Zhumrice	48.837	48837
15	Aguliçe	47.893	47893
16	Rigoni I Bardhë	46.363	46363
17	Bar Blete	45.475	45475
18	Trendafil I Eger	33.507	33507
19	Shtog	33.504	33504
20	Gjethe Ulliri	29.93	29930
21	Levore Fasuleje	29.225	29225
22	Lule Basani	27.84	27840
23	Konopice	27.298	27298
24	Sherebele E Eger	26.975	26975
25	Bisht Kali	26.528	26528
26	Verbena	25.484	25484
27	Bliri	22.465	22465
28	Dëllinjë E Kuqe	21.5	21500
29	Rrenje Llapoj	21.125	21125
30	Fare Merine	20	20000
31	Pelin I Bardhe	18.794	18794
32	Mellage E Bardhe	18.6005	18600.5
33	Mellage E Zeze	15.2	15200
34	Gjethe Ekualipti	13.969	13969
35	Meshtekna	13.345	13345
36	Kamomil	13.084	13084
37	Keputja	13	13000
38	Gjethe Frasheri	13	13000
39	Mjeder	11.868	11868
40	Caj Mali	11.137	11137
41	Nenexhik	11.108	11108
42	Boronice	10.575	10575

43	Levore Shelgu	10.1	10100
44	Terfil I Kuq	9.45	9450
45	Dell I Ngushtë	9	9000
46	Lepushe (Bar Peshku)	8.94	8940
47	Kin Fushe	8.6	8600
48	Caj Kamomili	8.4267	8426.7
49	Gjethe Dafine	7.55	7550
50	Mengjerrishte	7.5	7500
51	Cajra Te Ndryshem	4.79316	4793.16
52	Rrenje Karoline	4.479	4479
53	Gjethe Arre	4.3	4300
54	Kalendula Mjekesore	3.95	3950
55	Njemijegjetheshi	3.25	3250
56	Petale Ciani	2.595	2595
57	Bime(Cajra) Te Ndryshme, Vaj Bimore, Ekstrakte, Etj	2.366995	2366.995
58	Lerthi (Hurdha Eger)	2.36	2360
59	Sumbullari (Kulper E Bute)	2.1	2100
60	Bar Gjaku	2.025	2025
61	Molle	2.01	2010
62	Gjemb Gomari	2	2000
63	Infusion Melissa Lemon	1.91032	1910.32
64	Caj Mente	1.75944	1759.44
65	Bisqe Pishe	1.69	1690
66	Mustaqe Misri	1.525	1525
67	Hibisku	1.5	1500
68	Rozmarine	1.5	1500
69	Lule Kuqe	1.22	1220
70	Shpatore	1.203	1203
71	Celibashi	1.2	1200
72	Gjethe Mani	1.1002	1100.2
73	Kokceli Blu	1.1	1100
74	Levore Drunakuqi	1	1000
75	Geshtenje E Eger (Bluar)	0.985	985
76	Dell I Gjerë	0.95	950
77	Infusion Verbena	0.89614	896.14
78	Lule Dele	0.802	802
79	Çikore	0.75	750
80	Luleshtrydhe	0.7	700
81	Gjethe Boronice	0.7	700
82	Bar Pate	0.65	650
83	Bar Shelgu	0.6	600
84	Marubi Vulgar	0.5	500
85	Fare Finoku	0.5	500
86	Lule Kalendule	0.43	430
87	Petale Lule Dielli	0.4	400
88	Çajra Te Paketuar	0.34344	343.44
89	Trasta Cobanit	0.3	300
90	Thupra Shelgu	0.285	285

91	Rrenje Rrodhe	0.25	250
92	Akacie	0.235	235
93	Gjineshter	0.211	211
94	Gjethe Majdanoz	0.206	206
95	Karajpeli	0.15	150
96	Lule Dele	0.1	100
97	Drize	0.1	100
98	Luledele	0.06	60
	Total	8985.802145	8985802.145

Shënim: Burimi i të dhënave të mësipërme është Drejtoria e Doganave.

Tabela 12. Numri total i llojeve të mbrojtura sipas kategorive

Nr	Kategoria	Emertimi i kategorisë	Nr. i llojeve
1	EX	Lloje të zhdukura	0
2	EË	Lloje të zhdukura si gjendje spontane	0
3	CR	Lloje të rrezikuara në mënyrë kritike	54
4	DD	Lloje me të dhena të pamjaftueshme	30
5	EN	Lloje të rrezikuara	118
6	LR	Lloje pak të rrezikuara	60
7	NE	Lloje jo të vleresuara	3
8	VU	Lloje të perkeqesuara	96
	TOTAL		361

Tabela 13. Numri i llojeve të rrezikuara të bimëve mjekësore aromatike

Nr	Kategoria	Emertimi i kategorisë	Nr. i llojeve
1	EX	Lloje të zhdukura	0
2	EË	Lloje të zhdukura si gjendje spontane	0
3	CR	Lloje të rrezikuara në mënyrë kritike	8
4	DD	Lloje me të dhena të pamjaftueshme	0
5	EN	Lloje të rrezikuara	10
6	LR	Lloje pak të rrezikuara	4
7	NE	Lloje jo të vleresuara	0
8	VU	Lloje të perkeqesuara	8
	TOTAL		30

- **Gjendja e rrjetit të konservimit të burimeve gjenetike në habitatin e llojit Ah dhe Mështenkë**

Ruajtja dhe përdorimi i burimeve gjenetike pyjore, janë çështje thelbësore për të përsheptuar përshtatjen gjenetike të drurëve e popullatave të tyre në mjedis të reja dhe për të ruajtur kapacitetin adaptiv të tyre në evolucionin e mëtejshëm të pyjeve në Shqipëri. Menaxhimi i pyjeve ndërkohë është shumë i fokusuar edhe në ruajtjen e resurseve gjenetike pasi nëpërmjet diversitetit gjenetik arrihet që drurët pyjore mund të mbijetojnë dhe të zhvillohen në përshtatje me ndryshimin e kushteve mjedisore.

Njohja e gjëndjes së rrjetit të burimeve gjenetike pyjor kryhet nëpërmjet eksplorimit, grumbullimit të dhënave dhe evidentimit të problematikave të konstatuara gjatë vëzhgimit dhe kontrollit në terren të sipërfaqeve provë të përcaktuara. Vëzhgimet u konkretizuan me marrjen e një numri të domosdoshëm të sipërfaqeve provë në formë rrethore me rreze (11.28m) ose 400m² brenda së cilës u kryen matjet e treguesve në fushën e biodiversitetit dhe pyjeve.

Tabela 14. Rrjeti i monitorimit për llojin Ah dhe Mështeknë

Nr.	Bashkia	Lloji drunor	Nr. dru.per sipërfaqe prove	Moshë (vjet)	Sip. (m2)	Koordinata në KRGJSH	
						Y	X
1	Tropoj	Ah	40	mbi 60	400	502512.8942	4707737.168
2	M.Madhe	Ah	26	mbi 60	400	470028.1625	4705453.437
3	Kukës	Ah	18	mbi 60	400	535697.1731	4650602.21
4	Dibër	Ah	15	mbi 60	400	513879.569	4634140.778
5	Klos	Ah	25	mbi 60	400	504379.2929	4590713.228
6	Tiranë	Ah	18	mbi 60	400	511722.0479	4578593.133
7	Librazhd	Ah	20	mbi 60	400	537150.5695	4568381.525
8	Prrenjas	Ah	39	mbi 60	400	548272.7283	4558204.586
9	Elbasan	Ah	17	mbi 60	400	525934.1254	4543241.619
10	Pogradec	Ah	21	mbi 60	400	533845.3163	4533827.993
11	Maliq	Ah	15	mbi 60	400	542247.8878	4516415.945
12	Mirditë	Ah	9	mbi 60	400	510009.4686	4648601.572
13	Kolonjë	Ah	18	mbi 60	400	539912.7888	4475370.477
14	Bulqizë	Ah	36	mbi 60	400	525899.3365	4591829.835
15	Has	Ah	26	mbi 60	400	537193.5974	4668704.564
16	Tropojë	Ah	10	mbi 60	400	498744.4339	4708410.226
17	Fush-Arrëz	Ah	18	mbi 60	400	507757.9997	4670576.244
18	Shkodër	Ah	25	mbi 60	400	479961.9174	4694522.691
19	Kukës	Ah	30	mbi 60	400	551298.5156	4648644.15
20	Peshkopi	Mështekne	29	mbi 60	400	537167.3949	4634178.103
21	Kukës	Mështekne	26	mbi 60	400	551296.9999	4648853.955

Metodologjia e eksplorimit të burimeve gjenetike pyjore për evidentimin dhe monitorimin e tyre, u shtri në gjithë sipërfaqen e popullateve. Ato përmbajnë të dhëna ekologjike për grumbullim pyjor, të dhëna silvikulturale dhe mendime e vlerësime të punës së terrenit mbi bazën e të cilave kryhet studimi dhe vlerësimi i këtyre grumbujve. Në mënyrë të përmbledhur, për realizimin e objektivave sipas kësaj metode, u arrit të vendosen:

Kufizimi i rajoneve potenciale në hartë. Njohja në vend e popullatave për të kufizuar zonat e veçanta të konservimit nëpërmjet të dhënave të grumbulluara si: Kufizimi dhe kartelizimi i zonave të vlerësuara për konservimin e burimeve gjenetike pyjore; Përshkrimi i grumbujve pyjor dhe i kushteve ekologjike të tij; Plotësimi i një dokumentacioni individual për mbajtjen e të dhënave përkatëse për çdo RNI (rezervë natyrore) dhe përpunimin e të dhënave për klasifikimin e burimeve gjenetike.

Tabela 15. Vlerësimi nga vëzhgimi në terren i burimeve gjenetike për llojin Ah dhe Mëshsteknë

Bashkia	Lloji drunor	Vlerësimi gjatë matjeve në terren
Tropojë	Ah	Lartësia mesatare e drurit 13.5m. Pyll natyral me llojin Ah, drurë të vetkrasitur në 50% të trungut në lartësi. Pjerrësia e terrenit mesatare deri 20%. Nënpylli i rrallë, ferra, trëndafili i egër. Bimësia barishtore e rrallë dominuar nga graminacet 70%, leguminoze 30%. Nuk ka drurë të tharë dhe të rrëzuar. Drurët janë të prekur shumë pak nga dëmtuesit dhe sëmundjet. Kuror dendësia e grumbullit është 07-09. Moshë e grumbullit është mbi 60 vjet.
Kukës	Ah	
Peshkopi	Ah	
Klos	Ah	
Tiranë	Ah	
Librazhd	Ah	
Prrenjas	Ah	
Elbasan	Ah	
Pogradec	Ah	
Malësi e madhe	Ah	
Maliq	Ah	
Kolonjë	Ah	
Mirditë	Ah	
Bulqizë (Liqeni i Zi)	Ah	Lartësia mesatare e drurit 25m. Pjerrësia e terrenit 15%. Moshë mbi 100 vjet Pyll me llojin Ah, 100% në gjendje të mirë vegjetative dhe shëndetësore Nën pylli , filizeri bredhi, dëllinje, trëndafil i egër. Mbulesa barishtore boronice, shumë pak graminace dhe leguminoze. Nuk ka drurë të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja në 2/3 e gjatesise. Filizeria e Ahut dhe Bredhit kanë një lartësi deri në 1.5m dhe me diametër 2-5cm Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të rrugës ku ngjitesh për te “Liqeni i zi”.
Has (Tej Drinit të bardhë)	Ah	Lartësia mesatare 25m. Pjerrësia e terrenit 35%, Moshë mbi 100vjet Pyll me llojin Ah, 100% në gjendje të mirë vegjetative dhe shëndetësore. Nën pylli , panjë, muriz, dellinje, trendafil i eger. Mbulesa barishtore, shumë pak graminace dhe leguminoze, Nuk ka drurë të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja në 2/3 e gjatesise. Filizeria mungon. Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të rrugës ku ngjitesh për te maja e Boshrikut.
Tropojë (Dragobi)	Ah	Lartësia mesatare 26.5m Pjerrësia e terrenit 30%, Moshë mbi 100vjet,; Pyll 100% me llojin Ah, në gjendje të mire vegjetative dhe shendetesore, ka vetem pak prekje nga miza e ahut. Nën pylli mungon. Mbulesa barishtore, graminace dhe leguminoze, lepjeter, fjer, etj. Nuk ka drure të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja në 2/3 e gjatësisë. Ka filizeri te llojit bredh me parametra të mirë

		disa moshare. Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të rrugës ku ngjitesh për te maja e Çeremit.
Fushë Arrëz	Ah	Lartesia mesatare e drurit 24m. Mosha mbi 100 vjet Pjerrësia e terrenit 30%,; Pyll me llojin Ah, 100% në gjendje të mirë vegetative dhe shëndetësore. Nën pylli mungon. Mbulesa barishtore, shumë pak graminace dhe leguminoze. Nuk ka drure të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja në 10% e gjatësisë. Filizeria e instaluar 100% ne gjendje shume te mire. Ka drurë të rrallë të llojit Bredh si nënpyll . Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të rrugës që devijon nga rruga Fushë Arrëz-Bajram Curri në pjesën ekstreme të pyjeve të pa prerë.
Shkodër (Theth)	Ah	Lartesia mesatare e drurit 24m. Mosha mbi 100 vjet Pjerrësia e terrenit 30%,; Pyll me llojin Ah, 100% në gjendje të mirë vegetative dhe shëndetësore. Nën pylli mungon.. Mbulesa barishtore, shumë pak graminace dhe leguminoze. Nuk ka drure të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja në 40% e gjatësisë. Filizeria e rrallë në gjendje të mirë. Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të rrugës që shkon për në kampin e Thethit në krah të poshtëm sa kalon qafën që duket fshati.
Kukës (Shishtavec Zapot)	Ah	Lartesia mesatare e drurit 24m. Mosha mbi 100 vjet Pjerrësia e terrenit 30%,; Pyll me llojin Ah, 100% në gjendje të mirë vegetative dhe shëndetësore. Mbulesa barishtore, shumë pak graminace dhe leguminoze. Nuk ka drure të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja ne 50% e gjatësisë. Filizeria e instaluar e rrallë. Ngritur te stanet e Peshidanit.
	Mështekne	Lartesia mesatare e drurit 27m; Pjerrësia e terrenit 55%. Mosha mbi 100 vjet Pyll natyral, 100% me llojin Meshtekne, në gjendje të mirë vegetative dhe shëndetësore. Nën pylli , trendafil i egër, kumbull, ferra, murriz. Mbulesa barishtore, graminace dhe leguminoze (shpendra, lule shtrydhe, manushaqe) me gradë mbulimi deri në 60-70%. Drurë të dëmtuar nuk ka, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja ne 2/3 e gjatësisë. Filizeria mungon. Sipërfaqja provë eshte ngritur në afërsi të staneve verore.
Peshkopi (Kalaja e Dodës)	Mështekne	Lartesia mesatare e drurit 24m. Pjerrësia 3%, Mosha mbi 50vjet. Pyll 100% me llojin Meshtekne, pyllezim artificial, në gjendje të mirë vegetative dhe shëndetësore. Nën pylli mungon, shihet ndonjë dëllinje e rrallë. Mbulesa barishtore, graminace dhe leguminoze me grade mbulimi 60-70%. Nuk ka drure të dëmtuar, frutifikimi i bollshëm. Vetkrasitja ne 2/3 e gjatësisë. Filizeria mungon. Sipërfaqja provë është ngritur në afërsi të Kalasë së Dodës.

Si pasojë e rritjes së gjithëanëshme të presionit mbi pyjet ose tjetërsimit të tyre për përdorime të tjera, është evidentuar një shrytëzim në shkallë të gjerë i pyjeve natyralë të ahut për lëndë drusore dhe për dru zjarri, kjo ka shkaktuar një humbje të përshpejtuar të potencialit të çmuar të germoplazmës. Kjo humbje lidhet veçanërisht me faktin që në vendin tonë janë dëmtuar pjesërisht sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve ose plotësisht, ndërsa sipërfaqet e destinuar për të mbetur

si pyje iu janë nënështuar shumë formave intensive të përdorimit nga njeriu, por edhe dëmtimit të tyre nga rënia e zjarreve.

Në pyje me anë të konservimit "in situ" bëhet ruajtja e specieve si një pjesë jetësore e ekosistemit pyjor egzistues, përgjithësisht është metoda më e dëshirueshme për konservimin e burimeve gjenetike pyjore, me kusht që zona të jetë e ruajtur plotësisht dhe materiali gjenetikë i konservuar të jetë i vlefshëm për përdorim të dyfishtë brenda dhe jashtë vendit të origjinës.

Në praktikë koncepti i burimeve gjenetike, përmbledh grumbuj pyjorë natyral ose artificial me specie autoktone ose të futura, rezervate farore, arboretume, koleksione prejardhjesh, klone, hibride, fara, pjalmë dhe materiale të riprodhimit vegjetativ. Për këtë qëllim kërkohet të konservohet para së gjithash ndryshueshmëria gjenetike intraspecifike e cila asnjëherë nuk është e shpërndarë uniformë në arealin natyral të specieve dhe për këtë kërkohet të regjistrohen qendrat e kësaj ndryshueshmërie, të cilat do të shërbejnë për qëllime zbulimi, konservimi dhe koleksionimi.

• **Gjendja shëndetësore e pyjeve**

Treguesit e gjendjes shëndetësore të pyjeve janë fenomeni i ç’ngjyrosjes (tjetërsimit të ngjyrës së halave ose gjetheve), ç’halëzimit (rënies së halave) dhe ç’gjethtëzimit (rënies së gjetheve), si dhe dëmtuesit dhe sëmundjet kryesore të llojeve pyjore.

Monitorimi i gjendjes shëndetësore është përqëndruar në bashkitë me sipërfaqe më të madhe të fondit pyjor. Konkretisht në bashkitë: Berat, Poliçan, Skrapar, Dibër, Bulqizë, Mat, Klos, Krujë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Belsh, Peqin, Divjakë, Lushnje, Mallakastër, Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Pogradec, Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Finiq, etj. Vlerësimi për gjendjen shëndetësore bazohet në shkallën e fenomeneve të gjendjes shëndetësore.

Tabela 16 . Shkalla e fenomeneve të gjendjes shëndetësore

<i>Klasat</i>	<i>Shkalla e çgjethtëzimit (ç’halëzimit)</i>	<i>Çngjyrosja</i>	<i>Dëmtuesit</i>	<i>Sëmundjet</i>	<i>Përqindja</i>
0	Të pa çhalëzuara	Nuk ka çngjyrosje	Nuk janë prekur	Nuk janë prekur	0-10 %
1	Lehtësisht të çhalëzuara	Çngjyrosje e lehtë	Prekje e lehtë	Prekje e lehtë	11-25%
2	Mesatarisht të çhalëzuara	Çngjyrosje e mesme	Prekje mesme e	Prekje mesme e	26-60 %
3	Shumë të çhalëzuara	Çngjyrosje e shkallës së lartë	Prekje shkallës së lartë	Prekje shkallës së lartë	61-100%
4	Komplet të çhalëzuara	Komplet e çngjyrosur	Komplet të prekur	Komplet të prekur	100%

Llojet halorë**➤ Çhalëzimi (rënia e halave)**

Fenomeni i Çhalëzimit Halorë 2023				
Lloji	Klasat e vlerësimit			
	0-10%	11-25%	26-60%	61%-100%
Pishë e zezë	28.45%	29.85%	29.95%	11.75%
Pishë mesdhetare	26.32%	38.57%	24.54%	10.57%
Bredh	27.65%	29.24%	34.67%	8.44%
Halorë të tjerë	28.82%	29.65%	30.98%	10.55%

- **Për llojin pishë e zezë**, përqindja e rënies së halave në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.27 %, kurse në vitin 2023 është 11.75%, pra kemi një rritje 1.48%, kurse në klasën e katërt nuk kemi. Ky fenomen është takuar më së shumti në masivet e pyllëzuar jashtë arealit të vet dhe në terrene të eroduara e që janë shumë të cekëta. Faktor tjetër që ka ndikuar në këtë gjendje është, shkalla e nga dëmtuesi i procesonaries së pishës dhe temperaturat e larta.

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 6.24 %, kurse në vitin 2023 është 10.57%, pra kemi një rritje 4.33%. Nuk kemi fenomenin e tharjes komplet të drurëve (klasa e katërt).

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 5.10 %, kurse në vitin 2023 është 8.44%, pra kemi një rritje 3.34% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-**Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 9.47 %, kurse në vitin 2023 është 10.55%, pra kemi një rritje 1.08% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

➤ Çngjyrosja (tjetërsimi i ngjyrës së halave)

Fenomeni i Ç'ngjyrosjes Halorë 2023				
Lloji	Klasat e vlerësimit			
	0-10%	11-25%	26-60%	61%-100%
Pishë e zezë	29.35%	32.15%	29.57%	8.93%
Pishë mesdhetare	27.14%	38.18%	26.98%	7.70%
Bredh	26.87%	31.89%	33.14%	8.10%
Halorë të tjerë	31.58%	30.87%	25.49%	12.06%

- **Për llojin pishë e zezë**, përqindja e ç'ngjyrosja e halave në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 8.07 %, kurse në vitin 2023 është 8.93%, pra kemi një rritje 0.86%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (thenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 5.85 %, kurse në vitin 2023 është 7.70%, pra kemi një rritje 1.85%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (thenomenin e tharjeskomplet të drurëve).

- **Për llojin breddh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 3.91 %, kurse në vitin 2023 është 8.10%, pra kemi një rritje 4.19% kurse në klasën e katërt nuk kemi (thenomenin e tharjes komplet të drurëve).

-**Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 7.70 %, kurse në vitin 2023 është 12.06%, pra kemi një rritje 4.36% kurse në klasën e katërt nuk kemi (thenomenin e tharjes komplet të drurëve).

Llojet fletorë

➤ **Çgjethëzimi (rënia e gjetheve) për llojet fletorë**

Fenomeni i Çgjethëzimit Fletorë 2023				
Lloji	Klasat e vlerësimit			
	0-10%	11-25%	26-60%	61%-100%
Ah + meshtekn	29.22%	31.38%	27.11%	12.29%
Dushqe +Gështenjë	30.54%	35.48%	23.57%	10.41%
Fletorë të tjerë	31.35%	34.99%	22.98%	10.68%

- **Për llojin ah**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 9.57 %, kurse në vitin 2023 është 12.29%, pra kemi një rritje 2.72%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 7.72 %, kurse në vitin 2023 është 10.41%, pra kemi një rritje 2.69%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 6.73 %, kurse në vitin 2023 është 10.68%, pra kemi një rritje 3.95%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

➤ **Çngjyrosja e gjetheve**

Fenomeni i Çngjyrosjes Fletorë 2023				
Lloji	Klasat e vlerësimit			
	0-10%	11-25%	26-60%	61%-100%
Ah+ meshtekn	28.45%	32.21%	25.99%	13.35%
Dushqe +Gështenjë	29.14%	34.23%	25.57%	11.06%
Fletorë të tjerë	29.11%	35.45%	22.15%	13.29%

- **Për llojin ah**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.08 %, kurse në vitin 2023 është 13.35%, pra kemi një rritje 3.27%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.
- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 8.85 %, kurse në vitin 2023 është 11.06%, pra kemi një rritje 2.21%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.
- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 9.39 %, kurse në vitin 2023 është 13.29%, pra kemi një rritje 3.90%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

▪ **Shkalla e prekjës së pyjeve nga dëmtuesit dhe sëmundjet kryesorë të tyre.**

Insektet si dëmtues të pyjeve dhe fitopatogjenet (bakteret, viruset, kërpudhat) gjatë fenomenit të prekjës së drurëve shkaktojnë ndikime të mëdha, duke çuar në një dobësim të shëndetit dhe vitalitetit të tyre, për rrjedhojë pasohen me zvogëlim të rritjes vjetore dhe humbje ekonomike. Dëmtuesit dhe sëmundjet, kanë të ngjarë të reagojnë gjatë proceseve të ndryshme afatgjata siç është ndryshimi i klimës, për më tepër, dëmtimi prej tyre mund të ndikojë në përkeqësimin e gjendjes së drurëve, jo vetëm në vitin e shfaqjes, por edhe në vitet e mëvonshme.

Tabela 17. Dëmtuesit dhe sëmundjet e llojeve halorë dhe fletorë

Lloji	Dëmtuesit	Sëmundjet
Pishë e zezë	Procesionaria e pishës (<i>Thaumetopoea pityocampa</i> , Den and Schiff) më problematike paraqitet në bashkitë; Pukë, Fushë – Arrëz, Kukës, Mirditë, Bulqizë, Kolonjë, Pogradec, Korçë, Peshkopi, Mat, Klos, Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Vlorë, Librazhd, Prenjas, Pogradec, Gramsh dhe Elbasan	Shyta e zakonshme (<i>Lophodermium pinastri</i>) në bashkitë, Pukë, Kukës, Gramsh, Pogradec, Kolonjë, Dibër, Korçë. Ndryshku i halave (<i>Cronartium ribicola</i> Fisch); i përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Biskpërdredhësi i pishës (<i>Rhyacionia boliana</i> , Den and Schiff) më	

	<p>problematike paraqitet në bashkitë; Skrapar, Berat, Vlorë, Pukë, Shkodër , Mat.</p> <p>Kuqeziu i halave (<i>Haematoloma darsatum</i> Ahrens), ka një përhapje në habitatet e pishave në të gjithë territorin e vendit.</p> <p>Piralida e pishës (<i>Dioryctria sylvestrella</i> Ratz), problematike në bashkitë; Pukë, Dibër, Mat</p> <p>Nematoda (<i>Bursaphelenchus xylophilus</i> et Buhner), në bashkitë; Shkodër, Pukë, Kukës, Mat, Bulqizë,</p>	<p>Ç'ngjyrosja e halave (<i>Diplodia mutila</i>); në shkallë vendi, më e theksuar është në objektet e pyllëzuara</p>
Pisha Mesdhetare	<p>Krasitësi (<i>Tonicus Minor</i> Htg), në bashkitë: Skrapar, Berat, Vlorë Përmet, Mat, Fier, Lushnjë</p> <p>Skolitet e pishës (<i>Ips sexdentatus</i> Berner), në bashkitë: Skrapar, Tiranë, Vlorë, Berat.</p> <p>Hundëgjati i pishës (<i>Pissodes castaneus</i> De Geer), ku më i atakuar është në zonën e pishës së detit dhe pishës së egër në zonën bregdetare.</p> <p>Nematoda (<i>Bursaphelenchus xylophilus</i> et Buhner), në bashkitë; Shkodër, Kurbin, Durës, Kavajë</p>	
Bredh	<p>Skolitet e trungut dhe degëve të bredhit (<i>Cryphalus piceae</i> Ratz dëmtues ky i gjendur në bashkitë: Vlorë, Tropojë, Berat, Skrapar, Kolonjë, Korçë dhe Përmet.</p> <p>Turigjati i bredhit (<i>Pissades piceae</i>), ku më i përhapur është në bashkitë; Përmet, Tropojë, Kolonjë.</p>	<p>Rrëzimi i halave të bredhit (<i>Lophodermium nervisequum</i> D.C) në bashkitë; Tropojë, Vlorë, Kolonjë, Përmet etj.</p> <p>Nxirja e halave (<i>Trichosphaeria parasitica</i> Hartig në bashkitë: Tropojë, Pukë Korçë.</p> <p>Ndryshku kërpudhor i halave (<i>Hrysomyta rhedendria</i>), i përhapur në të gjithë vendin.</p>
Selvi	<p>Morri i selvisë (<i>cinara cupressi</i> Buckson në bashkitë; Berat, Vlorë, Përmet.</p> <p>Skolitet e selvisë (<i>Phlesinus aubie, thuyae</i> Pires), në bashkitë; Berat, Vlorë, Përmet.</p>	<p>Kanceri i selvisë (<i>Seiridium cardinale</i>), në bashkitë: Berat, Përmet, Vlorë.</p>
Ahu	<p>Miza e Ahut (<i>Micola fagi</i> Hartig), në bashkitë: Tropojë, Kukës, Has, Pukë, Shkodër, Librazhd, Kolonjë, Korçë, Pogradec.</p> <p>Turigjati i ahut (<i>Rhynchaenus fagi</i> L.); në sipërfaqet monitoruese të bashkive; Kukës, Tropojë, Shkodër, Korçë, Fushë - Arrëz.</p>	<p>Kanceri i ahut (<i>Nectia ditisima</i>), në të gjitha ahishtet e moçme</p> <p>Vrugu i Ahut (<i>Phytophthora fagi</i>), në bashkitë: Shkodër, Kukës, Has</p> <p>Kalbëzimi i ahut (<i>Fome fomentarius</i>), Librazhd, Has, Prrenjas (sipërfaqet e pa</p>

	Morri i ahut (<i>Phyllaphis fagi</i> L), është i përhapur në të gjitha sipërfaqet e monitorimit në shkallë vendi.	shfrytëzuara)
	Breshka e lëvores së Ahut (<i>Cryptococcus fagisuga</i> Lindinger); e përhapur në të gjitha ahishtet e moçme	
Dushqet	Vemja e dushkut (<i>Limantria dispar</i> L) në bashkitë: Maliq, Kukës, Has, Pukë, Shkodër, Mirditë, Librazhd, Pogradec, Gramsh, Librazhd dhe Kolonjë	Hiri i dushkut (<i>Microsphaera alphitoides</i>), në bashkitë: Kukës, Has, Shkodër, Mat, Mirditë, Klos, Librazhd, Maliq, Pustec, Kolonjë, Korçë etj.
	Gjethpërdredhësja e dushkut (<i>Tortrix viridana</i> L), në bashkitë: Maliq, Pustec, Has, Mirditë, Mat, Kukës, Shkodër dhe Gramsh.	Kanceri i dushkut (<i>Cryphonectria parasitica</i>); në të gjitha dushkajat e trajtuara për dru zjarri në të gjithë territorin e vendit.
	Krizomela e dushkut (<i>Altica quercetorum</i>) në të gjitha dushkajat ku gjendet lloji Bulger.	Tharja e majave të lisit (<i>Botryosphaera sterensi</i>) në bashkitë: Kukës, Kolonjë, Mirditë, Mat etj.
	Procesionaria e dushkut (<i>Thaumetopoea processionea</i> L), në bashkitë: Pogradec, Maliq, Vlorë, Tiranë, Berat dhe Has.	Eshka e dushkut (<i>Polyperus dryphilus</i>); në dushkajat që kanë kaluar moshën e shfrytëzimit.
	Matësi skeletues (<i>Erannis defoliaria</i> Clectk), në bashkitë: Kukës, Has, Pukë, Mirditë, Dibër.	Kalbëzimi i dushkut (<i>Armillaria mellea</i>), në bashkitë: Librazhd, Berat, Shkodër, Kukës etj
	Skolitet e dushqeve (<i>Scolitus intricatus</i> Ratz.), në gjitha sipërfaqet e dushqeve në shkallë vendi.	
Gështenja	Krimbi i gështenjës (<i>Carpocapsa Splendona</i> Hb), në bashkitë: Tropojë, Shkodër, Kukës, Pukë, Tiranë, Pogradec.	Kanceri i gështenjës (<i>Cryphonectria parasitica</i>), e përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Turigjati i gështenjës (<i>Corculio elephas</i> Gyll) në bashkitë: Shkodër, Kukës, Mat, Librazhd, Korçë.	Sëmundja e bojës (<i>Phytoftora cambirora</i> e përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Minusja e gjetheve të gështenjës (<i>Titischeria complonella</i> Hb në bashkitë: Shkodër, Kukës, Pukë, Pogradec.	Ndryshku i gështenjës (<i>Mycosporella maculiformis</i> , problematike për të gjitha masivet me gështenjë në vendin tonë.
	Grerëza aziatike e gështenjës, e përhapur në të gjithë territorin e vendit sidomos në masivet me gështenjë në: Tropjë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Pogradec, etj.	
Plepi	Krizomela e plepit (<i>Melasoma populic</i>) në Berat, Vlorë, Fier, Kolonjë	
	Saperda e plepit në bashkitë Fier, Kuçovë	
	Turigjati i plepit (<i>cryotorhynchus lapathi</i> .L) në Kolonjë	

	Grerëza e vogël e plepit në Kolonjë, Fier	
Rrap	Minuesja e gjetheve të rrapit përgjatë lumenjve Drino dhe Vjosë.	

➤ Llojet halore

Shkalla e prekjes së llojeve halorë nga dëmtuesit, viti 2023 paraqitet si mëposhtë:

Lloji	Klasat e vlerësimit në %			
	0-10%	21-25%	26-60%	61-100%
Pishë e zezë	24.80%	33.35%	31.85%	10.00%
Bredh	37.67%	33.59%	23.71%	5.03%
Pishë Mesdhetare	31.36%	36.21%	26.54%	5.89%
Halorë të tjerë	27.12%	36.35%	28.51%	8.02%

- **Për llojin pishë e zezë**, përqindja e prekjes nga dëmtuesit, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.45 %, kurse në vitin 2023 është 10.00%, pra kemi një rënie 0.45%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 2.94 %, kurse në vitin 2023 është 5.89%, pra kemi një rritje 2.95%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 1.76 %, kurse në vitin 2023 është 5.03%, pra kemi një rritje 3.27% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-

- **Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 3.50 %, kurse në vitin 2023 është 8.02%, pra kemi një rritje 4.52% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

➤ Llojet fletore

Shkalla e prekjes së llojeve fletorë nga dëmtuesit për vitin 2023 paraqitet si vijon:

Lloji	Klasat e vlerësimit në përqindje			
	0-10%	11-25%	26-60%	61-100%
Ah	29.58%	37.56%	24.11%	8.75%
Dushk dhe Gështenjë	29.24%	32.14%	24.11%	14.51%
Fletorë të tjerë	22.35%	35.24%	25.21%	17.20%

- **Për llojin ah**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 11.20 %, kurse në vitin 2023 është 8.75%, pra kemi një rënie me 2.45%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.60 %, kurse në vitin 2023 është 14.51%, pra kemi një rritje 3.91%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 13.50 %, kurse në vitin 2023 është 17.20%, pra kemi një rritje 3.70%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

▪ Shkalla e prekjes nga sëmundjet

➤ Shkalla e prekjes së llojeve halorë nga sëmundjet kryesore të tyre, viti 2023

Lloji	Klasat e vlerësimit përqindje			
	0-10%	11-25%	26-60%	61-100%
Pishë e zezë	27.89%	32.98%	33.12%	6.01%
Bredh	31.24%	33.45%	26.37%	8.94%
Pishë Mesdhetare	30.58%	34.27%	22.15%	13.00%
Halorë të tjerë	24.38%	35.27%	27.54%	12.81%

- **Për llojin pishë e zezë**, kemi, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 3.83 %, kurse në vitin 2023 është 6.01%, pra kemi një rritje 2.18%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (phenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 9.50 %, kurse në vitin 2023 është 13.00%, pra kemi një rritje 3.50%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (phenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 4.35 %, kurse në vitin 2023 është 8.94%, pra kemi një rritje 4.59% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-Për llojet halorë e tjerë, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 9.35 %, kurse në vitin 2023 është 12.81%, pra kemi një rritje 3.46% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

➤ **Shkalla e prekjes së llojeve fletorë nga sëmundjet kryesore, viti 2023**

Lloji	Klasat e vlerësimit në përqindje			
	0-10%	11-25%	26-60%	61-100%
Ah	28.69%	34.87%	23.57%	12.87%
Dushk dhe Gështenjë	27.57%	35.24%	22.37%	14.82%
Fletorë të tjerë	23.54%	37.58%	26.12%	12.76%

- **Për llojin ah**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.26 %, kurse në vitin 2023 është 12.87%, pra kemi një rritje me 2.61%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 10.50 %, kurse në vitin 2023 është 14.82%, pra kemi një rritje 4.32%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 11.60 %, kurse në vitin 2023 është 12.76%, pra kemi një rritje 1.16%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

Janë kryer verifikime në terren të gjëndjes së llojit rrap (*Platanus orientalis*), që shtrihet përgjatë brigjeve të lumenjve Shkumbin, Mat, Vjosë dhe Drino.

Vërehet tharje e llojit rrap , ku janë të pranishëm drurë të tharë komplet, drurë të tharë rreth 50% të masës së tyre dhe drurë tek të cilët ka nisur tharja.

Dëmtues më kryesor të konstatuar në këtë sipërfaqe monitoruese do të përmendim:

- Minuesja e gjetheve të rrapit (*Lithocolletis platania*. Stainton).
- Anekroza e rrapit (*Gnomonia veneta*.Kleb), (*Genomonium platanii*.Kleb) dhe (*Gloeosporium platania*).

Gjatë monitorimeve të kryera në terren, pothuajse në të gjithë arealin e përhapjes së llojit bush, është takuar tharja e këtij lloji. Ky fenomen është gjerësisht i përhapur në territoret e bashkisë Gramsh, Shkodër, Burrel, Vlorë, Maliq, Librazhd, etj.

Fenomeni i tharjes së llojit Hormoq në luginën e Valbonës u konstatua gjatë këtij viti dhe është vetëm në drurë të veçantë.

Fenomeni i prekjes së llojit Gështënjë nga grerëza aziatike është i përhapur në të gjithë masivet me gështënjë, fenomen që është shfaqur para disa viteve por këtë vit pati shumë dëmtime në prodhimtarinë e llojit.

Shkaqet kryesore që kanë ndikuar në gjëndjen shëndetësore të fondit pyjor janë;

1. Faktorët klimatikë si temperaturat ekstreme të ulta dhe të larta kanë patur ndikimin e tyre në fenomenin e çngjyrosjes dhe të çhalëzimit si dhe atë të zjarreve të rëna para fillimit të vegjetacionit.

2. Shkalla e prekjes nga dëmtuesit dhe sëmundjet ka qenë në varësi të ciklit biologjik të zhvillimit të tyre ku dëmtuesi i procesonaries së pishës është shfaqur gjatë gjithë vitit, kanceri i gështenjes ka qënë i pranishëm gjatë gjithë vitit.

- **Speciet drunore dhe bimët aromatiko mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje**

Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Shqipëria si edhe shumë vende të tjera të botës po përballen me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënime serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri dhe aktivitetet e tij. Për njohjen e gjëndjes së llojeve drunore është kryer monitorimi i specieve drunore të kërcënuara apo në rrezik zhdukje të listuara në Librin e Kuq shqiptar.

Tabela 18. Vlerësimi për llojet drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje.

Statusi	Lloji pyjor	Bashkia	Ekonomia Pyjore	Vlerësimi
Vu D2	Rrobull	Bulqizë Dibër Gramsh Mat Maliq Kukës Skrapar	Liçeni i Zi Lurë Sogor, Mali i Grabovës, Holtë- Lukovë Masdejë Strelcë, Mesmal Bicaj-Kolesjan Devriteroll	Në përgjithësi në të gjitha sipërfaqet e monitorimit, lloji ka një gjendje të mirë fitosanitare dhe vegetative.

EN A1b	Arnen	Tropojë Dibër Gramsh Mat Maliq	Çerem Dragobi Lurë Sogor, Mali i Grabovës Masdejë Strelcë	Lloji arne është në gjendje të mirë fitosanitare dhe vegetative.
EN A1b	Ilqe	Berat Gramsh Vlorë Mirditë	Hija e Roshnikut Lubinjë-Tunjë Llogara Gziq	Grumbulli është në gjendje shumë të mirë vegetative dhe fitosanitare
Vu A1b	Rrenjë	Fier Lezhë	Kunorë Kune - Vain	Gjendja vegetative dhe fitosanitare e llojit paraqitet e mirë.
EN A1b	Lajthi e egër	Kukës Pustec Has Libohovë	Arrën Parku i Prespës Tej drini i bardhë Çajup	Gjendja vegetative e drurëve është e mirë
Vu	Caraca e Tournefortit	Pustec	Parku i Prespës	Numri i drurëve është shumë i vogël. Gjendja vegetative e këtij lloji duket e mirë
CR 1b	Venja	Pustec Libohovë	Parku i Prespës Çajup	Lloji paraqitet në gjendje të mirë vegetative.
Vu A2b	Drunakuqja	Përmet	Petran – Çarshovë, Petran-Zavalan	Gjendja vegetative dhe fitosanitare e grumbullit është e mirë.
CR B2e	Mështekën	Dibër Korçë Kukës	Kastriot-Silovë Dardhë Shishtavec-Zapod	Lloji i mështeknës është në gjendje të mirë vegetative.
CR A1a	Gështenjë e Kalit	Librazhd Tepelenë	Stravaj Kurvelesh	Drurët janë në gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare.
CR A1b	Hartina	Peshkopi Maliq Tropojë	Lurë Lenie Cerem-Dragobi	Grumbulli është në moshë të re, takohet i shoqëruar nga lloji ah. Gjendja vegetative e grumbullit është shumë e mirë.
VU A1b	Tisi	Tiranë Dibër	Bizë Lurë	Druri i Tisit gjendet mbi një tokë shkëmbore. Lloji Tis bashkëshoqërohet nga lloji Ah.
CR A1b	Valanidhi	Vlorë	Himarë Vlorë	Gjendja vegetative është shumë e mire, gjithashtu ka një gjendje të mirë fitosanitare.

➤ Bimët mjekësore aromatike të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje

Zonat malore të vendit tonë përfaqësojnë habitate të rëndësishme për llojet aromatiko-mjekësore të rralla. Bimët mjekësore dhe aromatike janë pjesë e atyre produkteve të biodiversitetit që mund të përdoren për përfitime ekonomike. Kohët e fundit, sektori i bimëve mjekësore po udhëhiqet nga kërkesat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Me qëllim që të mbështetet ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit për bimët mjekësore dhe aromatike, ekziston nevoja për të rritur njohuritë e atyre që janë të përfshirë në mbrojtjen, administrimin por edhe atyre që bëjnë pjesë në sektorin privat e që janë pjesë e zinxhirit të produktit.

Tabela.19 Sherebela (*Salvia officinalis*), statusi i kërcënimit VU A1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Qafa e Muzinës,	Delvinë	Gjendja vegetative dhe fitosanitare e sherebelës paraqitet e mirë. Kjo sepse edhe presioni i ushtruar nga faktori human ka qenë më i pakët.
Qafa e Llogaras, 50 metra poshtë lokal Sorkadhe	Vlorë	Gjendja vegetative dhe fitosanitare e sherebelës paraqitet e mirë.
Qafa e Llogaras	Vlorë	Gjendja vegetative e kulturës së sherebelës në këtë sipërfaqe paraqitet e dobët.
Leskovik	Kolonjë	Gjendja vegetative dhe fitosanitare e kulturës së sherebelës në këtë sipërfaqe paraqitet e mirë.
Mali Partizan	Berat	Gjendja vegetative dhe fitosanitare është mesatare. Si pasojë e grumbullimit të bimëve të sherebelës jashtë normave dhe kritereve teknike gjendja e saj paraqitet disi e dëmtuar.
Tërpan (Lapidari)	Berat	Gjendja vegetative dhe fitosanitare është e mire.
Mali i Miçanit	Skrapar	Gjendja vegetative është e mire ndërsa fitosanitare paraqitet e dëmtuar. Kultura e sherebelës në këtë sipërfaqe po shkon drejt degradimit si rezultat i grumbullimit të saj.
Krastë	Martanesh	Gjendja vegetative dhe fitosanitare është e mirë .
Kallmet , Lugina e Manhatisë	Lezhë	Gjendja vegetative është e mirë. Gjendja fitosanitare e sherebelës është mesatare.. Vihen re disa dëmtime mekanike të cilat vijnë si pasojë e grumbullimit pa zbatuar të gjitha rregullat teknike të vjeljes.
Fushe Arrëz (Ducaj)	Shkodër	Lloji sherebelë ka një gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare.

Tabela 20. Çaji i Malit (*Sideritis raeseri*), statusi i kërcënimit EN A1c

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zonën e Prespës, Qafa e Bigllës	Pustec	Ka gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare. Megjithëse kjo zonë bën pjesë në kategorine e dytë të I.U.C.N, kategori e cila i takon statusit të Parkut Kombëtar, është vënë re se grumbullimi i kulturës ë Çajit të malit kryhet masivisht.
Dropull, Dervican	Gjirokastrë	Gjendja fitosanitare dhe vegetative, paraqiten shumë e mirë. Numri i bimëve është i lartë.
Pepellash	Kolonjë	Gjendja e kulturës së Çajit të malit paraqitet e mirë.

Tabela 21. Salepi (*Orchiss. Sp*) statusi i kërcënimit VUA1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zonën e Prespës, Llofka e kuqe	Pustec	Lloji salep ka gjendje mesatare vegjetative dhe gjendje të mirë fitosanitare.
Kepi i Rodonit (pas kishës)	Durrës	Nga verifikimi rezulton se gjëndja vegjetative është mesatare ndërsa ajo fitosanitare është e mirë.
Erind	Libohovë	Lloji salep se ka gjendje të mirë vegjetative dhe fitosanitare.

Tabela 22. Xhironull (*Colchicum autumnale*) statusi i kërcënimit EN A1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zona e Ballabanit	Përmet	Bimët kanë një gjendje të mirë vegjetative dhe gjendje të kënaqshme fitosanitare. Ka një rritje të lehtë të numrit të bimëve.

Tabela 23. Boronica (*Vaccinium myrtillus*) statusi i kërcënimit VUA2b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Bjeshkët Çeremit	Tropojë	Gjëndja vegjetative dhe fitosanitare e boronicës në këtë sipërfaqe monitoruese paraqitet shumë e mirë.
Lurë	Dibër	Gjëndja vegjetative dhe fitosanitare është e mirë. Numri i bimëve në këtë sipërfaqe të re paraqitet i lartë.
Shpellë Lushkës	Pogradec	Gjëndja vegjetative dhe fitosanitare është e mirë .

7.3 Rekomandime

Sugjerohet që të shfrytëzohen të gjitha të dhënat e grumbulluar dhe përpunuar sipas metodologjisë për paraqitjen e gjëndjes dhe hartografimi (GSI) të llojeve të eksploruar dhe i rritit të konservimit të burimeve gjenetike për llojin Ah dhe Mështekë.

Gjendja shëndetësore e pyjeve

- Mbatja nënkontroll e sëmundjeve dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjës është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.
- Kryerja e një studimi të hollësishëm për të përcaktuar të gjitha sipërfaqet dhe drurët e tharë nga ekstremet e temperaturave për llojet ekualipt, palma dhe mimosa si dhe rekomandimin e duhur për zvëndesimin e këtyrë drurëve të tharë.
- Marja e një studimi të hollësishëm për përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes së llojit rrap, dushk dhe plep.

- Identifikimi i të gjitha sipërfaqeve të llojeve të pishëve mesdhetare të prekura nga dëmtuesi i procesionares së pishës si dhe marrja e masave për mbajtjen nën kontroll të këtyre dëmtuesit.
- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar kjo me ruajtjen e parazitëve dhe larvave të dëmtuesit për luftimin e dëmtuesit të grrezës aziatike që dëmton gëshjtënjën.
- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar) për luftimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të llojit bush.
- Marja e një studimi të hollësish për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të përshkuar dhe të djegura nga zjaret në vitete e mëparshme që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale.
- Marjen e masave për parandalimin e fenomeneve të zjareve si; ndërjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënia parapërgjegjësisë të gjithë kundravajtësit që shkaktojnë zjaret, etj.

Speciet drunore dhe bimët mjekësore aromatike në rrezik kërcënimi apo zhdukjeje

- Grumbullimi i farave të specieve drunore nga këto pika monitorimi dhe prodhimi i fidanëve për pyllëzim të këtyre llojeve në arealin e përhapjes së tyre, do të ndihmonte në ruajtjen dhe shtimin e tyre në të ardhmen.
- Në vendet ku takohen llojet drunore të vihen tabela informuese për vlerat dhe kujdesin që duhet
- treguar ndaj këtyre llojeve, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e tyre.
- Kufizimi i grumbullimit të bimëve mjekësore aromatike.
- Sensibilizimi i komunitetit ku grumbullohen bimët mjekësore aromatike, përmes vendosjes së tabelave për rëndësinë e tyre dhe shkallën e kërcënimit për zhdukje.
- Hartimi i një strategjie për ruajtjen dhe përdorimin e burimeve bimore lokale në shkallë kombëtare dhe sidomos i atyre specieve që janë në rrezik zhdukjeje.

Biodiversiteti

- Të kryhet inventarizimi i florës dhe faunës.
- Të zbatohet udhëzuesi për metodikat e inventarizimit të florës dhe faunës.
- Monitorimi brenda territorit të Zonave të Mbrojtura ka disa vite që kryhet. Rekomandohet të realizohet monitorimi edhe jashtë territorit të Zonave të Mbrojtura.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrisë nr 1280, date 20.11.2013 “Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër”, sugjerojmë që të ketë monitorim të këtyre llojeve nga AKZM për territorin brenda Zonave të Mbrojtura dhe kontrata monitorimi me ekspertë dhe institucione të fushës për llojet e listës së kuqe, për të mundësuar grumbullimin e të dhënave dhe trendin e popullatave të këtyre llojeve ndër vite.

KAPITULLI 8

MENAXHIMI I MBETJEVE

KAPITULLI 8

MENAXHIMI I MBETJEVE

8.1 Të përgjithshme

Mbetjet bëhen të vlefshme kur menaxhohen si duhet. Menaxhimi i duhur sjell përfitime ekonomike dhe mbron mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Burimet e të dhënave për këtë raport janë marrë nga disa institucione publike, përfshirë:

- Njësitë e Qeverisjes Vendore
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për qëllimin e raportimit, mbetjet e ngurta përkufizohen si materiale, objekte, ose pjesë të tyre që nuk përdoren më ose që pronari ka për qëllim t'i hedhë. Këto materiale, objekte, ose pjesë të tyre konsiderohen mbetje për aq kohë sa materialet e nxjerra ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

Raporti Vjetor i Mbetjeve për vitin 2023 ofron një analizë të plotë të praktikave dhe trendeve të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, duke ndriçuar përparimet dhe sfidat në arritjen e qëllimeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve. Si në vitet e mëparshme, ky raport bazohet në të dhëna të mbledhura nga burime qeveritare dhe institucionale, duke reflektuar angazhimin e Shqipërisë për transparencë dhe llogaridhënie në raportimin e mbetjeve.

Në qendër të këtij raporti është çështja e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, që shërben si bazë për vendimmarrjen politike. Bazuar në informacionin e mbledhur nga njësitë e qeverisjes vendore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, dhe Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të gjenerimit, përbërjes dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin. Përmes analizës dhe interpretimit rigoroz të të dhënave, ky raport synon të identifikojë trendet, sfidat dhe mundësitë në peizazhin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Duke adresuar boshllëqet në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, ne mund të përmirësojmë saktësinë dhe besueshmërinë e vlerësimeve të ardhshme të mbetjeve, duke hedhur bazat për politikëbërjen e bazuar në prova dhe ndërhyrjet e synuara për të përmirësuar rezultatet e menaxhimit të mbetjeve.

8.1 Gjendja dhe tendenca

8.1.1 Mbetjet bashkiake


Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe kalimi në Ekonomi Qarkulluese mbeten një përparësi e ngutshme për Shqipërinë. Duke përdorur njohuritë e fituara nga Raporti Vjetor i Mbetjeve për vitin 2023, palët e interesuara në të gjitha nivelet mund të punojnë së bashku për të zhvilluar zgjidhje inovative në reduktimin e mbetjeve, për të promovuar riciklimin dhe eficiencën e burimeve, dhe për të mbrojtur mjedisin për brezat e ardhshëm.

Për vitin 2023, vetëm 39 bashki kanë raportuar menaxhimin e mbetjeve, ku theksojmë se ka pasur disa mospërputhje në të dhënat e raportuara dhe kjo paraqet një mundësi të vlefshme për përmirësim për vitet në vijim. Angazhimi i treguar nga këto bashki për të punuar së bashku për të siguruar që të gjithë treguesit e kërkuar të raportohen saktë është i vlerësuar.


Për vlerësimin e gjendjes së mbetjeve 2023, u vendos të përdoren të dhënat vetëm për bashkitë që raportuan. Ky përfundim vjen nga disponueshmëria e kufizuar e të dhënave të raportimit dhe konsistenca e vërejtur në modelet e gjenerimit të mbetjeve gjatë gjithë vitit 2023. Si rezultat paraqiten të dhëna për mbetjet e gjeneruara vetëm për bashkitë që kanë sasi të më të mëdha të gjenerimit të mbetjeve.

Sasia e mbetjeve bashkiake të gjeneruara nga 15 bashki me vlerat më të larta për vitin 2023, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 1. Gjenerimi i mbetjeve bashkiake, 2023



Grafiku 2. Grumbullimi i mbetjeve kg/person/ditë



Tirana është bashkia me gjenerimin më të lartë të mbetjeve, duke arritur 244,787 ton, shumë më tepër se bashkia e dytë, Durrësi, me 55,306 ton. Kjo tregon një përqendrim të lartë të gjenerimit të mbetjeve në kryeqytet. Bashki të tjera si Fieri, Vlora dhe Shkodra gjithashtu kanë nivele të konsiderueshme të gjenerimit të mbetjeve, por janë shumë më të ulëta në krahasim me Tiranën. Kjo tregon se zonat urbane më të mëdha kanë nivele më të larta të mbetjeve për shkak të dendësisë së popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike.

Përsa i përket shkallës së mbledhjes së mbetjeve për person në ditë (kg/person/ditë), vlerësohet se Vora është bashkia me mbledhjen më të lartë për frymë, me 1.17 kg/person/ditë, ndjekur nga Fieri 0.94 kg/person/ditë dhe Tirana me 0.93 kg/person/ditë. Bashki të tjera si Himara dhe Saranda gjithashtu tregojnë shkallë relativisht të larta të mbledhjes për frymë. Nga ana tjetër, bashki si Maliqi, Tropoja dhe Kamza kanë shkallët më të ulëta të mbledhjes, me vlera rreth 0.51 kg/person/ditë.

Tabela 1. Tendenca e gjenerimit të mbetjeve bashkiake sipas qarqeve (në kg)

Qarku	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
Shkodër	44,228,580	46,250,000	31,790,750	40,738,000	42,021,840	42,175,000	
Lezhë	4,288,000	24,118,250	-	21,593,000	33,182,600	28,126,000	
Kukës	9,698	10,138,000	-	14,009,000	27,031,000	11,485,000	
Dibër	7,200,000	18,946,000	-	18,833,000	22,994,000	10,479,000	
Tiranë	226,584,000	514,003,950	465,152,779	341,849,671	367,721,200	303,678,000	
Durrës	152,940,640	114,924,000	10,299,000	72,576,000	83,065,096	67,977,000	
Elbasan	42,161,000	38,847,870	43,645,393	48,190,780	42,048,900	42,290,000	
Fier	33,016,450	200,000	20,513,731	120,053,661	89,525,650	75,350,000	
Berat	15,855,400	41,587,000	-	35,216,000	24,518,829	17,678,000	
Korçë	46,598,000	16,960,000	80,471,859	48,813,840	47,800,860	44,299,000	
Vlorë	70,921,260	171,860,510	73,087,884	75,522,710	93,977,910	51,533,000	
Gjirokastrë	2,537,000	4,467,000	-	19,342,900	14,130,500	10,365,000	
TOTAL	646,340,028	1,002,302,580	792,519,781	856,738,562	888,018,385	705,435,000	

Tabela dhe grafiku përkatës tregojnë gjenerimin e mbetjeve komunale për rajonet e Shqipërisë nga viti 2017 deri në 2023. Çdo rajon paraqet një trend të ndryshëm në gjenerimin e mbetjeve, që mund të analizohet për të kuptuar më mirë zhvillimet dhe ndryshimet e mundshme në menaxhimin e mbetjeve në këto zona.

- Berat:** Rajoni i Beratit tregon një trend të qëndrueshëm deri në vitin 2020, me një rënie të lehtë më pas dhe një rikuperim të lehtë në vitin 2022.
- Dibër:** Rajoni i Dibrës ka përjetuar disa luhajtje, me një rritje të theksuar në vitin 2019, ndjekur nga një rënie e vazhdueshme.
- Durrës:** Gjenerimi i mbetjeve në Durrës ka qenë relativisht konstant, me një rënie në vitin 2020 dhe një rikuperim në vitet pasuese.
- Elbasan:** Elbasani tregon një rënie të konsiderueshme në vitin 2020, ndjekur nga një rritje e lehtë dhe stabilizim.

5. **Fier:** Fieri ka një trend të qëndrueshëm në rritje të mbetjeve, duke arritur kulmin në vitin 2021 dhe duke rënë lehtë në vitin 2022.
6. **Gjirokastër:** Gjirokastra paraqet luhatje të konsiderueshme, me një rritje të madhe në vitin 2021 dhe një rënie në vitin 2022.
7. **Korçë:** Korça tregon një rënie të mprehtë në vitin 2020, ndjekur nga një rikuperim i lehtë dhe stabilizim.
8. **Kukës:** Kukësi tregon një trend në rritje me luhatje të lehta, duke treguar stabilitet në vitin 2022.
9. **Lezhë:** Rajoni i Lezhës tregon një trend të ngadaltë në rritje, me disa rënie dhe rikuperime gjatë viteve.
10. **Shkodër:** Shkodra ka përjetuar rënie dhe rritje të lehta, duke treguar një trend të qëndrueshëm gjatë viteve.
11. **Tiranë:** Gjenerimi i mbetjeve në Tiranë kishte një trend në rritje deri në vitin 2020, me një stabilizim pasues.
12. **Vlorë:** Vlora tregon një trend të ngjashëm me qarqet e tjera, me një rritje të madhe në vitin 2021 dhe një rënie të lehtë në vitin 2022.

Nga analiza e të dhënave dhe trendeve të mbetjeve nëpër rajone të ndryshme, vërehet se shumë rajone kanë përjetuar luhatje të mëdha gjatë viteve, që mund të jenë rezultat i faktorëve të ndryshëm si ndryshimet në popullsi, zhvillimet ekonomike dhe politikat e menaxhimit të mbetjeve. Efektet e pandemisë COVID-19 në vitet 2020-2021 janë gjithashtu të dukshme në disa rajone, duke ndikuar në gjenerimin e mbetjeve. Stabilizimi i trendit në vitin 2023 tregon një adaptim dhe normalizim të situatës në pjesën më të madhe të vendit.

8.1.1 Transferimi i mbetjeve industriale

Në mbështetje të VKM Nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, të ndryshuar, VKM Nr. 371, datë 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, të ndryshuar, si dhe Urdhërit të Ministrit të Mjedisit Nr. 135 datë 16.04.2015 “Për Miratimin e Mënyrës së Administrimit të Formatit të Rregjistrimit të Transfertave Individuale dhe të Rregjistrimit Kombëtar të Transfertave si dhe Mënyrën e Administrimit të tyre”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson rregjistrin e transfertave të mbetjeve të kompanive që janë të pajisura me Kod Unik.

Tabela 2. Transferimi i mbetjeve për 2023 nga subjekte të pajisur me Kod Unik

Kodi i mbetjes	Përshkrimi i mbetjes	Viti 2023 (kg)
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues	10100
17 05 04 17 01 07	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 /Përzjerje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06	1 499 700
20 01 01	Letër dhe karton/ Mbetje nga pastrimi i rrugëve / Mbetjet e përziera urbane	97940
20 03 03		
20 03 01		
20 01 40	Metalet	415,198

01 04 08 20 02 02	Mbetje zhavorri dhe mbetje gurësh të tjera nga ato të përmendura në 01 04 07 /Dhera dhe gurë	4180
01 05 05*	Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet për naftë hidrokarbure	6803670
01 05 06*	Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet që përmbajnë substanca të rrezikshme	1531760
01 05 07	Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë kripëra të bariumit, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 05 dhe 01 05 06	216000
01 05 08	Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë klorure, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 06	2365940
02 02 02	Mbetje që vijnë nga indet shtazore	21 020
02 02 03	Lengje frutash	43896
02 03	duhan/cigare	53.5
02 03 04	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim	2226.12
03 01 05	Pluhur sharre, ashklat, copa prej druri, panele me materiale grimcore dhe me pllaka, të tjera nga ato të përmendura në 03 01 04	2200
04 01 01	Mbetje nga rrjepjet dhe prerjet	17560
04 02 09 02 03 04 04 01 08 (D5-LANDFILL)	Materiale të përziera (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere/ Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim / Mbetje të lëkurës së regjur (preje, kanale, mostrime, pluhura nga përpunimi) që përmbajnë krom	834850
05 01 03*	Llumra të fundit të depozitave	5 740 880
07 05 13* EKS	Mbetje të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme	700
04 02 22 (D5-LANDFILL)	Mbetje të fibrave tekstile të përpunuara	145 090
08 01 11*	Mbetje të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme	9410
08 03 18	Mbetje nga boja e printit, të tjera nga ato të përmendura në 08 03 17	9.03
10 02	Mbetje nga industria e hekurit dhe e çelikut	78105
10 02 02/ 10 02 01	Skorie e papërpunuar / Mbetje nga përpunimi i skorieve	10359000
10 02 07*	Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme	8611000
10 03 08*	Zgjyra kripore dhe prodhim dytesor	726060
10 04	Mbetje nga metalurgjia termike e plumbit	15265
11 01 16*	Acide të tjera të paspecifikuara	16150
12 01 01	Tallash të metaleve ferore	114 340
12 01 05, 04 01 09, 04 02 22, 16 01 17, 16 01 19, 20 01 01	Kode të përziera	5560
12 01 06*	Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjenë (përveç emulsioneve dhe solucioneve)	189 660
12 01 12*	Parafinat dhe Yndyrnat e shpezuara	17 040

13 01 10*	Vaj hidraulik i paklorinuar me bazë minerale	31 632
13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të paklorinuar me bazë minerale	86 720
13 02 08*	Vajra të tjera Motori ingranazhi delubrifikante	6050
13 04 03*	Vajra të ndotura nga lundrime të tjera	6 612 771
13 05 08*	Përzjerje mbetjesh nga seperatorët ujë/naftë	14 184 186
13 08 99*	Mbetje te tjera te paspecifikuara	3400
15 01	Ambalazh	1993
15 01 01	Mbetje Ambalazhi Letre dhe Kartoni	11928559
15 01 01/ 19 12 01	Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni /leter dhe karton	826457
15 01 02	Mbetje ambalazhi plastike	8390
15 01 04	Mbetje ambalazhi metalike	834847
15 01 05	Mbetje ambalazhi	8870
15 01 07	Mbetje ambalazhi qelqi	27 666
15 01 10*	Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	3259
15 01 10* EKS	Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	3170
15 02 02*	Absorbente, material filtrues (duke përfshirë filtra naftë të paspecifikuar) dhe rroba mbrojtëse të kontaminuara nga substanca të rrezikshme	12 688
150104;160117;1704;020110;16 01 18	Mbetje ambalazhi metalike / Filtra vaji, naftë /Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve) /Mbetje metalike /Metale joferrore	25 617 422
16 01 03	Goma jashtë përdorimit	25700
16 01 04*	Mjete jashtë përdorimit	720
16 01 07*	Filtra vaji, naftë	1600
16 01 07* EKS	Filtra vaji, naftë	870
16 01 17	Metale ferore	16120
16 01 19	Plastika	1203795
16 03 04	Mbetje inorganike që përmbajnë substanca ndryshe nga ato të 16 03 03	2140
16 06 01*	Mbetje bateri makinash	951 240
16 06 04	Bateri alkaline (përveç 16 06 03)	2980987
16 06 05	Bateri dhe akumulatorë të tjerë	25 393
17 04 01	Bakër, bronz, tunxh	1221970
17 04 01/17 04 04	Bakër, bronz, tunxh / Zink	174 324
17 04 02	Alumin	5511145
17 04 02/17 04 01	Alumin/ Bakër, bronz, tunxh	27545
17 04 03	Alumb	8210
17 04 04	Zink	75852
17 04 05	Hekur dhe çelik	264033
17 05 04	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03	16 736 910

17 08 01*	Materiale ndërtimi me gips qe jane te kontaminuara me substanca te reikshme	200
17 08 02	Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01	23180
17 09 04	Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03	16 849 680
18 01 01	Bisuritë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)	2 409.55
18 01 01 18 01 02 18 01 03	Bisuritë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) /Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03) / Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	28918
18 01 01 18 01 03	Bisuritë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)/Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	782583.22
18 01 02	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)	38696.79
18 01 02*	Medikamente citostatike dhe citotoksike	5710.9
18 01 03*	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	276295.08
18 01 04	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (p.sh. fasha, gips, çarçafë, veshje njëpërdorimëshe, pelena etj.)	3121.3
18 01 04 18 02 01	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (p.sh. fasha, gips, çarçafë, veshje njëpërdorimëshe, pelena etj.) /Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)	76609.2
18 01 08*	Medikamente citostatike dhe citotoksike	1273.3
18 01 09	Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08	56580.75
18 02 01	Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)	645
18 02 01 18 01 02	Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)/Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)	5
18 02 01 18 02 02	Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02) / Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	274

18 02 02	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	332
19 01	Mbetje nga iceneratorët ose piroliza e mbetjeve	580
19 01 11*	Hira fundore dhe numra që përmbajnë substanca të rrezikshme	27.85
19 01 13*	Hi fluturues qe permban substance te rrezikshme	3324.8
19 01 19 01 11* 19 01 12	Mbetje nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve/Hira fundore dhe numra qe permbajne substance te rrezikshme/Hira fundore dhe numra te tjera te tjera nga ato te permendura ne 19 01 11	380
19 03	Mbetje të stabilizuara të ngurtësuar	540220
19 03 05	Mbetje te stabilizuara te tjera nga ato te permendura ne 19 03 04	105060
19 03 19 03 05 19 03 04	Mbetje te stabilizuara te ngurtesuara/Mbetje te stabilizuara te tjera nga ato te permendura ne 19 03 04/ Mbetje te percaktuara sit e rrezikshme,pjeserisht te stabilizuara	106240
19 08 14	Llumra nga trajtime te tjera te ujerave te ndotura industriale te tjera nga ato te permendura ne 19 08 13	158520
19 12 01	Letër e karton	4463328.3
19 12 02	Metale ferore	78820
19 12 02/19 12 03	Metale ferore /metale joferore	101 240
19 12 03	Metale joferore	34 244
19 12 04	Plastik dhe gomë	1645849
19 12 11*	Te tjera mbetje (perfshire materiale te perziera) nga trajtimi mekanik I mbetjeve qe permbajne substanca te rrezikshme	460
20 01	Fraksionet e ndara (përveç 15 01)	10420
20 01 01	Letër dhe karton	3995019.8
20 01 01/20 03 01	Letër dhe karton / Mbetjet e përziera urbane	3420
20 01 02	Qelq	572020
20 01 11	Tekstilet	642220
20 01 25	Vajra dhe dhjamëra ushqimore	645193.3
20 01 33*	Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë	20
20 01 33* EKS	Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë	80
20 01 36	Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35	1086
20 01 38	Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37	38566
20 01 39	Plastikët	7547622.9

20 01 39 /19 12 03	Plastiket/ Metale joferrare	4 240
20 01 39/19 12 01	Plastike+leter	766.2
20 01 39/19 12 04	Plastikët /Plastike dhe gome	199 040
20 01 11/04 01 99/ 04 02 21/04 02 22	Tekstilet/Mbetje të tjera të paspecifikuara/Mbetje të fibrave tekstile të papërpunuara/Mbetje të fibrave tekstile të përpunuara	24040
20 01 40/17 04 05/15 01 04	Metalet / Hekur dhe çelik / Mbetje ambalazhi metalike	100 000
20 02 02	Dhe	81800
20 03 01	Mbetjet e përziera urbane	24781030
20 03 01 (d5-landfill)	Mbetjet e përziera urbane	716760
20 03 01/20 01 99	Mbetjet e përziera urbane / fraksione të tjera të paspecifikuara	4811.6
20 03 01/20 03 99	Mbetjet e përziera urbane /Mbetjet urbane të paspecifikuara	141110
20 03 03	Letër dhe karton/ Mbetje nga pastrimi i rrugëve / Mbetjet e përziera urbane	97940
20 03 04	Llumra nga gropat septike	11104882
20 03 06	Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza	176825
20 03 06/ 20 03 04	Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza /Llumra nga gropat septike	1444396
20 03 07	Mbetjet të vëllimshme	2540
20 03 99	Mbetjet urbane të paspecifikuara	31809192
20 03/20 03 01/20 03 99	Mbetje të tjera urbane/ Mbetjet e përziera urbane /Mbetjet urbane të paspecifikuara	48280
19 12 04	Plastike dhe gome	5540
20 01 39	Plastike	15288
13 01	Mbetje vajore (hidrokarbure) te perpunuara	660000
04 02 09/02 03 04/04 01 08 (d5 landfill/incinerator)	Materiale të përziera (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere) /Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim/Mbetje të lëkurës së regjur (preje, kanale, mostrime, pluhura nga përpunimi) që përmbajnë krom (d5 landfill/incinerator)	151800
04 02 22	Mbetje të fibrave tekstile të përpunuara	24660
03 03 08	Mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonëve të destinuar për riciklim	87300
15 01 04	Mbetje ambalazhi metalike	100940
15 01 02/15 01 09	Mbetje ambalazhi plastike/Mbetje ambalazhi tekstili	13320
04 02 09 (d5-landfill)	Materiale të përziera (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere)	96380
17 02 01	Dru	2900
19 01 12	Hira fundore dhe numra, të tjera nga ato të përmendura në 19 01 11	260
19 12 01/15 01 01	Letër e karton/Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni	406171
04 01 08	Mbetje të lëkurës së regjur (preje, kanale, mostrime, pluhura nga përpunimi) që përmbajnë krom	52480
20 01 01/02 03 04	Letër dhe karton/Lëndë të papërshtatshme për konsum apo	33

	përpunim	
20 03 01 (d5 landfill/incinerator)	Mbetjet e përziera urbane (d5 landfill/incinerator)	202990
Total		72,229,628

Gjatë vitit 2023 janë krijuar dhe transferuar rreth 72,230 ton mbetje në total (mbetje të rrezikshme e të parrezikshme. Kjo sasi mbetjesh e transferuar në vitin 2023 është më e ulët krahasuar me vitin 2022 ku janë transferuar rreth 237,000 ton.

Nga analiza e të dhënave, rezultojnë një strukturë e mirë-përcaktuar për klasifikimin, raportimin dhe trajtimin e mbetjeve në Shqipëri për vitin 2023. Proçedurat e dorëzimit dhe kërkesat për raportim janë të qarta, duke siguruar mbledhjen e saktë të të dhënave për secilën kategori mbetjesh. Për më tepër, menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe përpjekjet për një ekonomi rrethore theksohen si elementë kyç për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e emetimeve të gazrave serrë.

8.1.2 Mbetjet nga nënproduktet shtazore

Referuar të dhënave të raportuara nga Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve rezultojnë se në vitin 2023, sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve është rreth 4,930 ton/vit.

Tabela. 3. Mbetjet nga produktet e kafshëve, 2023


Qarku	Kodi i katalogut shqiptar	Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve kg/vit
Tiranë	Mbetjet nga produktet e kafshëve 02 01 02	2634518
Durrës		149320
Shkodër		38007
Vlorë		2278.1
Elbasan		657086
Korçë		349359
Fier		590679
Gjirokastrë		3178
Lezhë		258423
Dibër		31300
Berat		215760
Kukës		600
Total		4,930,508

Sasia më e madhe e gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve rezultojnë në qarkun Tiranë me 2634518 kg/vit ndërsa sasia më e ulët është në qarkun Kukës 600 kg/vit.

Tabela 4. Tendencat e gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve, kg/vit

Qarku	2021	2022	2023
Tiranë	1760300	2555299	2634518
Durrës	0	30000	149320
Shkodër	1500	2500	38007
Vlorë	0	0	2278.1
Elbasan	319303	664364	657086
Korçë	152990	438460	349359
Fier	65765	508728	590679
Gjirokastrë	0	0	3178
Lezhë	6971	59079	258423
Dibër	5480	20440	31300
Berat	125012	213880	215760
Kukës	0	0	600
Total	2,437,321	4,492,750	4,930,508

Referuar të dhënave vlerësohet se kemi tendencë në rritje nga viti në vit të gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve për të gjitha qarqet. Kjo reflektohet edhe në tendencën e gjenerimit të sasisë totale, ku për vitin 2023 kemi një sasi më të madhe të mbetjeve nga produktet e kafshëve, krahasuar me vitet e mëparshme.



8.1.3 Mbetjet nga bujqësia

Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe i produkteve plehëruese në bujqësi përveç funksionit pozitiv të mbrojtjes dhe rritjes së bimëve kanë edhe ndikim negativ në tokë dhe mjedis. Ujërat e vaditjes transportojnë përmbajtje të kimikateve që vijnë si rezultat i përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe të produkteve plehëruese kimike dhe shkaktojnë në mjedis.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet situata e sasisë së mbetjeve që gjenerohen nga përdorimi i pesticideve, plehrave kimike si dhe nga farat bimore. Një pjesë e produkteve me origjinë shtazore dhe joshstazore asgjësohen në vend-depozitime të caktuara.

Tabela 5. Mbetjet e gjeneruara nga bujqësia, 2023

	Sasia e mbetjeve nga plehra kimike dhe pesticideve të skaduara nga përdorimi në bujqësi Kg/ton në vit	Sasia e mbetjeve bimore	Sasia e mbetjeve farmaceutike bujqësore kg/ton në vit	Sasia e mbetjeve të depozituara në Landfill Ton/Litra/Kokrra veze/në vit
Tiranë	-	-	-	(1830.86 ton/176848.97 litra/ 1005 kokrra veze + 0.083 ton duhan
Durrës	-	-	488.5 kg PMB	102.478 ton/ 6571260 kokrra veze
Shkodër	-	-	-	31.756 ton/ 1350 kokrra veze
Vlorë	1.05 kg / 7 litra PMB	-	-	0.78 ton
Elbasan	-	0.015 ton farë	-	25.472 ton
Korçë	-	-	-	0.852 ton/ 312.5 litra/633 kokrra veze
Fier	-	72.000 cope fidana	11 litra PMB dhe +81 kg 31.5 litra PP	80.384 ton / 9.32 litra
Gjirokastrë	-	0.5 ton farë	-	102.323 ton/ 178954.71 litra
Lezhë	-	10.02 ton farë	535.7 kg dhe 1.6 litra PMB	0.0288 ton
Dibër	-	-	-	-
Berat	-	-	7 litra PMB	0.0005 ton farë perime
Kukës	-	-	-	-
Total	1.05 kg / 7 litra PMB	10.535 ton farë + 72.000 cope fidana	1.024 kg PMB 19.6 litra PMB 31.5 litra PP	

Burimi: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

PMB-Produkte për mbrojtjen e bimëve (pesticide)

PP-Produkte plehëruese (plehëra kimike)

Ton-Produkte me origjinë shtazore dhe jo shtazore të asgjësuara në landfill

Litra-Produkte me origjinë shtazore dhe jo shtazore të asgjësuara në landfill

8.1.4 Mbetjet spitalore

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për mbetjet spitalore që gjenerohen apo menaxhohen nga qendrat spitalore sipas qarqeve. Këtu përfshihen mbetjet spitalore të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, mbetjet dentare, farmaceutike si dhe sasia e mbetjeve që depoziten në landfill apo trajtohen në incinerator.

Tabela 6. Mbetjet spitalore, 2023 (kg)

Qarku	Sasia e mbetjeve spitalore jo të rrezikshme kg/vit	Sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme + dentare kg/vit	Sasia e mbetjeve farmaceutike kg/vit	Sasia e mbetjeve të depozituara në lëndfill kg/vit	Sasia e mbetjeve të depozituara në incenerator kg/vit
Tiranë	741520	21182.7	-	1034629	7506.5
Durrës	-	25889.9	16.7	-	-
Dibër	-	17131	-	-	-
Elbasan	18000	28135	50	-	-
Korçë	1000	27910.6	160	-	-
Berat	-	18099.8	70	-	-
Shkodër	196345	15980	3421	-	-
Lezhë	80424	17186	-	-	-
Kukës	1000	14600	5.0	-	-
Vlorë	1650	-	-	-	-
Fier	-	31858.75	300	16300.3	-
Gjirokastrë	-	2914.9	22.5	-	-
Total	1039939	2208886.5	4045.2	1050929.3	7506.5

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

8.3 Rekomandime

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) njih rëndësinë e përputhjes me standardet e raportimit mjedisor të Bashkimit Evropian (BE) dhe përfitimet e një qasjeje të centralizuar përmes një Sistemi të Integruar Mjedisor nëpërmjet AKSHI-t. Ky sistem do të lehtësonte mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe raportimin, duke mundësuar një kuptim të plotë të trendeve mjedisore dhe duke promovuar transparencën.
- Për të përmirësuar menaxhimin e mjedisit, bashkëpunimi ndërmjet komunave, ministrive përkatëse dhe organizatave joqeveritare (OJQ) është thelbësor për ndarjen e të dhënave dhe praktikave më të mira. Ky bashkëpunim do të harmonizojë përpjekjet drejt një ekonomie qarkulluese, duke trajtuar mbetjet si burime të vlefshme dhe duke i reintegruar ato në ciklin ekonomik.
- Mekanizmat e standardizuar të raportimit dhe përmirësimi i aksesit në të dhëna janë thelbësorë për të përmbushur pritshmëritë ndërkombëtare. Nismat si Sistemi i Integruar Mjedisor përputhen me direktivat e BE-së dhe adresojnë prioritetet e brendshme.
- Monitorimi i progresit me indikatorët kyç, siç sugjerohet nga Komisioni Evropian, mundëson politikëbërësit të vlerësojnë performancën dhe të identifikojnë zonat që kanë nevojë për ndërhyrje. Një strukturë me dy nivele me indikatorë për të gjithë ekonominë dhe për zona prioritare specifike ofron një qasje strategjike.

- Një strategji kombëtare për një ekonomi qarkulluese duhet të prioritetizojë prodhimin e qëndrueshëm, konsumimin, parandalimin e mbetjeve dhe mbështetjen për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve komunale, me fokus në parandalimin e mbetjeve ushqimore dhe kufizimin e plastikave një përdorim (SUP). Objektivat e riciklimit për mbetjet e paketimit duhet të rriten ndjeshëm për periudhën 2025-2030, me objektiva shtesë për ripërdorim, riciklim dhe devijim nga landfilli. Vendosja e skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) për paketimin, Mbetjet Elektrike dhe Elektronike (WEEE) dhe kategori të tjera është thelbësore për organizimin, zbatimin dhe financimin e mbledhjes dhe riciklimit të mbetjeve prioritare, duke përfshirë letrën, kartonin, plastikën, qelqin, metalet, WEEE, bateritë dhe tekstilet.
- Prioritetizimi i mbledhjes së veçantë të rritur, kompostimit dhe tretjes anaerobike të mbetjeve organike, të mbështetur nga mekanizmat financiarë. Zgjerimi i shërbimit të mbledhjes së mbetjeve komunale në 95% të banorëve deri në vitin 2025 për të reduktuar hedhjen e paligjshme. Përdorni instrumente ekonomike, si taksat mbi landfillin për landfillin jo në përputhje, për të mbështetur parandalimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin. Përmirësoni kapacitetin e autoriteteve kombëtare me burime të mjaftueshme për të zbatuar kërkesat ligjore dhe pajisni nivelet lokale për të organizuar sisteme efektive të menaxhimit të mbetjeve.

KAPITULLI 9

KIMIKATET

KAPITULLI 9

KIMIKATET

9.1 Të përgjithshme

Kimikatet dhe mbetjet janë pjesë përbërëse e pothuajse të gjithë sektoreve të shoqërisë dhe menaxhimi i sigurt i kimikateve gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor është thelbësor për të shmangur rreziqet komplekse për shëndetin e njeriut, ekosistemet dhe mjedisit.

Kimikatet përfshijnë pothuajse të gjitha mallrat e prodhuara që na rrethojnë dhe përdoren e prodhohen më gjerësisht se kurrë më parë. Ndërsa kimikatet mbështesin mirëqënien tonë, ato, nëse përdoren dhe menaxhohen keq, mund të kërcënojnë shëndetin tonë dhe mjedisin si dhe zhvillimin tonë ekonomik. Kontrolli i kimikateve i adresohet industrisë dhe konsumatorit të kimikateve si pjesë e menaxhimit të shëndoshë të kimikateve dhe është një element jetik izhvillimit të qëndrueshëm të strategjive kombëtare. Nevoja për menaxhim të sigurt të kimikateve theksohet më tej nga rritja e vazhdueshme e prodhimit, tregtisë dhe përdorimit të kimikateve. Kjo ushtron një barrë në rritje, veçanërisht mbi vendet në zhvillim dhe vendet me ekonomi në tranzicionit, të cilat kanë më pak kapacitet për të adresuar këto sfida.

9.2 Situata për menaxhimin e kimikateve

Kimikatet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të produkteve që ne përdorim në jetën e përditshme. Ka mbi 100,000 substanca të ndryshme të kimikateve të cilat përdoren në një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve. Infrastruktura ligjore dhe institucionale shihen si shtyllë kryesore e përpjekjeve kombëtare drejt menaxhimit të sigurt të kimikateve, e cila përcakton rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesuara të përfshira, instrumentat që duhet të përdoren dhe për rrjedhojë shpërndarjen e kostove ndërmjet palëve të interesuara. Marrëveshjet e vendosura midis institucioneve i japin mundësi operative proceseve duke organizuar burimet e disponueshme (njerëzore, teknike, financiare) për vendimmarrje, implementimin, zbatimin dhe pajtueshmërinë.

Për të patur një menaxhim të qartë ndër-institucional mbi Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) me mbështetje të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA) hartuan Planin Kombëtar të Menaxhimit të Sigurt të Kimikateve, i cili konsiston në forcimin e kapaciteteve administrative në institucionet kompetente, në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit legjislativ kimik në Shqipëri me *acquis* të BE-së dhe ndërtimin e kompetencave dhe aftësive të burimeve njerëzore.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Sigurt të Kimikateve ka si qëllim kryesor menaxhimin e kimikateve nëpërmjet uljes së efekteve negative të tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Ky qëllim do të arrihet nga përfshirja e të gjithë aktorëve kryesor që kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e kimikateve nëpërmjet harmonizimit të legjislativimit të kimikateve, krijimit të sistemeve të sigurta të shkëmbimit të informacionit, krijimit të “*Help Desk*”, Qendrës së Helmimeve dhe ndërgjegjësimit të publikut.

Realizimi i këtij Plani do të arrihet nëpërmjet veprimeve konkrete të lidhura me:

- Përcaktimin e kufizimeve të prodhimit, vendosjes në treg dhe përdorimit të kimikateve, përdorimit të kimikateve në artikuj, importit dhe eksportit të kimikateve të caktuara;
- Lehtësimin e lëvizjes së lirë të kimikateve dhe mallrave të tjera, si dhe rritjen e konkurrencës dhe inovacionit;

- Kontrollin në mënyrën e duhur të rreziqeve nga substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC);
- Harmonizimin e legjislacionit të kimikateve në vendin tonë me Sistemin Global të Harmonizuar (SGH/GHS) për klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve dhe përaftrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së;
- Krijimin e një sistemi të detyrueshëm për klasifikimin, etiketimin, paketimin dhe Dokumentin me të Dhënat e Sigurisë për Kimikatet (MSDS) dhe mbështetjen e funksionimit dhe mirëmbajtjes së *regjistrit të kimikateve* që vendosen në tregun e brendshëm ose prodhohen për t'u eksportuar jashtë Shqipërisë.

Plani i Veprimit mbi Menaxhimin e Sigurt të Kimikateve prezanton situatën aktuale të vendit tonë dhe njëkohësisht drejton në veprimet konkrete që do të ndërmerren për implementimin e tij nga të gjithë aktorët e përfshirë në një periudhë kohore 5 vjeçare (2023 - 2028).

Janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në kuadër të harmonizimit me Rregulloren e BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH) dhe me instrumenta të tjerë. Në shkurt të vitit 2020, Shqipëria miratoi Konventën e Minamatës për Mërkurin. Në prill 2021, u miratua VKM nr. 222/2021 "Mbi miratimin e listës së substancave kandidatë", e cila ka sjellë në legjislacionin shqiptar 211 substanca dhe grup substancash të vlerësuara në aspektin e sigurisë kimike, në zbatim të legjislacionit të Bashkimit Evropian për kimikatet (REACH dhe CLP). Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020; "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", në korrik 2020, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) është ngritur Zyra e Kimikateve, si një detyrim ligjor dhe organ kryesor për zbatimin e legjislacionit të kimikateve dhe menaxhimin e tyre në Shqipëri.

Për t'i ardhur në ndihmë ngritjes së një helpdesku kombëtar mbi kimikatet, në AKM është krijuar dhe funksionon adresa e e-mail info.kimikatet@akm.gov.al. Gjithashtu janë ndërmarrë disa hapa pozitiv lidhur me transpozimin në legjislacionin kombëtar të Rregullores REACH Nr.1907/2006, i cili ka avancuar më tej me miratimin e:

1. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 15.05.2019, "Për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar si të rrezikshëm";
2. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 09.01.2019, "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbytja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë";

Në vijim të miratimit nga Parlamenti Shqiptar të Ligjit Nr. 7/2020, "Për miratimin e Konventës së Minamatës "Për mërkurin", prej datës 26 Maj 2020, Shqipëria listohet përkrah shteteve që kanë miratuar Konventën e Minamatës për Mërkurin, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të mërkurit.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 442, datë 26.06.2019, "Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të mërkurit metalik, komponimeve dhe përzjerjeve të caktuara të mërkurit, ruajtjes së sigurt të mërkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së mërkurit metalik të konsideruar si mbetje", i cili ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi mërkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008, CELEX: 32017R0852. VKM 442/2019, ka hyrë në fuqi prej datës 1 Janar 2020 dhe synon zbatimin e Konventës së Minamatës për Mërkurin.

Po ashtu Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 19.02.2020, "Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti", i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën e Këshillit 87/217/EEC datë 19 Mars 1987, Për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti, e amenduar.

Sipas Planit Kombëtar të Integritimit Europian, prioritetet e MTM për vitin 2023 e në vijim për menaxhimin e kimikateve janë:

- Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e projektit në “Mbështetje për MTM për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve” dhe planit vjetor të punës;
- Ofrimin e mbështetjes teknike për Zyrën e Kimikateve për të siguruar funksionimin e duhur dhe zbatimin e legjislacionit për kimikate;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kimikateve dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë.

Projekti “Mbështetje për MTM për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve” ka nisur në Mars 2019 dhe realizohet nga KEMI me mbështetjen financiare të SIDA (Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim) për një periudhë 5-vjeçare. Projekti po kontribuon në rritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative të autoriteteve kompetente shqiptare për legjislacionin e kimikateve.

Plani i zhvilluar nga KEMI në bashkëpunim me autoritetet shqiptare ofron një listë treguese të aktiviteteve të ardhshme dhe fokusohet në mbështetjen e hartimit të legjislacionit kombëtar për produktet kimike dhe biocide duke vijuar me ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe inspektorëve pranë AKM. Për më tepër, ai parashikon angazhimin e palëve të interesuara dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit publik (p.sh. përgatitjen e materialeve informative për të rritur ndërgjegjësimin e industrisë, mbështetje për një takim informues me palët e interesuara të industrisë ose krijimin e një tavoline ndihmëse për industrinë). Së fundi, KEMI (Agjensia Suedeze e Kimikateve) do të ofrojë mbështetje në vlerësimin e parakushteve për krijimin e rregjistrit kombëtar për kimikate.

Plani Rajonal i Veprimit CBRN (Kimike, Biologjike, Radiologjike dhe Bërthamore) për Evropën Juglindore (2022-2027) mbi kërcënimet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN) përfshirë dhe armët e shkatërrimit në masë, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria ka si objektiv të përmirësojë aftësitë rajonale të zbutjes së rrezikut CBRN.

Baza ligjore mbi të cilën operon zyra e kimikateve është:

- Ligji Nr. 27/2016 për “Menaxhimin e Kimikateve”;
- Vendim Nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”;
- Vendim Nr. 665, datë 21.9.2016 “Për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme”;
- Vendim Nr. 319, datë 15.5.2019 “Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”;
- Vendim Nr. 161, datë 19.2.2020 “Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti”;
- Ligj Nr.10 277, datë 13.5.2010, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”;
- Ligj Nr. 9263, datë 29.7.2004 “Për miratimin e Konventës së Stokholmit Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”;
- Vendim Nr. 360, datë 29.4.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”;

- Vendim Nr. 442, datë 26.6.2019 “Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të mërkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të mërkurit, ruajtjes së sigurt të mërkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së mërkurit metalik të konsideruar si mbetje”;
- Vendim Nr. 222 datë 07.04.2021 “Për miratimin e Listës së Substancave Kandidate”;
- Vendim Nr. 489, datë 29.6.2016 “Për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) e të kriterëve për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimin e një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-ve”;
- Vendim Nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikateve, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”;
- Ligj Nr.10 277, datë 13.5.2010 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit “Mbi procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare”;
- Ligj Nr. 7/2020 “Për miratimin e Konventës së Minamatës Për Mërkurin”;
- Vendim Nr. 222 datë 07.04.2021 “Për miratimin e Listës së Substancave kandidatë”;
- Ligj Nr. 95/2015 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”;
- Vendim Nr. 553, datë 27.7.2016 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të komisionit të autorizimit të produkteve biocide”;
- Vendim Nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”;
- VKM Nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”;
- Vendimi Nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve” ky vendim duhet pasqyruar në faqen zyrtare të QKB në vend të vendimit nr. 100 datë 03.02.2008 “për përcaktimin e substancave të rrezikshme”, ndryshuar me VKM 402, datë 30.06.2021” për miratimin e katalogut të mbetjeve”;
- Ligji Nr. 105/2016 datë 27.10.2016 “Për Mbrojtjen e Bimëve” i ndryshuar dhe aktet nën ligjore;
- Ligji Nr.17/2020 datë, 17.02.2020 “Për Produktet Plehëruese” dhe aktet nën ligjore;
- Ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ka për qëllim zvogëlimin e risikut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile. Ky ligj rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Ky ligj është përafuar pjesërisht, me Direktivën e vitit 2012/18/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme,që ndryshon dhe më pas shfuqizon direktivën e Këshillit 96/82/KE.

Në zbatim të ligjit 27/2016 është miratuar VKM nr.9.datë 9.1.2019 ”Për rregullat dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si dhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”.

Vlerësimi i ” sigurise së kimikatit “, procedura e kryer nga prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi profesional që vlerëson dhe dokumenton risqet që vijnë nga substancat që ata prodhojnë, importojnë ose përdorin, janë kontrolluar në mënyrë të përshtatshme gjatë prodhimit dhe përdorimit/ve të tyre dhe se aktorët e tjerë në zinxhirin e furnizimit mund ti kontrollojnë ato(risqet) në mënyre të

përshtateshme. Vlerësimi i sigurisë së kimikatisë është një procedurë që rezulton me Dokumentin e të Dhenave të Sigurisë për Kimikatin, ku përfshihen rekomandimet për reduktimin e riskut dhe kontrollin e duhur të efekteve të dëmshme nga substancat e rrezikshme.

Prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi profesional i kimikateve, që kryejn vlerësimin e sigurisë së kimikatisë, duhet të përdorin metodat e përkrahura në ligjin 27/2016 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Keto rregulla përcaktohen në VKM-në e mësipërme.

Zyra e Kimikateve është përgjegjëse për:

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave të nxjerra në zbatim të tij.
2. Koordinimin ndërinstitucional lidhur me menaxhimin e kimikateve.
3. Bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me menaxhimin e kimikateve.
4. Përgatitjen e procedurave, krijimi dhe mirëmbajtja e Rregjistrimit Kombëtar të Kimikateve.
5. Publikimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) dhe listës së kandidatëve (lista e substancave që janë duke u konsideruar/shqyrtuar për t'u bërë pjesë e listës SVHC).
6. Lëshimin i autorizimeve për përdorimin e mëtejshëm të listës SVHC.
7. Propozimin e heqjes së kimikateve nga tregu ose kufizimin e përdorimit të tyre kur përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.
8. Shërbimin e informacionit (helpdesk) për të ofruar këshilla për prodhuesit, importuesit, përdoruesit e tjerë dhe çdo palë tjetër të interesuar për përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre përkatëse në bazë të këtij ligji.
9. Informimin e publikut të gjerë në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për rreziqet që vijnë nga kimikatet kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose mjedisit.
10. Plotësimin e detyrimeve lidhur me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për menaxhimin e kimikateve (Konventa e Stockholmit, Konventa e Rotterdemit, Komisioni Ndërsektorial i Sigurisë Kimike sipas Ligjit Nr. 27/2016).

Si autoritet shtetëror kompetent, zyra e kimikateve informon publikun në lidhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për rreziqet që vijnë nga kimikatet përmes identifikimit më të mirë dhe të hershëm të vetive të brendshme të substancave kimike. Kjo bëhet konkretisht nga katër procese, përkatësisht rregjistrimi, vlerësimi, autorizimi dhe kufizimi i kimikateve me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Në zbatim të këtij ligji prodhuesit dhe importuesit u kërkohet të mbledhin informacion mbi vetitë e substancave të tyre kimike, të cilat do të lejojnë trajtimin e tyre të sigurt dhe të rregjistrojnë informacionin mbi vetitë e substancave të tyre kimike dhe ta përcjellin në zyrën e kimikateve, e cila menaxhon bazën e të dhënave të nevojshme për të operuar sistemin, bashkërendon vlerësimin e thelluar të kimikateve të dyshimta dhe ndërton një bazë të dhënash publike në të cilën konsumatorët dhe profesionistët mund të gjejnë informacione mbi rreziqet. Gjithashtu zyra e kimikateve kërkon zëvendësimin progresiv të kimikateve më të rrezikshme (referuar si substanca me shqetësim shumë të lartë), kur të jenë identifikuar alternativa të përshtatshme. Në përmbyllje të detyrimeve ligjore zyra e kimikateve po bashkëpunon me institucionet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bujqësisë në dhënien e mendimeve dhe opinioneve për substancat kimike që importohen në Shqipëri nga importuesit për qëllime të përdorimit në bujqësi dhe në shëndetësi.

9.2.1 Ndikimi i kimikateve në mjedis (pesticidet)

Përdorimi dhe asgjësimi i gjerë i pesticideve nga fermerët, institucionet dhe publiku i gjerë siguron shumë burime të mundshme të pesticideve në mjedis. Pas lëshimit në mjedis, pesticidet mund të kenë fate të ndryshme. Pesticidet që spërkatën mund të lëvizin nëpër ajër dhe përfundimisht mund të përfundojnë në pjesë të tjera të mjedisit, si në tokë ose ujë. Pesticidet të cilat aplikohen direkt në tokë mund të lahen nga toka në trupat e afërt të ujit sipërfaqësor ose mund të depërtojnë nëpër tokë për të ulur shtresat e tokës dhe ujërat nëntokësore. Pesticidet që injektohen në tokë gjithashtu mund t'i nënshtrohen dy fateve të fundit. Aplikimi i pesticideve direkt në trupat ujqorë për kontrollin e barërave të këqija, ose në mënyrë indirekte si rezultat i kullimit nga boja e varkave, rrjedhja nga toka ose rrugë të tjera, mund të çojë jo vetëm në grumbullimin e pesticideve në ujë, por gjithashtu mund të kontribuojë në nivelet e ajrit përmes avullimit.

Lëvizja e pesticideve në mjedis është shumë komplekse me transferime që ndodhin vazhdimisht ndërmjet ndarjeve të ndryshme mjedisore. Në disa raste, këto shkëmbime ndodhin jo vetëm midis zonave që janë afër njëra-tjetrës (si p.sh. një pellg lokal që merr një pjesë të aplikimit të herbicidit në tokën ngjitur), por gjithashtu mund të përfshijë transportin e pesticideve në distanca të gjata

Përveç rezistencës ndaj degradimit, ekzistojnë një sërë veçorish të tjera të pesticideve të cilat përcaktojnë sjelljen e tyre në mjedis. Njëra është se sa të paqëndrueshme janë; domethënë sa lehtë avullojnë. Ato që janë më të paqëndrueshme kanë potencialin më të madh për të shkuar në atmosferë dhe, nëse janë të qëndrueshme, për të lëvizur në distanca të gjata. Një veti tjetër e rëndësishme është tretshmëria në ujë; ose sa lehtë treten në ujë. Nëse një pesticid është shumë i tretshëm në ujë, ai bartet më lehtë me ujërat e shiut, si rrjedhje ose përmes tokës si një ndotës potencial i ujërave nëntokësore (shpëlarje). Përveç kësaj, pesticidi i tretshëm në ujë ka më shumë gjasa të qëndrojë i përzier në ujërat sipërfaqësore, ku mund të ketë efekte të padëshiruara te peshqit dhe organizmat e tjerë. Nëse pesticidi është shumë i patretshëm në ujë, ai zakonisht ka tendencë të ngjitet në tokë dhe gjithashtu vendoset në fundet e trupave ujqorë sipërfaqësorë, duke e bërë atë më pak të disponueshëm për organizmat.

Lëshimi i pesticideve në mjedis mund të pasohet nga një seri ngjarjesh shumë komplekse të cilat mund ta transportojnë pesticidin përmes ajrit ose ujit, në tokë apo edhe në organizmat e gjallë. Rruga më e rëndësishme e shpërndarjes dhe shtrirja e shpërndarjes do të jenë të ndryshme për çdo pesticid. Kjo do të varet nga formulimi i pesticidit (me çfarë kombinohet) dhe si dhe kur lirohet. Pavarësisht nga ky kompleksitet, është e mundur të identifikohen situatat që mund të shkaktojnë shqetësim dhe të përpiqemi t'i minimizojmë ato. Megjithatë, ka boshllëqe të konsiderueshme në njohuritë për lëvizjen e pesticideve në mjedis dhe prandaj është mirë që të minimizohet çlirimi i panevojshëm i pesticideve në mjedis. . Kjo arrihet me miratimin e praktikave të mira menaxhuese të pesticideve.

9.2.2 Inventari i Poliklorurbifenileve (PCB)

Projekti "Inventarizimi dhe prioritizimi i PCB-ve dhe përgatitja e vlerësimeve tematike të vendit mbi Raportin Kombëtar të Analizës Diagnostike Ndërkufitare" është krijuar për të kontribuar në aktivitetet e projektit, përkatësisht, ndërhyrjet për të reduktuar prodhimin, përdorimin, konsumin dhe emetimet/shkarkimet e kimikateve të synuara dhe mbetjeve të synuara. Projekti fokusohet në disa pika kyçe, konkretisht, ndërhyrjet për të reduktuar prodhimin, përdorimin, konsumin dhe emetimet/shkarkimet e kimikateve të synuara dhe mbetjeve të synuara (PCB-POPs).



Kryerja e marrjes së mostrave dhe matjes së niveleve të Bifenileve të Poliklorinuara (PCB) ishte një hap kritik në vlerësimin e shkallës së kontaminimit dhe të kuptuarit e rreziqeve që lidhen me

të në Shqipëri. Kështu, u krijua një komunikim me autoritetet kombëtare për të siguruar miratimin për kryerjen e inspektimit në terren dhe marrjen e mostrave të pajisjeve. Ky proces ka përfshirë mbledhjen e mostrave të vajit nga transformatorët elektrikë, të ndjekur nga analiza rigoroze laboratorike për të përcaktuar përqëndrimet e PCB.

Për të kryer kampionimin në mënyrë efektive, u zhvillua një plan i shëndoshë shkencërisht i kampionimit që merr në konsideratë faktorë të tillë si përzgjedhja e vendit, metodat e mbledhjes së mostrave, ruajtja e mostrës dhe procedurat e sigurimit të cilësisë/kontrollit të cilësisë (QA/QC).

Zgjedhja e vendit ka prioritetizuar zonat me burime të njohura ose të dyshuara të ndotjes me PCB, si dhe vendndodhjet ku ka të ngjarë të ndodhë ekspozimi i njeriut. Metodatat e kampionimit u zgjedhën bazuar në metodologjinë e UNEP-it (Udhëzues për Menaxhimin e PCB) dhe objektivat e studimit, duke siguruar mbledhjen përfaqësuese dhe të besueshme të të dhënave.

Bazuar në numrin total të transformatorëve dhe/ose kondensatorëve në Shqipëri, një numër total prej rreth 272 mostrash vaji u zgjedhën për grumbullim gjatë procesit të skanimit për testimin e përmbajtjes së PCB-ve në transformatorët elektrikë dhe/ose kondensatorët. 25 transformatorë dhe/ose kondensatorë elektrikë i përkasin Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe 247 Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). Kriteret e përzgjedhjes u bazuan në faktorët e vlerësimit të rrezikut, siç janë mosha e pajisjeve dhe receptorëve të ekspozuar; afërsia me shkollat, spitalet, ambientet e banimit etj.



Mostrat janë mbledhur në bazë të IEC 60475:2022 “Metoda e kampionimit të lëngjeve izoluese”. Pas mbledhjes së mostrës, u krye analiza laboratorike për të matur përqëndrimet e PCB-së bazuar në pajisjen e testimit të sensorëve spektroskopikë (RAMAN) dhe pajisjet Sea Marconi (SM-TCPs KIT). Mostrat përgatiten dhe përpunohen sipas protokolleve të standardizuara për të matur PCB-

të në vajin e transformatorit dhe për të përcaktuar me saktësi përqendrimin e tyre. Para matjes, pajisja është kalibruar brenda përqendrimit nga 10 në 2000 mg/kg ose 10 deri në 100 mg/kg.

Rezultatet e matjeve të PCB japin informacion të vlefshëm për shpërndarjen hapësinore, madhësinë dhe tendencat e ndotjes së vajit të transformatorit në Shqipëri. Këto të dhëna mund të përdoren për të vlerësuar rreziqet e mundshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, për t'i dhënë përparësi zonave për rehabilitim dhe për të vlerësuar efektivitetin e masave rregullatore.

Interpretimi i të dhënave të PCB duhet të marrë parasysh faktorë të tillë si nivelet e sfondit, kushtet specifike të vendit dhe rrugët e mundshme të ekspozimit për të siguruar një kuptim të plotë të situatës së ndotjes.

Situata e inventarit të PCB-ve në Shqipëri lidhet kryesisht me përmbajtjen e tyre në transformatorë/kondensatorë të përdorur në sistemin energjetik. Sistemi aktual energjetik përbëhet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE).

Korporata Energjetike Shqiptare zotëron transformatorët në njësitë e prodhimit të energjisë elektrike; Hidrocentral (HEC) ose Termocentral (TEC). KESH është prodhuesi publik dhe, në të njëjtën kohë, prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri. KESH operon impiantet më të rëndësishme të prodhimit të energjisë elektrike në vend. Këto asete përbëhen nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin (HEC-i i Fierzës, HEC-i i Komanit dhe HEC-i i Vaut të Dejës), me fuqi të instaluar prej 1350 MW, dhe TEC-i i Vlorës, me një fuqi të instaluar prej 98 MW (aktualisht jashtë funksionit).). Kaskada e ndërtuar mbi lumin Drin është më e madhja në Ballkan për nga kapaciteti i instaluar, si dhe për nga madhësia e hidrocentraleve. KESH është gjithashtu përgjegjëse për administrimin, funksionimin e duhur dhe sigurinë teknike dhe funksionale të termocentraleve që operon.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), është një shoqëri publike me 100% pronësi shtetërore e krijuar në vitin 2004. OST garanton kapacitetet e nevojshme të transmetimit për Shqipërinë. OST zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit me energji elektrike të vendit dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) është një kompani energjetike e angazhuar në ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në shërbim të familjeve dhe klientëve privatë në të gjithë Shqipërinë. OSHEE është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Nga këto kompani është marrë informacion zyrtar për gjendjen e transformatorëve dhe mundësia e përmbajtjes së PCB-ve lidhet kryesisht me ekzistencën e transformatorëve të vjetër të prodhuar para vitit 1990.

Nga të dhënat e para të inventarit të PCB-ve u konstatua se 5.3% e sasisë së priturme të vajit ishte e kontaminuar me PCB, të cilët janë kryesisht transformatorë të vegjël dhe i përkasin OSHEE. KESH ka kryesisht transformatorë të rinj të prodhuar pas vitit 1990, të cilët nuk janë të kontaminuar me PCB dhe për rimbushjen e tyre përdoret vaj PCB pa pagesë. Rreth 97% e transformatorëve OSHEE janë transformatorë të vegjël të vendosur në kabina elektrike.

Megjithatë, objektet energjetike në Shqipëri ende përdorin transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1990. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zonave më të kontaminuara të

transformatorëve të naftës si zona e riparimit të transformatorëve që i përket OSHEE dhe zona e impiantit të trajtimit të naftës në Tiranë që i përket OST.

Gjetje dhe rekomandime

- Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH) operon aktualisht 17 transformatorë, me një peshë totale vaji prej 442.4 ton. Sipas të dhënave zyrtare të KESH, asnjë prej këtyre transformatorëve nuk është prodhuar para vitit 1990 dhe të gjithë janë të mbushur me vaj pa PCB.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) administron gjithsej 58 transformatorë dhe kondensatorë, me një peshë të kombinuar vaji prej 2,134 ton. Të dhënat zyrtare të OST-së sugjerojnë se 13 transformatorë pritet të jenë të kontaminuar me PCB, me një peshë totale prej 450 ton vaj të kontaminuar.
- Rezultatet e ekzaminimit në vend tregojnë se nga 25 transformatorë të testuar, 9 ishin të kontaminuar, duke përbërë 36% të mostrave të ekzaminuara.
- Peshë totale e vajt të kontaminuar, me përqendrim PCB mbi 50 mg/kg, vlerësohet në rreth 450 ton, dhe sasia e pritur e PCB-ve në vajin e kontaminuar mund të arrijë afërsisht 446 kg.
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) mbikëqyr gjithsej 13,967 transformatorë me një peshë totale vaji prej 6,233.1 ton. Të dhënat zyrtare të OSHEE konfirmojnë se asnjë transformator në përdorim nuk është prodhuar para vitit 1990 dhe një mungesë e pritshme e ndotjes me PCB.
- Rezultatet e ekzaminimit në vend zbulojnë kontaminim në 130 nga 247 transformatorët e testuar, që përbën rreth 53%.
- Peshë totale e vajt të kontaminuar, me përqendrim PCB mbi 50 mg/kg, vlerësohet në afërsisht 3,060 ton. Për më tepër, sasia e vlerësuar e PCB-ve në vajin e kontaminuar është afërsisht 750 kg.
- Peshë totale e vajt të kontaminuar si për OST-në ashtu edhe për OSHEE vlerësohet rreth 3,510 ton dhe sasia e vlerësuar e PCB-ve në vajin e kontaminuar është afërsisht 1196 kg.
- Si Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ashtu edhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duhet urgjentisht të zëvendësojnë vajin e kontaminuar me PCB në sistemet e tyre.
- Transformatorët e kontaminuar që rezultojnë të janë në përdorim ose në gatishmëri dhe në kushte të mira teknike duhet të mbushen me vaj të ri pa PCB.
- Transformatorët e kontaminuar që rezultojnë që janë në përdorim dhe në kushte të këqija teknike duhet të zëvendësohen me transformatorë të rinj.
- Transformatorët e kontaminuar që rezultojnë që janë në gatishmëri dhe në kushte të këqija teknike duhet të hiqen nga shërbimi dhe të çaktivizohen.
- OST-së dhe OSHEE-së i kërkohet të hartojnë një plan veprimi për zëvendësimin e vajrave dhe transformatorëve të kontaminuar. Ky plan duhet të përfshijë strategji zbutëse që synojnë reduktimin e rreziqeve të ekspozimit mjedisor dhe njerëzor që lidhen me PCB-të.

KAPITULLI 10

PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE

KAPITULLI 10

PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE

10.1 Të përgjithshme

Burimet natyrore janë burime që ekzistojnë duke qenë të pavarura nga veprimet njerëzore. Këtu përfshihen burimet e karakteristikave të çmuara si përdorimi tregtar dhe industrial, vlera estetike, interesi shkencor dhe vlera kulturore. Në Tokë, ai përfshin dritën e diellit, atmosferën, ujin, tokën, të gjitha mineralet sëbashku me të gjithë bimësinë dhe jetën e kafshëve.

Burimet natyrore mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme. Një burim natyror mund të ekzistojë si një entitet i veçantë si p.sh. uji i freskët burimor, ajri si dhe çdo organizëm i gjallë, ose mund të transformohet në një formë të dobishme ekonomike që duhet të përpunohet për të marrë burimin si p.sh. si xeheroret metalike, elementët e tokës së rrallë, nafta, druri dhe shumica e formave të energjisë. Disa burime janë burime të rinovueshme, që do të thotë se ato mund të përdoren me një ritëm të caktuar dhe proceset natyrore do t'i rivendosin ato, ndërsa shumë industri nxjerrëse mbështeten shumë në burime jo të rinovueshme që mund të nxirren dhe shfrytëzohen vetëm një herë.

Në jetën tonë të përditshme ne përdorim burimet natyrore për të mbështetur përparimet e jetës moderne, por disa janë të fundme dhe nuk mund të rigjenerohen në periudha të shkurtra kohore.

10.2 Gjendja

Në vitin 2022, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, vlerësohet rreth 20,2 milionë tonë, duke shënuar një rritje prej 5,6 %, krahasuar me vitin 2021. Struktura e burimeve të brendshmenatyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 50 %, “biomasa” 35 %, “minerale metalike” 10 % dhe “materiale të energjisë fosile” 5 % të materialeve gjithsej

- **Përdorimi i materialeve mjedisore**

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat sasinë totale vjetore të lëndëve të para që nxirren nga mjedisi, duke marrë në konsideratë dhe bilancin fizik tregtar. Në 2022, përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 21,4 milionë tonë, duke shënuar një rritje 5,7 % krahasuar me vitin 2021.

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore që vijnë nga shfrytëzimi i burimeve natyrore në raport me popullsinë paraqitet në tabelën e mëposhtme

Tabela 1. Përdorimi i materialeve mjedisore, ton/banor

Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022
Biomasa dhe produktet e Biomases	3.2	3.1	3.0	3.0	2.9
Mineralet dhe koncentratet metalike	0.5	0.6	0.5	0.6	0.7
Mineralet jo metalike	3.7	3.6	2.8	2.9	3.6
Materialet fosile të energjisë	0.6	0.5	0.5	0.6	0.4
Produkte të tjera dhe mbetje	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Total	8.0	7.9	6.8	7.2	7.7

Burimi: INSTAT

- **Përdorimi i ujërave**

Përdorimet kryesore të ujit janë klasifikuar:

- Uji për njerëzit që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve
- Uji për ushqimin që përfshin bujqësinë
- Uji për industrinë që përfshin hidroenergjetikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe së rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe zbatimet (turizmi)
- Uji për mjedisin që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat, pyjet

Tabela 2. Pasqyrë e përgjithshme e përdorimit të burimeve ujore në nivel baseni

	Drin-Bunë	Mat	Ishëm-Erzen	Shkumbin	Seman	Vjosë
Përdorimi i ujit						
Rezervuarët për ujitje	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim i lartë
Numri i hidrocentraleve	4	2	-	0	2	0
Koncesionet e hidrocentraleve	148	85	4	112	104	65
Përdorimi sipas industrisë	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim mesatar	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar
Numri i zonave të mbrojtura	10	6	2	6	11	18
Përdorime të tjera	Transport ujqor /peshkim	Ndërtim	Turizëm	Ndërtim	Peshkim	Turizëm
Rreziku nga thatësitrat	I ulët	I ulët	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Mesatar

Burimi: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027

Tabela 3 . Përdorimi i burimeve ujore

Lloji i përdorimit	Sasia	
Perdorim I burimit ujqor sipërfaqësor(m ³)	17,488,655,557	
Per furnizim me ujqe te pijshem te popullates	88,539,416	
Per ujqitje ne bujqesi		Faturohet sipas sipërfaqes se vaditjes(nuk identifikohet qarte sasia e ujqit te perdorur)
Per Akuakulture(ujqra te rrjedhshem)		Faturohet per kg/peshkte shitur(nuk identifikohet sakte sasia e ujqit te perdorur)
Per prodhim hidroenergjik	17,399,941,735	Perlogaritur nga sasia e energjise se prodhuardhe tregetuar per 10 mujorin e 2023dhe te dhenat e prurjeve te lejuara te llogaritura
Per qellime industrial dhe /ose teknologjike	170,623	
Per qellime te tjera	3,783	
Perdorim burimi ujqor nentoksor(m ³)	133,333,534	
Per furnizim me ujqe te pijshem(sistemim te furnizimit me ujqe te populates)	129,347,001	
Per ujqe te ambalazhuar	699,205	
Per akuakulture		Faturohet per kg/peshkte shitur(nuk identifikohet sakte sasia e ujqit te perdorur)
Per qellime industrial dhe /ose teknologjike	2,857,435	
Per turizem dhe argetim	218	
Per ujqitje ne bujqesi		Faturohet sipas sipërfaqes se vaditjes (nuk identifikohet sakte sasia e ujqit te perdorur)
Termal, Gjeotermal kurativ		Faturohet sipas vaskave (nuk identifikohet sakte sasia e ujqit te perdorur)
Per qellime blegtorale kur shoqerohet me instalime tubacionesh dhe ndertime objektesh	1,262	
Per prodhim hidroenergjik	0	
Per qellime te tjera	428,413	
Totali(m ³)	17,621,989,090	

Materiale inerte lumore të nxjerra për përdorim nga shtetërit e lumenjve rezultojn të jetë 381,653m³

Përdorimi i burimeve ujore për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike

Hidrocentralet publike, në vitin 2023, prodhuan 5.123 GWh nga 3.859 GWh të prodhuar në vitin 2022, duke shënuar kështu një rritje të prodhimit me 32,8 %. Hidrocentralet private dhe koncensionare prodhuan 3.582 GWh nga 3.093 GWh të prodhuar një vit më parë, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 15,8 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike, në vitin 2023, arriti vlerën 8.796 GWh nga 7.003 GWh energji të prodhuar në vitin 2022, duke shënuar një rritje të prodhimit me 25,6 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 58,2 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 40,8 % dhe nga të tjerë prodhues (Fotovoltaikë) në masën 1,0 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Tabela 2. Bilanci i energjisë elektrike

Treguesit	2022	2023
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	7.923.653	7.875.822
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	7.002.647	8.795.634
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	6.951.387	8.705.910
a Publike (a=a.1-a.2)	3.858.562	5.123.417
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	3.895.093	5.166.787
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	36.531	43.370
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncensionarë	3.092.825	3.582.493
1.3 Të tjerë prodhues (Fotovoltaik)	51.260	89.724
2 Importi bruto (energji në marrje)	3.043.533	1.921.743
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	2.122.527	2.841.555
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	7.923.653	7.875.822
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	1.657.835	1.654.540
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	199.995	220.267
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	1.457.840	1.434.273
a Humbjet teknike në shpërndarje	980.012	990.500
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	477.828	443.773
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	6.265.818	6.221.282
2.1 Familjarë	3.074.801	3.116.817
2.2 Jo Familjarë	3.191.017	3.104.465

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2023, arriti vlerën 6.221 GWh nga 6.266 GWh që ishte në vitin 2022.

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë u rrit me 1,4 %, duke arritur vlerën 3.117 GWh në vitin 2023 nga 3.075 GWh që ishte në vitin 2022, ndërsa përdorimi nga konsumatorët jo familjarë u ul me 2,7 % duke arritur vlerën 3.104 GWh në vitin 2023 nga 3.191 GWh që ishte një vit më parë .

- *Përdorimi i tokës*

Tabela 4. Sipërfaqe me prodhime organike në tokë bujqësore, 2022

				Ha
Emërtimi	Sipërfaqe			
	Gjithsej	- në kalim organik	- organike	- nga e cila në serra
Tokë e punueshme	586.8	56.2	530.6	1.2
- Drithra	2.7	2.7	0.0	0.0
- Bimë aromatike dhe mjekesore)*	579.6	51.9	527.7	0.9
- Perime	0.6	0.3	0.3	0.3
- Foragjere	1.8	1.3	0.5	0.0
- Të tjera	2.1	0.0	2.1	0.0
Drufrutorët	146.6	106.9	39.7	0.2
- Pemë frutore	20.2	20.3	0.4	0.2
- Agrume	0.5	0.5	0.0	0.0
- Ullinj	110.7	76.1	34.6	0.0
- Vreshta	15.2	10.5	4.8	0.0
Gjithsej	733.4	163.1	570.3	1.4

) * - këtu janë të përfshira edhe erëzat e gatimit

Burimi i informacionit: INSTAT

Tabela 5. Sipërfaqja e mbjellë me bimë arash, 2018-2022"

000ha						
Nr.	Qarku	2018	2019	2020	2021	2022
1	Berat	26.4	25.4	25.2	24.8	23.7
2	Dibër	29.9	35.5	40.6	39.1	37.8
3	Durrës	31.1	30.2	30.3	30.5	30.3
4	Elbasan	49.9	49.5	49.0	48.9	47.9
5	Fier	90.7	87.9	87.3	87.4	86.6
6	Gjirokastrë	19.4	19.2	19.2	19.1	19.1
7	Korçë	47.0	46.2	45.9	46.7	46.2
8	Kukës	12.0	11.7	11.8	11.9	11.7
9	Lezhë	24.6	24.4	24.3	24.2	24.1
10	Shkodër	37.4	33.5	33.4	33.3	33.4
11	Tiranë	36.3	35.7	35.7	35.8	35.7
12	Vlorë	15.6	17.7	18.8	18.9	19.8
Gjithsej		420.3	417.0	421.6	420.6	416.5

Burimi i informacionit: INSTAT

- Hidrokarbure

Tabela 6. Treguesit kryesorë të prodhimit të Hidrokarburëve në Shqipëri , 2023

Nr.	Shoqëria	Vendburimi	Prodhi m naftë [ton]	Prodhim Gazi Shoqëru es [Mijë Nmt]	Prodhim Uji Teknologji k (shtresor) [Mijë mt]	Prodhim Rrëre [mt]
1	Albpetrol sh.a.	Patos, Cakran- Mollaj, Kuçovë, Gorisht-Kocul, Amonicë, Karbunarë	68,958.0	1,858.5	213.3	-
2	Shell Upstream Albania	Blloku 2-3 i kërkimit	-	-	19.8	-
3	Shell Albania Block 4	Blloku 4 i kërkimit	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Bankers Petroleum Albania l.t.d.	Patos-Marinza	527,311. 4	43,555.3	5,552.5	3,323.3
5	Sherwood International Petroleum l.t.d.	Kuçovë	928.2	167.4	1.2	-

6	Anio Oil & Gas sh.a.	Ballsh-Hekal	27,334.9	592.0	273.5	-
7	TerraOil Swiss sh.a.	Visokë	14,084.0	316.8	52.5	-
8	Fin Pek Petroleum sh.a.	Finiq-Krane	1,362.0	0.0	0.0	-
9	Fin Pek Petroleum sh.a.	Pekisht-Murriz	1,194.1	0.0	0.0	-
10	Delvina Gas Company	Delvinë (Kondensat)	411.2	2,229.0	50.5	-
11	Eni Albania BV	Blloku Dumre i kërkimit	0.0	0.0	0.0	0.0
12	EDG Natural Gas	Frakulla (Gaz)	0.0	0.0	0.0	0.0
13	EDG Natural Gas	Povelça (Gaz)	0.0	0.0	0.0	0.0
SHUMA			572,625.7	46,860.6	5,930.4	3,323.3

- *Shfrytëzimi mineralar*

Tabela 7 . Lejet aktive të shfrytëzimit mineralar, 2023

Lloji i mineralit	Numri i lejeve
KROM	235
BAKËR	17
HEKUR NIKEL	29
GËLQEROR	180
BITUMI	11
TË TJERA	58
TOTAL	530

- *Vlerësim i përgjithshëm*

Në vitin 2022, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, vlerësohet rreth 20,2 milionë tonë, duke shënuar një rritje prej 5,6 %, krahasuar me vitin 2021. Struktura e burimeve të brendshmenatyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 50 %, “biomasa” 35 %, “mineralet metalike” 10 % dhe “materialet e energjisë fosile” 5 % të materialeve gjithsej. Përdorimi i burimeve nga banorët për vitin 2022 rezultojnë 7.7 ton/banor.

Përdorimet kryesore të ujit janë klasifikuar në: Uji për njerëzit që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve, Uji për ushqimin që përfshin bujqësinë, Uji për industrinë që përfshin hidroenergjetikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe zbavitjet (turizmi) dhe Uji për mjedisin që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat, pyjet.

Përdorimi i burimeve ujore në nivel baseni, ka përdorim të lartë të ujit në rezervuaret për ujitje në basenin Drin-Bunë, Ishëm-Erzen, Seman dhe Vjosë, përdorimi sipas industrisë në basenin Drin-Bunë dhe Seman.

Përdorim i burimit ujqor sipërfaqësor është 17,488,655,557 m³, sasia më e madhe përdoret për prodhim hidroenergjik. Përdorim i burimit ujqor nëntoksor është 133,333,534, m³ sasia më e madhe përdoret për furnizim me ujë të pijshëm (sistemim të furnizimit me ujë të popullatës).

Material inerte lumore 381,653 m³.

Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbjellë kategorizohet në tokë e punueshme me sipërfaqe 586.6 ha nga këto 56.2 ha në kalim organik, 530.6 ha organike dhe 1.2 ha ne sera. Për dru-frutore me sipërfaqe 146.6 gjithsej nga këto 106.9 ha në kalim organik, 39.7 ha organike dhe 0.2 ha në sera.

Treguesit kryesor të prodhimit të Hidrokarburëve në Shqipëri për vitin 2023 janë prodhim naftë 572.625.7 ton, prodhim gazi shoqërues 46,860.6 mijë Nm³, prodhim uji teknologjik (shtresor) 5,930.4 mijë m³ dhe prodhim rëre 3,323.3 m³.

Lejet aktive të shfrytëzimit mineral janë në total 530.

KAPITULLI 11

AKTIVITETET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

KAPITULLI 11

AKTIVITETET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

1. Të përgjithshme

Industria prodhuese jep një kontribut të rëndësishëm në mirëqënien ekonomike dhe zhvillimin e tij, por nga ana tjetër mund të jenë një burim kryesor i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës.

Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore për zbatimin e kushteve të vendosura në lejen mjedisore dhe të legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin për monitorimin e përputhshmërisë si dhe plotësimin e formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit menaxhon sistemin e informacionit mjedisor me të dhënat e grumbulluara nga operatorët ekonomik të pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B. Gjithashtu kryen inspektime dhe kontrole në subjekte të ndryshme për zbatueshmërinë e kushteve të lejes mjedisore.

Një rol të rëndësishëm për mjedisin luajnë dhe zhvillimi i projekteve me financim të huaj qe ndiqen nga MTM dhe që janë zbatuar gjatë periudhës 2020-2023 me qëllim përmbushjen e objektivave në fushën e mjedisit dhe turizmit.

2. Gjendja dhe tendenca

2.1 Vetmonitorimet për shkarkimet


Gjatë vitit 2023 kemi një rritje të numrit të dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit nga Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore. Numri i operatoreve të cilët kanë raportuar **për vitin 2023 është rreth 2333 nga të cilat 80 janë operator të pajisur me Leje Mjedisit Tipi A dhe 2253 operatorë të pajisur me Leje Mjedisit Tipi B.**

Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit A dhe B të ndara përkatësisht në secilin qark, për vitin 2023 paraqitet si më poshtë.


Tabela 1. Numri i subjekteve që kanë realizuar vetëmonitorimin, 2023

Qarku	Viti 2023		
	Leje Tipi A	Leje Tipi B	Total
Tiranë	8	601	609
Durrës	13	313	326
Lezhë	8	130	138
Gjirokastrë	1	75	76
Vlorë	4	181	185
Berat	7	111	118
Fier	16	220	236

Kukës	0	74	74
Shkodër	2	107	109
Dibër	1	139	140
Elbasan	17	161	178
Korçë	3	141	144
Totali	80	2253	2333



Grafiku nr.1 Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit A dhe B të ndara përkatësisht në secilin qark, për vitin 2023.



Grafiku Nr.2. Numri i raporteve te vetemonitorimit ne 10 vitet e fundit.

Tab. 2 Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe B në secilin qark, për vitin 2014 – 2023.

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Qarku										
Tiranë	49	89	188	145	227	162	232	351	496	609
Durrës	33	80	165	77	160	119	124	180	233	326
Lezhë	27	21	53	31	49	35	49	92	112	138
Gjirokastrë	1	9	14	15	28	13	28	30	53	76
Vlorë	31	50	68	38	87	63	85	102	146	185
Berat	15	35	91	58	82	64	60	78	95	118
Fier	29	75	92	67	107	131	97	124	188	236
Kukës	3	27	23	23	37	5	19	29	45	74
Shkodër	8	21	45	43	67	53	60	72	99	109
Dibër	49	88	41	23	126	68	59	87	106	140
Elbasan	29	35	29	29	62	35	68	86	119	178
Korçë	16	36	56	43	68	31	49	83	121	144
Totali	290	566	865	549	1100	779	930	1314	1813	2333

Mbetjet e Industrisë Kimike (siç janë mbetjet që përmbajnë substanca të rrezikshme) janë më së shumti të theksuara duke qënë se kjo lloj industrie është më e pranishme në qarkun e Elbasanit. Për këto në Raportet e Vetëmonitorimit janë paraqitur sasitë e shkarkuara; vendgrumbullimi i këtyre mbetjeve; riciklimi; ripërdorimi, trajtimi i mëtejshëm në vendndodhje dhe subjekti i licencuar ku dorëzohen mbetjet.

Përsa i përket shkarkimeve në ajër, pothuajse në të gjitha subjektet është bërë matja e temperaturës, lagështisë, shpejtësia e erës, PM 10 dhe presionit atmosferik për mostrat e ajrit. Në disa subjekte janë matur më shumë parametra (përfshirë CO, CH₄, O₂, SO₂, H₂S, përqëndrimi i nivelit të pluhurit në nivele të ulëta etj). Ndërsa për mostrat ujore pothuajse në të gjitha subjektet kemi matje të vlerave të Nevoja Kimike për Oksigjen, Nevoja Biokimike për Oksigjen, temperaturë, konduktivitet, pH, dhe lëndët në pezulli. Në disa subjekte kemi më shumë parametra të matura në mostrat ujore si p.sh: Diferenca e temperatures, rrjedhja ditore, P-organik, N-amonikal, produkte nafte, fortësia e përgjithshme, As, Cd, Zn, Cr, Pb, Cianid i lirë, Cianid totalëtj.

Referuar raporteve të vetëmonitorimit të subjekteve rezulton se nuk kemi tejkalime të vlerave të matura sipas legjislacionit në fuqi.

Nga raportet e vetëmonitorimit të dërguara nga operatorët pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2023 rezulton se parametrat e matur të përcaktuar në lejen mjedisore të tyre janë brenda normave të përcaktuara në legjislacion përkatës.

Më poshtë jepet një vlerësim përsa i përket numrit të raporteve të vetëmonitorimit mjedisor të dorëzuar gjatë vitit 2023 nga subjektet duke e krahasuar me vitin 2022.

Tabela nr. 3 Rritja e raporteve të dorëzuar gjatë 2023 krahasuar me vitin 2022 (%)

Qarku	Rritja në % e raporteve të dorëzuara krahasuar me 2022
Tiranë	18.6 %
Durrës	28.6 %
Lezhë	18.9%
Gjirokastër	30.3%
Vlorë	21.1%
Berat	19.5%
Fier	20.4%
Kukës	39.2%
Shkodër	9.2%
Dibër	24.3%
Elbasan	33.2%
Korçë	16%

Për secilin qark kemi një rritje të dorëzimit të raporteve të vetëmonitorimit krahasuar me vitin 2022, gjë e cila tregon rritjen e përgjegjësisë të subjekteve për realizimin e vetëmonitorimit të burimeve të shkarkimit të veprimtarisë së vet në zbatim të legjislacionit përkatës. Rritja e numrit të raporteve të vetëmonitorimit vjen si pasojë e ndërgjegjësimit të operatorëve, njoftimeve nga AKM për dorëzimin e raporteve në zbatim të kushteve të lejes mjedisore si dhe sanksioneve të ndërmarra ndaj tyre.

Qarku Kukës ka rritjen më të madhe të dorëzimit të raporteve me 39.2% duke rritur numrin nga 45 në vitin 2022 në 74 në vitin 2023.

2.2 Inspektimet mjedisore

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, lidhur me procesin e inspektimeve në mjedis, kryen aktivitetet në lidhje me:

- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese.
- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve që shfrytëzojnë burimet natyrore, në mënyrë të vecantë guroret, minierat dhe subjektet me aktivitet shfrytëzimi të naftës dhe gazit.
- Sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm në fuqi.
- Sigurimin dhe përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit.
- Parandalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të pa trajtuara në burimet ujore pritëse,

sidomos gjatë sezonit turistik.

- Sigurimi i informimit për publikun për çështjet mjedisore.
- Sigurimi i informimit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit.
- Kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur.

➤ Inspektimet në mjedis

Inspektimet në mjedis kryhen në zbatim të ligjit Nr. 10 448 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, VKM –ve respektive etj. Qëllimi i tyre është kryerja e kontroleve për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese.

Fushat e veprimtarisë për të cilat kryhen inspektime përfshijnë:

- Industria minerare
- Industria energjetike
- Industria kimike
- Gurore
- Prodhim dhe përzierje e betonit
- Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to
- Përpunimi i tekstileve ose fibrave
- Veprimtaritë e lëndës së drurit
- Prodhimi dhe përpunimi i metaleve
- Menaxhimi i mbetjeve
- Veprimtaritë e prodhimit të letrës, pulpës dhe dërrasës
- Blegtoria
- Veprimtaritë e gomës
- Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lëkurës
- Etj.

➤ Inspektimet në ujëra

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, procesi i inspektimeve në fushën e ujërave është përqëndruar në fushat e veprimtarisë, si më poshtë:

1. Për përdorimin e burimeve ujore.

- a. Inspektimi i subjekteve të cilat e kanë të përqëndruar aktivitetin e tyre në përdorimin e burimeve ujore.
- b. Subjeket të cilat janë të pajisur me leje nga organet përkatëse të AMBU.
- c. Për përdorimin e ujit për proces teknologjik (veprimari prodhuese).
- d. Për përdorimin e ujit për aktivitet industrial.
- e. Imbotilim, koncesione.
- f. Për përdorimin e ujërave për prodhim hidroenergjie.
- g. Për qëllime të tjera tregtare dhe fitimi.
- h. Akuakulturë
- i. Shfrytëzim i burimeve natyrore të ujërave kurativë, minerale, gjeotermale, etj.

2. Shfrytëzimi i inerteve lumore

- Subjektet që veprojnë në këtë fushë të jenë pajisur me leje për shfrytëzimin apo e materialeve inerte si rërë, zhavor që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrrenjve, liqeneve.
- Inspektimi i impjanteve të fraksionimit të inerteve për lejen e përdorimit të ujit për larjen e inerteve dhe prodhimin e betonit.

3. Shkarkimet dhe monitorimi i cilësisë së ujërave.

- Kontrollin për paisjen me lejen përkatëse të çdo subjekti që ushtron një aktivitet prej të cilit shkarkohen ujëra të ndotura në trupat ujore.
- Kontrollin në zonat e mbrojtjes higjeno-sanitare.
- Kontrollin e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajuara.
- Kontrollin për parandalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të pa trajtuara në burimet ujore pritëse, sidomos gjatë sezonit turistik.

Inspektimet në fushën e mjedisit dhe të burimeve natyrore (ujërat) kryhen nga inspektorët e Drejtorisë së Inspektim- Kontrollit në AKM si dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit në 12 qarqe.

Nr	Drejtoria Inspektim-Kontrollit , AKM	Numri i Inspektimeve	Gjoha të vendosura
1	Inspektime mjedisore	274	
2	Inspektime të burimeve natyrore	185	6
3	TOTALI	459	6

Sipas degëve rajonale të AKM, realizimi i inspektimeve në sektorin e mjedisit dhe të ujërave për vitin 2023, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme;

Nr	Degët Rajonale të AKM	Numri i Inspektimeve	Gjoha të vendosura
1	ARM (Lezhë, Shkodër, Kukës)	130	22
2	ARM (Tiranë, Durrës, Dibër)	233	8
3	ARM (Fier, Vlorë, Gjirokastrë)	163	13
4	ARM (Berat, Elbasan, Korçë)	157	35
TOTALI		683	78

Për sa i përket inspektimeve të kryera nga AKM, inspektorët kanë proceduar me sistemin on-line të kryerjes së inspektimeve, ku për vitin 2023 janë kryer 1,142 inspektime, nga të cilat janë vendosur 84 masa administrative (gjobë).

- **Tendenca**

Gjatë vitit 2023 kemi një rritje të numrit të inspektimeve si dhe të masave administrative në lidhje me burimet natyrore krahasuar me vitet e mëparshme. Ndërsa referuar inspektimeve në mjedis gjatë vitit 2023, numri i inspektimeve dhe si pasojë edhe i masave administrative është më i ulët krahasuar me vitet 2021 dhe 2022.

	2021	2022	2023
SEKTORI I INSPEKTIMIT TË BURIMEVE NATYRORE			
<i>Numri i inspektimeve</i>	301	268	329
<i>Masa administrative</i>	23	20	36
SEKTORI I INSPEKTIMIT MJEDISOR			
<i>Numri i inspektimeve</i>	1021	897	813
<i>Masa Administrative</i>	66	92	48

Në zbatim të Ligjit Nr 28, datë 17.03.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”si dhe VKM-së Nr. 367, datë 30.05.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”, pika 8.1. “Për zbatimin e këtij vendimi krijohet Task-Forca për qeset plastike mbajtëse”.

Përbërja, mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, si dhe në zbatim të kërkesave të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 190, datë 15.11.2022 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin të Task – Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi ju bëjmë me dije se:

Nga momenti i krijimit të Task – Forcës të përbërë nga inspektorë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Policisë së Shtetit janë kryer verifikime dhe kontrolle në terren në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fuqi përse i përket përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse.

Nga kontrollet e kryera në njësitë e paracaktuara është sekuestruar një sasi qesesh, të cilat nuk plotësojnë kriteret në përputhje me ndryshimet ligjore në fuqi. Për konstatimet e bëra nga ana e grupeve të punës, për gjetjet dhe shkeljet e kërkesave ligjore, janë marrë masa administrative si dhe janë sensibilizuar në zbatimin e saktë të legjislacionit.

Nga inspektimet e kryera janë konstatuar subjekte duke prodhuar qese plastike mbajtëse jashtë standarteve. Për këto subjekte janë marrë masa administrative me gjobë si dhe sekuestrim i qeseve.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia e qeseve të bllokuara gjatë kryerjes së inspektimeve në subjekte të ndryshme prodhuese për vitin 2023 sipas qarqeve.

Tabela 3. Sasia e qeseve të sekuestruara për vitin 2023

Qarku	Sasia e qeseve
Qarku Tiranë	415 kg (në 7 subjekte)
Qarku Fier	15 kg (në 1 subjekt)
Qarku Berat	50 kg (në 1 subjekt)
Total	480 kg

2.3 Zhvillimi i projekteve mjedisore

Projektet me financim të huaj që ndiqen nga MTM dhe që janë zbatuar gjatë periudhës 2020-2023, janë financuar kryesisht nga donatorët Bashkimi Evropian, Qeveria Gjermane, KFW, GEF-UNEP, UNDP dhe kishin qëllim kryesor të përmbushin prioritetet e MTM në arritjen e përmbushjes së objektivave në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Projektet e Bashkimit Evropian ose projektet IPA (Instrumentat e Para Aderimit) ndahen në disa kategori por gjate kësaj periudhe janë përfutur dhe zbatuar projektet të bashkëpunimit ndërkufitar.

Fondet IPA II - IPA 2014-2020

Fondet IPA II i përkasin fushës të mjedisit dhe turizmit por në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit përfitimet janë në kuadrin e bashkëpunimi rajonal dhe territorial. Projektet e këtij programi vazhdojnë deri në 2022 (këtu theksojmë që 2014-2020 quhet viti i marrëveshjes IPA II dhe jo viti i zbatimit të projekteve) i cili është instrumenti kryesor financiar i ofruar nga BE për të mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e reformave me qëllim anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Objektivat kryesorë në kuadër të këtyrë bashkëpunimeve janë si më poshtë:

- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve respektive dhe shkembimi i eksperiencave në aktivitetet e zbatuara në fushën e turizmit dhe mjedisit;
- Rritja e kapacitetit të administratës publike në lidhje me menaxhimin e burimeve të tokës dhe ujit, mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e kornizës ligjore përkatëse, ku gjithçka do të jetë e arritshme për të gjithë dhe duke mos shkaktuar shkatërrim të tregut.
- Menaxhimi të qëndrueshëm i burimeve ujore në zonën nderkufitare të zbatimit të projektit dhe rritja e efikasitetit në kuadër të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU) nëpërmjet aplikimit të metodikave të avancuara të monitorimit të ujërave, duke përdorur imazhet satelitore në kontekst ndërkufitar për të dy shtetet Greqi dhe Shqipëri.
- Ruajtja e burimeve kulturore dhe natyrore si kusht për zhvillimin e turizmit në zonën ndërkufitare, me qëllim promovimin e turizmit të burimeve termale në kontekst ndërkufitar.
- Të kontribuojë në ruajtjen e biodiversitetit dhe të ekosistemeve natyrore në Zonat e Mbrojtura Detare, duke formuluar dhe zbatuar një qasje të harmonizuar ndaj mbetjeve detare,
- Të kontribuojë në përmirësimin i biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore, përmes forcimit të menaxhimit dhe rritjes së zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare;

- Promovimin e turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm si dhe përmirësimi i drejtpërdrejtë i dukshmërisë së zonës së zbatimit të programit përmes platformës së përbashkët interaktive të internetit, ndikimin e promovimit të produkteve dhe shërbimeve vendase, si dhe promovimin e aseteve kulturore dhe natyrore.

Projektet e Qeverisë Gjermane, BMZ / GIZ (Zyra e Bashkëpunimit Gjerman)

Qeveria Gjermane ka qënë një nga kontribuesit më të mëdhenj të shtetit Shqiptar dhe finacimi i shtetit Gjerman është në formën e grantit dhe pala Shqiptare angazhohet të paguajë të gjitha detyrimet që lindin nga TVSH-ja dhe doganat. Këto projekte nënshkruhen në formën e marrëveshjeve qeveritare dhe zbatues i tyre është zyra e bashkëpunimit Gjerman GIZ (Ministria është përfituese).

UNDP ka zbatuar disa projekte si:

- ✓ Komunikimi i Katërt Kombëtar i Shqipërisë në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Raporti i saj i Parë Dyvjeçar i Përditësuar
- ✓ Krijimi i sistemit të menaxhimit dhe monitorimit mjedisor në linjë me raportimet globale Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare

Projektet e Qeverisë Suedeze të cilat janë në formën e grantit, SANE 27, dhe Projekti i Kimikateve.

PËRMBLEDHJE

AJRI URBAN

Bazuar në të dhënat të cilësisë së ajrit urban për vitin 2023, vlerësohet se cilësia e ajrit në qytetet e monitoruara nuk është e një niveli shumë të mirë.

Ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë pluhurat me diameter 10 mikrometer dhe 2.5 mikrometër PM10 dhe PM2.5, sidomos në stacionin e Korçës në periudhën e dimrit dhe në stacionin Tirana Higjena. Burimi kryesor i ndotjes nga PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Korçës është përdorimi i druve të zjarrit për ngrohje gjatë periudhës së dimrit dhe shkarkimet e automjeteve.

Për NO₂, gjatë vitit 2023 nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore në asnjë nga stacionet e monitoruara. Në stacionin Tirana ASHR vlera e monitoruar është shumë afër normës vjetore të NO₂, në këtë stacion kemi tejkalim në muajt Janar, Gusht, Shtator- Dhjetor. Burimi i ndotjes nga NO₂ është përpunimi i lëndës djegëse në proceset industriale dhe nga transporti rrugor.

Nivelet më të larta të ozonit janë monitoruar në stacionin e Fierit, vlera më e lartë është 283.77 µg/m³ më datën 20.09.2023. Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosfere, ai formohet si rezultat i zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosfere si NO_x, CO, NMVOCs dhe CH₄ në prani dhe të rrezatimit diellor. Kjo është arsyeja që në vendin tonë gjatë periudhës së verës ku rrezatimi diellorë është shumë i lartë kemi një rritje të ozonit në qytetet e monitoruara. Përsa i përket SO₂, CO dhe Benzenit nuk kemi tejkalim të normës në asnjë nga qytetet e monitoruara.

NDRYSHIMET KIMATIKE

Në kuadër të Komunikimeve Kombëtare (KK) për Ndryshimet Klimatike është realizuar Inventari Kombëtar i GES-ve përfshin vitet 2009-2019 në përputhje me Udhëzimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK) të vitit 2006. Inventari përmban vlerësime të GES-ve nga sektori i energjisë, proceset industriale dhe përdorimi i produkteve (PIPP), bujqësia, përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (PTNPTP) dhe i mbetjeve.

● Sektori i Energjisë

Në vitin 2019, sektori i transportit përbën konsumin më të madh final të energjisë me 40.22%, i pasuar nga sektori familjar me 25.02% dhe ai i industrisë me 19.02%. Burimet kryesore të emëtimit të GHG vijnë nga proceset industriale që transformojnë materialet fizikisht ose kimikisht (për shembull, furnalatat në industrinë e hekurit dhe çelikut dhe në industrinë e çimentos).

● Sektori i Bujqësisë

Emëtimit e GHG janë rritur me 4.7%, nga 2236,31 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 2341,53 kt CO₂ eq. në vitin 2019.

● Sektori i Blegtorisë

Në këtë sektor, gjedhët janë emetuesit kryesorë të GES-ve, që përbëjnë rreth 74% të totalit në kategorinë e bagëtive. Kategoritë e tjera të bagëtive që kontribuojnë ndjeshëm janë delet me 15% dhe dhitë me 73%. Emëtimit e GES-ve nga blegtoria varen në masë të madhe nga numri, struktura dhe përbërja e llojit të kafshëve. Një tjetër faktor i rëndësishëm është menaxhimi i plehut.

● Sektori i PTNPTP

Pyjet janë përthithës të GES-ve për shkak të rritjes së biomasës së tyre. Rritja vjetore mesatare është vetëm 1,4 m³ /ha/vit. Gjatë periudhës së inventarit, pyjet kanë përthithur CO₂ nga atmosfera, kjo gjë rezulton në kufizimin e sasisë së CO₂ që akumulohet. Nga ana tjetër, për shkak të zjarreve dhe prerjes së pyjeve, ata mund të kthehen në emetues të GES-ve. Pyjet më cilësore në Shqipëri janë pyjet e larta, të cilat mbulojnë rreth 36% të sipërfaqes së fondit pyjor dhe 83% të vëllimit të stokut.

● Sektori i mbetjeve

Gjatë periudhës llogaritjes emetimet janë rritur me 42%, nga 620,90 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 881,56 kt CO₂ eq. në vitin 2019. Emetimet e GES-ve nga sektori i mbetjeve përfshijnë asgjësimin i mbetjeve të ngurta, trajtimin biologjik të mbetjeve të ngurta, incinerimi dhe djegia e mbetjeve në ambiente të hapura dhe trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të përdorura.

MJEDISI BREGDETAR

● Cilësia e ujrave të bregdetit

Sipas rezultateve mikrobiologjike të monitoruara ,vlerësohen të cilësisë shumë të mirë plazhet e Zvërnecit, Palasës, Drimadhes, Jalës, Livadhës dhe Lukovës. Gjatë sezonit veror të vitit 2023 u konstatua prani e lartë e pushuesve gjatë gjithë sezonit ,në të gjithë bregdetin e Shqipërisë. Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të këtyre ujërave.

Përsa i përket parametrave kimik (oksigjen i tretur, amonjak, nitrite dhe ortofosfate) vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithë stacionet e monitoruara. Referuar rezultateve të ndikimit të shkarkimeve të lëngëta urbane në zonat bregdetare, vlerësohet se ndikimi më i lartë paraqitet në stacionin Hidrovori Vlorë – Pylli i Sodës duke vijuar me stacionin në Porto Romano dhe Currilat. Ujërat e lagunës së Butrintit vlerësohen me cilësi eutrofike për përmbajtjen e lartë organike.

Gjatë sezonit turistik 2023 sipërfaqja totale e plazheve të shfrytëzuara është **4,971,346 m²**, duke treguar një rritje krahasuar me vitin 2022 ku sipërfaqja totale rezulton **4,531,889 m²** dhe në vitin 2021 me një sipërfaqe totale **4,579,706 m²**.

● Lagunat bregdetare

Lagunat të cilat kanë komunikim me detin janë habitate me kripshmëri të lartë dhe si të tilla shfaqin luhatje të vlerave të pH në kohë dhe hapësirë.

-Në lagunën e butrintit vlera mesatare e transparencës së matur është 1.6 m dhe referuar këij treguesi vlerësojmë se cilësia është mezotrofike. Nevoja kimike për oksigjen është vlerësuar në vlerë mesatare 24 mg O/l dhe e klasifikon lagunën me cilësi eutrofike. Gjithashtu edhe vlerat e nevojës biokimike për oksigjen e klasifikojnë lagunën e Butrintit me cilësi eutrofike. Përmbajtja e nitrateve rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike pasi vlera mesatare e dy stacioneve të monitoruara është 0.377 mg/l dhe vlera e fosforit total është 0.012 mg/l ku i klasifikojnë këto ujëra me cilësi mezotrofike.

Si përfundim *vlërësojmë se ujërat e lagunës së Butrintit vlerësohen me cilësi eutrofike, e vlerësuar kjo për përmbajtjen e lartë organike. Bazuar mbi përmbajtjen e Cd dhe Pb, ujërat e lagunës klasifikohen me cilësi të dobët.*

-Për lagunen e Karavastasë dhe Nartës, rezultatet tregojnë se **As dhe Hg nuk janë të pranishëm**. Problematika shfaqet me përmbajtjen e **Cd dhe Pb** duke i klasifikuar ujërat e tyre me **cilësi të dobët**. Tendenca e përqëndrimit të lartë të metaleve Cd dhe Pb është e njëjtë për tre sezonet Pranverë, Verë dhe Vjeshtë.

Ekspozimi i njerëzve ndaj riskut mjedisor (përmbajtja e lartë e Cd dhe Pb) mund të ndodhë vetëm nëpërmjet konsumimit të produktit të këtyre lagunave.

● **Dinamika bregore për bregdetin shqiptar**

Gjëndja aktuale e sipërfaqeve të eroduara dhe të akumuluar në bregdetet e deteve Jon dhe Adriatik është si vijon:

-Në detin Adriatik zonat me problematikën më të lartë është ai i Gjirit të Drinit, (Grykderdhja e Drinit - Grykëderdhja e Matit zona Kune - Shëngjin, segmentin Rrjoll – Shëngjin në afërsi të Shëngjinit) ku bilanci është negativ. Gjithashtu me bilanc negativ për bregdetin e Adriatikut rezulton rajoni i gjirit të Lalzit, segmenti Darëzezë –grykëderdhja e Vjosës. Rajonet e tjera paraqiten me bilanc pozitiv.

Plazhet e detit Jon kanë shfaqur një bilanc negativ në rajonin verior nga Palasa deri në Kakome, ndërsa për pjesën në jug të Kakomesë i vetmi segment me bilanc negativ është ai i Plazhit të Kakomesë. Pjesa tjetër e plazheve të bregdetit të Jonit janë në gjëndje akumuluese ose në stabilitet.

● **Sipërfaqet e shfrytëzuara të plazheve**

Kemi një tendencë në rritje të hapësirave të plazheve të shfrytëzuara (private dhe publike) gjatë sezonit turistik 2023 krahasuar me vitet e mëparshme. Kemi rritje të sipërfaqeve të shfrytëzuara në të gjitha bashkitë duke përfshiruar Vlorën e cila ka tendencë në ulje të hapësirave të shfrytëzuara. Përsa i përket hapësirave të menaxhuara vihet re tendencë në rritje për bashkitë Shkodër, Durrës, Kavajë, Pogradec, Himarë dhe Sarandë, ndërsa për bashkitë Lezhë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier dhe Vlorë shihet tendencë në ulje gjatë vitit 2023.

UJRAT

● **Cilësia e ujërave të lumenjve**

Monitorimi është kryer në 38 stacione në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë.

Temperaturat e ujërave variojnë në varësi të stinës dhe pozicionimit të stacioneve të kampionimit, ku në rrjedhat e sipërme ujërat e lumenjve karakterizohen nga temperatura më të ulëta, pasi janë ujëra që burojnë nga zonat malore. Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline.

Ujërat të Basenit të Drinit vlerësohen në Klasën IV – Gjëndje e varfër duke nënvizuar se ndotja është vlerësuar në stacionin Drini Lezhë, pasi të gjithë stacionet e tjera janë me parametra brënda normës. Ujërat e Basenit të Matit klasifikohen në Klasën II – Gjëndje e mirë.

Ujërat e Basenit Ishëm – Erzen klasifikohen në Klasën V – Gjëndje e keqe. Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Shkumbinit klasifikohen në Klasën e III – Gjëndje e moderuar, stacionet e Basenit të Vjosës klasifikohen në Klasën II –

Gjëndje e mirë, Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën IV- Gjëndje e varfër me një ndotje të konstatuar në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është i lartë.

Referuar radioktivitetit alfa dhe beta për lumenjtë Drin, Mat, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë, vlerësohet se janë nën vlerat e përcaktuara në standartet ndërkombëtare (KE) dhe kombëtare për ujë dhe pijshëm.

● Cilësia e ujërave të liqeneve

Referuar të gjithë parametrevë të monitoruar, vlerësojmë se ujërat e liqenit të Shkodrës, Ohrit dhe Prespës së Madhe, janë me cilësi mezotrofike. Ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike.

Referuar përmbajtjes së metaleve As, Hg, cilësia e ujit të liqeneve Pogradec, Prespë dhe Shkodër Cu, konsiderohet e mirë (A1). Megjithatë, janë gjetur gjurmë të Cd dhe Pb në disa pika monitorimi mbi vlerat e rekomanduara nga DKU. Gjurmë të tilla janë gjetur në përroit e Vërdovës i cili derdhet në Liqenin e Pogradecit, në Prespë dhe Liqenin e Shkodrës.

● Tributarët

Lumi i Pogradecit vlerësohet në Klasën II- Gjëndje e mirë. Lumi i Vërdovës klasifikohet në Klasën III- Gjëndje e moderuar, referuar përmbajtjes së amonjakut dhe fosforit, të cilat dëshmojnë se shkarkimet urbane derdhen direkt pa asnjë trajtim paraprak. Por duhet theksuar se kemi përmirësim krahasuar me 2022 ku ky lumë ishte i një cilësi të varfër. Lumi i Tushemishtit vlerësohet në Klasën I- Gjëndje e lartë.

● Prurjet ujore

Nga rezultatet e matjeve të kryera në lumenjtë Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë, rezulton se në përgjithësi kemi patur sasi të vogla të prurjeve ujore në të gjitha stacionet ku janë kryer këto matje, referuar edhe stinëve përkatëse dhe sasisë tepër të kufizuar të reshjeve në vendin tonë. Bazuar mbi vlerat mesatare vjetore rezulton se lumi Buna ka sasinë më të madhe të prurjeve, duke vijuar me lumin Drin dhe Vjosa.

Rreziku i përmbajtjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Nga shkaqet kryesore të këtij fenomeni janë ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë.

● Ujërat nëntokësore

Në basenet e monitoruara në akuiferët porozë e karbonatikë shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të UN për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve dhe zonave të banuara, për industrinë e shpesh edhe për vaditje.

Nga monitorimi i UN të akuiferëve porozë e karbonatikë me frekuencë 2 herë në vit në muajt Korrik dhe Shtator – Tetor, rezultojnë me veti fiziko - kimike të mira.

Nga monitorimi hidrodinamik i kryer në akuiferë ka rezultuar se amplituda e këtij viti nuk ka qenë më e lartë se e viteve të mëparshme. Nivelet hidrodinamike të fazës së dytë të monitorimit vitit 2023 në përgjithësi janë më të ulta se të fazës së parë.

Ka përmbajtje të lartë mbi përmbajtjen e rekomanduar të disa treguesve të Cl, Mg, Na, SO₄ në shpimet nr.46 H. Gjuetisë, nr.177 Patok, st. Vidhas, nr. 286 Cermë, Konjat, st. Divjakë, st. Gramëz, 327 F. Krujë, nr.1v I. Terova - Korçë, Banaj, Kozare, Otlak, Lapardha 2, Kafaraj, Pishë - Poro.

Ndotje masive nuk ka. Në disa shpime në faza të ndryshme të monitorimit shfaqet prezenca e NO₂ dhe NH₄ të cilat nuk përsëriten dhe lidhen kryesisht nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare. Më problematike janë shpimet: st. nr.50 Barbullonjë, st. Shëngjinit, nr. 46 H. Gjuetisë - Lezhë, Lankas, nr.3 Konjat, st. Vidhas, nr.1D Divjakë, Pishë - Poro, Banaj, St. Çiflig, st. Kozare. Ujërat nëntokësore në akuiferin e Lezhës të shtresave të sipërme janë shumë të butë. Analizat e kryera për mikroelemente në akuiferët ujëmbajtës rezultojnë me përmbajtje të disa metaleve të rënda Ni, Mn, Zn, Pb, Cu, Co, Cr të cilët kanë vlera të ulëta, nën sasinë e rekomanduar. Tendenca për treguesit e ndotjes së ujërave nëntokësore me Amonjak, Nitrite, Nitrate nuk është në rritje dhe nën përmbajtjen maksimale të lejuar.

Zona me përmbajtje të lartë të Natriumit dhe Klorit dhe me tendence rritje janë Kafaraj, Pishë – Poro dhe Konjat.

Stacioni Pishë - Poro ka ujë më cilësi jo të mirë, përmbajtja e NO₂, NO₃, NH₄, Cl, Na dhe Mg mbetjes së thatë dhe mineralizimi i përgjithshëm janë mbi normat e ujit të pijshëm sipas standartit shqiptar në fuqi dhe BE.

ZHURMAT URBANE

Bazuar në të dhënat e zhurmave ditën, të monitoruara në qytetet kryesore të vendit tonë , rezulton se kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në qytetin Tiranës ku kemi tejkalim të normës në masën 17.9 %,Shkodër 15.01%, Vlorës 14.18%.

Nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Kemi tejkalimin të normës natën (që është 45 dB) në të gjitha qytetet. Niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Vlorës ku kemi tejkalim të normës me 21.75 %, Tiranës me 21.15 % dhe Shkodrës me 18.57 % ndërsa nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Korçës.

Ndikimin kryesor në rritjen e nivelit të zhurmave në qytetet e monitoruara e kanë fluksi i madh i automjeteve, gjëndja motorike e automjeteve në qarkullim dhe mosha e vjetër e tyre, boritë e automjeteve ku drejtuesit e të cilëve u bien pa kriter. Gjatë natës, zhurma mjedisore duke filluar nga nivelet LAeq në 45 dB mund të shkaktojë prishje të gjumit dhe shqetësim në sistemin kardiovaskular që bëhen të dukshme mbi 55 dB.

TOKAT

Degradimi i tokave bujqësore

Degradimi i tokës bujqësore është një problem serioz, i cili shoqërohet me zvogëlimin ose humbjen totale të produktivitetit fizik, kimik, biologjik dhe ekonomik të saj.

Çështjet që trajtohen në këtë raport janë evidentimi i sipërfaqes dhe shkalla e degradimit të tokave bujqësore për tokat me kripëzim të lartë në Dërmenas dhe Libofshë qarku Fier dhe tokat e moçalizuara në Orikum Vlorë dhe Sheqeras, Qarku Korçë.

Sheqerasi përbën një tokë kryesisht moçalore, tokat në këtë njësi paraqiten me një strukturë shumë të mirë, me një aftësi të lartë prodhuese dhe me kapacitet të mirë ujëmbajtës. Elementët bazë prodhues janë në raporte të kënaqëshme. Pehashi ujqor është në normalitet të plotë duke mos krijuar asnjë problematikë stresuese për rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Në parcelat e tokës kemi prezant fenomenin e djegies dhe konduktivitetit është i lartë si rezultat i akumulimit dhe lidhjes së gazrave gjatë procesit të djegies. Prania e torfës dhe lëndës organike paraqitet në tregues shumë të mirë e shoqëruar edhe me përbërjen mekanike të lehtë, krijon kushte specifike për rritjen dhe zhvillimin e kulturave zhardhokore si panxhar, patate dhe qepë.

Në njësinë administrative të Orikumit, përgjithësisht tokat paraqiten me tregues stabël dhe me ambient të mirë për rritjen dhe zhvillimin normal të bimëve të arave dhe kulturave drufrutorë. I vetmi problem, por jo në raport të rënduar dhe frenues për zhvillim normal, paraqitet pH me vlera 8.1 deri 8.4. Treguesit granulometrik paraqiten në raporte shumë normale duke krijuar një mjedis shumë normal, me aftësi të mira dhe shumë të mira për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Prania e torfës dhe lëndës organike e cila paraqitet në tregues shumë të mirë, shoqëruar edhe me përbërjen mekanike të lehtë, krijon kushte specifike për rritjen dhe zhvillimin e kulturave zhardhokor. Faktori pengues për kultivimin e tyre është prania e madhe e ujit, duke u kthyer në një moçal, duke penguar në këtë mënyrë plugimin dhe zhvillimin normal të bimëve.

Në njësinë administrative Dërmenas dhe Libofshë ,përsa i përket pH, tokat klasifikohen në masën 45.5% mesatarisht alkaline, 38.7% fuqimisht alkaline, 6.0% pak alkaline dhe 3.6% shumë fuqimisht alkaline. Nivelet më të larta të konduktivitetit elektrik janë regjistruar në tokat e Dërmenasit të rrethit të Fierit, ku vlerat luhaten në kufij 0.164-15.7 dS/m në periudhën e thatë të vitit. Ndërsa vlerat më të ulta të konduktivitetit elektrik janë regjistruar në tokat e Libofshës.

Nga të dhënat e analizave kimike rezulton se pjesët më të ulta më depresione të fushës paraqiten me kripëzim më të lartë se ato me sipërfaqe të sheshtë. Kjo dukuri duket së është rezultat i akumulimit dhe avullimit të mëvonshëm të ujit të kripur gjatë sezonit të nxehtë dhe të thatë të vitit, por edhe nga ujrat e ardhura nga pjesët e sipërme të fushës. Gjithashtu të dhënat e konduktivitetit elektrik treguan së në rritjen e kripëzimit ndikon shumë *tipi i tokës*.

Po ashtu mund të themi se sistemi i mbjelljeve dhe punimit kanë ndikim të dukshëm pozitiv në uljen e kripëzimit dhe sodimit. Kështu mostrat e tokës përfaqësuese të ngastrave të mbjellë me kultura bujqësore, vlerat e konduktivitetit elektrik rezultuan më të ulta se ato të lëna jashtë sistemit të mbjelljeve apo ato të lëna djerr dhe të abandonuara. Degradimi dhe shkretëzimi i këtyre tokave mund të parandalohet duke aplikuar një sistem mbjelljesh me bimë tolerante dhe përmiresues kimik dhe biologjik.

BIODIVERSITETI

Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimëruës në Shqipëri për vitin 2023 mbuloi 34 ligatina (lumenj, liqene, rezervuare, ekosisteme bregdetare etj) në të gjithë Shqipërinë. Në total u regjistruan 66 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 114293. Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*).

Në RNM “Liqeni_Shkodrës” është evidentuar numri më i madh i shpendëve me 32089 individë, më pas vjen PK “Divjakë – Karavasta”, me 25757 individë.

Në ndjekjen përmanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim janë gjithsej 40 specie. Nga këto specie, 13 janë gjitarë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e gjitarëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujqorë e jo

ujorë. Nga këto 40 specie, 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat, konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim. Referuar të dhënave të numrit total të individëve kemi tendencë në ulje të numrit total të individëve krahasuar me vitet e mëparshme.

• Zona e mbrojtura mjedisore

I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshinë aktualisht rreth 21.4% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së, në gjashtë kategori: Park Kombëtar me sipërfaqe **313923,77 Ha**, Monumente Natyre me sipërfaqe **1550,00 Ha**, Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror me sipërfaqe **216024,68 Ha** dhe Peizazh i Mbrojtur me sipërfaqe **81922,68 Ha**, në total zënë një sipërfaqe prej **613456.63 Ha**. Në total janë gjithsej **724** monumente natyrorë në vendin tonë.

Vërehet tendencë në rritje e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në vitin 2023 krahasuar me vitet e mëparshme.

PYJET

• Shtrirja e fondit pyjor kombëtar

Bazuar në të dhënat kadastrale të vitit 2023 pyjet në Shqipëri shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 ha, që përfaqëson 67 % të fondit pyjor dhe kulllosor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 449.175 ha ose 26 % të fondit pyjor dhe kulllosor. Sipërfaqet më bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 121.351 ha ose 7,0 % të këtij fondi.

Fondi pyjor klasifikohet sipas formës së qeverisjes dhe tipit të pyllit. Pyjet e vendit mbulojnë një sipërfaqe prej 1,146,725 ha dhe llogaritet të ketë një volum në këmbë prej 54 milion m³. Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë dhe kjo është e lidhur ngushtësisht me pozicionin gjeografik dhe ekologjik të vendit. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor.

Analizimi i klasave të moshës ndarë sipas formës së qeverisjes është shumë e rëndësishme për tu analizuar mbasi ky tregues ka të bëjë me shpërndarjen diametrike të drurëve në pyje sipas formës menaxhuese, dy elemente që shërbejnë për përcaktimin e disponueshmerisë së pyllit për lëndë druri aq më tepër si rregullatore për normalizimin e ciklit të prodhimit të grumbujve pyjorë.

- **Shpërndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit për klasat e moshës**

Nga sipërfaqia totale rreth 402 mijë ha janë trungishte, 67% e trungishteve janë pyje të rinj (më pak se 81 vjeçarë) dhe vetëm 34% janë pyje të pjekur/të arrirë (më të vjetër se të 80 vjeçarë). Nga pyjet e pjekur vetëm 17% janë mbi 100 vjeçarë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë druri është vetëm në 34% të pyjeve me regjim trungishteje. Nga sipërfaqia totale e rreth 471,000 ha pyje cungishte, 96% janë më të reja se 40 vjeç dhe vetëm 4% e tyre janë pyje cungishte të pjekur/të arrirë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë është vetëm në 4% të pyjeve me regjim cungishteje, shifër kjo tejet e ulët. Nga sipërfaqia totale e rreth 273.300 ha shkurre, 88% janë më të reja se 20 vjeç dhe vetëm 12% janë më të pjekura/të arrira.

Rritja vjetore totale e pyjeve në shkallë kombëtare nga llogaritjet rezultoi 1,36 milion metër kub në vit. Nëse bëjmë një bilanc midis rritjes vjetore të pyjeve (1,36 milion m³) dhe sasisë vjetore prej 2.48 milion m³ /vit të materialit drusor që nevojitet për dru zjarri, në shkallë kombëtare është 1.82 herë më të mëdha sesa rritja vjetore e pyjeve e llogaritur nga IKPK 2021. Në mënyrë që të kemi një akumulim të volumit në këmbë të materialit drusor, duhet që çdo vit të vilet një sasi materiali drusor e cila të jetë më e vogël se rritja vjetore në volum psh: 80-85% e kësaj rritje.

- **Fondi kulloror dhe Sipërfaqet pyjore e kullorore të djegur nga zjarret**

Rreth 90% e sipërfaqes kullorore është në pronësi publike dhe vetëm 10% është në pronësi private. Kullorat, zënë një sipërfaqe totale që është rreth 449,175 ha, e shpërndarë në format e përdorimit si kullota verore dhe kullota dimërore. Kullorat verore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash nëse ato përdoren në një mënyrë të qëndrueshme kur bëhet shtegëtimi i bagëtive në këto kullota gjatë verës, siç është bërë tadicionalisht vite më parë.

Nga të dhënat e raportuara nga 61 bashkitë rezultojnë se numuri i rasteve të zjarreve në pyje e kullota gjatë vitit 2023 është 150 me një sipërfaqe të përkrahur 1563 ha dhe sipërfaqe të djegur plotësisht 307 ha.

Matëriali drusor i djegur plotësisht raportohet në volum prej 2722 m³, ndërsa matëriali drusor i djegur por i përdorshëm raportohet nga bashkitë në volumin prej 5938 m³.

- **Pyjet si sekuestrues të karbonit**

Pyjet trungishte japin kontributin kryesor në stokimin e C me 78% e ndjekur nga cungishtet që stokojnë rreth 14% të sasisë së C dhe vetëm 8% e C stokohet nga shkurret. Pyjet trungishte fletorë kontribuojnë me 51% (10 milion ton) në stokimin e karbonit, kurse pyjet trungishte halorë stokojnë 27% të C (5.4 milion ton).

- **Gjendja shëndetësore e pyjeve**

-Rënia e halave-gjetheve

Gjithmonë gjethet dhe halat e drurëve pyjor reagojnë ndaj kushteve klimatike dhe ekstremet e motit, ata reagojnë gjithashtu edhe nga shkalla e ekspozimit të drurëve pyjor ndaj nivelit të prekjës prej sëmundjeve kërpudhore dhe dëmtimeve nga insektet. Vëzhgimet e kryera ndaj fenomenit të rënies së halave për llojet e halorve dhe rënia e gjetheve për llojet fletorë, tregojnë se ka rritje në përqindje gjatë këtij viti, e cila ndikon në gjëndjen e kurorave të drurëve. Gjithashtu kjo ndikohet nga thatësira, mungesa e lagështirës ajrore dhe ujit, të cilat kanë shkaktuar rënien e halave e gjetheve.

-Demtuesit dhe sëmundjeve kërpudhore

Dëmtimet e insekteve dhe sëmundjeve kërpudhore, në kombinim me rritjen e vulnerabilitetit të shkaktuar nga ngarkesat e depozitimit, kushtet e motit, dhe faktorë të tjerë antropogjenë, të cilat janë të lidhura ngushtë me këto trende. Si rrjedhojë e këtyre ndikimeve kemi një përkeqësim në llojin bush si pasojë e shkallës së lartë të prekjes nga dëmtuesit dhe sëmundjet, kemi një tharje masive si lloj në të gjithë arealin e përhapjes së tij, një fenomen i veçantë këtë vit ishte edhe prekja e llojit gështënjë nga dëmtuesi i grerëzës Aziatike e cila preku të gjitha grumbujt me llojin gështënjë në të gjithë territorin.

- **Speciet drunore**

Në specie përfshihen, masivet e grumbujve pyjorë me llojet e pishës së zezë, pishave mesdhetare hartinës, hormoqit, arnenit, bredhit të bardhë, rrobullit, ahut, dushkqeve, gështenjes si dhe fletorëve të tjerë. Gjithashtu shfaqet dhe fenomeni i tharjes së llojeve bush dhe rrap. Fenomeni i çfaqjes së dëmtuesit të procesionares së pishës është me një shkallë të lartë prekjeje. Nga monitorimi i kryer në terren rezulton se shkaktarët për kërcënimin për zhdukje për llojet emësipërme janë të ndryshëm dhe kryesisht si pasojë e ndryshimeve të treguesve klimatike apo prishjes së habitatit të tyre. Kërcënim i vjen edhe si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të ndodhura në vitet e mëparshme apo zjarreve të shfaqura në arealin e vendndodhjes së tyre.

- **Bimët aromatike dhe mjekësore**

Mbështetur në dokumentacionin e inventareve të bimëve aromatike dhe mjeksore rezulton se në shkallë vëndi rriten 252 lloje bimësh mjeksore dhe aromatike ku vetëm drunore janë 66 lloje. Sipërfaqja ku shtrihen këto bimë është 591908 ha dhe drunoret zënë 342049.2 ha, në total **933957**. Speciet aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje janë sherebele, boronice, çaji mali, xhrokull dhe salep. Gjëndja vegetative dhe fitosanitare e sherbelës në sipërfaqen monitoruese të qafë Muzinës dhe Leskovik, zona e Terpanit paraqitet më e mirë se ajo e viteve të kaluara. Në Llogara, Krastë të Martaneshit dhe Fushë-Arrëz paraqitet shumë e mirë. Në Berat, Kallmet të Lezhës gjëndja fitosanitare e sherebeles paraqitet disi e demtuar. Gjëndja e kulturës së sherbelës në zonën Mali i Miçanit po shkon drejt degradimit si rezultat i grumbullimit të saj. Gjëndja vegetative dhe fitosanitare e çajit të malit në zonën e Pustecit, Dropullit, dhe Kolonjës paraqitet e mirë. Gjëndja vegetative dhe fitosanitare e salepit në zonën e Pustecit, Kepi i Rodonit dhe Libohovë paraqitet e mirë. Përsa i takon gjëndjes vegetative të xhrokullit në zonën Ballaban të Përmetit, themi që kanë një gjëndje të mirë vegetative dhe se ka një rritje të lehtë të numrit të bimëve. Gjëndja Vegetative dhe fitosanitare e boronices në Tropojë, Bulqizë dhe Pogradec është e mirë si pasojë e ndërhyrjes së ulët të faktorit human dhe klimës së përshtatshme.

MENAXHIMI I MBETJEVE

Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe kalimi në Ekonomi Rrethore mbeten një përparësi engutshme për Shqipërinë. Duke përdorur njohuritë e fituara nga Raporti Vjetor i Mbetjeve përvitin 2023, palët e interesuara në të gjitha nivelet mund të punojnë së bashku për të zhvilluar zgjidhje inovative në reduktimin e mbetjeve, dhe për të promovuar riciklimin dhe eficiencën e burimeve, dhe për të mbrojtur mjedisin për brezat e ardhshëm.

Tirana është bashkia me gjenerimin më të lartë të mbetjeve, duke arritur 244,787 ton, shumë më tepër se bashkia e dytë, Durrësi, me 55,306 ton. Kjo tregon një përqendrim të lartë të gjenerimit të mbetjeve në kryeqytet. Bashki të tjera si Fieri, Vlora dhe Shkodra gjithashtu kanë nivele të

konsiderueshme të gjenerimit të mbetjeve, por janë shumë më të ulëta në krahasim me Tiranën. Kjo tregon se zonat urbane më të mëdha kanë nivele më të larta të mbetjeve për shkak të dendësisë së popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike.

Përsa i përket shkallës së mbledhjes së mbetjeve për person në ditë (kg/person/ditë), vlerësohet se Vora është bashkia me mbledhjen më të lartë për frymë, me 1.17 kg/person/ditë, ndjekur nga Fieri 0.94 kg/person/ditë dhe Tirana me 0.93 kg/person/ditë. Bashki të tjera si Himara dhe Saranda gjithashtu tregojnë shkallë relativisht të larta të mbledhjes për frymë. Nga ana tjetër, bashki si Maliqi, Tropoja dhe Kamza kanë shkallët më të ulëta të mbledhjes, me vlera rreth 0.51 kg/person/ditë.

Gjatë vitit 2023 janë krijuar dhe transferuar rreth 72,230 ton mbetje në total (mbetje të rrezikshme e të parrezikshme. Kjo sasi mbetjesh e transferuar në vitin 2023 është më e ulët krahasuar me vitin 2022 ku janë transferuar rreth 237,000 ton.

Sasia më e madhe e gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve për vitin 2023 rezulton në qarkun Tiranë me 2634518 kg/vit ndërsa sasia më e ulët është në qarkun Kukës 600 kg/vit.

Vlerësohet se kemi tendencë në rritje nga viti në vit të gjenerimit të mbetjeve nga produktet e kafshëve për të gjitha qarqet për periudhën 2021-2023.

KIMIKATET

● Inventari i PCB

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) ka në përdorim aktualisht 17 transformator, me një peshë totale vaji prej 442.4 ton., asnjë prej këtyre transformatorëve nuk është prodhuar para vitit 1990 dhe të gjithë janë të mbushur me vaj pa PCB.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) administron gjithsej 58 transformatorë dhe kondensatorë, me një peshë të kombinuar vaji prej 2,134 ton. Rezultatet e ekzaminimit në vend tregojnë se nga 25 transformatorë të testuar, 9 ishin të kontaminuar, duke përbërë 36% të mostrave të ekzaminuara. Pesha totale e vajt të kontaminuar, me përqendrimet PCB mbi 50 mg/kg vlerësohet në rreth 450 ton dhe sasia e pritur e PCB-ve në vajin e kontaminuar mund të arrijë afërsisht 446.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) mbikëqyr gjithsej 13,967 transformatorë me një peshë totale vaji prej 6,233.1 ton kg. Rezultatet e ekzaminimit në vend zbulojnë kontaminim në 130 nga 247 transformatorët e testuar, që përbën rreth 53%. Pesha totalee vajt të kontaminuar, me përqendrimet PCB mbi 50 mg/kg, vlerësohet në afërsisht 3,060 ton. Për më tepër, sasia e vlerësuar e PCB-ve në vajin e kontaminuar është afërsisht 750 kg. Pesha totale e vajt të kontaminuar si për OST-në ashtu edhe për OSHEE vlerësohet rreth 3,510 ton dhe sasia e vlerësuar e PCB-ve në vajin e kontaminuar është afërsisht 1196 kg.

PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE

• Përdorimi i burimeve natyrore

Në vitin 2022, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, vlerësohet rreth 20,2 milionë tonë, duke shënuar një rritje prej 5,6 %, krahasuar me vitin 2021. Struktura e burimeve të brendshmenatyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 50 %, “biomasa” 35 %, “mineraletmetalike” 10 % dhe “materiale të energjisë fosile” 5 % të materialeve gjithsej. Përdorimi i burimeve nga banorët për vitin 2022 rezulton 7.7 ton/banor.

• Përdorimi i ujrave

Përdorimet kryesore të ujit janë klasifikuar në: Uji për njerëzit që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve, Uji për ushqimin që përfshin bujqësinë, Uji për industrinë që përfshin hidroenergjetikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe zbatimet (turizmi) dhe Uji për mjedisin që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat, pyjet.

Përdorimi i burimeve ujore në nivel baseni, ka përdorim të lartë të ujit në rezervuaret për ujitje në basenin Drin-Bunë, Ishëm-Erzen, Seman dhe Vjosë, përdorimi sipas industrisë në basenin Drin-Bunë dhe Seman.

Përdorim i burimit ujqor sipërfaqësor është 17,488,655,557 m³, sasia më e madhe përdoret për prodhim hidroenergjik. Përdorim i burimit ujqor nëntoksor është 133,333,534, m³ sasia më e madhe përdoret për furnizim me ujë të pijshëm (sistemim të furnizimit me ujë të popullatës). Material inerte lumore 381,653 m³.

• Përdorimi i burimeve ujore për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike

Hidrocentralet publike në vitin 2023, prodhuan 5.123 GWh ndërsa në 2022 është prodhuar 3.859 GWh, duke shënuar kështu një rritje të prodhimit me 32,8 %. Hidrocentralet private dhe koncensionare prodhuan 3.582 GWh nga 3.093 GWh krahasuar me prodhimin e një vit më parë, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 15,8 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike, në vitin 2023, arriti vlerën 8.796 GWh nga 7.003 GËh energji të prodhuar në vitin 2022, duke shënuar një rritje të prodhimit me 25,6 %.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 58,2 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 40,8 % dhe nga të tjerë prodhues (Fotovoltaikë) në masën 1,0 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Bilanci i energjisë elektrike.

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2023, arriti vlerën 6.221 GWh nga 6.266 GWh që ishte në vitin 2022, nga konsumatorët familjarë u rrit me 1,4 %, duke arritur vlerën, ndërsa përdorimi nga konsumatorët jo familjarë u ul me 2,7 % ..

• Përdorimi i tokës.

Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbjellë kategorizohet në tokë e punëshme me sipërfaqe 586.6 ha nga këto 56.2 ha në kalim organik, 530.6 ha organike dhe 1.2 ha ne sera. Për dru-frutore me sipërfaqe 146.6 gjithsej nga këto 106.9 ha në kalim organik, 39.7 ha organike dhe 0.2 ha në sera.

● **Hidrokarburet** -Treguesit kryesor të prodhimit të Hidrokarburëve në Shqipëri për vitin 2023 janë prodhim naftë 572.625.7 ton, prodhim gazi shoqërues 46,860.6 mijë Nm³, prodhim uji teknologjik (shtresor) 5,930.4 mijë m³ dhe prodhim rëre 3,323.3 m³.
Lejet aktive të shfrytëzimit mineral janë në total 530.

AKTIVITETET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

● Raportet e vetëmonitorimit

Gjatë vitit 2023 kemi një rritje të numrit të dorëzimit të raporteve të vetëmonitorimit nga Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore. Numri i operatoreve të cilët kanë raportuar për vitin 2023 është rreth 2333 nga të cilat 80 janë operator të pajisur me Leje Mjedisi Tipi A dhe 2253 operatorë të pajisur me Leje Mjedisi Tipi B.

Për Mbetjet e Industrisë Kimike në Raportet e Vetëmonitorimit janë paraqitur sasitë e shkarkuara, vendgrumbullimi i këtyre mbetjeve, riciklimi, ripërdorimi, trajtimi i mëtejshëm në vendndodhje dhe subjekti i liçensuar ku dorëzohen mbetjet. Përsa i përket shkarkimeve në ajër, pothuajse në të gjitha subjektet është bërë matja e temperaturës, lagështisë, shpejtësia e erës, PM 10 dhe presionit atmosferik për mostrat e ajrit. Në disa subjekte janë matur më shumë parametra (përfshirë CO, CH₄, O₂, SO₂, H₂S, përqëndrimi i nivelit të pluhurit në nivele të ulëta etj). Ndërsa për mostratujore pothuajse në të gjitha subjektet kemi matje të vlerave të Nevoja Kimike për Oksigjen, Nevoja Biokimike për Oksigjen, temperaturë, konduktivitet, pH dhe lëndët në pezulli. Në disa subjekte kemi më shumë parametra të matura në mostrat ujore si p.sh: Diferenca e temperaturës, rrjedhja ditore, P-organik, N-amonikal, produkte naftë, fortësia e përgjithshme, As, Cd, Zn, Cr, Pb, Cianid i lirë, Cianid total etj.

Në raportet të vetëmonitorimit të subjekteve rezulton se nuk kemi tejkalime të vlerave të matura sipas legjislationit në fuqi.

● Inspektimet në mjedis

Inspektimet në mjedis kryhen në zbatim të ligjit Nr. 10 448 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, VKM –ve respektive etj. Qëllimi i tyre është kryerja e kontrolleve për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese.

Ka nja sërë fushash inspektimi si Industria minerare dhe energjetike, Industria kimike, Gurore, Prodhim dhe përzierje e betonit, Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, Përpunimi i tekstileve ose fibrave, Veprimtaritë e lëndës së drurit, Prodhimit të letres, pulpës dhe dërrasës, Prodhimi dhe përpunimi i metaleve, Menaxhimi i mbetjeve, Blegtoria, Veprimtaritë e gomës, Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lëkurës etj.

● Inspektimet në ujëra

Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, procesi i inspektimeve në fushën e ujërave është përqëndruar në fushat e veprimtarisë, si më poshtë:

1. **Për përdorimin e burimeve ujore**
2. **Shfrytëzimi i inerteve lumore**
3. **Shkarkimet dhe monitorimi i cilësisë së ujërave.**

Për vitin 2023 inspektimi I burimeve natyrore nga inspektorët e Drejtorisë së Inspektim Kontrollit në AKM është në total 329 ndërsa masat administrative 36. Ndërsa numri i inspektimeve mjedisore është 813, masat administrative 48.

Sipas degëve rajonale të AKM , realizimi i inspektimeve në sektorin e mjedisit dhe të ujërave për vitin 2023 është në total 683 inspektime dhe 78 gjoba. Për sa i përket inspektimeve të kryera nga AKM, inspektorët kanë proceduar me sistemin online të kryerjes së inspektimeve, ku për vitin 2023 janë kryer 1,142 inspektime, nga të cilat janë vendosur 84 masa administrative (gjobë). Gjatë vitit 2023 kemi një rritje të numrit të inspektimeve si dhe të masave administrative në lidhje me burimet natyrore krahasuar me vitet e mëparshme.

● Inspektimet për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike

Nga kontrollet e kryera për qeset plastike në njësitë e paracaktuara është sekuestruar një sasi qesesh, të cilat nuk plotësojnë kriteret në përputhje me ndryshimet ligjore në fuqi. Për konstatimet e bëra nga ana e grupeve të punës, për gjetjet dhe shkeljet e kërkesave ligjore, janë marrë masa administrative si dhe janë sensibilizuar në zbatimin e saktë të legjislacionit.

Sasia e qeseve të sekuestruara për vitin 2023 është në total 480 kg nga keto:

1. Qarku Tiranë 415 kg në 7 subjekte
2. Qarku Fier 15 kg në 1 subjekt
3. Qarku Berat 50 kg në 1 subjekt

● Zhvillimi i projekteve mjedisore

Projektet me financim të huaj që ndiqen nga MTM dhe që janë zbatuar gjatë periudhës 2020-2023, janë financuar kryesisht nga donatorët Bashkimi Evropian, Qeveria Gjermane, KFW, GEF-UNEP, UNDP dhe kishin qëllim kryesor të përmbushin prioritetet e MTM në arritjen e përmbushjes së objektivave në fushën e mjedisit dhe turizmit.

Projektet e Bashkimit Evropian ose projektet IPA (Instrumentat e Para Aderimit) ndahen në disa kategori por gjatë kësaj periudhe janë përfituar dhe zbatuar projektet e bashkëpunimit ndërkuftar:

- 1- **Fondet IPA II - IPA 2014-2020**
- 2- **Projektet e Qeverisë Gjermane, BMZ / GIZ**
- 3- **UNDP**
- 4- **Projektet e Qeverisë Suedeze (SANE 27)**

ANEKS 1

Rrjetet e monitorimit të pyjeve



Rrjeti i monitorimit për shëndetin dhe vitalitetin në pyje

- Për llojin Pishë e zeze

<i>Nr.</i>	<i>Bashkia Ekp</i>	<i>Lloji drunor</i>	<i>Nr dru.</i>	<i>Mosha (vjet)</i>	<i>Sip. (m2)</i>	<i>(Y) KRGJSH</i>	<i>(X) KRGJSH</i>
1	Mat (Dushku-kuq)	P. e zeze	21	mbi 60	400	511509.1	4592872
2	Diber (Slllove)	P. e zeze	74	mbi 60	400	539128.4	4634189
3	Vlore (Llogara)	P. e zeze	11	mbi 60	400	463310.2	4455283
4	Tirane (Shkalle)	P. e zeze	29	mbi 60	400	500907.6	4571885
5	Kruj (Qaf-Shtam)	P. e zeze	11	mbi 60	400	490748.7	4598330
6	Elbasan (Zavalin)	P. e zeze	36	mbi 60	400	517218.4	4543157
7	Librazhd (Qarisht)	P. e zeze	25	mbi 60	400	534485.8	4568934
8	Tropoj (Valbon)	P. e zeze	20	mbi 60	400	489192.6	4702417
9	Gramsh (Skenderbegas)	P. e zeze	20	mbi 60	400	522024	4514200
10	Kukes (Kalis)	P. e zeze	47	mbi 60	400	530542.3	4635011
11	Skrapar (Mollaj)	P. e zeze	28	mbi 60	400	521719.7	4489861
12	Korce (Voskopoje)	P. e zeze	16	mbi 60	400	550658.1	4501529
13	Kolonje (Germenj)	P. e zeze	37	mbi 60	400	555413.4	4455363
14	Bulqize (Liqenet)	P. e zeze	24	mbi 60	400	519392	4595265
15	Fush Arrz.	P. e zeze	46	mbi 60	400	503355.9	4660400
16	Shkoder	P. e zeze	8	mbi 60	400	484571.1	4693812
17	Fush Arze	P. e zeze	21	mbi 60	400	513897.1	4667849
18	Puke	P. e zeze	14	mbi 60	400	491994.6	4656906
19	Kukes	P. e zeze	20	mbi 60	400	543769.9	4651999
20	Kukes	P. e zeze	21	mbi 60	400	532981.8	4633876
21	Elbasan	P. e zeze	18	mbi 60	400	505120.2	4563250
22	Gramsh	P. e zeze	13	mbi 60	400	521147.3	4515234
23	Skrapar	P. e zeze	14	mbi 60	400	527271.6	4504504
24	Skrapar	P. e zeze	9	mbi 60	400	528652	4498351
25	Korce	P. e zeze	23	mbi 60	400	548139.8	4489543
26	Korce	P. e zeze	12	mbi 60	400	563463.1	4488520

27	Devoll	P. e zeze	10	mbi 60	400	580481.7	4486110
28	Memaliaj	P. e zeze	13	mbi 60	400	500347	4480002
29	Kolonje	P. e zeze	23	mbi 60	400	561493.4	4467698
30	Vlore	P. e zeze	11	mbi 60	400	464334.2	4453890
31	Kolonje	P. e zeze	14	mbi 60	400	551330	4455078
32	Kolonje	P. e zeze	7	mbi 60	400	549828.7	4455569
Totali			696		12800		

- **Për llojin e pishave mesdhetare**

<i>NR</i>	<i>Bashkia</i>	<i>Lloji drunor</i>	<i>Nr. dru</i>	<i>Mosha (vjet)</i>	<i>Sip. (m2)</i>	<i>(Y) KRGJSH</i>	<i>(X) KRGJSH</i>
1	Divjak	P.ebutë,Vidh, fra	36	mbi60	400	457275.177799	4539988.195890
2	Divjak	P.eegër	16	mbi60	400	457209.561795	4539326.449190
3	Fier	P.ebutë	41	mbi60	400	448797.225058	4504853.304910
4	Fier	P.ebutë	39	mbi60	400	448625.965566	4504210.485450
5	Permet	P.eegër,P.deti	28	mbi60	400	531063.651425	4456063.173780
6	Elbasan	P.ebutë	46	mbi60	400	500897.109151	4557490.873660
7	Librazhd	P.ebutë	24	mbi60	400	522118.825266	4560423.687870
8	Shkoder	P.ebutë	24	mbi60	400	453742.630849	4636665.318700
9	Shkoder	P.deti,Plep	33	mbi60	400	450199.335271	4636949.224480
10	Lezhe	P.deti	24	mbi60	400	465736.865675	4625203.198190
11	Mirdite	P.ebutë	18	mbi60	400	482538.246868	4626101.876110
12	Tropoje	Hormoq,Ah	33	mbi60	400	496498.489533	4707450.777300
13	Kavaje	P.eegër	25	mbi60	400	459951.901143	4554445.761760
14	Rogozhin	P.ebutë	21	mbi60	400	454558.954055	4548361.935160
15	Vore	P.ebutë	28	mbi60	400	471932.953436	4586948.751440
16	Peqin	P.ebutë	28	mbi60	400	489268.020687	4547556.497150
17	Gramsh	P.ebutë	21	mbi60	400	516843.613318	4522437.890530
Totali			485		6800		

- Për llojet halorë të tjerë

Nr.	Bashkia	Lloji drunor	Nr dru.	Mosha (vjet)	Sip. (m ²)	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Gramsh	Hartinë	59	<60	400	534937.3	4516409
2	Gramsh	Robull	30	>60	400	534937.3	4516409
3	Kukes	Robull	15	>60	400	539681.2	4650884
4	Tropojë	Arne	22	>60	400	499611.9	4707052
5	Librazhd	Bredh	26	>60	400	534299.6	4567434
6	Permet	Bredh	29	>60	400	532592.7	4467892
Totali			181		2400		

- Për llojet e dushqeve dhe gështenjës

Nr.	Bashkia	Lloji drunor	Nr. dru. s.pr	Mosha (vjet)	Sip. (m ²)	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Pustec	Bunge	51	mbi 60	400	540642.2	4540655
2	Kolonje	Bun.Shpar	11	mbi 60	400	580387.8	4496494
3	Korçë	Qarr	33	mbi 60	400	502365.7	4539031
4	Tiran	Bun.Shpar	14	mbi 60	400	500046.5	4576451
5	Kukes	Bun.Shpar	35	mbi 60	400	533693.7	4656345
6	Tirane	Geshtenje	10	mbi 60	400	496689.5	4707670
7	Delvine	Geshtenje	15	mbi 60	400	538311.2	4707775
8	Tropoje	Bun.Shpar	16	mbi 60	200	504732.7	4680048
9	Fushe Arrez	Bunge	16	mbi 60	200	505071.8	4677043
10	Puke	Qarr	10	mbi 60	200	487149.7	4661840
11	Mirdite	Bunge	15	mbi 60	200	499494.8	4632488
12	Lezhe	Bunge	11	mbi 60	200	477414	4622229
13	Diber	Qarr	23	mbi 60	200	517553.8	4610490
14	Mat	Bunge	16	mbi 60	200	490774.8	4607871
15	Kurbin	Bunge	8	mbi 60	200	481857.7	4609788
16	Mat	Qarr,Shparth	22	mbi 60	200	500148.3	4602684
17	Tirane	Qarr,Bung	14	mbi 60	200	496751.1	4592649

18	Tirane	Qarr	21	mbi 60	200	499507.9	4570685
19	Skrapar	Bulger	19	mbi 60	200	527107.7	4473988
20	Kolonje	Bunge	12	mbi 60	200	543816.3	4456480
21	Vlore	Bung,Bullgr	19	mbi 60	200	462364	4451764
22	Gjirokaster	Bullgr.Bung	12	mbi 60	200	500239.8	4445514
23	Dropull	Bulger	14	mbi 60	200	529254.4	4442826
Totali			417		6000		

Rrjeti i monitorimit të specieve drunore dhe bimëve aromatiko mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

- **Llojet drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje**

Nr	Lloji pyjor	Bashkia	Ekonomia Pyjore	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Rrobull	Bulqizë	Liçeni i Zi	516496.7657	4623080.057
2	Rrobull	Dibër	Lurë	516090.6832	4627912.76
3	Rrobull	Gramsh	Sogor, Mali i Grabovës, Holtë-Lukovë	535100.6037	4517017.247
4	Arnen	Tropojë	Çerem Dragobi	499611.8609	4707052.441
5	Arnen	Dibër	Lurë	516309.878	4627554.39
6	Ilqe	Vlorë	Llogara	464131.9926	4454103.881
7	Rrenjë	Fier	Kunorë	458557.6222	4519940.772
8	Lajthi e egër	Korce	Gollumbac	576071.187	4522980.443
9	Lajthi e egër	Has	Tej drini i bardhë	537194.4106	4668550.291
10	Lajthi e egër	Libohovë	Çajup	518520.4124	4451142.054
11	Caraca e Kaukazit	Pustec	Gollomboc	579182.4828	4525635.519
12	Venja	Libohovë	Çajup	516407.8476	4454560.885
13	Venja	Libohovë	Sheper	522844.8332	4452511.038
14	Drunakuqja	Përmet	Petran – Çarshovë, Petran-Zavalan	542988.8305	4445134.282
15	Drunakuqja	Përmet	Pagri	529435.9358	4466414.069
16	Drunakuqja	Përmet	Ali Bostivan	526229.3645	4463099.066
17	Mështekën	Dibër	Kastriot-Sllovë	537167.3949	4634178.103
18	Mështekën	Kukës	Shishtavec-Zapod	551274.1543	4648829.106

19	Gështenjë Kali	Librazhd	Stravaj	532322.5404	4540520.894
20	Gështenjë Kali	Tepelenë	Kurvelesh	496543.5272	4453623.03
21	Hartina	Gramsh	Sogore-Mali I Graboves	536734.6096	4517876.063
22	Valanidhi	Himare	Borsh	489616.5495	4434008.273
23	Valanidhi	Himare	Pilur	480790.6183	4440595.133
24	Tisi	Librazhdi	Shebenik	537652.5763	4571982.432

- **Bimët aromatiko-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje**

Nr	Lloji	Bashkia	Ekonomia Pyjore	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Sherebel	Delvine	Muzine	517084.3761	4420415.059
2	Sherebel	Vlore	Llogara	465232.1555	4451295.415
3	Sherebel	Kolonje	Leskovik	552270.9011	4446946.191
4	Sherebel	Berat	Mali Partizan	495369.3802	4507370.924
5	Sherebel	Permet	Mali Miçanit	534092.6264	4475416.476
6	Sherebel	Poliçan	Terpan	502213.3475	4491420.72
7	Sherebel	Bulqize	Kraste Martanesh	515810.4544	4586628.278
8	Sherebel	Lezhe	Kallmet	473880.7686	4634419.815
9	Sherebel	Vlore	Llogara	464115.1941	4454052.247
10	Sherebel	Fush Arrze	Kryezi	504774.5955	4663318.622
11	Çaj mali	Pustec	Gollomboc	577129.9835	4514446.616
12	Salep	Pustec	Gorice	579289.6444	4525322.483
13	Çaj mali	Dropull	Dropull	515372.0295	4431858.752
14	Çaj mali	Kolonje	Gramoz	562415.317	4469393.462
15	Xhirokull	Kelcyre	Ballaban	518227.2411	4465594.738
16	Salep	Dures	Kepi Rodonit	454692.0787	4605356.962
17	Salep	Libohove	libohove	518193.5809	4447703.098
18	Boronice	Tropoje	Çerem	498701.1439	4708340.666
19	Boronice	Bulqize	Liqeni Zi	524867.9662	4591305.182
20	Boronice	Pogradec	Qaf Panje	544706.3752	4522442.293

Institucionet bashkëpunuese

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Brendshme

Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Agjencia Kombëtare e Bregdetit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Instituti i Shëndetit Publik

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore

Instituti i Gjeoshkencës

